UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS:

E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË NË PROCEDURËN PENALE NË KOSOVË

Kandidati:
Ma.Sc. Vilard BYTYQI

Mentori:
Prof. Dr. Rexhep MURATI

Mars 2018

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi.

_____

Ky punim i doktoraturës është shkruar sipas kritereve të përcaktuara të Rregullores për Studimet e Ciklit të Tretë, të miratuar më 15 korrik 2014 nga Senati i Universitetit të Evropës Juglindore.

PËRMBAJTJA:

Falënderim 10

Shkurtesat 11

Abstrakt 12

Abstract 13

HYRJE 14

1. Objekti dhe qëllimi i studimit 14

1.2. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit 16

2. Metodologjia e hulumtimit 17

3. Struktura e punimit 19

PJESA E PARË 21

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TË DREJTËN PËR GJYKIM TË DREJTË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT DHE E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË SIPAS AKTEVE DHE JURISPRUDENCËS NDËRKOMBËTARE 21

KAPITULLI I 22

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TË DREJTËN PËR GJYKIM TË DREJTË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT 22

1. Rëndësia e të drejtës për gjykim të drejtë në procedurën penale 22

2. Koncepte dhe përkufizime bazë të së drejtës për gjykim të drejtë 24

3. Origjina e të drejtës për gjykim të drejtë 30

KAPITULLI II 33

E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË SIPAS INSTRUMENTEVE NDËRKOMBËTARE 33

1. E drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve të detyrueshme ndërkombëtare 33

2.1. E Drejta për gjykim të drejtë sipas PDCP-së 34

2.2. E Drejta për gjykim të drejtë sipas KEDNJ-së 37

2.2.1. E drejta për ankesë sipas KEDNJ-së 41

2.3. E drejta për gjykim të drejtë sipas Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut 44

2.4. Konventat ndërkombëtare kundër torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese 46

2. 5. E drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve tjera të detyrueshme ndërkombëtare 49

3. E drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve jo të detyrueshme ndërkombëtare 52
3.1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut 52
3.2. Tërësia e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave në çfarëdo forme të arrestit ose burgut 54
3.3. Parimet themelore për rolin e avokatëve 57
4. Konceptualizimi i instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë në procedurën penale në Kosovë 58

KAPITULLI III 61
E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË NË JURISPRUDENCËN NDËRKOMBËTARE 61
1. E drejta për gjykim të drejtë në gjykatat ndërkombëtare 61
2. E drejta për gjykim të drejtë në TPNJ 63
2.1. Përfundimi i mandatit dhe strategjia përmbyllëse e TPNJ-së 66
3. E drejta për gjykim të drejtë pranë Gjykatës Ndërkombëtare Penale 68
3.3. Interpretimi dinamik i të drejtës për gjykim të drejtë 73

PJESA E DYTË 75
ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË 75
KAPITULLI IV 76
E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË PARA NJË GJYKATE TË PAVARUR 76
1. Vështrim i përgjithshëm mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor 76
2. Ekzistimi i mbrojtjes efektive të gjyqësorit nëpërmes pavarësisë institucionale 79
2.1. Organizimi gjyqësor për garantimin e pavarësisë sipas standardeve ndërkombëtare 79
2.2. Autonomia dhe pavarësia e KGJK-së 81
2.3. Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të KGJK-së 84
2.4. Pavarësia në vendimmarrje 87
2.5. Pavarësia administrative dhe financiare 89
3. Ekzistimi i mbrojtjes efektive të gjyqtarëve nëpërmes pavarësisë individuale 93
3.1. Roli dhe rëndësia e pavarësisë individuale të gjyqtarëve 93
3.2. Ekzistimi i mbrojtjes së gjyqtarëve nga presionet e brendshme dhe të jashtme 95
3.3. Emërimi, promovimi, pagat dhe politikat e trajnimit 98
3.4. Liria e shprehjes dhe liria e asociimit gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore 101

3.5. Imuniteti i gjyqtarëve 105
3.6. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve 109
4. Gjykata si institucion apolitik 113

KAPITULLI V 116
E DREJTA PËR TU GJYKUAR PARA GJYKATËS SË PAANSHME, TË THEMELUAR ME LIGJ, E DREJTA PËR BARAZI PARA GJYKATËS DHE MBROJTJA GJYQËSORE 116
1. Gjykata si institucion i paanshëm 116
1.1. E drejta e të pandehurit për gjykim të paanshëm 116
1.2. Kriteret për vlerësimin e paanshmërisë 118
1.3. Procedura dhe vendimi për përjashtim të gjyqtarit 121
2. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë kompetente dhe të themeluar me ligj 124
2.1. E drejta për t'u gjykuar nga një gjyqtar apo trup gjykues kompetent 125
3. E drejta për barazi para gjykatës 128
4. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut 130
4.1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës 131
4.2. E drejta për mjete efektive juridike 133

KAPITULLI VI 137
E DREJTA PËR GJYKIM PUBLIK DHE BRENDA AFATIT TË ARSYESHËM 137
1. E drejta për gjykim publik 137
1.1. Historiku dhe kuptimi i gjykimit publik 137
1.2. E drejta për gjykim publik sipas Kushtetutës së Kosovës 140
1.3. E drejta për gjykim publik sipas KPP-së 141
1.4. Prania e mediave në gjykatore 144
1.5. Shpallja e aktgjykimit dhe publikimi i tij 145
2. E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm 148
2.1. Rëndësia dhe konceptualizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm 148
2.2. Kriteret përcaktuese për gjykim në afat të arsyeshëm 150
2.3. Zhvillimi i procedurës së hetimit jo-formal dhe formal sipas afatit të arsyeshëm 153
2.4. Zhvillimi i procedurës së gjykimit dhe apelit sipas afatit të arsyeshëm 156
2.5. Lirimi në pritje të gjykimit dhe cenimi i parimit të sigurisë ligjore 158

2.6. Cenimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe adresimi i tij 160

PJESA E TRETË 164

ELEMENTET E VEÇANTA TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË 164

KAPITULLI VII 165

E DREJTA E TË PANDEHURIT PËR T'U MBROJTUR 165

1. Shqyrtime të përgjithshme 165

2. E drejta për t'u informuar për akuzën 165

3. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur 169

3.1. Rëndësia dhe funksionet e të drejtës për t'u mbrojtur 169

3.2. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur vet, pa mbrojtës 172

3.3. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur me mbrojtës 174

3.4. Përshtatshmëria e mbrojtjes dhe mbrojtja efektive 176

3.5. Mbrojtësi me shpenzime publike tek mbrojtja e detyruar dhe jo e detyruar 179

3.6. E drejta për komunikim konfidencial ndërmjet të të pandehurit dhe mbrojtësit 182

4. E drejta për t'u asistuar nga një përkthyes apo interpret 183

4.1. Rëndësia dhe funksionet e të drejtës për t'u asistuar nga një përkthyes apo interpret 183

4.2. E drejta për përkthyes kompetent dhe vëllimi i përkthimit apo interpretimit 187

5. E drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim 189

5.1. Kuptimi dhe funksionet e të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim 189

5.2. Gjykimi në mungesë të të pandehurit 191

5.3. Prania e të pandehurit në procedurën penale 194

5.4. Nxjerrja e të pandehurit nga seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe zhvillimi i procedurës penale pa praninë e tij 196

5.6. Prania e të pandehurit në seancën e kolegjit të apelit 198

KAPITULLI VIII 202

PREZUMIMI I PAFAJËSISË, *"BARAZIA E ARMËVE"* DHE E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE 202

1. E drejta për prezumim të pafajësisë 202

1.1. Kuptimi dhe funksionet e të drejtës për prezumim të pafajësisë 202

1.2. Koncepti i *"barrës së provës"* në procedurë penale 204

1.3. Rëndësia e parimit *in dubio pro reo* 207
1.4. E drejta për të heshtur dhe e drejta për t'u mos u vet-inkriminuar 209
1.4.1. Kuptimi dhe funksionet e të drejtës për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar 209
1.4.2. E drejta për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar sipas KPP-së 211
1.4.3. E drejta për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar e *"dëshmitarit bashkëpunues"* dhe urdhrat e nevojshëm për shqyrtimin e provave nga eksperti 214
1.5. Cenimi i prezumimit të pafajësisë 216
2. E drejta për *"barazi të armëve"* 218
2.1. Kuptimi dhe funksionet e *"barazisë së armëve"* dhe kontradiktoritetit 218
2.2. Konceptualizimi i *"barazisë së armëve"* në Kushtetutë dhe KPP 223
2.2.1. *"Barazia e armëve"* gjatë rrjedhës së procedurës penale 225
2.2.2. E drejta e të pandehurit për të propozuar dëshmitar, ekspertë dhe prova të tjera 229
2.2.3. Kontradiktoriteti në procedurat shqyrtuese të dëshmitarëve, ekspertëve dhe e drejta e të pandehurit për të kundërshtuar dhe komentuar provat 233
2.2.4. Shqyrtimi i *"dëshmitarëve anonimë"* dhe efektet e dëshmisë së tyre 235
3. E drejta për mjete juridike 238
3.1. Funksionet dhe rëndësia e të drejtës për mjete juridike 238
3.2. E drejta për të ditur arsyet e vendimit dhe efektet e mos-arsyetimit 240
3.2. Konceptualizimi i të drejtës për mjete juridike në KPP 242
3.2.1. E drejta e përdorimit të mjeteve juridike nga i pandehuri sipas KPP-së 242
3.2.2. Gëzimi i gjykimit të drejtë në procedurën shqyrtuese sipas mjetit juridik 244
3.2.3. Efektet e vendimeve të gjykatës së apelit në shqyrtimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë 247
3.2.4. Favoret e të pandehurit përkitazi me ushtrimin e mjeteve juridike dhe e drejta për ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme 250
3.3. Efektiviteti i mjeteve juridike dhe rishikimi i njëmendtë 254
3.4. Subsidiariteti i instancave që veprojnë sipas mjeteve juridike 257

PJESA E KATËRT 259

EFEKTET JURIDIKE TË PROVAVE TË PAPRANUESHME, ROLI I GJYKATËS KUSHTETUESE NË GJYKIMIN E DREJTË DHE KUFIZIMI I TË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË GJATË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME 259

KAPITULLI IX 260

EFEKTET JURIDIKE TË PROVAVE TË PAPRANUESHME NË TË DREJTË PËR GJYKIM TË DREJTË 260

1. Shqyrtime krahasuese për provat e papranueshme 260

2. Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi provat e papranueshme 262

4. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese mbi provat e papranueshme 265

5. Efektet e provave të papranueshme në cenimin e të drejtave tjera të garantuara 268

KAPITULLI X 270

EFEKTET E SHQYRTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PËR CENIMIN E TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË NGA GJYKATA KUSHTETUESE 270

1. Shqyrtime hyrëse 270

2. Kriteret formale për pranueshmërinë e kërkesës 272

2.1. Subjekti kërkues 273

2.2. Afati ligjor për parashtrimin e kërkesës 274

2.3. Shterimi i mjeteve juridike 275

2.4. Saktësimi dhe bazueshmëria e kërkesës 277

3. Kufijtë e shqyrtimit të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë 278

4. Efektet e shqyrtimit të vendimeve gjyqësore 280

5. Analizë e kërkesave për cenim të së drejtës për gjykim të drejtë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për periudhën 2009 – 2016 283

KAPITULLI XI 295

EFEKTET JURIDIKE TË KUFIZIMIT TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË 295

1. E drejta për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme 295

1.1. E drejta për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme sipas instrumenteve ndërkombëtare 295

1.2. E drejta për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme sipas Kushtetutës 296

1.3. Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti 298

1.4. Instrumentet ndërkombëtare të cilat nuk lejojnë pezullimin e të drejtës për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme 299

2. Kufizimi i të drejtës për gjykim të drejtë 300

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET 303

1. Gjetjet kryesore të studimit 303
2. Rekomandimet kryesore të studimit 312
3. Kufizimet e studimit dhe mundësitë për hulumtime të mëtejshme 314

BIBLIOGRAFIA 316

***Indeksi i kuptimeve* 335**
***Indeksi i autorëve* 339**

Falënderim

Pas një pune dhe angazhimi të përkushtuar në hulumtimin shkencor u nxjerrë në dritë ky punim i doktoratës. Për këtë punë hulumtuese falë Zotit u përkraha dhe u inkurajova nga shumë njerëz, gjë që tani gjejë rastin t'i falënderojë.

Mirënjohje të veçantë i shprehi mentorit tim të studimeve të doktoratës, Profesorit Rexhep Murati. Gjatë hulumtimit dhe hartimit të punimit të disertacionit të doktoratës, kisha fatin e madh të punojë me një mentor kurajoz e profesional. Profesor Murati më dha motivim dhe mbështetje të pa rezervë në të gjithë nivelet e studimeve dhe në karrierën profesionale, e posaçërisht në hulumtimin dhe hartimin e punimit të doktoratës.

Për bashkëpunimin konstruktiv dhe komentet e vlefshme me qëllim të avancimit dhe begatimit të këtij punimi, falënderojë anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, profesorët: Prof. Dr. Rexhep Gashi (UP), Prof. Dr. Ismail Zejneli (UEJL), Prof. Asoc. Dr. Besa Arifi (UEJL) dhe Prof. Asoc. Dr. Jeton Shasivari (UEJL).

Për gatishmërinë dhe përkrahjen e ofruar gjatë zhvillimit të procedurave të studimeve të doktoratës shpreh konsideratë për menaxhmentin e Fakultetit të Drejtësisë të UEJL-së, për Doc. Dr. Emine Zendeli, Dekane dhe Doc. Dr. Blerton Sinani, Prodekan, si dhe për koleget nga studimet e doktoratës, Vedije Ratkoceri (Asistent Doktorant në UEJL) dhe Blerta Ahmedi Arifi (Asistent Doktorant në UEJL).

Për përkrahjen e vazhdueshme dhe të pakursyer në rrugëtimin tim jetësor dhe profesional, në shenjë mirënjohje të përjetshme, e falënderoj familjen time, vëllezërit Artonin, Valbonin dhe Leotrimin, të fejuarën Fitoren, gjyshen Ferdezen, e veçanërisht falënderoj prindërit, nënën Mihrijen dhe babain Xhavitin, që ndanë gjithçka për suksesin tonë.

Në fund, dëshirojë tu shprehi mirënjohje të gjithë atyre që në çfarëdo mënyrë më ndihmuan për të hulumtuar dhe përfunduar punimin.

Prishtinë, mars 2018

Shkurtesat

BE	-	Bashkimi Evropian
DUDNJ	-	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	-	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJNP	-	Gjykata ndërkombëtare Penale
IGJK	-	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KADNJP	-	Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve
KE	-	Këshilli i Evropës
KEDNJ	-	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	-	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKGJE	-	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
KLD	-	Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Shqipëri
KPK	-	Kodi Penal i Kosovës
KPP	-	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KPrK	-	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KV	-	Komisioni i Venedikut
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PBPGJ	-	Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit
PDCP	-	Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike
SHBA	-	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TPNJ	-	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi

Abstrakt

Studimi ka si qëllim trajtimin e të drejtës për gjykim të drejtë në procedurën penale në Kosovë. Në mënyrë të veçantë analizon praninë e të drejtës për gjykim të drejtë në Kushtetutë, Kodin e Procedurës Penale, ligjet relevante, si dhe në aktet përkatëse nënligjore. Gjithashtu trajton nivelin e harmonizimit të së kësaj të drejte me instrumentet dhe jurisprudencën ndërkombëtare. Punimi trajton elementet e përgjithshme dhe të veçanta të së drejtës për gjykim të drejtë, çështjen e gjykimit të të pandehurit me prova juridikisht të papranueshme, kufizimin e të drejtës për gjykim të drejtë, si dhe çështjen e të drejtës për gjykim të drejtë në rrethana të jashtëzakonshme. Në këtë studim është aplikuar metoda kualitative: historike, komperative, e studimit të rasteve individuale, normative, si dhe metoda kuantitative për t'i paraqitur në mënyrë statistikore numrin e rasteve të ngritura pranë Gjykatës Kushtetuese lidhur me cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë.

Nga rezultatet e trajtimit mund nxjerrim se në procedurën penale në Kosovë, i pandehuri gëzon të drejta sikurse janë të garantuara me instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë është përfshirë në mënyrë të përshtatshme në të gjithë aktet juridike relevante në Kosovë dhe parimisht kjo e drejtë është në përputhje me instrumentet relevante ndërkombëtare. Ndërsa, në raste të caktuara mund të shohim se drejta e të pandehurit për ndihmë juridike falas nuk është në tërësi në përputhje me parimin e *"barazisë së armëve"*. Gjithashtu përbërja diverse e KGJK-së edhe me jo-gjyqtarë, si dhe emërimi i disa anëtarëve të kësaj trupe nga Kuvendi, nuk është harmonizuar në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venedikut për emërimet gjyqësore. Tejkalimi i afateve të përcaktuara ligjore cenon të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm, ndërsa në raste të caktuara vet afati ligjor cenon këtë të drejtë. Në shumë raste mjetet juridike përdoren gabimisht nga i pandehuri, ku ata humbasin shanse të rëndësishme në procedurë penale, ku më së shumti shprehet në përdorimin e mjeteve juridike drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Fjalët kyçe: e drejta për gjykim të drejtë; të drejtat e të akuzuarit; gjykatë e pavarur, e paanshme, e themeluar me ligj; të drejtat e përgjithshme dhe të veçanta për gjykim të drejtë

Abstract

The aims of this study is to treating the right to a fair trial in criminal proceedings in Kosovo. Specifically, it analyzes the presence of the right to a fair trial in the Constitution, in the Criminal Procedure Code and the relevant laws, as well as relevant sub-legal acts. It also addresses the level of harmonization of this right with international instruments and jurisprudence. The paper has dealt with the general and specific elements that constitute this right, the cause of the trial of the defendant with legally inadmissible evidence, the restriction of the right to a fair trial, and the question of the right to a fair trial in exceptional circumstances .

In this study we applied the qualitative method: historical, comparative, individual case study, normative, and quantitative method to present statistically the number of cases raised by the Constitutional Court regarding the violation of the right to a fair trial .

From the results of the treatment we can find that in the criminal proceedings in Kosovo, the defendant enjoys the same rights as are guaranteed by the most important international instruments for the protection of human rights and freedoms. This right is appropriately incorporated in all relevant legal acts in Kosovo, in principle this right complies with relevant international instruments. While, in special cases, we can see that the defendant's right to free legal aid is not entirely consistent with the principle of *"equality of arms"*. Also, the different composition of the KJC with non-judges, as well as the appointment of some members of the Assembly, has not been harmonized in accordance with the recommendations of the Venice Commission for judicial appointments. Exceeding established legal deadlines damages the right to a trial within a reasonable time, while in certain cases the legally established deadline violates this right. Remedies, in many cases, are misused by defendants and lose important chances in criminal proceedings. This is mostly expressed in the use of remedies to the Constitutional Court.

Key words: right to fair and impartial trial; rights of the accused; independent and impartial tribunal established by law; general and special rights for fair trials.

HYRJE

1. Objekti dhe qëllimi i studimit

Objekt i trajtimit në këtë temë të doktoratës është studimi kritik i të drejtës për gjykim të drejtë në procedurë penale në Kosovë. E drejta për gjykim të drejtë që përbënë thelbin e të drejtës së procedurës penale është dimension i gjerë që përfshin një mori elementësh me karakter të përgjithshëm dhe të veçantë, sikurse është e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e themeluar me ligj; e drejta për gjykim në afat të arsyeshëm; e drejta për gjykim publik; e drejta për prezumimin e pafajësisë; e drejta për t'u mbrojtur; e drejta për t'u njoftuar me shkaqet dhe natyrën e akuzës; e drejta për lehtësi të përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen; e drejta për përkthyes apo interpret dhe një mori standardesh të tjera pranuara ndërkombëtare për të drejtën për gjykim të drejtë në procedurë penale.

Diskutimet aktuale për të drejtat që duhet t'i gëzojë i pandehuri në procedurë penale, janë orientuar tek ndërtimi i parimeve dhe standardeve më të larta të së drejtës për gjykim të drejtë. Deri më tani e drejta për gjykim të drejtë e garantuar me instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut që parasheh *"garancitë minimale"* që duhet t'i gëzojë i pandehuri në procedurë penale është e shprehur në nenin 10 të DUDNJ-së, nenin 14 të PDCP-së apo nenin 6 të KEDNJ-së. Po ashtu, kjo e drejtë garantohet edhe në një mori instrumentesh ndërkombëtare jo të detyrueshme, sikurse është *Tërësia e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave në çfarëdo forme të arrestit ose burgut* (1988); *Parimet themelore për rolin e avokatëve* (1990) dhe instrumente të tjera. Ndërsa në rrafshin e brendshëm, kjo e drejtë e garantuar me Kushtetutë, Kodin nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (tani e tutje: KPP), Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (tani e tutje: Ligji për KGJK), Ligjit për Gjykatat (tani e tutje: Ligji për gjykatat) dhe një sërë aktesh tjera, përveç *"garancive minimale"* të parapara me instrumentet e përmendura më sipër, pretendojnë t'i ofrojnë të pandehurit standardet më të larta të gjykimit të drejtë.

Në këtë punim do të analizohen dhe shtjellohen standardet e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuara me instrumentet e rëndësishme ndërkombëtare të karakterit global dhe

rajonal, si dhe do të bëhet krahasimi i këtyre standardeve me standardet të cilat i gëzon i pandehuri në procedurën penale në Kosovë, përkitazi për të drejtën për gjykim të drejtë.

Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë praninë e të drejtës për gjykim të drejtë në të drejtën e procedurës penale në Kosovë, për tu plotësuar me dy objektivat kryesore të mëposhtme:

1) Të shqyrtohet niveli i konceptualizimit të drejtës për gjykim të drejtë dhe të analizohen efektet e kësaj të drejte ndaj të pandehurit në procedurën penale në Kosovë.

Në objektivin e parë të punimit do të pasqyrohet shqyrtimi, elaborimi dhe trajtimi i pranisë të së drejtës për gjykim të drejtë në përmbajtjen e akteve juridike pozitive të procedurës penale, duke bërë përpjekje për të analizuar praninë e kësaj të drejte në Kushtetutë, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për KGJK-në, Ligjin për gjykatat dhe një sërë aktesh tjera juridike të zbatueshueshme. Përveç trajtimit të së drejtës për gjykim të drejtë, do të analizohen efektet e gjykimit të të pandehurit nën dritën e standardeve që i garantohen të pandehurit në procedurë penale, përkatësisht efektet që ka gjykimi me prova juridikisht të papranueshme, çështja e gjykimit në rrethana të jashtëzakonshme, si dhe të shqyrtuarit e mundësisë së kufizimit të së drejtës për gjykim të drejtë. Trajtimi i gjithanshëm imponon domosdoshmërisht elaborimin e konceptualizimit të elementëve të përgjithshëm sikurse është e drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e themeluar me ligj, e drejta për gjykim publik dhe në afat të arsyeshëm, si dhe trajtimin e elementëve të veçantë, sikurse është e drejta për prezumimin e pafajësisë; e drejta për t'u mbrojtur; e drejta për t'u njoftuar me shkaqet dhe natyrën e akuzës; e drejta për lehtësi të përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen; e drejta për përkthyes apo interpret. Këto dy dimensione themelore të kësaj të drejte, na orienton në shpjegimet tona për të pasqyruar masën e konceptualizimit të së drejtës për gjykim të drejtë në instrumentet e zbatueshme juridike në procedurën penale.

2) Të krahasohet niveli i harmonizimit të normave të së drejtës për gjykim të drejtë në të drejtën e procedurës penale në Kosovë, me standardet e përcaktuara në instrumentet dhe jurisprudencën ndërkombëtare për këtë të drejtë.

Duke u nisur nga supozimi se e drejta e procedurës penale në Kosovë është në përputhje me standardet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut, në objektivin e dytë të punimit si qëllim është parashtruar krahasimi i nivelit të harmonizimit të normave të së drejtës për gjykim të drejtë në të drejtën e procedurës penale, me standardet ndërkombëtare për këtë të drejtë. Së pari, do të jepen shpjegime të rëndësishme lidhur me përmbushjen e *"garancive minimale"* që parashihen me instrumentet ndërkombëtare, përkatësisht me dispozitat që rrjedhin nga DUDNJ, PDCP, KEDNJ dhe instrumente të tjera, si dhe do të bëhen krahasime me jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, duke filluar nga standardet që burojnë nga jurisprudenca e Gjykatës Penale për Krimet e Kryera në ish-Jugosllavi dhe në Ruandë, Gjykatës së Përhershme Penale, si dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përveç elaborimit dhe krahasimit që do të reflektohet në përmbajtje të punimit, të gjeturat kryesore të studimit, do të pasqyrohen tek konkluzat e punimit në formë të rekomandimeve.

1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit

Meqenëse qëllimi i studimit është të shqyrtuarit e të drejtës për gjykim të drejtë në procedurën penale në Kosovë, studimi synon të testojë hipotezën e formuluar si në vijim:

"E drejta për gjykim të drejtë me anë të rregullave kushtetuese dhe ligjore është e konceptualizuar në mënyrë të përshtatshme në procedurën penale në Kosovë dhe se kjo e drejtë është e harmonizuar me "standardet minimale" të parapara me instrumentet dhe jurisprudencën ndërkombëtare."

Duka analizuar rrethanat dhe të gjithë faktorët të cilët kanë ndikuar në praninë e të drejtës për gjykim të drejtë në procedurën penale në Kosovë dhe me qëllim të shqyrtimit të hipotezës së parashtruar, ky studim i adresohet pyetjeve kërkimore specifike si në vijim:

P1. Sa është harmonizuar e drejta për gjykim të drejtë në procedurën penale, me standardet e drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut?

P2. Sa është konceptualizuar e drejta për gjykim të drejtë në Kushtetutë, Kodin e Procedurës Penale dhe në aktet tjera relevante?

P3. Në çfarë mase janë barazuar të drejtat e mbrojtjes në raport me prokurorin e shtetit në procedurë penale, sipas parimit të *"barazisë së armëve"*?

P4. Deri në çfarë mase i pandehuri gëzon të drejtën për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, apolitike dhe të themeluar sipas ligjit?

P5. Cilat janë efektet e gjykimit të të pandehurit me prova juridikisht të papranueshme dhe efektet e kufizimit të së drejtës për gjykim të drejtë në situatat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme?

2. Metodologjia e hulumtimit

Me qëllim të arritjes së objektivave kryesore të studimit, në këtë hulumtim do të përdorim metodologji të përzier të hulumtimit. Hulumtimi është i gërshetuar ndërmjet metodës kualitative dhe metodës kuantitative. Qëllimi i përdorimit të këtyre metodave është mbledhja dhe analiza e të dhënave që ndihmojnë studiuesit për të shqyrtuar marrëdhëniet shkak - pasojë. Në rastin e këtij studimi pretendohet identifikimi i nivelit të konceptualizimit të së drejtës për gjykim të drejtë në sistemin juridik të Kosovës, si dhe krahasimi i masës së harmonizimit të kësaj të drejte me standardet që garantohen sipas instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Shfletimi i literaturës parashtroi një bazë të gjerë konsultuese të materialeve bibliografike të tanishme dhe të mëhershme mbi të drejtën për gjykim të drejtë në rrafshin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Hulumtimi do të përqendrohet në dy qasje. Së pari, do t'i

trajtojmë dispozitat normative që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, nisur me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera nënligjore. Së dyti, do të shqyrtojmë të drejtën për gjykim të drejtë që garantohet me anë të instrumenteve ndërkombëtare dhe standardet që dalin nga GJEDNJ për këtë të drejtë, për t'i krahasuar të njëjtat me standardet të cilat ofron sistemi juridik në Kosovë.

Metodat kualitative që do t'i shfrytëzojmë në këtë punim janë: metoda historike, metoda komperative, metoda e studimit të rasteve individuale (case study), metoda normative dhe metoda të tjera. Metoda historike, mundëson që të njohim shtrirjen në rrafshin historik të gjykimit të drejtë si kategori historike dhe si një e drejtë themelore pozitive. Me anë të saj do të kuptojmë lindjen, ndryshimin dhe zhvillimin e kësaj të drejte në një rrafsh më të gjerë kohor. Metoda komperative, do të na krijojë hapësirë për t'i krahasuar rregullat e të drejtën për gjykim të drejtë me sisteme tjera juridike, p.sh. me rregullat e sistemit juridik-procedural të Republikës së Shqipërisë. Kjo metodë vë në pah ngjashmëritë dhe dallimet mes sistemeve juridike. Gjithashtu, ndihmon në krahasimin e harmonizimit që ekziston në mes rregullave kushtetuese dhe ligjore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe atyre të garantuara me të drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut që paraqiten si norma juridike konvencionale (*ius cogens*) dhe jo-konvencionale. Metoda e studimit të rasteve individuale (case study), mundëson studimin e të drejtës për gjykim të drejtë në një kontekst më të gjerë rastet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Metoda normative, na mundëson trajtimin e thelluar të normave që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë. Sikurse çdo rend tjetër juridik, sa i përket mënyrës së krijimit dhe zhvillimit nuk është krejtësisht i pavarur, por është pjesërisht derivat i huazimit gjuhësor dhe teknikave tjera të përvetësimit nga instrumentet ndërkombëtare, apo jurisprudencës ndërkombëtare. Kjo metodë tenton që t'i nxirret kuptimi i drejtë i normës.

Me anë të metodës kuantitative do të paraqesim në mënyrë statistikore numrin e rasteve të ngritura pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë. Kjo metodë përdoret në kapitullin X për të analizuar kërkesat e paraqitura nga individët si subjekte të autorizuar pranë kësaj gjykate nga viti 2009 deri në vitin 2016.

3. Struktura e punimit

Punimi përbëhet abstrakti, hyrja, katër pjesë, konkluzionet, regjistri i literaturës, indeksi i kuptimeve dhe indeksi i autorëve.

Pjesa e parë me titull **"Vështrim i përgjithshëm mbi të drejtën për gjykim të drejtë bazuar në të drejtat e njeriut dhe e drejta për gjykim të drejtë sipas akteve dhe jurisprudencës ndërkombëtare"** përbëhet nga tre kapituj, ku përfshihen: shqyrtimet përfundimtare për të drejtën për gjykim të drejtë dhe gjykimi i drejtë sipas instrumenteve dhe jurisprudencës ndërkombëtare. Lidhur me shqyrtimet e përgjithshme përfshihet rëndësia e të drejtave të njeriut në procedurën penale, nocioni dhe elementet e gjykimit të drejtë dhe një historik i shkurt i tij, gjithashtu e drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve ndërkombëtare trajtohet nën dritën e instrumenteve ndërkombëtare të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, ndërsa jurisprudenca ndërkombëtare fokusohet në praktikën e krijuar nga GJEDNJ, Gjykatat ad hoc për ish-Jugosllavi dhe Ruandë, Gjykata e Përhershme Penale etj.

Pjesa e dytë me titull: **"Elementët e përgjithshme të drejtës për gjykim të drejtë"** trajton elementet të përgjithshme të së drejtës për gjykim të drejtë. Kjo pjesë ndahet në tre kapituj dhe përfshin të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, e pavarur, e themeluar me ligj, mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe barazia para gjykatës. Në kapitullin tjetër trajtohet e drejta e të pandehurit për gjykim publik dhe në afat të arsyeshëm kohor. Lidhur me të drejtën e të pandehurit për gjykim publik, fokusi qëndron në garancionet e përgjithshme që gëzon ai në procedurë penale dhe çështja e kufizimit të së drejtës për gjykim publik dhe rastet se kur është e lejueshme për t'u bërë një gjë e tillë. E drejta e të pandehurit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, përfshin të drejtën e të pandehurit trajtimin e afateve optimale dhe të arsyeshme që gëzon ai në procedurë penale, filluar nga faza e hetimeve dhe deri kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Pjesa e tretë me titull: **"Elementet e veçanta të së drejtës për gjykim të drejtë"** trajton të drejta të veçanta që gëzon i pandehuri në procedurë penale. Trajtimi në këtë pjesë përqendrohet në të drejtat që gëzon mbrojtja, duke filluar nga e drejta për t'u njoftuar me akuzën, të drejtën për avokat mbrojtës dhe lehtësi të përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen,

të drejtën për përkthyes dhe interpret, të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim. Gjithashtu trajtohet e drejta e të pandehurit për *"barazi të armëve"* dhe të drejtën për të marrë pjesë në kërkimin e provës, përfshirë të drejtën e të pandehurit për të shqyrtuar provat e paraqitura nga prokurori i shtetit, me qëllim të përmbushjes së parimit të kontradiktoritit dhe *"barazisë së armëve"* në procedurë penale. E drejta për t'u prezumuar i pafajshëm përfshin të drejtën që trajtohet çështja e barrës së provave dhe parimit *in dubio pro reo*, pa përjashtuar trajtimin e të drejtës për të heshtur dhe të drejtë për t'u mos u inkriminuar.

Pjesa e katërt me titull: **"Efektet juridike të provave të papranueshme, roli i Gjykatës Kushtetuese në gjykimin e drejtë dhe kufizimi i të drejtës për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme"** përfshin trajtimin e gjykimeve me prova juridikisht të papranueshme nën dritën e standardeve për gjykim të drejtë. Kjo pjesë vazhdon me trajtimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese në kontrollimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të marra në procedurë penale, përfshirë pjesën e kushteve formale që duhet plotësuar nga palët, apo dhe natyrën subsidiare të këtij mekanizmi. Dhe krejt në fund, trajtohet e drejta për gjykim të drejtë në rrethana të jashtëzakonshme, bazuar në rregullat e brendshme dhe ndërkombëtare, por dhe kufizimin e të drejtës për gjykim të drejtë dhe rrethanat që mund të ndodh një kufizim i tillë.

PJESA E PARË

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TË DREJTËN PËR GJYKIM TË DREJTË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT DHE E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË SIPAS AKTEVE DHE JURISPRUDENCËS NDËRKOMBËTARE

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TË DREJTËN PËR GJYKIM TË DREJTË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT

1. Rëndësia e të drejtës për gjykim të drejtë në procedurën penale

Procedura penale i parashtron vetes arritjen e disa objektivave të rëndësishëm, njëra ndër të cilat është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo procedurë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut e shtrin në dy rrafshe, *e para*, në luftë kundër kriminalitetit procedura penale mbron të drejtat e garantuara në kuadër të rendit juridik që mund t'i cenohen individëve, sikurse është cenimi të drejtës për jetë, integritet, pronë, dinjitet apo liri, dhe *e dyta*, sistemi i drejtësisë penale i parashtron vetes ruajtjen dhe garantimin e të drejtave të të pandehurit pikërisht gjatë zhvillimit të procedurës penale. Lidhur me këtë, Kempen (2014, f. 6) thekson se qëllimi më i rëndësishme i të drejtave në procedurë penale është mbrojtja kundër arbitraritetit të shtetit, gjë që këto të drejta shndërrohen në dimensione të rëndësishme të pothuajse të të gjitha sistemeve juridike, e veçanërisht e drejta për liri, pastaj, e drejta për gjykim të drejtë, si dhe e drejta për jetën private, janë pjesë të rëndësishme të pothuajse çdo çështje penale. Ndërsa, autori Murati (2006, f. 27-29) thekson se legjislacionet penalo-procedurale të shoqërive bashkëkohore, duke përqafuar dispozitat e shumë instrumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, bëjnë përpjekje të garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë dhe një mori të drejtash dhe liri të tjera në procedurë penale, gjë që shkeljet e të drejtave themelore të njeriut në procedurë penale mund të jenë me karakter penalo-juridik dhe penalo-procedural. Këto të drejta, pra janë të rëndësishme për tu mbrojtur gjatë zhvillimit të procedurës penale, pasi të njëjtat bazuar në standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, përbëjnë procedurën penale bashkëkohore.

Parimet e procedurës penale që i mundësojnë të pandehurit gëzimin e të drejtave të garantuara sipas instrumenteve ndërkombëtare, janë në rrugë të unifikimit në pothuajse të të gjitha procedurat penale bashkëkohore. Për më tepër, gjykimi i drejtë tani po kuptohet si një

garanci që procedura penale ndaj për të pandehurit do të udhëhiqet sipas standardeve themelore të parapara me instrumente relevante ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut. Si rregull, realizimi i drejtë i procedurës penale është në dorën e autoriteteve shtetërore, përfshirë këtu organet hetuese, ato prokuroriale dhe autoritetet gjyqësore. Mbikëqyrja e vazhdueshme nga këto autoritete përkitazi për respektimin rregullave dhe garancioneve procedurale, i mundësojnë të pandehurit të përfitojë nga efektet pozitive të garancive procedurale që i gëzon ai në procedurë, duke i mundësuar realizimin e të drejtës së të pandehurit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Autori Trechsel (2011, f. 181) thekson se shumica e të drejtave procedurale janë të lidhura me të drejtën për gjykim të drejtë. Në esencë, të gjitha garancionet procedurale kanë qëllimin përfundimtar që të pandehurit t'i ofrohet një gjykim i drejtë. Pra, e drejta e procedurës penale e bazuar në të drejtën për gjykim të drejtë, duhet të konceptohet dhe interpretohet gjerësisht, duke mos qenë procedurë përjashtuese kundrejt të drejtave tjera, pasi e drejta që realizohet në procedurë penale, parimisht paraqet drejtësi formale që realizohet në interes të të pandehurit në procedurë penale.

Autori Krapac (2010, f. 79) për rëndësinë e të drejtës për gjykim të drejtë, thekson se një kohë të gjatë në teorinë e të drejtës së procedurës penale të sistemit kontinental, parimi i së vërtetës materiale është konsideruar si *parimi kryesor – mbizotërues* i të drejtës së procedurës penale. Me kalimin e kohës, duke u reformuar sistemet e brendshme shtetërore të rregullave procedurale, procedura penale vë në fokus liritë dhe të drejtat njerëzore, si parime fundamentale. Marrë shkas nga kjo, tani "*gjykimi i drejtë"* është bërë parim mbizotërues që lidhet me standardet për të drejtat e njeriut. Sipas theksimeve të këtij autori (Krapac, 2010, f. 80), parimet e vjetra të procedurës penale, përfshirë këtu parimin e së vërtetës materiale, parimin e oficialitetit, apo të legalitetit, u vënë në pikëpyetje për shkak të praktikës së re të procedurës penale, e cila ishte e detyruar të gjejë zgjidhje të çështjes së mbingarkesës së sistemit gjyqësor. Nën ndikimin e të drejtës anglo-saksone janë shfaqur lloje të përziera të formave të reja të procedurës penale, sikurse janë marrëveshjet për pranimin e fajësisë, apo zgjidhjet alternative të çështjeve penale. Me këto zgjidhje një numër i madh i rasteve përfundojnë në mënyrë të shpejt. Këto forma të organizmit të procedurës penale detyrojnë që

të braktisen zgjidhjet tradicionale të zbatuara për një periudhë relativisht të gjatë dhe të përqafohen zgjidhje të reja më fleksibile të cilat paralelisht mundësojnë arritjen e efikasitetit, si dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut në procedurë penale.

Është më rëndësi të themi se i pandehuri duke u gjendur përball aparatit shtetëror që udhëheq me procedurën penale në çështjen, nga theksimet e sipërpërmendura mund të themi se garancitë e ofruara i mundësojnë të pandehurit të paraqes rastin në mënyrën më të mirë, me ç'rast të drejtat ndaj tij mund të kufizohen në masën e arsyeshme dhe të domosdoshme. Këto standarde të të drejtave të njeriut janë pjesë përbërëse e instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që obligojnë shtetet që të njëjtat t'i jetësojnë praktikisht.

Me zhvillimet bashkëkohore në procedurë penale, është shtruar nevoja e përshpejtimit të zgjidhjeve të çështjeve penale. Efektet e sistemit anglosakson kanë ndikuar që edhe sistemi kontinental i procedurës penale të mos jetë i paprekshëm karshi tendencave për zgjidhje të përshpejtuar të çështjeve penale, sikurse janë procedurat alternative. Dilemat më të mëdha të këtyre zgjidhjeve në procedurë penale më së shumti prekin çështjen e mundësisë së dhënies së dënimeve të gabuara, pasi të njëjtat anashkalojnë ballafaqimin e të pandehurit me dëshmitë ku mbështetet aktakuza ndaj tij. Prandaj, kur zbatohen forma të thjeshtëzuara të procedurës penale, është e rëndësishme të respektohet e drejta e personit për gjykim të drejtë (Ņesterova, 2013, fv. 205-206). Në të vërtetë, një nga problemet qendrore në procedurën penale është nevoja për të harmonizuar çështjen e zgjidhjeve në mënyrë efektive, me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kërkesën themelore që të respektohet e drejta e një personi për një gjykim të drejtë (Ashworth & Redmayne, 2005, f. 22, cituar nga Ņesterova, 2013, f. 206).

2. Koncepte dhe përkufizime bazë të së drejtës për gjykim të drejtë

Instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e njeriut, qofshin instrumente të detyrueshme apo jo të detyrueshme kanë unifikuar rregullat dhe standardet që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë. Në këtë kontekst, praktika gjyqësore ndërkombëtare, e veçanërisht

praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, ka zënë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të të drejtave të njeriut, e posaçërisht të drejtës për gjykim të drejtë. Rëndësia e kësaj praktike gjyqësore qëndron në të shpjeguarit e shumë çështjeve komplekse të paraqitura para saj, gjë që të zgjeruar mund të vërejmë kuptimin e të drejtës për gjykim të drejtë, ku përfshihen standarde tjera të reja cilat nuk kanë qenë të përmendura shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ-së. Në shumë vendime të saj (shih: Douwe Korf, 2006), kjo gjykatë thekson se qëllimi i hartuesit të KEDNJ-së, nuk ka qenë kufizimi në interpretimin restriktiv të të drejtave të parapara në këtë akt, por ka pasur si qëllim zgjerimin dhe avancimin e këtyre të drejtave, duke i mundësuar të pandehurit mbrojtje të drejtë dhe të plotë në procedurë penale.

KEDNJ si një nga instrumentet më të hershme ndërkombëtare konvencionale, ka luajtur një rol të rëndësishëm në konceptualizimin e të drejtës për gjykim të drejtë në shumë vende. Neni 6 ka qenë pikë referuese për shumicën e legjislacioneve nacionale. Sipas kësaj dispozite, të drejtën për gjykim të drejtë e përbëjnë elementet themelore sikurse në vijim:

1) e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj;

2) e drejta për gjykim publik;

3) e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm;

4) e drejta e të pandehurit për t'u prezumuar i pafajshëm;

5) e drejta për t'u njoftuar brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngritët kundër tij;

6) e drejta kohë të mjaftueshme dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

7) e drejta të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës dhe

8) e drejta për ndihmë falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë (KEDNJ, 1953).

Sipas protokollit nr. 7 të KEDNJ-së (1984), parashihen tri të drejta plotësuese:

1) e drejta ankesës, me anë të së cilës mund të kërkohet rishqyrtim të vendimit të shkallës së parë nga një instancë më e lartë gjyqësore;

2) e drejta e kompensimit për dënimin e padrejtë dhe

3) e drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale.

Me zhvillimin progresiv të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, elemente të së drejtës për gjykim të drejtë janë përcaktuar edhe e drejta për të heshtur dhe e drejta për t'u mos u inkriminuar. Në çështjen *Murray kundër Britanisë së Madhe*, GJEDNJ përmend se e drejta për të heshtur dhe e drejta për t'u mos u inkriminuar, edhe pse nuk janë paraparë tekstualisht si pjesë e nenit 6, janë rregulla të pranuara në mënyrë të përgjithshme që përbëjnë thelbin e të drejtës për gjykim të drejtë të paraparë me nenin 6 të KEDNJ-së (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 365). Dhënia e arsyeve të qarta për vendimin e marrë nga gjykata, është një nga të drejtat të cilat gëzon i pandehuri në procedurë penale. Edhe kjo e drejtë nuk është përcaktuar shprehimisht në pjesën normative të nenit 6 të KEDNJ-së, por është një e drejtë e nënkuptuar që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për ushtrimin e mjeteve juridike (Hadjianastassiou v. Greqia, GJEDNJ, 1992, paragr. 33). Një element tjetër që përbën të drejtën për gjykim të drejtë, është e drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim në çështjen kundër tij. Kjo e drejtë edhe pse jo shprehimisht e përcaktuar në nenin 6, është objekt i përpunimit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ku në çështjen *Hermi kundër Italisë*, kjo gjykatë thekson se është e drejtë themelore e të pandehurit për të qenë pjesëmarrës në gjykatë në çështjen penale kundër tij. Me vet faktin që të pandehurit iu janë dhënë të drejtat sipas nenit 6 § 3, përkatësisht e drejta për të pasur avokat mbrojtës dhe përkthyes, apo e drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të propozojë dëshmitarë, është e vështirë të thuhet se si ai mund t'i ushtrojë këto të drejta pa qenë i pranishëm në gjykim (Hermi v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 59). Në lidhje me praninë e të pandehurit në procedurën penale, në dispozitën e nenit 14 të PDCP-së theksohet se prania e të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore në çështjen penale kundër tij, është kusht për t'u zhvilluar procedura penale. Të njëjtat zgjidhje janë pranuar edhe nga statutet e gjykatave ad hoc për ish-Jugosllavi dhe Ruandë dhe në statutin e Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare. Nga trajtimi i mësipërm mund të themi se tanimë pjesë përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë janë edhe:

1) e drejta për të heshtur dhe e drejta për t'u mos u inkriminuar;

2) e drejta për të ditur arsyet e vendimit dhe

3) e drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim në çështjen kundër tij.

Studiues të ndryshëm kanë bërë klasifikimin e elementëve themelore të cilat e përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë. Edhe pse pothuajse shumica e tyre pajtohen se e drejta për gjykim të drejtë ka elemente përbërëse pothuajse të njëjta, jepen mendime se edhe pse deri më tani disa nga të drejtat themelore nuk janë përfshirë në tekstet normative të instrumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, apo nuk janë pranuar nga gjykatat ndërkombëtare, janë elementë të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë.

Studiuesi Kempen (2014, f. 9), thekson se në përgjithësi elementet e gjykimit të drejtë ose të procesit të rregullt në procedurat penale përfshijnë: të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë të pavarur dhe të paanshme; të drejtën për gjykim publik; të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; prezumimi e pafajësisë (përfshirë privilegjin kundër vetë-inkriminimit); të drejtën për t'u ndihmuar nga një avokat mbrojtës; të drejtën për të paraqitur dëshmi për mbrojtjen dhe për të kundërshtuar provat e prokurorisë; të drejtën për t'u njoftuar me akuzën; të drejtën për të paraqitur argumente kundër akuzës; dhe të drejtën për të ankimuar vendimin.

Studiuesi Krapac (2010, fv. 148-149), përmend se e drejta për gjykim të drejtë përbëhet nga elementet e përgjithshme dhe elementet e veçanta. Elementet e përgjithshme përfshijnë:

a) të drejtën e palëve të jenë të pranishëm në procedurë dhe të dëgjojnë para se të merret vendimi (parimi i kontradiktoritetit)

b) parimi i *"barazisë së armëve"*;

c) arsyetimi i vendimeve gjyqësore;

d) Ndalimi i shfrytëzimit të provave juridikisht të papranueshme.

Ndërsa, elementët e posaçme i klasifikon sipas ndarjes që ekzistojnë sipas nenit 6 § 2 dhe 6 § 4 të KEDNJ-së, dhe nenit 2, 3 dhe 4 të protokollit nr. 7 të KEDNJ-së (1984).

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë përgjatë periudhës 25 vjeçare të funksionimit si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës së Shqipërisë, në jurisprudencës e saj ka ndërtuar elementët përbërës të së drejtës për gjykim të drejtë. Elementet kanë qenë të ndryshme, por asnjëherë shteruese. Këto elementë janë zhvilluar rast

pas rasti, në reflektim të kërkesave të paraqitura nga individët, dhe përfshijnë elemente të tilla si: aksesi në gjykim, gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur, e paanshme, kohëzgjatje e arsyeshme e gjykimit, drejta e ankimit, e drejta për t'u mbrojtur, e drejta për të marrë pjesë vetë në gjykim, *"barazia e armëve"*, ekzekutimi i vendimi dhe arsyetimi i vendimit (Zaganjori, Anastasi, & Çani, 2011, f. 90).

Sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, theksohet se e drejta themelore për gjykim të drejtë rrjedh nga e drejta themelore për mbrojtje gjyqësore, e garantuar me nenin 54 të Kushtetutë. Më shumë se të drejtat e tjera themelore, e drejta për gjykim të drejtë kërkon që gjyqtarët të jenë të kujdesshëm, pasi që ata janë gjithmonë në rrezik për ta shkelur atë të drejtë. Në të vërtetë, e drejta për gjykim të drejtë është një referencë e përgjithshme për një kompleks të të drejtave të tjera, konkretisht: e drejta për qasje ne gjykata, e drejta për të paraqitur argumente dhe prova, parimet e adversaritetit dhe të *"barazisë së armëve"* (shih: Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A. v. Gjykatës Supreme, GJK, 2014)

Kushtetuta e Kosovës në nenin 31 të saj, të drejtën për gjykim të drejtë e parasheh si të drejtë të veçantë, me elementet sikurse më poshtë, se:

1) çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike (paragr. 1);

2) çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj (paragr. 2);

3) gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj; (paragr. 3);

4) çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet (paragr. 4);

5) çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij, në pajtim me ligjin (paragr. 5);

6) ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi (paragr. 6).

Ndërsa, sipas nenit 30 të Kushtetutës përcaktohen të drejtat e të akuzuarit. Këto të drejta janë pjesë përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë. Ato mund të gjenden të sistemuara në nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 14 të PDCP-së. Të drejtat e njëjta në praktikën e GJEDNJ-së janë të njohura si elemente të së drejtës për gjykim të drejtë. Në bazë të këtij neni çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

2) të njoftohet për të drejtat e tij sipas ligjit;

3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;

6) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;

7) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Sipas nenit 32 të Kushtetutës, si e drejtë e veçantë parashihet e drejta për mjete juridike, ndërsa sipas nenit 34, parashihet e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, ku garantohet që askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

Duke marrë në konsideratë çdo klasifikim të sipërpërmendur, përpunimi në arritjen e objektivave të këtij punimi, e posaçërisht vërtetimi i hipotezës kryesore dhe dhënia e përgjigjeve në pyetje e ngritura hulumtuese, do të bazohet në renditjen e përmbajtjes ekzistuese të nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo cytje ndodh për shkakun e ndikimit që ka luajtur kjo dispozitë në kontinentin e Evropës, duke u shndërruar në një standard të rëndësishëm të procedurës penale. Pesha e kësaj dispozite i atribuohet faktit se nuk bazohet në një model të

veçantë të procedurës penale. Në këtë aspekt, nuk është rastësi që literatura e shumtë e të drejtës së procedurës penale krahasuese vazhdon t'i përmbahet kuptimit të sistemeve procedurale penale evropiane, të ndara në dy grupime: akuzator dhe inkuizitor (shih: Sarah, 2007).

3. Origjina e të drejtës për gjykim të drejtë

Varësisht nga periudhat e zhvillimit historik, procedura penale ka pasur zhvillime me karakteristika të veçanta. Në periudhat e mëhershme, përkatësisht në periudhën kur shoqëria njerëzore nuk ishte e organizuar në shtet dhe e drejta ishte e pazhvilluar, nuk mund të hasim në ndonjë element të gjykimit të drejtë, por as në ndonjë procedurë të organizuar penale, ndërsa me zhvillimet e mëvonshme u krijuan kushtet e përshtatshme për paraqitjen e procedurës penale në forma të ndryshme, gjë që edhe filluan të lindin edhe elemente të caktuara të gjykimit të drejtë. Përkitazi me këtë, elemente të gjykimit të drejtë në formë të fragmentarizuar mund të gjenden në dokumente të ndryshme me një histori të hershme, sikurse është Kodi i Hamurabit, Bibla apo dhe Kur'ani, apo të tjera.

Sikurse pajtohen shumica e studiuesve, procedura penale në kontekstin historik, ka njohur tri sisteme më të rëndësishme të procedurës penale: sistemi akuzator (paditës), sistemi inkuizitor (hetues) dhe sistemi i përzier (mikst - akuzator dhe inkuizitor) (Sahiti & Murati, 2016, fv. 19-20). Këto sisteme ishin familjet më të mëdha të organizimit të procedurës penale, pasi në të njëjtën kohë kanë bashkekzistuar dhe nënsisteme tjera të procedurës penale, por për shkak të ndikimit të vogël që ato kanë ushtruar, nuk kanë lënë gjurmë të rëndësishme në historinë e procedurës penale. Këto sisteme të procedurës penale në kontekstin e zhvillimit historik kanë shtrirje të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Klasifikimi i tillë, shumë herë has në kundërshtime nga disa autorë, pasi shumë prej tyre mendojnë se këto sisteme edhe pse mund të kenë karakteristika të veçanta dhe një identitet të kultivuar ndër vite, ato nuk përbëjnë në mënyrë të pastër një ide të veçantë, pasi asnjëherë nuk kanë qëndruar konsistente në parimet e përgjithshme të cilat duhet ta karakterizojnë një sistem. Edhe në kohën e tanishme, ekziston

një laramani karakteristikash, sa që është e pasigurt të klasifikohet në ndonjë sistem, qoftë akuzator apo inkuizitor, pasi nëse identifikohet rregullisht një juridiksion me një traditë, ai mund të shfaq disa karakteristika që lidhen me tjetrën (Field, 2009, fv. 367-368), gjë që bënë relativ vet klasifikimin.

Rëndësia e të drejtave themelore individuale për sistemet e drejtësisë penale nuk është e re. Për shembull, në vitin 1215 Magna Carta parashihte që askush nuk do të privohet nga jeta, liria ose prona pa një proces të rregullt ligjor (Kempen, 2014, f. 5). Ky dokument përfaqësonte iniciativën e parë për të kufizuar pushtetin arbitrar te mbretit dhe proklamonte idenë që askush nuk është mbi ligjin. Vlera e këtij dokumenti për kohën kur është nxjerrë është e madhe dhe paraqet aktin e parë që vendos themelet e lirisë njerëzore në raport me pushtetin e pakufizuar të atëhershëm të mbretit. Megjithatë edhe pas shumë studimeve të bëra, nuk është arritur tek ndonjë përfundim i pranueshëm shkencor për të përcaktuar kohën kur në të vërtet ka filluar të përdoret termi *"gjykim i drejtë".* Juristët dhe hulumtuesit anglez që janë marrë më për së afërmi me këtë çështje, shprehen se afërsisht shekulli XVII mund të jetë fillimi i përdorimit të nocionit *"gjykim i drejtë"* nga organet e pushtetit shtetëror, mirëpo nuk nuk mund të thuhet me siguri që edhe më herët gjatë zhvillimit të procedurës penale palët të kenë përdorur këtë term. Në vitin 1676 llogaritet se për herë të parë Gjykata e Vjetër e Londrës ka përdorur termin *"gjykim i drejtë"* me rastin e dhënies së aktgjykimit për një çështje gjyqësore. Aty përmendet dënimi që i është dhënë të pandehurve në procedurën penale ndaj të cilëve është zhvilluar procesi gjyqësor, ku përmendet se *"janë dënuar për krimet e tyre duke u përcjellë me një gjykim të drejtë."* Në mes të viteve 1674 e deri 1834, termi *"gjykim i drejtë"* nga kjo gjykatë është përdorur rrallë. Përdorimi i këtij termi në atë kohë, nuk do të thotë se kjo të nënkuptohet sikurse në kuptimin tanishëm (Langford, 2009, f. 44).

Idetë e mëtejshme kundër arbitraritetit lidhur me akuzat penale evoluan në shekullin e XVIII-të, ku në këtë periudhë këto parime u integruan në shumë instrumente, që mund të shihen në Pjesën e VIII të Kartës së të Drejtave të Virgjinias të vitit 1788 dhe në Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit të vitit 1789. Përgjatë shumë dekadave dhe pas dy luftërave botërore në shekullin XX, nocioni i të drejtës për një gjykim të drejtë u shfaq si një parim i pranuar në të drejtën humanitare ndërkombëtare, ligjin e të drejtave të njeriut dhe të drejtën

penale ndërkombëtare (Widder, 2015, f. 10-11). Evoluimin dhe zhvillimin më të shprehur kjo e drejtë e ka pasur me miratimin e Deklaratës Universale për të Drejta e Njeriut. Sipas kësaj Deklarate, e drejta për gjykim të drejtë parashihej në nenin 10 dhe u njihej të gjithë personave në mënyrë të barabartë. Edhe pse ky instrument nuk kishte rëndësi detyruese më shumë se sa të një deklarate, rëndësia e saj shtrihet në sensibilizimin e debatit në rrafshin ndërkombëtar për të ndërtuar instrumente të qëndrueshme që garantojnë të drejtat dhe liritë njerëzore. Efektet pozitive të Deklaratës mund të vihen në pah me miratimin e KEDNJ-së në vitin 1953, si dhe të miratimit të PDCP-së në vitin 1966, apo edhe të instrumenteve të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

KAPITULLI II

E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË SIPAS INSTRUMENTEVE NDËRKOMBËTARE

1. E drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve të detyrueshme ndërkombëtare

Instrumentet ndërkombëtare sot luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e të drejtave të njeriut. Sipas standardeve të këtyre instrumenteve, e drejta për gjykim të drejtë shprehet me anë të disa *"garancive minimale"* që gëzon i pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës penale. Këto garanci janë të ndërtuara që të mbrojnë dhe të sigurojnë të drejtën e të pandehurit për t'i ushtruar në mënyrë të përshtatshme dhe efektive të drejtat e parapara në procedurë penale (Sivasubramaniam, 2013, f. 21-22). Garancitë e parapara me këto instrumente nuk është e thënë që domosdoshmërisht të jenë të njëjta, pasi në disa instrumente ka standarde më të detajuara se sa të tjerët, gjë që shtetet me anë të ligjeve kombëtare duhet së paku të arrijnë ato standarde të parapara, por nuk janë të kufizuara që të ofrojnë standarde më të larta sesa ato të obliguara. Nën dritën e standardeve ndërkombëtare, një gjykim i drejtë do të vlerësohet nëse shtetet zbatojnë procedurat penale në përputhje me *"garancitë minimale"* të përfshira në këto instrumente (Sivasubramaniam, 2013, f. 22).

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto rregulla, shumica e shteteve tani janë duke i harmonizuar rregullat e brendshme, me rregullat e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, gjë që edhe Republika e Kosovës është duke ndjekur një rrugë të tillë. Këto instrumente që paraqiten si instrumente të detyrueshme dhe si jo të detyrueshme, janë shndërruar në rregulla të rëndësishme edhe në të drejtën e brendshme. Përveç PDCP-së që është instrumenti i parë dhe më i rëndësishëm që garanton të drejtën për gjykim të drejtë, gjithashtu janë një mori instrumentesh tjera ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, të tilla sikurse:

- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (1987);
- Konventa për të drejtat e fëmijës (1989);

- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (1981);
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (1981).

Këto instrumente janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Kosovës (neni 22). Përveç instrumenteve të detyrueshme, janë një mori instrumentesh tjera jo të detyrueshme, apo siç njihen edhe si *"rregulla të buta"*, të tilla sikurse Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) që është instrumenti i parë jo i detyrueshëm ndërkombëtarë, që shprehimisht parasheh të drejtën për gjykim të drejtë si një e drejtë themelore dhe universale e njeriut. Në periudha të mëvonshme, e drejta për gjykim të drejtë është përfshirë në shumë sisteme juridike kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë KEDNJ-në dhe PDCP-në. Të gjithë këto instrumente përmbajnë dispozita të rëndësishme të cilat garantojnë gjykimin e drejtë, si një nga të drejtat themelore në procedurë penale.

2.1. E Drejta për gjykim të drejtë sipas PDCP-së

Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike,[1] është instrumenti i parë ndërkombëtar i obligueshëm dhe më i rëndësishëm që garanton të drejtat dhe liritë e njeriut. Të drejtat civile dhe politike zënë vend të rëndësishëm në tërë tekstin e këtij instrumenti ndërkombëtar dhe për dallim nga DUDNJ, që paraqet instrument deklarativ dhe shumë të përgjithshëm, PDCP paraqet konkretizim të të drejtave dhe lirive të njeriut. Rëndësia e të drejtës për gjykim të drejtë, nga një gjykatë e paanshme e themeluar me ligj, është e paraparë në shumë dispozita të të këtij instrumenti dhe parasheh të drejtën e të pandehurit për gjykim të drejtë nga stadi i hetimeve, e deri në dhënien e verdiktit përfundimtar. Në aspektin përmbajtësor, ky instrument ngërthen në vete rregulla të rëndësishme që i garantojnë të pandehurit të drejta themelore në procedurë penale. Sikurse mund të shohim, ky instrument garanton të drejtën për dinjitet dhe të drejtën për barazi në të gjithë situatat, qofshin ato momente para autoriteteve gjyqësore, apo

[1] Ky instrument është miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën nr. 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966. Instrumenti ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976, në përputhje me nenin 49 të saj.

autoriteteve tjera publike. Lidhur me këtë, parashihet e drejta për liri dhe siguri (neni 9 § 1), me ç'rast secilit subjekt i garantohet e drejta për tu trajtuar sipas rregullave ligjore, duke ia njohur të drejtën secilit që të dijë për arsyet e akuzës ndaj tij. Përveç kësaj, është paraparë që secili që ndalohet ose arrestohet, duhet të dijë për arsyet e ligjshme të ndalimit, si dhe t'i jepet e drejta që brenda një afati kohor të arsyeshëm të dal para një gjykate të pavarur dhe të paanshme.

Dispozita më e rëndësishme që parasheh të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është nenit 14 i këtij instrumenti, ku theksohet se të gjithë duhet të jenë barabartë përpara gjykatave, dhe se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet publikisht në mënyrë të paanshme nga një gjykatë kompetente, e pavarur, e paanshme dhe e themeluar me ligj. Në këtë dispozitë njihet e drejta e të pandehurit të drejtën për tu prezumuar i pafajshëm përderisa të mos provohet fajësia e tij sipas procedurës përkatëse ligjore. Ndërsa, dispozita e nenit 14 § 3 parasheh në mënyrë taksative *"garancitë minimale"* për secilin person të akuzuar për një vepër penale, që përfshin të drejtën:

a) të informohet menjëherë dhe hollësisht me gjuhën që e kupton, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës;

b) të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të ketë të drejtën të komunikojë me një mbrojtës të përzgjedhur;

c) të gjykohet pa vonesa;

d) të jetë i pranishëm gjatë gjykimit dhe të mbrohet vetë apo nëpërmjet një mbrojtësi të përzgjedhur; ndërsa nëse nuk ka angazhuar avokat mbrojtës, ai duhet të informohet për të këtë të drejtë dhe çdoherë kur e kërkon interesi i drejtësisë, në rastet nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, duhet t'i caktohet një mbrojtës pa pagesë;

e) të marrë në pyetje ose të kërkoj të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sillen në gjykatë, e të merren në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes në emër të tij, në të njëjtat kushte sikurse edhe dëshmitarët kundër tij;

f) të ketë ndihmën falas të një përkthyesi në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën që përdoret në gjykatë dhe

g) të mos shtrëngohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë se është fajtor.

Edhe sipas PDCP-së të gjithë personave pa dallim, u garantohen të drejta të barabarta, pasi edhe siç përmendet në preambulën e këtij dokumenti ndërkombëtar, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë. Sipas këtij akti ndërkombëtar çdo shtet i cili ratifikon këtë dokument dhe e bënë pjesë integrale të sistemit të vet juridik, obligohet që të respektojë dhe të sigurojë të drejtat e garantuara me këtë pakt të gjithë individëve në territorin e tyre dhe që janë nën pushtetin e tyre, pa kurrfarë dallimi. E drejta e përdorimit të mjeteve efektive juridike, në tekstin e këtij pakti është paraparë në nenin 2 § 3 (a), (b) dhe (c). Shtetet të cilat ratifikojnë këtë pakt obligohen që: *"të sigurojë që çdo person, kur t'i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare"* (PNDCP, neni 2 § 3 (1)). Shteti aderues gjithashtu obligohet që të sigurojë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit, do t'i përcaktoj të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik si dhe të zhvilloj mundësit e paraqitjes së mjetit juridik (PNDCP, neni 2 § 3 (2)). Si dhe secili shtet palë obligohet që të sigurojë që autoritetet kompetente do të veprojnë sipas çdo mjeti juridik që parashihet me akte ligjore (PNDCP, neni 2 § 3 (3)). PDCP-ja nuk e përcakton qartë emërtimin e mjetit juridik dhe as nuk precizon mënyrën e paraqitjes, apo bazat me anë të të cilave i pandehuri mund t'i ushtrojë kundrejt vendimit të marrë në shkallë të parë. Ky diskrecion i gjerë që i është dhënë shteteve, ka krijuar një mundësi që shtetet të kenë rregullime diverse në çështjen e përcaktimit të modaliteteve për një mjet juridik të cilin mund të gëzojë i pandehuri. Ashtu edhe siç është përcaktuar në pjesën tekstuale të aktit, mjeti juridik që i jepet të pandehurit nënkuptohet si një të drejtë që duke ushtruar atë, mund të kërkojë nga instancat më të larta gjyqësore që vendimi i tij të rishikohet. Pra, bazuar në këtë pikë, shtetet kanë përpunuar legjislacionet e brendshme të tyre dhe kanë ndërtuar të drejtën e paraqitjes së ankesës nga të pandehurit, por edhe mjete juridike tjera të cilat i mundësojnë të pandehurit të arrijë drejtësinë procedurale ashtu edhe siç i garantohet me aktet juridike pozitive.

Komitet i të Drejtave të Njeriut ka përshkruar tiparet përmbajtësore të mjetit juridik që duhet të gëzojnë të pandehurit në procedurë penale. Për Komitetin, mjeti juridik i rishqyrtimit

nënkupton shqyrtim substancial të vendimit të shkallës së parë dhe qasje efektive në sistemin e apelit. Tipari kryesor i të drejtës për ankesë ka të bëjë me natyrën e rishikimit. Komiteti ka përmendur që, në mënyrë që të ketë pajtueshmëri me nenin 14 § 5 të PDCP-së, vendimi duhet të ketë bazë të gjerë të rishikimit, përfshirë mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave, zbatimit të ligjit material, si dhe respektimit të normave procedurale. Pra, fokusi qëndron në përmbajtjen ose përshtatshmërinë e rishikimit, e jo në emërtimin që i është dhënë mjetit juridik të përcaktuar në PDCP (Marshall, 2011, f. 18)

Rëndësia e këtij instrumenti është e shumëfishtë, e para, ky është instrumenti i parë ndërkombëtar i detyrueshëm që parasheh të drejtën për gjykim të drejtë, së dyti, e drejta për gjykim të drejtë përmban të gjitha elementet më të rëndësishme që duhet t'i gëzojë i pandehuri në procedurë penale, përfshirë këtu elementet e përgjithshme dhe të veçanta të kësaj të drejte, si dhe së treti, ky instrument përveç theksimeve të saja me anë të rregullave parasheh edhe mekanizmin për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij instrumenti, sikurse është Komiteti për Drejtat e Njeriut. Përveç kësaj rëndësie, ky instrument ka ngritur ndërgjegjësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtës për gjykim të drejtë në mënyrë të veçantë. Pothuajse të gjitha legjislacionet nacionale rregullat e tyre lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, i kanë unifikuar me këtë instrument ndërkombëtar. Përkundër periudhës së hershme të hyrjes në fuqi të tij, instrumenti edhe më tutje është adresë relevante për të zgjidhur të drejtat dhe liritë e njeriut në kontekstin global. Tani, ky instrument është bërë pjesë e pandashme e rregullave të së drejtës nacionale, duke u bërë burim reference për garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

2.2. E Drejta për gjykim të drejtë sipas KEDNJ-së

Për gjeografinë e Evropës KEDNJ[2] përfaqëson instrumentin ndërkombëtar më të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Për të siguruar respektimin e

[2] Pas përpjekjeve të vazhdueshme nga shumë shtete për të krijuar një dokument të përbashkët, ky instrument është nënshkruar në Romë në vitin 1950 nga shtetet anëtare të KE-së, me qëllim që secila palë kontraktuese dhe

obligimeve të marra nga shtetet palë, është krijuar GJEDNJ që të funksionojë në mënyrë të përhershme (KEDNJ, 1953, neni 19). Bazuar në nenin 6, ky instrument parasheh inter alia edhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Sipas nenit 6 § 1 parashihet që çdo person ka të drejtë për gjykim të drejtë, publik dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për çështjet civile, ashtu edhe për ato penale. Sipas kësaj dispozite, vendimi duhet të shpallet publikisht, por prania në gjykatore mund t'i ndalohet mediave dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare, apo kur kjo kërkohet nga interesat e personave të mitur ose nga mbrojtja e privatësisë së palëve në procedurë ose në shkallën që vlerësohet e domosdoshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta gjykimi publik do të dëmtonte vet interesat e drejtësisë. Është e rëndësishme të theksohet se këto të drejta njihen si të drejta të përgjithshme, pasi të njëjtat janë të zbatueshme në të gjitha llojet e gjykimeve. Natyrisht karakteristikat dalluese të procedurës penale merren çdoherë në konsideratë, pavarësisht se kjo normë nuk iu është dedikuar vetëm çështjeve penale.

Përveç paragrafit të parë, pjesa tjetër e nenit 6 i referohet vetëm çështjeve penale. E drejta për tu prezumuar i pafajshëm garantohet me nenin 6 § 2, ku theksohet se çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, përderisa sipas ligjit nuk është vërtetuar fajësia e tij. Ndërsa, sipas nenit 6 § 3 të KEDNJ-së, garantohen të drejtat minimale të të akuzuarit sikurse:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë të kuptueshme dhe të hollësishme për natyrën dhe për shkakun e akuzës;

b) t'i jepet kohë dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mund të mbrohet vetë ose me anë të një mbrojtësi të zgjedhur nga ai, ose në qoftë se nuk ka mjete të mjaftueshme për shpenzimet e mbrojtjes, atij t'i mundësohet ndihma ligjore falas, kur këtë e kërkojnë vet interesat e drejtësisë;

---

secili shtet evropian të sigurojë dhe garantojë të drejtat minimale njerëzore (shih: KEDNJ, të miratuar më 1950, të hyrë në fuqi më 1953).

d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e prokurorisë dhe të ketë të drejtën të thërras dhe të pyes dëshmitarët në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës dhe

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë.

a) E drejta e të pandehurit që të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë të kuptueshme dhe të hollësishme për natyrën dhe për shkakun e akuzës (neni 6 § 3 (a)) mund të nënkuptohet që të pandehurit duhet t'i jepet një përshkrim i veprës penale si dhe të gjitha rrethanat relevante që e mbështesin dyshimin apo akuzën. Kjo dispozitë nuk specifikon se informatat relevante duhet të jepen me shkrim ose, kur është e rëndësishme, të përkthyera në gjuhën e të pandehurit, pasi shprehet vetëm kërkesa që të njoftohet me natyrën e akuzave kundër tij. Është e qartë se një i pandehur që nuk flet ose nuk e lexon gjuhën në të cilën është ngritur aktakuza është në rrezik të mohohet një gjykim i drejtë (Gamble & Dias, 2008, f. 34).

b) E drejta e të pandehurit për t'iu dhënë kohë dhe lehtësirë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 6 § 3 (b)), është e lidhur plotësisht me të drejtën që i pandehuri të njoftohet menjëherë për dyshimin apo akuzën kundër tij. E drejta për lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes, përfshin ndër të tjera, mundësinë për të organizuar mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme dhe për të pasur mundësi të paraqitjes të të gjitha argumenteve. Për t'u realizuar mbrojtja e përshtatshme, prokuroria duhet të shpalosë atë që është në dosjen e lëndës kundër të pandehurit në kohë të përshtatshme dhe pa vonesa (Gamble & Dias, 2008, f. 36). Njoftimi paraprak i datës së seancës është kërkesë e domosdoshme sipas pjesës për lehtësi të përshtatshme për mbrojtje. Lehtësitë e përshtatshme për mbrojtje duhet siguruar edhe gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore. Komisioni për të drejtat e Njeriut, ka konstatuar në raste të ndryshme shkelje të të drejtës për lehtësi të përshtatshme të mbrojtjes:

1) kufizime në parashtrimet gojore të të akuzuarit dhe avokatit;

2) dështimi që gjykimi të shtyhet pasi i pandehuri i ka hequr autorizimin avokatit të tij për përfaqësim;

3) ndryshim i aktakuzës dhe

4) propozimi i dëshmitarëve për t'u dëgjuar pa paralajmërim të nevojshëm (Gamble & Dias, 2008, f. 38).

c) E drejta e të pandehurit që të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur nga ai, ose në qoftë se nuk ka mjete të mjaftueshme për të angazhuar mbrojtës, është në diskrecion të të pandehurit të vendos nëse do të përfaqësohet me avokat mbrojtës, apo do të vet-përfaqësohet në procedurë penale. Në rrethana të veçanta, i pandehuri duhet të përfaqësohet domosdoshmërisht me avokatë mbrojtës, duke ia bërë obliguese përfaqësimin e tij në procedurë penale, kur p.sh. ekziston mundësia e dënimit me vdekje. Lidhur me këtë, KEDNJ përcakton se i pandehuri duhet të ndihmohet në mënyrë efektive nga një avokat në të gjitha fazat e procedurës (Gamble & Dias, 2008, f. 39). Kjo e drejtë përfshinë dhe disa elemente të tjera të cilat e bëjnë të domosdoshme respektin adekuat, përfshirë këtu: a) të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë ne seancën e zhvilluar kundër tij; b) ndihma e nevojshme ligjore; c) përshtatshmëria e avokatit mbrojtës dhe d) komunikimi i papenguar dhe konfidencial ndërmjet avokatit mbrojtës dhe të pandehurit (Gamble & Dias, 2008, fv. 40 - 44).

d) E drejta e të pandehurit që të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës që garantohet me nenin 6 § 3, gjë që mund të shpjegohet se edhe pse çështja e pranueshmërisë së provave është kryesisht një çështje e rregullimit të brendshëm të shteteve, vlen rregulla që të gjitha provat në një gjykim penal duhet të paraqiten në praninë e të akuzuarit në një seancë publike me qëllim të realizimit të parimit të kontradiktoritetit. Kjo është e përcaktuar me parimin e *"barazisë së armëve"* në procedurë penale.

e) Në përputhje me çështjen që i pandehuri duhet të informohet menjëherë për akuzat, dhe që ai ka të drejtën e përfaqësimit dhe ndihmës juridike, neni 6 § 3 (e), parashikon që i pandehuri ka të drejtë në përkthyes kur ai nuk mund ta kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë. Kështu që një i pandehur i cili nuk mund ta kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë ka të drejtën e përkthimit ose interpretimit të lirë të të gjitha këtyre dokumenteve ose deklaratave në procedurë, që është e nevojshme për të që ai të kuptojë për të siguruar një gjykim të drejtë (Gamble & Dias, 2008, f. 50).

Megjithatë, nuk ka dallim të qartë midis garancive të përgjithshme që parashihen në nenin 6 § 1 dhe atyre specifike që parashihen në nenit 6 § 3, gjë që në vend të kësaj, jurisprudenca e GJEDNJ-së shumë shpesh kombinon garancitë e përgjithshme me ato specifike, me një qasje të tillë që e quan si *"vlerësimi i procedurave në tërësinë e saj"*. Jurisprudenca e GJEDNJ paraqet një procedurë dinamike, gjë që kjo dinamikë e posaçme krijoi parime të reja që tani përfshihen në nocionin e gjykimit të drejtë edhe pse nuk përmenden në mënyrë shprehimore, sikurse mund të themi për parimet e *"barazisë së armëve"*, apo për të drejtën për procedurë kontradiktore. Për më tepër, e drejta për gjykim të drejtë duhet t'i përshtatet më shumë veçorive të ndryshme kombëtare, andaj zbatimi praktik mund të zhvillohet në mënyrë fleksibile (Widder, 2015, f. 29-30).

KEDNJ është instrument drejtpërdrejt i zbatueshëm në Kosovë. Për shkak të problemeve të ditura politike që ka Kosova, këtë instrument nuk e ka ratifikuar sikurse shtetet tjera dhe sipas nenit 22 të Kushtetutës, ky instrument zbatohet pa ekuivoke në kuadër të rendit juridik në Kosovë. Përveç zbatimit të drejtpërdrejt të Konventës, duke përdorur teknikën e huazimit gjuhësor, përmbajtja e këtij instrumenti mund të gjendet në shumë akte të zbatueshme në Kosovë. Siç dihet, kjo teknikë ka gjetur një zbatim të gjerë praktikë nga shtetet të cilat kanë dal pas shpërbërjes së sistemit komunist (Morina, 2005, f. 117). Nëse krahasojmë përshkrimin e të drejtës për gjykim të drejtë të përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së, dhe përshkrimin e të drejtës për gjykim të drejtë të përcaktuar në nenin 31 të Kushtetutës, përshkrimi tekstual është pothuajse i njëjtë, gjë që kjo teknikë është përdorur tek shumica e të drejtave tjera kushtetuese. Pra, sistemimi i këtyre të drejta në Kushtetutë është bërë sipas një rendi logjik, ashtu sikurse ekziston në KEDNJ.

2.2.1. E drejta për ankesë sipas KEDNJ-së

E drejta për ankesë nuk është pjesë e nenit 6 të KEDNJ-së. Pavarësisht se në fillim nuk është paraparë si pjesë e nenit 6, GJEDNJ në shumë vendime të saja ka vlerësuar se e drejta e ankesës nuk mund të përjashtohet si një nga elementet më të rëndësishme që e përbëjnë të

drejtën për gjykim të drejtë. Me futjen në fuqi të protokolleve shtesë të KEDNJ, në nenin 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, garantohet e drejta e apelimit në çështje penale, ku theksohet se çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë, ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimin. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, janë të përcaktuara me akte ligjore. Kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta siç janë përcaktuar nga ligji, ose kur kërkuesi ka qenë i gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose deklaruar fajtor dhe dënuar në vijim të një kundërshtimi kundër pafajësisë së tij. Mekanizmi i cili merret ekskluzivisht në instancë të fundit me mbrojtjen e të drejtave që garantohen me anë të kësaj konvente, është GJEDNJ. Juridiksioni i gjykatës shtrihet mbi çështjet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe Protokolleve të saj, siç përcaktohet me nenet 33, 34 dhe 47 (Gruda, 2012, f. 64). Sipas nenit 13 të KEDNJ-së, garantohet e drejta për zgjidhje efektive, ku përcaktohet se çdokujt që i janë shkelur të drejtat dhe liritë e parapara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare. Bazuar në pjesën normative të Konventës, Jurisprudenca e GJEDNJ-së të drejtën për mjete efektive juridike gjerësisht e ka interpretuar, duke i dhënë një peshë dhe rendësi jashtëzakonisht të madhe për gjithë korpusin e garantuar të lirive dhe të drejtave të njeriut. E drejta e ankimimit do të ishte e zbehtë pa pjesën e garancioneve që ofron neni 13 i Konventës që garanton individin zgjidhje efektive. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, referuar praktikës së GJEDNJ-së, në rastin *Valon Bislimi kundër MPB-së, KGJK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë*, rikujton që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë (në nivel kombëtarë) të një mjeti juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventë, ne çfarëdo forme që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit. Qëllimi i nenit 13 është të kërkojë sigurimin e një mjeti juridik vendor për ta trajtuar substancën e një *"pretendimi te diskutueshëm"* sipas Konventës dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike (Valon Bislimi v. Ministria e Punëve të Brendshme, KGJK dhe Ministria e Drejtësisë, GJK, 2010, paragr. 91).

Sipas KEDNJ-së, shtetet kanë një shkallë të konsiderueshme të diskrecionit në lidhje me modalitetet e shqyrtimit të apelit, si dhe arsyet në të cilat mund të ushtrohet. Ky *"kufi i gjerë vlerësimi"*, i është atribuuar shumëllojshmërisë së gjerë të llojeve të ankesave që ekzistojnë në Evropë. Kështu, një shtet nuk do të jetë në kundërshtim me nenin 2 të Protokollit nr. 7, kur i jep të pandehurve të drejtën të paraqesin ankesë në kufijtë e përcaktuar me ligj. Për më tepër, shtetet kanë të drejtë të vendosin kufizime që rregullojnë qasjen në shqyrtimin e apelit. Megjithatë, këto kufizime duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe të mos shkelin thelbin e së drejtës (Marshall, 2011, f. 25). Kriteret të cilat vlejnë për të drejtën për gjykim të drejtë gjatë zhvillimit të procedurës penale, janë të vlefshme dhe njëllojtë të zbatueshme edhe gjatë zhvillimit të procedurës së apelit. Thelbi i të drejtës për ankesë, është që çdo person që ka marrë vendim nga instancat gjyqësore të shkallës së parë, të kenë gëzojë mundësi të atakojnë të njëjtin vendim në një nivel më të lartë gjyqësor për rishqyrtim. Kjo nuk duhet të paragjykohet dhe t'i pamundësohet asnjë personi, pavarësisht statusit apo gjendjes së tij.

Në rastin *Gurepka kundër Ukrahinës*, e GJEDNJ theksoi që shtetet palë të KEDNJ-së kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin se si do të ushtrohet e drejta e paraparë me nenin 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. Në disa vende, një i pandehur që dëshiron të apelojë mund t'i kërkohet që ai (i pandehuri) të kërkojë leje për ta bërë këtë. Megjithatë, çdo kufizim që përmbahet në legjislacionin e brendshme mbi atë të drejtën e rishikimit, duhet të interpretohet me analogjikisht me të drejtën e qasjes në një gjykatë, të mishëruar në nenin 6 § 1. Për të qenë një mjet juridik efektiv, duhet të jetë i pavarur nga çdo veprim diskrecional nga ana e autoriteteve shtetërore dhe duhet të jetë në dispozicion të drejtpërdrejtë për palët e interesuara (Gurepka v. Ukrahina, GJK, 2005, paragr. 57-61) . Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kjo gjykatë përmend se edhe pse shtetet kontraktuese gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së, megjithatë, gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazojnë vendimin e tyre të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë. Kjo bënë të mundur që i pandehuri të ushtrojë në mënyrë të përshtatshme të drejtën e ankesës. Mungesa e arsyetimit të përshtatshëm të vendimit, apo vendimi që ka arsyetim gjysmak apo nuk është fare i arsyetuar, cenon të drejtën

për gjykim të drejtë, përkatësisht vet të drejtën për lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes (Hadjianastassiou v. Greqia, GJEDNJ, 1992, paragr. 33).

Praktika e GJEDNJ-së, thekson se shteteve nuk u kërkohet të ofrojnë mundësi të pafundme për t'u ankuar. Kritere të arsyeshme mund të vendosen për ushtrimin e së drejtës për ankesë, duke përfshirë afatet kohore për paraqitjen e ankesave, pas të cilave ankesa mund të shpallet e papranueshme. Në mënyrë të ngjashme, kur një ankues nuk merr pjesë në seancat që thirren dhe nuk përgjigjet, ankesa mund të refuzohet pa e trajtuar çështjen në mënyrë meritore. Kjo nuk shkel nenin 2 të Protokollit nr. 7, sepse shërben për administrim më të mirë të drejtësisë, që ka për qëllim sigurimin e pranisë së palëve në procedurë dhe shqyrtim të plotë dhe të shpejtë të çështjes (Marshall, 2011, f. 27).

Konventa përcakton se e drejta për gjykim të drejtë plotësohet atëherë kur ndaj vendimit të shkallës së parë i pandehuri mund të atakojë duke pasur në dorë një mjet juridik të përshtatshëm. Në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike, Konventa nuk lëshohet për t'i obliguar shtetet që të plotësojnë dhe këtë kusht për të ngritur standardet e të drejtës për gjykim të drejtë. Mënyrë e përcaktimit të mjeteve juridike të jashtëzakonshme, është e drejtë e brendshme e shteteve dhe mospasja e mjeteve të tilla për të atakuar vendimin gjyqësore nga ana e të pandehurit, nuk cenon të drejtën për gjykim të drejtë. Pra, është një diskrecion i madh i shteteve të cilat kanë në dorën e tyre mundësinë për të përcaktuar të gjithë mjetet juridike të cilat do të duhej t'i kishte i pandehuri që gjatë procedurës penale të atakojë vendimet gjyqësore, për të cilët pretendon se mund të jenë bërë shkelje të natyrës procedurale, gjë që nuk iu është ofruar një gjykimi i drejtë, në harmoni me standardet e pranuara për këtë të drejtë.

2.3. E drejta për gjykim të drejtë sipas Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut

Kontinenti afrikan ka qenë një nga territoret ku më së gjati është mbajtur kolonializmi dhe skllavëria, gjë që liritë dhe të drejtat njerëzore në këtë pjesë kanë qenë të mohuara, duke mos pasur mundësi gëzimi as edhe të drejtat minimale njerëzore si të drejta natyrore.

Përfundimi i luftës së dytë botërore zgjoi ndërgjegjen e këtyre popujve për t'u çliruar dhe kërkuar lirinë dhe të drejtën për të krijuar shtetet e tyre nacionale në përputhje me të drejtën kolektive të vetëvendosjes. Shumica popujve nga territoret afrikane kanë arritur të lirohen nga kolonializmi dhe të bëhen shtete në vete, duke vënë në jetë një nga qëllimet kolektive të popullsive të tyre për të krijuar shtetet nacionale. Në vazhdën e këtyre përpjekjeve është ndërtuar Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, e miratuar në vitin 1981 si dokument i rëndësishëm për shtetet e kontinentit afrikan, përkatësisht për shtetet anëtare të Organizatës së Bashkimit Afrikan. Përmbajtja e preambulës së këtij instrumenti shpreh qartë nevojën e garantimit të të drejtave dhe lirive qytetare. Për nga rëndësia, ky instrument mund të shihet sikurse është KEDNJ për shtet evropiane. Për nga forma dhe përmbajtja, ky instrument përfshin shumicën e të drejtave të garantuara me DUDNJ, PDCP dhe KEDNJ. Instrumenti ndahet në tre grupe të marrëveshjeve konceptuale: a) të drejtat; b) obligimet dhe c) zbatimi i Kartës (EI-Obaid & Appiagyei-Atua, 1996).

Sipas nenit 7 § 1 (a) të KADNJP-së, garantohet e drejta e secilit qytetar për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe paanshme. Gjithashtu, është e garantuar e drejta për ankesë për të atakuar vendimet e organeve publike për çdo veprim që shkel të drejtat e garantuara nga instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacioni nacional. Sipas nenit 7 § 1 (b) dhe (c) të KADNJP-së, garantohet e drejta për t'u trajtuar si i pafajshëm (supozimi i pafajësisë) dhe e drejta për t'u mbrojtur nga një avokat sipas zgjedhjes së tij. Ndërsa, sipas nenit 7 § 1 (d) parashihet e drejta e të pandehurit t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor nga një gjykatë e paanshme. Edhe parimi i legalitetit është garantuar në këtë instrument, ku theksohet se askush nuk mund të dënohet për veprimet apo mosveprimet e tij, në qoftë se në kohën e caktuar nuk janë paraparë të njëjtat si vepër penale.

Sipas nenit 6 të KADNJP-së, garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë, ku theksohet se: *"Askush nuk mund të privohet nga liria e tij, përveç për arsyet dhe nën kushtet e përcaktuara paraprakisht me ligj. Në mënyrë të veçantë, askush nuk mund të ndalohet ose arrestohet në mënyrë arbitrare."* Dokumenti, sipas dispozitës së nenit 26 në mënyrë shprehimore garanton pavarësinë e gjykatave dhe objektivitetin e vendimeve që nxirren nga to. Pra, gjykatat janë të obliguara të respektojnë të gjithë dispozitat e garantuara me KADNJP. Shtetet anëtare të

Organizatës së Bashkimit Afrikan janë duke bërë përpjekje për të krijuar një Gjykatë Afrikane të tipit të GJEDNJ-së, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me KADNJP. Në këtë drejtim është nxjerrë një protokoll nga kjo organizatë për të krijuar këtë institucion ndërkombëtar në nivel të kontinentit të Afrikës, mirëpo e njëjta nuk është ratifikuar nga shumica e shteteve anëtare të organizatës.

2.4. Konventat ndërkombëtare kundër torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese

Që nga nxjerra e DUDNJ-së, si dhe PDCP, është bërë përpjekje e vazhdueshme që çështja e përdorimit të torturës të ndalohet formalisht dhe praktikisht. Tortura dhe në mënyrë të veçantë tortura e ushtruar për qëllime të arritjes tek e vërteta në procedurën penale, është një sfidë jo e zakonshme për t'u eliminuar edhe në kohën bashkëkohore. Me anë të legjislacionit të brendshëm, shtetet në aspektin formal kanë ndaluar përdorimin e torturës ndaj të pandehurit, apo dëshmitarëve. Ndërsa, rrafshin global instrumenti ndërkombëtar më i rëndësishëm për ndalimin e torturës është Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, ndërsa në nivelin rajonal, përkatësisht në nivelin e kontinentit të Evropës, instrumenti më i rëndësishëm është Konventa evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Në vazhdim do të trajtojmë këto dy instrumente ndërkombëtare, me theks të veçantë do t'i trajtojmë normat *ius cogens* të këtyre instrumenteve kundër zbatimit të torturës ndaj të pandehurve apo dëshmitarëve në procedurë penale.

Në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e OKB-së (1945), njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë, se këto të drejta burojnë nga dinjiteti i lindur i njeriut, për të nxitur respektimin universal dhe efektiv të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën e saj 39/46 të vitit 1984, miratoi Konventën kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. Siç

është theksuar në preambulë të kësaj konvente, qëllimi i miratimit të saj ka qenë që luftën kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ta bëjnë sa më efektive në botë.

Ky instrument ndërkombëtare përmban dispozita të shumta që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë për të pandehurin në procedurë penale. Me anë të këtyre dispozitave, shtetet obligohen që pandehurin, si dhe viktimën e një vepre penale të trajnojnë me dinjitet. Pra, organeve zbatuese të ligjit u ndalohet përdorimi i metodave torturuese ndaj të pandehurit në procedurë penale. Ky instrument ndalon që deri tek e vërteta të vihet me përdorimin e metodave torturuese, duke u keqtrajtuar të pandehurit, duke ia nxjerrë deklaratën me metoda të palejuara, apo edhe duke detyruar dëshmitarin të dëshmojë pa vullnetin e tij, apo sipas urdhrave të palejuar dhe duke detyruar të njëjtën të paraqes një të vërtetë tjetër që është në kundërshtim me të vërtetën materiale.

Me anë të dispozitës së nenit 4 § 1 dhe 2 të kësaj konvente, çdo shtet palë duhet të kujdeset që të gjitha veprimet e torturës të kryera individualisht apo me bashkëveprim, si dhe ato veprime torturuese që mbesin në tentativë, nga ligji i brendshëm penal duhet të konsiderohen vepra penale. Sipas dispozitës së nenit 11, çdo shtet palë detyrohet që të ushtrojë një mbikëqyrje sistematike të rregullave, udhëzimeve, metodave dhe praktikave të pyetjes dhe të dispozitave lidhur me ruajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar, të privuar nga liria ose të burgosur në çfarëdo mënyre në çdo pikë të territorit nën juridiksionin e tij, me qëllim që të mënjanohet çdo rast i torturës.

Konventa i kushton rëndësi të veçantë dëshmisë dhe deklaratës së nxjerrë me anë të torturës, ku sipas nenit 15 parashihet se në rast se deklarata e nxjerrë në këtë mënyrë, duhet të cilësohet si provë e papranueshme në procedurë penale dhe se kjo provë nuk mund të përdoret si dëshmi me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit. Sipas konventës ndalohet ekstradimi i personit të kërkuar, nëse dyshohet se të njëjtit nuk do t'i sigurohet një gjykim i drejtë në përputhje me të drejtat e garantuara procedurale, apo se ekziston supozimi se ai mund t'i nënshtrohet torturës nga organet shtetërore të zbatimit të ligjit. Me këto rregulla, shteti ka në diskrecion të vlerësojë nëse ekzistojnë kushtet e përshtatshme dhe të lejuara që një person i kërkuar të mund të ekstradohet në shtetin tjetër.

Në rast vlerësimi se dëbimi i një personi në një shtet të huaj do të përbënte një rrezik të vërtetë se i njëjti do t'i nënshtrohet torturës, sipas interpretimit të dhënë nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut shtetit që i kërkohet të bëjë ekstradimin do të duhet të marrë parasysh gjendjen faktike të çdo rasti veç e veç. Gjithashtu, duhet të kihen parasysh të gjithë elementët relevantë, përfshirë gjendjen e përgjithshme të të drejtave të njeriut në shtetin e huaj (shih raportin: Interpretation of torture in the light of the practice and jurisprudence of international bodies, 2011, fv. 15-16) .

Pra, shtetet të cilat kanë pranuar detyrimet të cilat dalin nga ky instrument ndërkombëtar, janë të obliguar t'i shmangin torturat që ndodhin në territorin ku ushtrojnë autoritetin e tyre shtetëror, që veprimet torturuese cilado qofshin ato t'i inkriminohen si vepra penale, të bëjnë shqyrtime serioze për pretendimet për dëmtimet eventuale nga tortura duke qenë këmbëngulës për rivendosjen e drejtësisë për këto raste, duke përcaktuar si objektiv serioz vënien para drejtësisë së çdo të dyshuari dhe atij t'i sigurohet gjykimi i drejtë, të përjashtohet si prova të papranueshme të gjithë dëshmitë e nxjerra me anë të torturës dhe të garantohet kompensim i dëmit për çdo të dëmtuar. Për të monitoruar respektimin e dispozitave të këtij instrumenti, sipas nenit 17 § 1 të Konventës kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (1987) është paraparë themelimi i një mekanizmi me emërtimin Komiteti kundër torturës.

Edhe Konventa evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese (1987), është instrument ndërkombëtar me karakter rajonal që ndalon përdorimin e torturës në kontinentin e Evropës. Konventa më shumë përqendrohet në krijimin dhe funksionalizimin e mekanizmave të cilat do të merren me parandalimin dhe evidentimin e rasteve të torturës. Dihet se me dispozitën e nenit 3 të KEDNJ në mënyrë shprehimore është garantuar se *"askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese."* Ky instrument si qëllim kryesor ka jetësimin e filozofisë së kësaj dispozite, përkatësisht zbatimin praktik të saj, duke respektuar në plotësi ndalesën kategori të përdorimit të torturës dhe dënimeve të tjera jo të lejuara me legjislacionin ne fuqi.

Nëse individit i shkelet e drejta që i garantohet me dispozitën e nenit 3 të KEDNJ për t'iu mos *"...nënshtruar torturës as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese"*, ai në të

njëjtën kohë mund t'i drejtohet instancave përkatëse me mjete juridike në dispozicion brenda shtetit ku pretendon se ka pasur një trajtim të tillë. Në të njëjtën kohë, mund t'i drejtohet Komitetit evropian për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, në përputhje me dispozitat e këtij instrumenti. Është një ndërmarrje e rëndësishme funksionimi i mekanizmit të vizitave për parandalimin e torturës në bazë të fakteve të paralajmëruara në vendet e ndalimit dhe përgjithësisht kontrolli i veprimeve të ndërmarra nga zyrtarët publik të zbatimit të ligjit. Miratimi konventës ka paraqitur instrument të ri në fushën e mbrojtjes nga aplikimi i torturës. Respektimi i parimeve të dokumentit garanton që puna do të kryhet në konfidencialitet (Ginther, 1990, fv. 129-130).

2. 5. E drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve tjera të detyrueshme ndërkombëtare

Përveç instrumenteve ndërkombëtare të cilat i përmendëm më sipër, janë një mori instrumentesh tjera të cilat garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, të tilla sikurse:

1) Konventa për të drejtat e fëmijës (1989),

2) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (1979),

3) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (1965), apo dhe instrumente tjera të rëndësishme.

Rëndësia e këtyre instrumenteve qëndron në faktin se të njëjtat përcaktojnë të drejta për komunitete të veçanta njerëzish, sikurse janë fëmijët, gratë, apo grupet tjera që margjinalizohen për shkak të racës apo origjinës. Është me rëndësi të theksohet se bazuar në dispozitën e nenit 22 të Kushtetutës, të gjitha këto instrumente ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

a) Konventa për të drejtat e fëmijës[3] (1989) - është instrument i rëndësishëm ndërkombëtar që parasheh mbrojtje të veçantë për persona që janë nën moshën 18 vjeçare dhe veçanërisht përmban të gjitha garancitë që fëmija si i pandehur të mund t'i gëzojë gjatë

[3] Ky instrument është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1989.

zhvillimit të procedurës penale. Sipas këtij instrumenti, personi i mitur përveç që gëzon të drejtat e përgjithshme sikurse të gjithë personat e rritur, njëkohësisht ai gëzon të drejta të veçanta në procedurë penale (shih: The right to a fair trial, Amnesty International, 2002, f. 4-5). Sipas nenit 40 § 1 të këtij instrumenti, shtetet i njohin çdo fëmije që dyshohet, akuzohet ose për të cilin pretendohet se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon tek fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën për të ndihmuar në ri-integrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv. Konventa garanton që fëmija është i mbrojtur me parimin e ligjshmërisë në të drejtën materiale, duke mos guxuar të akuzohet për një veprim apo mosveprim në një kohë kur nuk është paraparë si vepër penale. Sipas nenit 40 § 2 (b), fëmija gëzon këto garancinë minimale:

- të drejtën për prezumim të pafajësisë;

- të drejtën të informohet menjëherë në gjuhën që e kupton për akuzën ndaj tij dhe të ketë të drejtë të njoftojë anëtarët e familjes apo personat që kujdesen për të;

- të drejtën që çështja e tij duhet të trajtohet pa vonesa nga një gjykatë kompetente, e pavarur, e paanshme dhe e themeluar me ligj;

- të drejtën për mos-inkriminim dhe të drejtën në barazi të mjeteve me prokurorin e shtetit;

- të drejtën e përdorimit të mjeteve juridike si e drejtë e garantuar kundër një vendimi fajësues të marrë në shkallë të parë;

- të drejtën për përkthyes, si të drejtë të garantuar në gjithë rastet kur ai nuk flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura penale dhe garancinë tjera.

Sipas nenit 40 § 3, secili shtet që respekton dispozitat e këtij instrumenti, duhet të përpiqet të nxisë hartimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të veçanta për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer vepra penale dhe në mënyrë të veçantë duhet të:

- përcaktohet mosha nga e cilat fëmija përgjigjet penalisht; apo të

- marrin masa, sa herë është e domosdoshme, për t'i trajtuar fëmijët pa iu drejtuar gjykatës, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut sipas ligjit.

Ky instrument paraqet një nga detyrimet më të rëndësishme për mbrojtjen e integritetit të fëmijës dhe është i harmonizuar me të gjithë instrumentet tjera ndërkombëtare që rregullojnë të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, e në mënyrë të veçantë të drejtën e fëmijëve për të pasur një gjykim të drejt dhe të paanshëm. Instrumenti reflekton detyrim të rëndësishëm për të gjitha shtetet për të respektuar dinjitetin e personit të mitur në procedurë penale, duke i ofruar atij të gjithë garancionet e nevojshme që të mos pësojë dëmtime të panevojshme gjatë zhvillimit të procedurave ndaj tij. Ky instrument është i zbatueshëm në shumicën e shteteve që janë anëtare të OKB-së, ndërsa sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës zbatohet drejtpërdrejt edhe në Kosovë.

b) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas[4] (1979) - është një nga instrumentet ndërkombëtare, që parasheh që edhe gratë sikurse burrat, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Sistemi i drejtësisë, duhet tu sigurojë trajtim të barabartë të për dy gjinitë. Të gjithë aktet normative të cilat përmbajnë diskriminim ndaj gruas, përfshirë në fushën penale, bazuar në dispozitën e nenit 2 të Konventës duhet të shfuqizuar në të gjitha shtetet. Sipas nenit 2 § c, shtetet janë të obliguara të vendosin një mbrojtje gjyqësore të të drejtave të grave, mbi bazën e barabartë me burrat, nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, dhe të sigurojnë mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues.

Me këtë instrument ndërkombëtar është bërë përpjekje që të vendoset një drejtësi e barabartë ndërmjet të dy gjinive pa asnjë dallim. Përkundër që shumica absolute e shteteve kanë pranuar detyrimet që dalin nga ky instrument, në shumë shtete diskriminimi faktik ndërmjet dy gjinive ende është i pranishëm. Në aspektin gjinor, pjesa me e margjinalizuar në sistemin e drejtësisë mbeten personat e gjinisë femërore, pra, ende nuk është arritur barazi e plotë ndërmjet dy gjinive dhe në sistemin e drejtësisë. Janë bërë shumë përparime në barazinë

[4] Ky instrument është miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën nr. 34/180 dt. 18 dhjetor 1979, në përputhje me nenin 27 (1) ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1981.

formale, d.m.th. në barazinë para ligjit, ku shumica e shteteve në aktet e veta formale kanë bërë barazinë ndërmjet dy gjinive, gjë që është një inkurajim për përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri, edhe pse përmirësimet më të mira janë në rrafshin praktik.

c) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor[5] (1965) - është një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin. Instrumenti përmban dispozita të rëndësishme që kërkojnë trajtim të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat pavarësisht ngjyrës apo racës. Sipas nenit 2 § 2 (a) të këtij instrumenti, shtetet që kanë pranuar këto detyrime, nuk do të duhej të bëjnë asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit racor kundër personave apo grupeve të personave. Në përputhje me detyrimet themelore të Konventës, sipas nenit 5 të saj, shtetet obligohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit, sidomos lidhur me gëzimin *inter alia* të drejtës për trajtim të barabartë nga gjykatat ose nga çdo organ tjetër që administron me sistemin e drejtësisë. Ndërsa sipas nenit 8, parashihet të funksionojë Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial që do të kujdesej që shtetet të respektojnë detyrimet që dalin nga ky instrument.

3. E drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve jo të detyrueshme ndërkombëtare

3.1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Pas miratimit të Kartës së OKB-së (1945), miratimi i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, shënon një moment të rëndësishëm. Kjo Deklaratë ishte akti i parë ndërkombëtar i nxjerrë nga OKB që proklamon të drejtat dhe liritë e njeriut. Një përpjekje e tillë dha rezultate të mëvonshme, pasi e njëjta u bë adresa kryesore e ndërtimit të rregullave të rëndësishme ligjore në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Bazuar në përmbajtjen e saj, u hartuan shumë dokumente të rëndësishme

[5] Ky instrument është miratuar dhe hapur për nënshkrim e ratifikim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën nr. 2106 A (XX) dt. 21 dhjetor 1965, në përputhje me nenin 19 ka hyrë në fuqi më më 4 janar 1969.

ndërkombëtare, duke paraparë të drejta dhe liri të shumta individuale dhe kolektive, gjithashtu shumë shtete përshtaten rregullat e paraqitura në të, duke i përvetësuar në legjislacionet e tyre. Me këtë instrument ndërkombëtar, e drejta për gjykim të drejtë parashihet si një e drejtë themelore në procedurën penale. Megjithëse kjo deklaratë përbënte iniciativën më të rëndësishme të të drejtave të njeriut në historinë e së drejtës ndërkombëtare, asaj i mungonte mekanizmi i zbatimit, pasi nënshkruesit që shkelin dispozitat e Deklaratës, asnjëherë nuk u ngarkuan me sanksione sipas rendit publik ndërkombëtar (Gamble & Dias, 2008, f. 30).

Deklarata proklamon të drejtën që secilit person t'ia ruaj dinjitetin njerëzor, duke përjashtuar çdo mundësi që dikush të mund t'i nënshtrohen torturës. Tortura sipas këtij instrumenti nuk duhet të gjejë hapësirë në asnjë vend, si dhe duhet dhënë të drejtë të gjithë personave të mos ndalohen dhe paraburgosen në mënyrë arbitrare. Përveç kësaj, e drejta për përdorimin e mjeteve juridike parashihej për të gjitha rastet kur pretendohet se shkelen të drejtat e përcaktuara me ligj. E drejta për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe publik (neni 10) i garantohet secilit pa asnjë dallim, gjithashtu edhe supozimi i pafajësisë është i njohur edhe nga ky instrument ndërkombëtar. Sipas nenit 11, secili që akuzohet për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm përderisa sipas ligjit të vërtetohet fajësia në një proces publik në të cilin të pandehurit i sigurohen të gjitha garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij. Përveç kësaj, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit për rastet penale është i përfshirë në nenin 12, ku parashihet që askush nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime, përderisa në kohën kur janë kryer ato, nuk përbënin një vepër penale. Gjithashtu, nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale (Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948).

Deklarata në kohën kur është nxjerrë nuk ka pasur ndonjë obligim juridik për shtetet anëtare të OKB-së, por ky dokument mbahet mend si një nga aktet juridike që patën jehonë dhe ndikim të madh në hartimin dhe fillimin e një procesi të rëndësishëm për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në periudhat e mëvonshme. Në fillim të iniciativës së hartimit të këtij instrumenti, shtetet paraqitën rezerva sa i përket peshës, rëndësisë dhe përgjegjësive që dalin nga ky dokument, pasi shumica e anëtarëve të OKB-së nuk ishin të interesuara të krijojnë dokument që prodhon obligime për to. Autorët Sahiti & Murati (2016) theksojnë se Deklarata

nuk ka karakter obligues, por ka karakter deklarativ. Megjithatë normat e saj përgjithësisht pranohen nga shtetet bashkëkohore, pasi të drejtat dhe liritë që i parasheh ky instrument, janë kategori të pranuara universalisht nga gjithë shtetet (f. 14).

3.2. Tërësia e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave në çfarëdo forme të arrestit ose burgut

Tërësia e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave në çfarëdo forme të arrestit ose burgut (1988),[6] përmban standarde të rëndësishme për mënyrën e trajtimit të personave të ndaluar ose të burgosur. Edhe pse këto standarde nuk janë kritere të reja, por paraqesin sistemin më të avancuar dhe më të konsoliduar të trajtimit të personave të ndaluar ose të burgosur, rregulla këto që mund të shërbejnë për shtetet të caktuara për të ndërtuar kuadrin ligjor të brendshëm, duke përafruar mbrojtjen e të drejtave të personave të ndaluar apo të burgosur me standardet bashkëkohore ndërkombëtare.

Në funksion të realizmit të gjykimit të drejtë, ky instrument ka paraparë praktikat më të mira që duhet t'i gëzojë i ndaluari apo i burgosuri. Instrumenti është i ndërtuar mbi bazën e 40 parimeve themelore, duke mundësuar shteteve të adoptojnë përmbajtjen tekstuale si pjesë integrale në sistemet e tyre të brendshme, për të mundësuar standardet më të larta të trajtimit për personat e ndaluar, të paraburgosur, apo të burgosur. Instrumenti udhëzon autoritetet shtetërore që trajtimi i personave të arrestuar duhet bërë me dinjitet dhe nuk duhet nënshtruar trajtimit që bie në kundërshtim me rregullat bashkëkohore të trajtimit të personave të ndaluar ose të burgosur. Paraburgimi duhet të caktohet vetëm nga autoritetet gjyqësore dhe nuk bënë që funksionet gjyqësore t'i ushtrojnë autoritete tjera të cilat mund të abuzojnë dhe bie në kundërshtim me rregullat themelore parimit të ligjshmërisë.

Sipas parimit 8, autoritetet shtetërore udhëzohen që në rastet kur personat të cilët nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë, duhet trajtuar si të pafajshëm dhe nuk bënë t'i

[6] Ky instrument është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën nr. 43/173, dt, 9 dhjetor 1988.

nënshtrohen regjimit programor ose disiplinor të burgut, sikurse personat e dënuar. Pra, ndaj tyre duhet vepruar sipas parimit të prezumimit të pafajësisë, ku përveç kufizimit të lirisë që mund të bëhet nën masat e përcaktuara me ligj, ata duhet trajtuar si çdo qytetarë tjetër. Sipas rregullës 10 parashihet që çështja e caktimit dhe vazhdimit të paraburgimit, duhet të bëhet vetëm sipas ligjit dhe duhet të jetë në diskrecion vetëm të gjyqtarit dhe në asnjë rrethanë këtë nuk mund të bëjë dikush tjetër që nuk ushtron funksione gjyqësore. Gjatë kësaj faze, personi i ndaluar ka të drejtë që të ushtrojë të drejtat e tij të mbrojtës, qoftë personalisht, apo sipas dëshirës së tij të angazhojë avokat mbrojtës që ta mbrojë dhe t'ia përfaqësojë interesat e tij në procedurë penale.

Sipas parimit 18 parashihet e drejta e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës nga momenti i ndalimit ose arrestimit. Të pandehurit i garantohet fshehtësia e komunikimit ndërmjet tij dhe avokatit, ndërsa çfarëdo dëshmie e cila mund të nxirret nga ky komunikim përbënë provë juridikisht të papranueshme, përveç rasteve kur bëhet fjalë për ndonjë vepër tjetër penale, e që bashkëpjesëmarrës mund të jetë avokat mbrojtës dhe klienti i tij. Në të gjithë rastet kur personi nuk mund të angazhojë avokat mbrojtës, dokumenti udhëzon që shteti të sigurojë një avokat mbrojtës të përgatitur, për t'i ushtruar funksionet e mbrojtjes në emër të personit të ndaluar apo të paraburgosur. Avokati mbrojtës duhet të ushtrojë mbrojtje efektive dhe personi nuk duhet të pësojë nga mungesa e profesionalizmit dhe angazhimit të tij në procedurë penale në çështjen ndaj tij. Ndërsa sipas parimit 21 të këtij instrumenti, parashihet që gjatë periudhës së ndalimit ose mbajtjes së paraburgimit, i pandehuri duhet të trajtohet i barabartë dhe është e ndaluar që ai të vendoset në kushte të atilla që të pranojë diçka në lidhje me veprën penale që dyshohet apo akuzohet, kundër vullnetit të tij. Trajtimi torturues, çnjerëzor, poshtërues, apo denigrues është i ndaluar, gjë që provat të cilat mund të nxirren nga një trajtim i tillë duhet të mos pranohen në procedurë penale. Në këtë mënyrë asnjë vendim nuk mund të bazohet në dëshmi të nxjerra në kundërshtim me ligjin dhe parimet themelore universale të pranuara ndërkombëtarisht. Kohëzgjatja e marrjes në pyetje nga zyrtarët e autoriteteve shtetërore, duhet të jenë në përputhje me parimet bazë të pranuara, dhe nuk duhet të bien ndesh me vullnetin e personit që merret në pyetje, si dhe ndalohet që personi të

merret në pyetje gjatë kohës kur është caktuar periudha e gjumit, apo ka lodhje të tepërt dhe nuk është i gatshëm të përgjigjet në pyetjet të cilat i bëjnë autoritetet kompetente shtetërore.

Parimet e përmendura më sipër ne mund t'i shikojmë në dy rrafshe. *E para*, këto parime paraqesin rëndësi të veçantë për shkak të përmbajtjes që ato paraqesin në funksion të ruajtjes dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të personave të ndaluar dhe të arrestuar për ndonjë dyshim të veprës penale. *E dyta,* këto parime nuk për zbatimin e këtyre parimeve është përcaktuar ndonjë mekanizëm për të monitoruar respektimin e tyre në praktikë. Pasi të njëjtat nuk janë marrëveshje ndërkombëtare sikurse paraqesin rregullat që derivojnë nga PDCP apo instrumente e tjera, por megjithatë këto mbesin parime udhëzuese të cilat ndihmojnë autoritetet shtetërore përkatëse për të ndërtuar kuadër ligjor të pranuar në harmoni me rregullat bashkëkohore për trajtimin e personave të ndaluar, arrestuar, paraburgosur ose të burgosur.

Përveç rëndësisë së sipërpërmendur, këto rregulla paraqesin peshë të rëndësishme në trajtimin e situatave të personave të ndaluar ose të arrestuar, lidhur me të drejtat e tyre për gjykim të drejtë. Sikurse është e ditur, e drejta për gjykim të drejtë nuk është e lidhur vetëm me procedurën që fillohet në gjykatë, por është e lidhur me të gjitha veprimet procedurale në procedurë penale, pra nga momenti kur subjekti kupton ndërhyrjen e autoriteteve të shtetit tek ai, e deri në përfundim të çështjes kundër tij. Çështja e masës së ndalimit ose arrestit dhe sidomos çështja e paraburgimit dhe burgimit, është një nga temat më të ndjeshme që adresohen në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo qëndron kështu për faktin, pasi personi në këtë mënyrë, në mënyrë të prekshme ndjen pushtetin represiv të shtetit ndaj tij, ku dhe gjatë kësaj periudhë është nën administrimin e pushtetit shtetëror, gjë që nga ky trajtim varen edhe të drejtat dhe liritë e tij themelore.

3.3. Parimet themelore për rolin e avokatëve

Parimet themelore për rolin e avokatëve[7] paraqet konkretizim të standardeve të vendosura nga instrumentet ndërkombëtare, sikurse është PDCP, DUDNJ, apo të instrumentit tjetër *"Tërësia e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave në çfarëdo forme të arrestit ose burgut".* Këto instrumente kërkojnë nga shtetet që ndaj personave të cilët ndalohen, arrestohen, apo ndaj tyre ka dyshim të caktuar apo ndonjë akuzë në procedurë penale, tu japin të drejtë të kenë avokat mbrojtës gjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale. Ashtu edhe siç parashihet në këtë akt, për t'iu përgjigjur maksimalisht natyrës së rastit që ka i pandehuri, mbrojtja nuk duhet të jetë vetëm formale, por duhet të jetë efektive dhe e përshtatshme. Pasi, mbrojtja adekuate mundëson përfaqësim të interesave të të pandehurit në procedurë penale, për të zvogëluar maksimalisht mundësitë që procedura penale të mund të devijojë larg një procedure penale jo të ndershme.

Sipas parimeve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij instrumenti, theksohet që për të pasur gjykim të drejtë, është e domosdoshme që interesat e të pandehurit në procedurë penale të përfaqësohen në mënyrë profesionale. Nëse i pandehuri nuk është në gjendje të përfaqësohet vet, ai ka të drejtë të angazhojë avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij. Në rast se ai nuk ka mundësi financiare të bëjë një gjë të tillë, atëherë shteti duhet të krijojë mundësi që ai të ketë avokat mbrojtës të përshtatshëm për t'i përfaqësuar interesat e tij në procedurë penale. Përveç të drejtës për avokat mbrojtës, i pandehuri ka të drejtë që shërbimet profesionale të avokatit mbrojtës të jenë në përputhje me kërkesat dhe interesat e tij në procedurë penale. Ofrimi i këtyre mundësive nuk duhet të jetë objekt i trajtimit diskriminues për çfarëdo natyre. Përveç kësaj, në këtë instrument bëhet thirrje që për të gjithë të pandehurit, gjatë marrjes së avokatit mbrojtës, apo edhe gjatë përfaqësimit të interesave të tij në procedurë, trajtimi duhet të bëhet mbi bazën e kritereve të barazisë dhe mos-diskriminimit (Parimet themelore për rolin e avokatëve, OKB, 1990).

[7] Dokumenti është miratuar në vitin 1990 në Kongresin e tetëmbëdhjetë të OKB-së për parandalimin e kriminalitetit dhe trajtimin e personave të pandehur.

Ndërsa, sipas parimeve 5, 6, 7 dhe 8 të këtij instrumenti, me rastin e realizmit të procedurës penale janë përcaktuar standarde të veçanta. Kërkohet që personi posa të ndalohet ose arrestohet, të njoftohet për të drejtën e tij për avokat mbrojtës. Në rastet kur i pandehuri nuk ka mundësi që vet të angazhojë, sikurse e përmendëm më sipër, atëherë atë duhet siguruar shteti me fonde publike. Varësisht nga natyra e veprës penale për të cilën ngarkohet i pandehuri me akuzë, avokati duhet të jetë kompetent për të përfaqësuar atë. Qasja për avokat mbrojtës duhet të jetë e shpejt dhe pa vonesa. Në të gjitha rastet kjo mundësi nuk duhet t'i kalojë 48 orë nga momenti i ndalimit apo arrestimit, në të kundërtën, të pandehurit i mohohet një e drejtë themelore në procedurë penale dhe cenon të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Gjatë kohës së ndalimit, apo qëndrimit në paraburgim, i pandehuri gëzon të drejtën e plotë të komunikojë lirisht me avokatin e tij mbrojtës, të ketë të drejtën të bëjë komunikim konfidencial dhe të pacenuar nga autoritetet shtetërore, apo nga kushdo tjetër (Parimet themelore për rolin e avokatëve, OKB, 1990).

Ky instrument nuk është pjesë e instrumenteve të detyrueshme ndërkombëtare dhe nuk është i hapur për t'u ratifikuar apo aderuar nga ndonjë shtet. Megjithatë instrumenti paraqet vullnetin e gjithë anëtarëve të OKB-së, që të përafrohen zgjidhjet më progresive që i pandehuri të gëzojë të drejta të plota në procedurë penale. Instrumenti si i tillë, nëpërmes mbrojtjes me avokat mbrojtës në procedurë penale, adreson në instancë të fundit çështje të rëndësishme për realizimin e të drejtave të njeriut në këtë procedurë. Të gjithë këto bëjnë të mundshme përafrimin e mundësive, që në procedurë penale të realizohen standardet e gjykimit të drejtë.

4. Konceptualizimi i instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë në procedurën penale në Kosovë

Në procedurën penale në Kosovë, përveç zbatimit të akteve shtetërore të brendshme, njëkohësisht janë të zbatueshme edhe disa instrumente ndërkombëtare. Kjo është mundësuar nga përfshirja e drejtpërdrejt e këtyre instrumenteve në nenin 22 të Kushtetutës së miratuar në vitin 2008, ku parashihet që: "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe

instrumentet ndërkombëtare, garantohen me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe në rast konflikti kanë prioritet ndaj ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese."

Teknika e sipërpërmendur nuk është mundësia e vetme që është përdorur për përfshirjen e përmbajtjes së instrumenteve ndërkombëtare në sistemin kosovar, pasi janë përdorur edhe teknika tjera, sikurse është ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare dhe teknika e huazimit gjuhësor, ku përmbajtja e instrumentet merret dhe vendoset si dispozita të ligjit dhe më pas ligji merr miratimin nga parlamenti. Për shumë arsye, teknika më e shpeshtë që përdoret është teknika e huazimit gjyqësor, kjo për shkak se shteti kosovar ende nuk është pjesë e disa nga organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, sikurse është Këshilli i Evropës apo OKB-ja, gjë që shumica e instrumenteve ndërkombëtare derivojnë nga iniciativa e ndërmarrë në këto organizata. Qasja moniste që është zbatuar me përfshirjen e instrumenteve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm, ka ndikuar që standardet që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë të përafrohen me parimet e këtyre instrumenteve. Kjo mund të shihet edhe në formën dhe përmbajtjen që ka neni 31 i Kushtetutës së miratuar në vitin 2008, që është harmonizuar me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 14 të PDCP-së.

Megjithatë, mos-përfshirja e shtetit të Kosovës në këto organizma ndërkombëtar shkakton drejtpërdrejt mohim të arritjes së drejtësisë në një nivel më të lartë se sa niveli kombëtar, pasi pamundësia e arritjes së çështjeve që mund të parashtrohen nga subjekte të

autorizuara pranë GJEDNJ, apo Komitetit për të Drejtat e Njeriut, cenon të drejtën e subjekteve për tu qasur në drejtësinë ndërkombëtare. Rëndësia e pjesëmarrjes së shtetit në këto organizma është e shumëfishtë, kjo do të prodhonte përgjegjësi më të madhe në marrje të vendimeve nga instancat e brendshme, do të konsolidonte mënyrën e trajtimit të çështjeve, si dhe do të ndihmonte në ndërtimin e një sistemi konsistent të drejtësisë në vend.

KAPITULLI III

E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË NË JURISPRUDENCËN NDËRKOMBËTARE

1. E drejta për gjykim të drejtë në gjykatat ndërkombëtare

Standardet për të drejtën në gjykim të drejtë nuk kufizohen vetëm në instrumente ndërkombëtare, pasi këto standarde janë të përfshira edhe në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare. Lufta e parë dhe sidomos lufta e dytë botërore solli pasoja të pariparueshme për njerëzimin, ndërsa shkaktarët e krimeve të kësaj lufte asnjëherë nuk ishin ballafaquar me drejtësinë. Kultura e mosndëshkimit ishte irrituese dhe për këtë shkak ishte e domosdoshme që kryerësit e këtyre krimeve të gjykohen dhe të dënohen sa më parë. Një rol të rëndësishëm në përhapjen e idesë së krijimit të një gjykate për të dënuar kriminelët e kësaj lufte, ishte vet krijimi i OKB-së. Siç edhe përshkruhet në Kartën e OKB-së (1945) qëllimi i themelimit të kësaj organizate ishte ruajtja e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare, me qëllim të parandaluar dhe mënjanimit të kërcënimet e paqes, si dhe për të zgjidhur me mjete paqësore sipas parimeve të drejtësisë dhe të drejtës ndërkombëtare konflikte apo situata ndërkombëtare, që do të mund të çonin në shkelje të paqes (Karta e OKB-së, 1945, neni 1). Funksionalizimi i OKB-së bëri që të merren hapa konkrete në ndërtimin e kapaciteteve ligjore dhe vendosjen e parimeve fundamentale për gjykimin e personave të përfshirë në krimet e kryera.

Qeveritë e SHBA-së, Britanisë së Madhe, Francës dhe Bashkimit Sovjetik, më 8 gusht 1945, në Londër kanë nënshkruar marrëveshjen për ndjekjen dhe dënimin e kriminelëve kryesorë të luftës së shteteve të boshtit për gjeografinë evropiane (Gruda, 2012, f. 297), ndërsa në dhjetor 1946 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë që konfirmon parimet e pranuara me Statut dhe aktgjykim të Gjykatës së Nyrnbergut, si parime të së drejtës ndërkombëtare, ku nga 7 parimet e paraqitura, garantohet parashihej që cilido person i akuzuar për krime, sipas të drejtë ndërkombëtare ka të drejtë për një gjykim të drejtë (Gruda, 2012, f. 298). Dokumenti që parashihte disa të drejta për personat e pandehur pranë kësaj gjykate, ishte Karta e Gjykatës Ushtarake. Sipas kapitullit IV të këtij dokumenti, parashihej e

drejta për gjykim të drejtë për të pandehurit, ndërsa sipas nenit 16 § 1, parashihej që aktakuza duhet të përfshijë të dhëna të plota dhe të hollësishme ndaj të të pandehurve, ku nga një kopje e aktakuzës dhe dokumenteve tjera përbërëse të aktakuzës, duhej t'i jepet të pandehurit në gjuhën që ai kupton dhe në një kohë të arsyeshme para zhvillimit të procesit gjyqësor. Sipas nenit 16 § 1, parashihej që të pandehurit mundësohej të jep sqarime lidhur me aktakuzën, qoftë në fazën para ngritjes së akuzës, apo gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore. E drejta për të përdorur gjuhën të cilën i pandehuri e kupton, ishte një e drejtë e garantuar me nenin 16 § 3, qoftë përdorimin e gjuhës gjatë fazës paraprake, apo gjatë fazës së zhvillimit të procesit gjyqësor. Përveç të drejtës për përdorimin e gjuhës që ai e kupton, ai kishte të drejtë të pranojë materialet gjyqësore në të njëjtën gjuhë. E drejta për t'u mbrojtur vet, ose me ndihmën e një mbrojtësi, në rastin e tillë të një avokati, ishte e garantuar me nenin 16 § 4. Ndërsa me nenin 16 § 5, i pandehuri qoftë në mënyrë të pavarur, qoftë me ndihmën e avokatit mbrojtës kishte të drejtë të propozojë dhe paraqes prova në favor të tij dhe në të njëjtën kohë kishte të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët e propozuar nga prokuroria, duke siguruar në këtë mënyrë kontradiktoritetin e procedurës penale, apo dhe *"barazinë e armëve"*. Përveç Gjykatës së Nyrnbergut, për krimet e kryera gjatë luftës së dytë botërore është formuar edhe Gjykata e Tokios, ku kjo gjykatë për mbështetje ka pasur rregullat e Gjykatës së Nyrnbergut.

Duhet thënë se në kohën kur janë zhvilluar procedura gjyqësore në këto gjykata, në rrafshin ndërkombëtar nuk ka ekzistuar asnjë instrument ndërkombëtar që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Megjithatë, nga ajo çfarë trajtuam mund të shprehemi se në rregullat formale kanë ekzistuar parime që mundësojnë zhvillimin e procedurës gjyqësore në mënyrë të drejtë, afërsisht sikurse ne i njohim sot. Ndërsa, çështja tjetër se sa kanë qenë të zbatueshme dhe sa janë respektuar këto rregulla dhe se në të vërtet a kanë gëzuar të pandehurit gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kjo megjithatë është dimension tjetër që shumë herë është vështirë i matshëm. Idenë e themelimit dhe të funksionimit të kësaj gjykate mund ta shohim në anën tjetër të medaljes, ku mund të kuptohet se pavarësisht krimeve që kryejnë palët ndërluftuese, asnjëra palë nuk ka të drejtën që në mënyrë arbitrare dhe pa gjykim t'i eliminojë apo t'i vendos individët e palës kundërshtare në kushte të atilla çnjerëzore, poshtëruese apo denigruese. Nisur nga kjo, tanimë është ndërtuar bindja që pavarësisht

luftërave dhe konflikteve që ndodhin, gjykimi dhe dënimi i krimeve të luftës duhet të bëhet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Në periudhat e mëvonshme, gjykatat ad hoc edhe gjatë viteve të 90'ta u krijuan nga OKB-ja për të parandaluar dhe dënuar krimet që kryheshin në ish-Jugosllavi dhe ato në Ruandë.

Rëndësia e krijimit të gjykatave ndërkombëtare është e shumëfishtë. Autorja Natalya Clark (2001, fv. 522-523) si përkrahëse e gjykatave ndërkombëtare penale, përdorë disa argumente pse duhet të funksionojnë këto gjykata si të tilla, pasi ato me dhënien e drejtësisë ndihmojnë, inter alia:

- të individualizohet faji;
- të frenohet dëshira e viktimave për hakmarrje dhe
- të nxitet ndërtimi i paqes dhe pajtimin.

Përveç këtyre argumenteve, gjykatat ndërkombëtare shihen si institucionet e përshtatshme për t'i adresuar çështjet që lidhen me krimet e luftës.

2. E drejta për gjykim të drejtë në TPNJ

Ideja e themelimit të një gjykate të përhershme penale ndërkombëtare, ishte e kahershme. Duke u gjendur përballë mungesës së një gjykate të përhershme ndërkombëtare, krijimi i një gjykate për ish-Jugosllavi ishte një veprim i domosdoshëm për t'iu përgjigjur krimeve të luftës, gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit. Nisur nga kjo, Gjykata Penale Ndërkombëtare për Krimet e kryera në ish-Jugosllave (tutje: TPNJ) është krijuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së në vitin 1993 me anë të Rezolutës nr. 827. Rregullat themelore që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë pranë kësaj gjykate janë të parapara në Statutin e saj, si dhe në Rregulloren e procedurës dhe të provave. Bazuar në dispozitën e nenit 15 të Statutit, gjyqtarët e TPNJ-së kanë miratuar *"Rregulloren e procedurës dhe provave"* për kryerjen e fazës paragjyqësore, gjykimit dhe apelit, pranimit të provave, mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve dhe çështje të tjera relevante. Rregullorja është miratuar në vitin 1994, ndërsa është plotësuar dhe ndryshuar vazhdimisht, në një procedurë të njëjtë sikurse është miratuar.

Meqenëse Statuti i TPNJ-së paraqet akt të përgjithshëm, e drejta për gjykim të drejtë në mënyrë më të hollësishme parashihet me Rregulloren e procedurës dhe provave, që mund të cilësohet si instrument konkretizues që obligon instancat kompetente lidhur me zhvillimin e aktiviteteve gjyqësore. Ky dokument përmban rregulla të veçanta që ofrojnë garanci të prekshme për të pandehurin, duke filluar nga stadi i hetimeve, e deri tek stadi përfundimtar kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Lidhur me formën e funksionimit, sot ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme se procedura para kësaj gjykate, por edhe asaj të GJNP-së është e tipit të përzier në atë që përmban elemente të dy sistemeve kryesore të procedurës penale, të *"sistemit akuzator"* dhe *"sistemit inkuizitor"* (Ambos, 2003, f. 5). Procedura penale pranë këtyre gjykatave ndërkombëtare është e ndikuar nga procedura civile kontinentale, ku palët udhëheqin me procedurën penale, mirëpo nuk përjashtohet asnjëherë mundësia që gjyqtari të ushtrojë veprime të caktuara, sidomos në procedurën e provave, ku roli i gjykatës mund të jetë më aktiv. *"Roli ndërhyrës"* i gjyqtarëve duket se do të garantojë një menaxhim më efikas të gjykimit dhe të kontribuojë në shkurtimin e procedurave gjyqësore (Ambos, 2003, f. 36).

E drejta për gjykim të drejtë është e paraparë me Statutin e gjykatës, si dhe me Rregulloren e procedurës dhe të provave. Sipas nenit 21 të Statutit, parashihet e drejta për barazi, si dhe e drejta e të pandehurit për gjykim të drejtë dhe publik. Gjykimi publik mund të kufizohet sipas rasteve të përcaktuara shprehimisht kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë dhe janë rrethana të domosdoshme për të mbrojtur dëshmitarët dhe viktimat e krimit të cilat paraqiten në një çështje penale. Statuti garanton të drejtën për t'u konsideruar i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë me aktgjykim të formës së prerë. Pasi që elementet e posaçme të së drejtës për gjykim të drejtë janë pothuajse të njëjta me nenin 14 të PDCP, e që të njëjtat i trajtuam tek e drejta për gjykim të drejtë sipas instrumenteve ndërkombëtare, në vazhdim do të elaborojmë disa nga praktikat e gjykatës që lidhen me të drejtën për gjykim të drejtë.

Njëra ndër karakteristikat që përmban statuti i TPNJ-së është domosdoshmëria e pranisë fizike të të pandehurit në procedurë penale. Kjo e drejtë buron nga të drejtat themelore të përcaktuara me nenin 14 të PDCP-së, ku kërkohet me ngulm që kjo e drejtë duhet patjetër të jetësohet dhe se është e drejtë themelore e të pandehuri që të jetë i pranishëm në procedurë

penale. Me praninë fizike të të pandehurit në procedurë penale, realizohen edhe të drejta tjera të ndërlidhura, siç është:

- e drejta për t'u mbrojtur vet apo me avokat mbrojtës;

- e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata;

- e drejta për të kundërshtuar provat kundër tij, përfshirë këtu të drejtën për t'i parashtruar pyetje dëshmitarëve kundër tij, elemente fundamentale këto që përcaktojnë *"barazinë e armëve"* ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit.

Në disa nga vendimet e nxjerra nga TPNJ, e drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim është konsideruar si "*gur i domosdoshëm themeli i drejtësisë"*. Edhe pse TPNJ ka mbajtur qëndrim se e drejta e të akuzuarit për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit është një nga parimet themelore të një procesi të drejtë gjyqësor, në raste të caktuara gjykimi mund të zhvillohet në mungesë të të akuzuarit. Raste të tilla janë situatat kur i pandehuri pengon zhvillimin e procesit gjyqësor, përkundër faktit që ka marrë paraprakisht paralajmërim për këtë, ai mund të përjashtohet nga procesi gjyqësor. Edhe pse pjesëmarrja e të akuzuarit në gjykim përbën një *"të drejtë"*, ai mund të heqë dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte, pasi është informuar për pasojat e heqjes dorë, për shkak të sëmundjes apo i pandehuri nuk dëshiron të merr pjesë në procedurë gjyqësore për arsye tjera. Nga avokati i të pandehurit kërkohet që të parashtrojë gjykatës njoftimin se i pandehuri është informuar për të drejtën e tij për të qenë i pranishëm në gjykim, por në mënyrë vullnetare ka hequr dorë nga kjo e drejtë (ICTY Manual on Developed Practices, 2009, f. 93). Ndërsa, në rastet kur vet i pandehuri heq dorë nga e drejta e tij, apo rastet kur mungon përkohësisht gjatë gjykimit, nuk duhet ngatërruar me gjykimin në mungesë - *in absentia*, pasi në këto raste gjykimi zhvillohet, ndërkohë i pandehuri mungon plotësisht në një pjesë apo gjatë gjithë gjykimit. Gjykimet në mungesë nuk janë paraparë në legjislacionin e TPNJ-së, edhe pse njihet në të drejtën ndërkombëtare, ku gjykimi në mungesë nuk bie në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në mënyrë që të ndiqen kushtet e përcaktuara për rastet e gjykimit në mungesë (ICTY Manual on Developed Practices, 2009, f. 94). Pra, gjykimet në TPNJ nuk mund të fillohen pa praninë fizike të të pandehurit, ndërsa vazhdimi i gjykimit nën kushtet e përcaktuara me legjislacionin e TPNJ-së mund të bëhet edhe në mungesë të përkohshme të të pandehurit si subjekt kryesor i procedurës penale.

Kohëzgjatja e madhe e procedurave gjyqësore, është një nga çështjet të cilat e kanë përcjellë punën pranë kësaj gjykate dhe se faktorët të cilët ndikojnë në vonesa të zhvillimit të procedurave gjyqësore janë të shumëfishta. Është vërtetuar se kohëzgjatjet zakonisht ndodhin me fajin e vet të pandehurit që kërkon të vet-përfaqësohet, apo është i papërshtatshëm për të zhvilluar gjykimin kundër tij, dhe e përdorë gjykatoren si arenë të propagandimit politik, duke e devijuar në një mënyrë ose tjetrën paraqitjen dhe mbrojtjen e tij për çështjen kryesore. Këto praktika gjykata është munduar t'i ndalojë, dhe vëmendja të zhvendoset në çështjet penale që zhvillohen pranë saj. Është e vështirë që autoritetet gjyqësore të japin saktësi aritmetike për standardin e afatit të arsyeshëm, pasi shumë faktorë të tjerë duhet të merren në konsideratë lidhur me ndonjë çështje të veçantë. Lidhur me zgjatjen e një gjykimi të caktuar, praktika gjyqësore ka insistuar që përgjegjësia të përqendrohet tek shpjegimet që do të mund t'i ofrojnë autoritetet gjyqësore për zgjatjet e caktuara. Në raste të tilla nga autoritetet mund të kuptohet se kanë tejkaluar standardin kohor të arsyeshëm nëse nuk janë në gjendje të japin një shpjegim ose mund të japë vetëm një shpjegim që fajësojnë mungesën apo vështirësitë e administrimit të provave, për të cilat ka qenë e domosdoshme zhvillimi i gjykimit (Warbrick, 1998, f. 58).

2.1. Përfundimi i mandatit dhe strategjia përmbyllëse e TPNJ-së

TPNJ e themeluar në 1993, si institucion i përkohshëm, u krijua posaçërisht për hetimin e krimeve të kryera gjatë luftërave në ish-Jugosllavi dhe ndjekjen penale të përgjegjësve të këtyre krimeve. Afër dekadës së tretë të funksionimit të kësaj gjykate ende nuk janë përfunduar çështjet e ngritura pranë saj. Edhe pse që nga viti 2004 nuk ka raste të reja që janë iniciuar, të gjithë rastet tjera kanë pasur një periudhë interesante të paraqitjes, ku disa nga to kanë mbetur të stopuara për shkak të mungesës së bashkëpunimit të shteteve, e sidomos shtetit të Serbisë. Shteti i Serbisë ka prolonguar punën e gjykatës, pasi të akuzuarit e profilit të lartë, sikurse janë të akuzuarit R. Karadžić apo R. Mladić, të akuzuar për vepra penale të krimeve të luftës, përfshirë dhe akuzën për gjenocid, nuk janë dorëzuar me vite nga këto shtete për t'u gjykuar, dhe pikërisht këto raste janë duke vazhduar ende për t'u gjykuar. Këta të akuzuar të cilët nuk iu

janë përgjigjur drejtësisë me kohë, vazhdojnë të prolongojnë punën e gjykatës tash e kësaj dite, me anë të veprimeve destruktive në gjykatore dhe jashtë saj, gjë që drejtpërdrejt varet efikasiteti i procedurës në çështjet penale kundër tyre.

Me Rezolutën nr. 1503 (2003), Këshilli i Sigurimit të OKB-së, bëri thirrje që të gjitha hetimet e nisa nga TPNJ duhet të përfundohen më së largu deri në vitin 2004, ndërsa proceset gjyqësore të shkallës të parë duhet të përfundojnë më së largu deri në fund të vitit 2008, ndërsa gjithë puna e gjykatës duhet të përfundojë më së largu deri në vitin 2010. Me qëllim të përcjelljes së përmbushjes së Strategjisë Përmbyllëse, me Rezolutën nr. 1534 (2004) të Këshillit të Sigurimit, kërkohet që gjykata për çdo gjashtë muaj duhet t'i paraqes Këshillit të Sigurimit vlerësime të hollësishme lidhur me përparimin e bërë në zbatimin e Strategjisë Përmbyllëse. Pavarësisht afateve të përcaktuara në mënyrë të vazhdueshme, nga Letra e datës 17 maj 2017, e shkruar nga Presidenti i TPNJ-së, drejtuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, përmend se TPNJ mbetet e angazhuar për të mbyllur punën e tij deri në fund të vitit 2017. Në veçanti, mbetet i angazhuar për përfundimin e çështjeve përfundimtare në kohë dhe në mënyrë të shpejtë, duke pasur parasysh se parimet e drejtësisë dhe procesi i rregullt janë parësore. Edhe përkundër këtyre zotimeve, edhe gjatë këtij viti (2018) është duke vazhduar punën TPNJ.

Zgjatja mund të ketë ardhur si pasojë e rregullave procedurale të cilat nuk iu janë përshtatur rrethanave të tanishme bashkëkohore, pasi nuk janë përqafuar rregulla fleksibile të cilat japin mundësi që prokurori të mbledh të dhëna si në dëm, ashtu edhe në dobi të të akuzuarit. Rregullat e përcaktuara për funksionimin e TPNJ-së, kanë qenë më shumë karakteristikë e tipit inkuizitor, ku prokurori ka përfaqësuar akuzën në kuptimin klasik, ndërsa i akuzuari më pas ka pasur mundësi si përgjigje të paraqes dhe dëshmi tjera të cilat në fazat e mëvonshme e kanë ngarkuar zhvillimin normal të çështjes gjyqësore. Përveç kësaj, gjykata ka funksionuar jashtë territorit nga ku kanë qenë të akuzuarit dhe ku kanë ndodhur krimet, gjë që në masë të madhe ka ndikuar në efikasitetin e tillë. Nuk duhet harruar se gjykimi i krimeve të luftës nuk është një proces i zakonshëm, apo i krahasueshëm me krimet të cilat ndodhin brenda juridiksioneve shtetërore. Gjykimi i këtyre krimeve është më i komplikuar dhe kërkohet mund dhe angazhim i madh për të siguruar që përfundimi i gjykimeve të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara për një gjykim të drejtë.

Nga gjykimi i përgjithshëm për këtë gjykatë, kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga gjykatat ndërkombëtare për të gjykuar të pandehurit për krime lufte ka qenë objekt i kritikave të ashpra. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën janë quajtur *"shumë të kushtueshme, tepër joefikase dhe tepër joefektive ... të pasuksesshme politikisht dhe financiarisht"* (Higgins, 2007, f. 394). Në këtë kontekst, është e rëndësishme të thuhet se tani është ndërtuar bindja se ekzistenca dhe funksionimi i gjykatës për këto vite nuk e ka arsyetuar punën e saj. Sigurisht janë shumë faktorë që e kanë ngecur efikasitetin e adresimit të krimeve të luftës, por me një planifikim dhe analizë me të mirë, sigurisht se do të mund të ishte bërë shumë më shumë në trajtimin e krimeve të luftës. Shumë krime që janë kryer në hapësirën e ish-Jugosllavisë nuk janë proceduar për tu shqyrtuar nga kjo gjykatë, disa për arsye të kapaciteteve të vogla të gjykatës, e disa të tjera për shkak të faktorëve politikë apo faktorëve tjerë. Gjykata ka dështuar të vendos para drejtësisë fajtorët kryesorë të luftërave dhe se individët fajtorë asnjëherë nuk iu janë përgjigjur drejtësisë, përkundër se drejtësia bëhet edhe në emër të viktimave të krimeve të luftës. Transferimi i procedurave nga kjo gjykatë tek organet nacionale edhe më shumë ka penguar dhënien e drejtësisë, kjo për shkakun se gjykatat nacionale ende nuk janë të gatshme të udhëheqin me gjykimin e krimeve të luftës.

3. E drejta për gjykim të drejtë pranë Gjykatës Ndërkombëtare Penale

Ideja e krijimit të Gjykatës së Përhershme Penale ka qenë e kahershme. Draft-dokumenti ndërkombëtar për të themeluar një gjykatë të përhershme penale ndërkombëtare ka marrë një kohë relativisht të gjatë. Draftet fillestare të statutit të gjykatës filluan të dalin nga komitetet e OKB-së në vitin 1951, por polarizimet mes dy blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë pezulluan idenë e një gjykatë të tillë. Aktualizimi i idesë për krijimin e një gjykate të tillë, mund të gjendet në një fjalim në dhjetor 1989, në të cilin kryeministri i Trinidad dhe Tobago, Arthur N. R. Robinson, në një sesion të posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, propozoi një gjykatë penale ndërkombëtare për t'u marrë me çështjen e trafikut të drogës. Ideja e

Robinsonit për të krijuar një gjykatë të tillë vetëm për drogë u hodh poshtë në Komisionin Ndërkombëtar të Drejtësisë, por debati mori një pamje më të gjerë pasi në vitin 1992 u propozua që të krijohet një një gjykatë penale ndërkombëtare (Gaynor & Morris, 2008, fv. 815-819). Në lidhje me këtë ide, administrata e Presidenti republikan George HW Bush shprehu rezerva, megjithëse SHBA-të vazhduan të nxisin bashkëpunimin transnacional për të luftuar trafikun e drogës dhe terrorizmin. Në vitin 1993, administrata e presidentit demokrat Clinton, shpalli *"interesin e rëndësishëm dhe pozitiv"* të SHBA-ve për një Gjykatë Ndërkombëtare Penale. SHBA-të ndihmuan në hartimin e statutit të GJNP-së, si dhe të gjykatave ad hoc, sikurse ishte ajo për krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe ajo për Ruandë (Amann & Sellers, 2002, fv. 383-384).

GJNP-ja është themeluar me Statutin e Romës në vitin 1998. Sipas nenit 1 të Statutit, GJNP-ja është një institucion i përhershëm dhe ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare dhe është plotësim i juridiksioneve penale kombëtare. Sipas nenit 4 § 2, gjykata nuk ka juridiksion universal për të ndjekur dhe gjykuar krimet që ndodhin ku do në botë, ajo mund të ushtrojë funksionet dhe kompetencat e saj, ashtu siç parashikohet në Statut, në territorin e çdo shteti palë dhe, me anë të një marrëveshjeje të veçantë, në territorin e çdo shteti tjetër. Miratimi i Statutit të GJNP-së në Romë, hapi shpresa të reja dhe ngriti sfida të reja për drejtësinë penale ndërkombëtare. Ndryshe nga statutet e tribunave ad hoc për ish-Jugosllavinë dhe për Ruandën, të cilat u miratuan me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Statuti i GJNP-së u negociua për vite me radhë dhe përfundimisht u miratua si një traktat ndërkombëtar. Gjatë zhvillimit të negociatave lidhur me draftimin e Statutit, u bënë kompromise të shumta për ta bërë Statutin të pranueshëm për numrin më të madh të shteteve (Hunt, 2004, f. 56). Gjatë kohës së hartimit të dokumenteve përgatitore të Statutit të GJNP-së, çështja e ushtrimit të funksioneve ndjekjes dhe të gjykimit ishte pjesë e debateve dhe kërkesave të shumta. Kërkesa amerikane ishte që të futej një dispozitë që thekson se efektet e Statutit nuk do të përfshijnë edhe SHBA, apo çështja e ndjekjes të kalojë nëpërmjet dhënies së lejes nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Kjo kërkesë nuk gjeti përkrahje nga përfaqësuesit e shteteve tjera pjesëmarrëse, gjë që më pas shtyiu SHBA-të të mos pajtohen me Statutin e kësaj

gjykate. Përfundimisht, në vitin 2002 administrata e Presidentit G. W. Bush thekson se SHBA-të mbështesin ndjekjen penale për përgjegjësitë e mizorive dhe krimeve të luftës që ndodhin në mbarë botën, duke përkrahur krijimin e gjykatave të përkohshme shtesë, por jo me anë të një gjykate të përhershme ndërkombëtare (Amann & Sellers, 2002, fv. 383-385). Statuti i Romës hyri në fuqi në vitin 2002 dhe mbetet i hapur për aderim për të gjithë shtetet anëtare të OKB-së. Bazuar në dispozitën nenit 120, nuk janë të lejuara paraqitja e rezervave në asnjë dispozitë të dokumentit (Statuti i Romës, 1998).

GJNP ka paraparë rregulla që garantojnë të drejtat e të pandehurit në procedurë penale. Krahasuar me statutet e gjykatave ad hoc dhe të disa instrumente ndërkombëtare, Statuti i GJNP-së është hartuar në një periudhë kohore të mëvonshme, ku ka përfshirë gjithë kuadrin normativ të domosdoshëm nga këto tekste ligjore, që të garantojë të drejtën e të pandehurit për gjykim të drejtë. GJNP-ja ka pasur vështirësi në përcaktimin e saktë të kritereve të cilat përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë, pasi gjykimi i drejtë është një referencë e një standardi të gjerë. Ajo ka nxjerrë në mënyrë të vazhdueshme garancitë e reja procedurale nga nocioni abstrakt i *"drejtësisë"*. Për shembull, GJNP-ja ka përkufizuar të drejtën për një gjykim të drejtë si *"... mundësia e të pandehurit për të paraqitur në mënyrë të përshtatshme rastin e tij, me qëllim që rezultati procedurës të jetë në favor të tij"* (Croquet, 2011, f. 99). Statuti dhe Rregullorja e Procedurës dhe Provave, përcaktojnë një kuadër të drejtash të cilat mund të ndahen sipas ndarjes së procedurës penale që zhvillohet pranë gjykatës, filluar nga të drejtat e të dyshuarit në procedurën paraprake, gjatë zhvillimit të gjykimit dhe pas përfundimit të gjykimit.

E drejta e të pandehurit për t'u prezumuar i pafajshëm gjatë gjithë zhvillimit të procedurës gjyqësore, është e përcaktuar si e drejtë themelore me dispozitën e nenit 66 të Statutit. Në këtë dispozitë është përcaktuar se barra për vërtetimin e fajit të të akuzuarit i bie prokurorit dhe nuk bie mbi të akuzuarin dhe i njëjti është i liruar për të provuar se nuk është fajtor, edhe pse ka të drejtë të mbrohet në çështjen kundër tij. Shprehimisht në këtë dispozitë nuk përmendet parimi *in dubio pro reo*, mirëpo nënkuptohet ky parim, pasi është vendosur rregulla që kërkon nga gjykata se për të dënuar të akuzuarin, gjykata duhet të jetë e bindur në fajin e të akuzuarit dhe pa asnjë dyshim të arsyeshëm.

Në përputhje me nenin 64 § 2 të Statutit, një nga funksionet dhe kompetencat e Dhomës së Gjykimit, është që të sigurojë që gjykimi të jetë i drejtë e i shpejtë, dhe të zhvillohet me respekt të plotë për të drejtat e të akuzuarit dhe me kujdes të vazhdueshëm për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve. Një nga të drejtat themelorë të të pandehurit, sipas nenit 67 § 1 dhe nenit 43 § 7, është se gjykimi kundër tij bëhet në seancë të hapur, me përjashtim të rasteve të cilat janë të trajtuara në dispozitën nenit 68, që lidhen me mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim. Gjykata mund të vendos që gjykimi të zhvillohet nën kushtet e publicitetit të kufizuar, apo të publicitetit vetëm të palëve. I pandehuri në përputhje me nenin 67 të Statutit, ka të drejtë për një gjykim të drejtë të zhvilluar në mënyrë të paanshme.

Në funksion të arritjes së standardeve për gjykim të drejtë, Statuti ka përcaktuar garancione minimale për të pandehurin që akuzohet nga GJNP-ja. Kështu me nenin 67 § 1, garantohet barazi të plotë dhe të drejtë tjera sikurse:

a) të njoftohet menjëherë dhe në hollësi rreth natyrës, shkakut dhe përmbajtjes së akuzës, në gjuhën të cilën e kupton dhe flet i akuzuari;

b) të ketë kohë dhe mjete për përgatitjen e mbrojtjes dhe të komunikojë lirisht me avokatin e përzgjedhur;

c) të gjykohet pa vonesa të paarsyeshme;

d) të jetë i pranishëm në gjykim, të bëjë mbrojtjen personalisht ose përmes ndihmës juridike sipas përzgjedhjes së tij, ose të jetë i informuar për këtë të drejtë dhe të ketë ndihmën juridike në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, dhe pa pagesë, në rast se të akuzuarit i mungojnë mjetet e mjaftueshme;

e) të merr në shqyrtim ose të ketë shqyrtuar dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe nën kushtet e njëjta shqyrtimin e dëshmitarëve në dobi të tij, si edhe për dëshmitarët kundër tij. I akuzuari, po ashtu, ka të drejtë të paraqesë mbrojtjen dhe prova të tjera të lejueshme;

f) të ketë ndihmën e një përkthyesi kompetent pa pagesë;

g) të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajin dhe të ketë të drejtën të heshtë, dhe se heshtje të mos merret në konsideratë gjatë përcaktimit të fajit ose pafajësisë;

h) të japë deklaratë verbale ose me shkrim në mbrojtje të tij pa u betuar; dhe

i) të mos i nënshtrohet detyrimit për të vërtetuar pafajësinë e tij ose të ketë barrën për të kundërshtuar provat (Statuti i GJNP-së, 1998).

Për dallim nga gjykatat ad hoc, GJNP ka përcaktuar zgjidhje fleksibile, pasi nuk është e lidhur me praninë e të akuzuarit në ambientet fizike të gjykatores deri në fillimin e procesit gjyqësor kundër të akuzuarit. Para ngritjes së aktakuzës, sipas nenit 61 § 1, Statuti përcakton se duhet të mbahet seancë nga Dhoma e Procedurës Paraprake, seancë kjo për të vërtetuar akuzat, në bazë të të cilave Prokurori mendon të kërkojë gjykimin. Dëgjimi mbahet në praninë e Prokurorit dhe personit të akuzuar, gjithashtu edhe në praninë e avokatit të tij. Dhoma e procedurës paraprake, sipas kërkesës së Prokurorit ose sipas detyrës zyrtare, mund ta mbajë seancën në mungesë të personit të akuzuar, për të vërtetuar akuzat në të cilat Prokurori mendon të kërkojë gjykimin, në rastet kur personi:

a) ka hequr dorë nga e drejta e tij ose saj për të marrë pjesë në seancë; ose

b) është larguar ose nuk mund të gjendet dhe janë ndërmarrë të gjithë veprimet e arsyeshme për të siguruar paraqitjen para gjykatës dhe për të informuar personin rreth akuzave, si dhe për atë se do të mbahet seanca për vërtetimin e akuzave. Në këtë rast, personi përfaqësohet nga avokati, kur Dhoma e Procedurës Paraprake përcakton se kjo është në interes të drejtësisë (Statuti i GJNP-së, 1998).

Ndërsa, nga momenti i fillimit të gjykimit, i akuzuari duhet të jetë i pranishëm procedurën gjyqësore ku zhvillohet çështja penale kundër tij. Sipas nenit 63, nëse i pandehuri duke qenë i pranishëm para Gjykatës, vazhdon të pengojë gjykimin, Dhoma e Gjykimit mund ta largojë të akuzuarin dhe i krijon kushte që të ndjekë gjykimin dhe të këshillojë avokatin jashtë gjykatës, përmes përdorimit të teknologjisë së komunikimit, nëse kjo kërkohet. Masa të tilla ndërmerren vetëm në rrethana të posaçme, pasi të gjitha mundësitë e tjera të arsyeshme të jenë provuar si të papërshtatshme dhe vetëm për kohën e përcaktuar rreptësishtë (Statuti i GJNP-së, 1998).

Zhvillimi i gjykimit në mungesë është i lejuar deri në fillimin e procedurës gjyqësore në një seancë të hapur pranë dhomave gjyqësore, në rastet e tjera të mungesës, gjykimi nuk do të thotë se do të zhvillohet në mungesë, por ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat mundësojnë

një gjë të tillë, por asnjëherë pa praninë e avokatit mbrojtës të të pandehurit. Sikurse edhe në procedurën gjyqësore pranë TPNJ-së, i pandehuri mund të heqë dorë nga pjesëmarrja në gjykim, i kushtëzuar që të paraqes vullnetarisht dorëheqjen dhe të paralajmërohet për pasojat e heqjes dorë nga e drejta e tij për të qenë pjesë e procesit gjyqësor ku gjykohet çështja penale kundër tij. Sikurse e përmendëm më sipër, prania fizike e të pandehurit përderisa zhvillohet procedura në çështjen penale kundër tij, ngërthen në vetvete dhe të drejta të tjera procedurale të cilat janë të mundshme për t'u ushtruar vetëm kur është pjesëmarrës në gjykim dhe nuk mund të ushtrohen jashtë gjykimit dhe as të atakohen me anë të mjeteve juridike kundër vendimit nga dhomat gjyqësore.

Krahasuar me elementet e të drejtës për gjykim të drejtë që i trajtuam në instrumentet dhe statutet e gjykatave ndërkombëtare, mund të themi se sistemi ligjor i kësaj gjykatë është një nga më të avancuarit sa i përket kësaj të drejte. Sigurisht sistemi i tillë progresiv mund të arsyetohet falë kohës së mëvonshme kur janë ndërtuar këto parime, pasi që siç dihet shumica e të drejtave të përcaktuara në instrumentet e përmendura ndërkombëtare i takojnë një periudhë të mëhershme dhe se të njëjtat ishin të parat që u paraqitën në mbrojtjen e të drejtave të të pandehurve në rrafshin ndërkombëtar. Një faktor tjetër që duhet të merret në konsideratë në këtë rast, është se gjykatat penale i kushtojnë rëndësi të posaçme standardeve për gjykim të drejtë dhe përgjithësisht të drejtave të të akuzuarit në procedurë penale. Kjo sigurisht se do të mund të arsyetonte ekzistencën e vet gjykatës, në të kundërtën do të dëmtonte kredibilitetin e gjykatës si instancë ndërkombëtare, por edhe vet interesat e drejtësisë në përgjithësi.

3.3. Interpretimi dinamik i të drejtës për gjykim të drejtë

Të drejtat e të pandehurit të përcaktuara me instrumentet e përmendura më sipër, nuk janë vetëm rregulla formale statike, të njëjtat janë të hapura në vazhdimësi për tu plotësuar me standarde të reja që i japin dimensione të rëndësishme figurës të së drejtës për gjykim të drejtë. Të tillat janë edhe rregullat statutore dhe rregullat tjera që parashohin të drejtat e të

pandehurit për gjykim të drejtë. Duke shfrytëzuar diskrecionin në bazë të nenit 21 të Statutit, GJNP sikurse edhe GJEDNJ ndajnë të njëjtën qasje ndaj drejtësisë procedurale, duke e lënë të hapur mundësinë e interpretimit dinamik edhe të standardeve që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë. E drejta për gjykim të drejtë në procedurën penale nënkupton garancitë minimale të të akuzuarit, por përfshinë gjithashtu edhe garancitë e tjera procedurale që shprehimisht nuk janë të përcaktuara në instrumentet përkatëse statutore të GJEDNJ-së dhe GJNP-së. Në të njëjtën kohë, ky fleksibilitet normativ përpiqet të favorizojë të pandehurin, duke i dhënë diskrecion gjyqtarit që të llogarisë lëshimet procedurale që pengojnë barazinë procedurale, të cilat nuk ishin domosdoshmërisht të parashikuara nga hartuesit e teksteve përkatëse (Croquet, 2011, f. 129).

PJESA E DYTË

ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË

KAPITULLI IV

E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË PARA NJË GJYKATE TË PAVARUR

1. Vështrim i përgjithshëm mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor

Pushteti gjyqësor, së bashku me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv paraqesin tri funksionet themelore të ushtrimit të pushtetit shtetëror. Organizimi i tillë i pushtetit shtetëror qëndron në themelet e shtetit liberal, ashtu siç lindi dhe evoluoi përgjatë shekullit XVIII dhe XIX: përqendrimi i pushtetit në një qeveri të vetme, zëvendësohet nga ndarja e pushteteve mes disa organeve. Pushteti shtetëror, edhe pse në thelb mbetet unik, ndahet për të garantuar që ai të mos ushtrohet në mënyrë arbitrare apo të pa-kontrolluar (Martines, 2011, f. 126).

Pra, ndarja dhe balancimi i pushtetit shtetëror, e veçanërisht ndarja dhe pavarësia e gjyqësorit është e një rëndësie të veçantë në shoqëritë demokratike. Rëndësinë e pavarësisë së pushtetit gjyqësor si karakteristikë e demokracive të avancuara me sundim të ligjit, e proklamon edhe Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), i përkrahur nga Komisioni i Venedikut dhe Këshilli i Evropës. Në instrumentin *Magna Karta e Gjyqtarëve* (2010), theksohet se gjyqësori është një nga tri pushtetet e çdo shteti demokratik, që ka për mision të garantojë sundimin e ligjit në mënyrë të paanshme, të drejtë, të ndershme dhe efikase. Sipas *Parimeve bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit* (1985), theksohet se pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet nga shteti dhe të ruhet me anë të kushtetutës apo ligjit. Lidhur me këtë, sipas *Opinionit të KKGJE-së për standardet e pavarësisë së gjyqësorit dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve* (2001), theksohet roli i rëndësishëm që ka pavarësia e gjyqësorit lidhur me sundimin e ligjit, e veçanërisht për gëzimin e të drejtës për gjykim të drejtës. Rëndësia e pavarësisë së gjykatave qëndron në faktin se kjo pavarësi përbënë garanci praktike për qytetarët, pasi liritë themelore të tyre nuk mund të kufizohen vetëm në rastet dhe mënyrat e parapara me ligj dhe me vendim të autoriteteve kompetente gjyqësore (Martines, 2011, f. 307).

Në përputhje me këto instrumente ndërkombëtare, parimin e ndarjes së pushteteve shprehimisht e pranon edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Sipas nenit 4, paragr. 1 të saj,

theksohet se: *"Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë."* Ndërsa, sipas nenit 4 theksohet që: *"Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ"* (paragr. 2), *"Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar"* (paragr. 3), ndërsa *"Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat"* (paragr. 5). Kjo qasje që haset në Kushtetutë, i përgjigjet parimeve të përcaktuara në shumë instrumente ndërkomëbtare që trajtojnë ndarjen e pushteteve dhe reflekton qasje pragmatike që pushtetit gjyqësor t'i sigurohet pavarësi nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ.

Ndërsa në kapitullin VI të Kushtetutës, sistemi i drejtësisë përkufizohet si *tërësi unike*, ndërsa sipas nenit 102, në paragr. 1 dhe 2, ritheksohet se *pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat dhe se ai duhet të jetë unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata* (Kushtetuta, 2008). Sipas këtyre dispozitave mund të kuptohet që funksioni gjyqësor është i rezervuar vetëm për autoritetet gjyqësore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ushtrohen nga autoritete jo-gjyqësore. Ky rregull është absolut dhe nuk mund të rivalizohet, pavarësisht rrethanave të ndryshme faktike apo juridike që mund të shfaqen me zhvillime të caktuara. Meqenëse Kushtetuta edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme është në fuqi dhe nuk suspendohet, rrjedhimisht nuk parashihet që funksionet gjyqësore të mund ushtrohen nga autoritete tjera jo-gjyqësore.

2. Standardet e të drejtës për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur

E drejta e të pandehurit për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur është e garantuar me një mori instrumentesh ndërkombëtare me karakter global dhe rajonal. Kjo e drejtë është e shprehur në shumicën e legjislacioneve nacionale dhe refektohet si parakusht i domosdoshëm për të drejtën për tu gjykuar në mënyrë të paanshme. Sikurse parashihet në nenin 14 § 1 të PDCP-së apo nenin 6 § 1 të KEDNJ-së, kjo e drejtë garantohet edhe me nenin 31 të Kushtetutës

së Kosovës. E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur është element i përgjithshëm i të drejtës për gjykim të drejtë që shtrihet në çështjet penale, civile dhe ato administrative.

GJEDNJ i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtës së të pandehurit për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe të paanshme. Kjo gjykatë deri më tani ka zgjidhur një mori rastesh dhe njëkohësisht ka vendosur disa standarde lidhur me pavarësinë e gjykatave. Në çështjen *Campell dhe Fell kundër Britanisë së Madhe*, kjo gjykatë përmbledh vendimet e dhëna nga jurisprudenca e saj e mëparshme, lidhur më kriteret për pavarësinë e gjyqësorit, ku thekson se në përcaktimin nëse një gjykatë mund të konsiderohet të jetë *"e pavarur"*, veçanërisht ndaj pushtetit ekzekutiv dhe palëve të përfshira në rast, duhet të marren parasysh këto kritere:

a) mënyrën e emërimit të anëtarëve të saj;

b) kohëzgjatjen e emërimit;

c) ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe

d) çështja nëse gjykata paraqet një pamje të pavarësisë (Campell dhe Fell v. Britania e Madhe, GJEDNJ 1984, paragr. 78).

Termi *"gjykatë e pavarur"* përfshin gjithashtu edhe të drejtën për tu gjykuar nga një gjyqtar apo trup gjykues i pavarur, gjë që reflekton aspektin subjektiv të elementit të pavarësisë.

Në këtë kontekst, Komisioni i Venedikut e përpunon edhe më shumë çështjen e pavarësisë së gjykatave dhe shpreh qëndrimin se çështja e pavarësisë së gjyqësorit mund të koncpetohet në dy forma dhe atë si: *pavarësi institucionale* dhe si *pavarësi individuale*. *Pavarësia institucionale* i referohet ndarjes së sistemit gjyqësor nga pushtetet e tjera shtetërore dhe aftësisë së gjyqësorit që të veprojë si pushtet i pavarur pa ndonjë presion nga legjislativi apo ekzekutivi. Ndërsa, *pavarësia individuale* i referohet aftësisë së gjyqtarëve për të vendosur për raste të caktuara pa presion politik apo presione tjera të brendshme apo të jashtme (Opinioni nr. 712 mbi draft ligjin mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjë dhe Hercegovinës, Komisioni i Venedikut, 2014, f. 11). Kjo formë e ndarjes sikurse e përmendëm, është bërë një nga kriteret kryesore të trajtimeve lidhur me llojet e pavarësisë së gjyqësorit. Këto standarde të shprehura nëpërmes instrumenteve dhe jurisprudencës ndërkombëtare

reflektojnë *"garancitë minimale"* që shtetet me legjislacionet e tyre nacionale duhet t'i ofrojnë të pandehurit në procedurë penale.

2. Ekzistimi i mbrojtjes efektive të gjyqësorit nëpërmes pavarësisë institucionale

2.1. Organizimi gjyqësor për garantimin e pavarësisë sipas standardeve ndërkombëtare

Përpjekja e vazhdueshme e shteteve për të krijuar mekanizma të përshtatshëm që të ruajnë dhe përparojnë pavarësinë e gjyqësorit, ka mundësuar krijimin e një modeli të rëndësishëm në Evropë, sikurse është krijimi i këshillave gjyqësorë. Edhe pse ekzistojnë dy modele të organizimit të këshillave gjyqësorë, njëra që i takon shteteve të Evropës Veriore dhe tjetra që i takon shteteve të Evropës Jugore, të dy këto sisteme promovojnë pavarësinë e gjyqësorit dhe në mënyrë të përshtatshme garantojnë paanshmëri funksionale. Lidhur me këto modele, Këshilli i Evropës, Komisioni i Venedikut, OSBE-ja dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë, kanë marrë iniciativa që modelet e tilla të zbatohen në shtete të tjera që nuk e kanë të organizuar ende mënyrën e funksionimit të pushtetit gjyqësor me këshilla gjyqësorë.

Lidhur me këtë, autorët Voermans & Albers (2003, f. 13) theksojnë se promovimi i pavarësisë së gjyqësorit është një motiv i rëndësishëm për themelimin e këshillit gjyqësor. Kjo pavarësi dhe statusi i pavarur i gjyqësorit nuk është i njëjtë në të gjitha vendet. Efekti i favorshëm i këshillave gjyqësorë, pavarësisht se a bazohen në modelin e sistemit të Evropës Veriore apo asaj Jugore, mbi statusin e pavarur të gjyqtarëve dhe të organizimeve gjyqësore është i perceptueshëm në të gjitha shtetet. Ndërsa sipas instrumentit *"Magna Karta e Gjyqtarëve"*, parashihet që për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve, çdo shtet duhet të krijoj një këshill gjyqësor apo ndonjë organ tjetër, institucion i pavarur nga fuqitë legjislative dhe ekzekutive, të mbuluara me kompetenca të gjëra lidhur me statusin e tyre, si dhe me organizimin, funksionimin dhe prestigjin e institucioneve gjyqësore. Ky këshill duhet të

përbëhet ekskluzivisht nga gjyqtarët ose nga një shumicë e konsiderueshme e gjyqtarëve të zgjedhur ndërmjet tyre (neni 13).

Komisioni i Venedikut në Opinionin mbi draft-ligjin mbi këshillin e lartë gjyqësor dhe prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës (2014), përmend se themelimi dhe funksionimi i këshillave gjyqësore, si dhe aktiviteteve në kompetencat e tyre janë objekt i rregullimit nga standardet ndërkombëtare. Standardet bazë të mbrojtura në aktet ndërkombëtare të të drejtave janë më tej të specifikuara dhe elaboruara përmes një serie të instrumenteve jo-detyruese, që merren me aspekte të ndryshme të funksionimit të gjyqësorit. Këto instrumente kanë përfshirë:

- Parimet Bazë të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985),
- Parimet Bazë për Rolin e Avokatëve (1990);
- Udhëzimet për rolin e prokurorëve (1990);
- Statutin Universal të Gjyqtarëve (1999);
- Parimet Bangalore të Sjelljes së Gjyqësorit (2002); dhe
- Komisionin e OKB-së për Rezolutat e të drejtave të njeriut 2003/39: Integriteti i sistemit gjyqësor dhe 2004/33: Pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit, anëtarëve të jurisë dhe vlerësuesve si dhe pavarësia e avokatëve.

Pavarësia e gjyqësorit ka kuptimin e njëmend përderisa materializohet e drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, ashtu sikurse garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 14 të PDCP-së, nenin 10 të DUDNJ-së apo nenin 31 të Kushtetutës. Lidhur me rëndësinë që ka pavarësia e gjyqësorit, autori Trechsel thekson se nëse gjykata nuk është e pavarur dhe gjyqtarët nuk janë të paanshëm, të gjithë procedurat janë me të meta që nga fillimi. Sipas tij, është e parëndësishme nëse procedurat në këto raste janë apo jo të drejta, pasi nuk është e mundur që të ketë procedura të drejta, nëse vetë gjykata është e mangët sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë (Trechsel, 2011, f. 186). Në këtë kuptim, i njëjti autor shprehet se me termin *"pavarësi"* do të thotë se nuk duhet të ketë kontroll nga asnjë autoritet mbi gjyqtarët. Pra, askush nuk ka autoritetin të tregojë gjyqtarëve se si të gjykojnë dhe kur duhet të nxjerrët vendimi dhe se pavarësia e gjykatës imponon që autoriteti i gjykatës të

respektohet nga të gjithë, përfshirë edhe autoritetet më të larta politike (Trechsel, 2011, fv. 186-187).

Që nga çlirimi i Kosovës, në përputhje me instrumentet e trajtuara më sipër, është ndërmarrë iniciativë e vazhdueshme për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për organizimin e pushtetit gjyqësor. Ideja fillestare për organizimin e gjyqësorit nuk ka qenë ndonjë risi, pasi sistemi gjyqësor vazhdoi të funksionojë me fizionominë e ish-sistemit të kaluar, ndërsa për disa vite pushteti gjyqësor asnjëherë nuk ishte dalluar si pushtet i pavarur, sikurse do të duhej të dallohej nga sistemi ekzekutiv dhe legjislativ. Kjo periudhë tranzicioni përkundër elementëve të shumtë sfidues, pati edhe sukseset e veta, gjë që do t'i trajtojmë më tutje.

2.2. Autonomia dhe pavarësia e KGJK-së

Lidhur me mënyrën e themelimit dhe funksionimit të KGJK-së, është me rëndësi që së pari të bëjmë një përmbledhje të fakteve se si u krijua ky institucion. Pas përfundimit të luftës, me qëllim të funksionimit të jetës institucionale u shtrua nevoja e themelimit të institucioneve publike të përkohshme, përfshirë funksionalizmin e gjykatave, gjë që misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut në vitin 1999 nisi funksionalizmin e gjykatave sipas strukturës që ka ekzistuar me ligjin e ish-Jugosllavisë. Në vitin 2001 hyri në fuqi Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme që sanksiononte strukturën e gjykatave sikurse më herët, përfshirë Gjykatën Supreme, gjykatat e qarqeve, gjykatat komunale dhe gjykatat për kundërvajtje (shih: Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, 2001). Ideja për themelimin e një institucioni që ka për mandat të sigurojë pavarësinë e gjyqësorit u dha në vitin 2005, pasi PSSP-ja i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së nxjerri Rregulloren për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Mandati i atëhershëm i këtij institucioni ishte me qëllim të sigurimit të një gjyqësori të paanshëm, të integruar, të pavarur, profesional dhe llogaridhënës, si dhe duke marrë parasysh ri-organizimin e atëhershëm të sistemit gjyqësor të Kosovës (shih: Rregullorja nr. 2005/52 për themelimin e KGJK-së).

Miratimi i Kushtetutës së Kosovës (2008) fuqizoi pushtetin gjyqësor, duke i përcaktuar pavarësi të plotë dhe rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe administrimin e gjykatave nga vet gjyqtarët. Sipas nenit 108, paragr. 1 të Kushtetutës, KGJK paraqitet si institucion që duhet sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Sipas nenit 108, paragr. 1 të Kushtetutës, KGJK përkufizohet se është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të saja. Ky institucion siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike. Përcaktimi i pozitës së KGJK-së me anë të Kushtetutës , është në funksion të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit, respektivisht përmbushet një standard ndërkombëtar për pavarësinë e gjyqësorit, gjë për të cilën shprehen edhe autorët Voermans & Albers (2003), ku theksojnë se aspektet kryesore të ndarjes së kompetencave dhe pozitave më të rëndësishme shtetërore në vend duhet të rregullohen me Kushtetutë.

Miratimi i Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për KGJK-në, krijoi situatë të re për të ndërruar strukturën e funksionimit të deriatëhershëm të gjykatave. Çështjet e emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve, vlerësimi i performancës së tyre, trajnimet gjyqësore, karriera dhe avancimet, etika profesionale, disiplinimi, administrimi gjyqësor dhe menaxhmenti, buxheti i gjyqësorit, të gjitha këto janë kritere bazë që garantojnë pavarësinë e gjyqësorit në proces të rregullimit ose vetëm kanë gjetur vend në dispozitat ligjore nën mbikëqyrjen e KGJK-së. Përmes këtyre instrumenteve kushtetuese dhe ligjore, pozita e gjyqësorit është fuqizuar në të njëjtin nivel me dy pushtetet tjera. KGJK është organ që funksionin në bazë të Ligjit për KGJK-në, të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2010. Ky ligj është instrument i gjerë që përfshin shumë aspekte të funksionimit dhe është i sistemuar në 10 kapituj, përfshirë: dispozitat themelore; kompetencat, përgjegjësitë dhe përbërja e këshillit; rekrutimi, emërimi dhe caktimi i gjyqtarëve; vlerësimi, ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; administrimi i gjykatave; procedurat disiplinore; zyra e prokurorit disiplinor; trajnimi gjyqësor dhe dispozitat përfundimtare. Ligji përcakton përgjegjësitë që ka ky institucion i rëndësishëm për pavarësinë e gjyqësorit. Pavarësia e gjyqësorit e përcaktuar me dispozitën e nenit 3 të Ligjit për KGJK-në, krahasimisht paraqet version më të zgjeruar me dispozitën kushtetuese që garanton pavarësinë e gjyqësorit, ku përcaktohet se KGJK-ja është plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të

veta me qëllim të sigurimit të një sistemi të drejtësisë të pavarur, të drejtë, apolitik, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm i cili pasqyron natyrën shumë etnike të Kosovës dhe zbaton Kushtetutën si dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Sikurse e përmendëm më sipër, ideja e themelimit të këshillave gjyqësore ishte që vet gjyqësori të administrojë me drejtësinë, me qëllim të ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë. Nisur nga kjo as Kosova nuk ka shpëtuar nga ideja e themelimit të një këshilli gjyqësor që do të ushtronte këto funksione dhe të kujdesej për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Çështja e themelimit të KGJK-së sikurse u tha, ndodhi nga koha e administrimit të misionit të UNMIK-ut, ku dhe sot është ruajtur koncepti sikurse ishte që nga themelimi fillestar i saj. Kompetencat dhe përgjegjësitë e KGJK-së janë të pranishme në një sërë aktesh juridike me rëndësi , duke filluar nga Kushtetuta, Ligji për gjykatat dhe me Ligji për KGJK. Çështja e pavarësisë së KGJK-së nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, apo nga një pushtet i tretë mund të analizojmë mbi bazën e përgjegjësive dhe kompetencave që gëzon ky institucion të përcaktuara në legjislacionin e përmendur.

Nëse marrim për shqyrtim Ligjin për KGJK-në, mund të shohim se sipas nenit 4 të këtij ligji, me qëllim të sigurimit të pavarësisë së gjykatave, KGJK ka përgjegjësi të shumta, pa u kufizuar në: sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor; rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërimin dhe riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe përcaktimin e numrit të tyre; transferimin dhe procedurën disiplinore për gjyqtarë; organizimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të duhur të gjykatave; sigurimin e vlerësimeve të rregullta periodike mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave ashtu që të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave; mbikëqyrjen e inspektimit gjyqësor, administrimit gjyqësor dhe nxjerrjen e rregulloreve të brendshme për gjykatat në përputhje me ligjit ekzistues; përgatitjen, dërgimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit për të siguruar funksionimin efikas të gjykatës dhe llogaritjen e përdorimit të burimeve fiskale; administrimin e gjyqësorit dhe personelit të tij; shpalljen e Kodit të Etikës Profesionale për anëtarët e KGJK-së dhe Kodit të etikës profesionale për gjyqtarë dhe gjyqtarë porotë, shpalljen e Kodit të Etikës për punonjësit mbështetës të gjykatës; përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e

gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe personelit tjetër gjyqësorë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë nga Instituti dhe nga shoqatat dhe organizatat e tjera trajnuese; sigurimin e informacioneve dhe të dhënave statistikore mbi sistemin gjyqësor; bashkëpunimin me individë dhe organizata përgjegjëse për monitorim të pavarur të sistemit të drejtësisë; shpalljen e akteve nën-ligjore në përputhje me ligjet për Informimin publik që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe zbulimin e informacionit që ruhet nga gjyqësori i Kosovës; menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale (shih: Ligji për KGJK-në, 2010, neni 4 dhe Ligji nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KGJK-në, 2015, neni 2). Ndërsa sipas nenit 21 të Ligjit mbi KGJK-në, ky institucion ka përgjegjësi të mbikëqyrë funksionimin e gjykatave dhe të përcaktojë politikat dhe strategjitë për funksionimin efikas dhe efektiv të tyre. Kryesuesi dhe vet KGJK janë përgjegjës për punën efektive dhe efikase të gjykatave.

Nisur nga kjo, KGJK është institucion që ka kompetencë të zgjeruar në ushtrimin e përgjegjësive të saj, gjë që ligjërisht është institucion që si e vetme administron me gjyqësorin duke përfaqësuar interesat e këtij sistemi që lidhen me shumë çështje relevante në funksion të pavarësisë dhe të paanshmërisë së gjyqësorit. Nisur nga kjo, nëse analizojmë një nga raportet për këshillat gjyqësore në Evropë të përpiluar nga Holanda në fund të 1990, aty përcaktohen dy modele kryesore të këshillave gjyqësore: modeli i Evropës Jugore në të cilin këshilli fokusohet në menaxhimin e gjyqësorit dhe modeli i Evropës Veriore në të cilin këshilli ka kompetenca të zgjeruara në administratë, buxhet dhe menaxhim të gjykatës (Opinioni nr. 712 mbi draft ligjin mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjë dhe Hercegovinës, Komisioni i Venedikut, 2014, f. 7). Krahasuar modelet e sipër trajtuara me përgjegjësitë dhe kompetencat e KGJK-së në administrimin e gjyqësorit, mund të themi se rregullimi ligjor aktual gërsheton elementet e të të dyja këtyre modeleve.

2.3. Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të KGJK-së

Përveç kompetencave dhe përgjegjësive të ndara ndërmjet gjyqësorit dhe pushteteve tjera, një nga çështjet me më rëndësi për të përcaktuar pavarësinë institucionale të KGJK-së

është edhe përbërja e anëtarëve të këtij institucioni, si dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre. Në këtë kontekst, sipas nenit 108, paragr. 8 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Ligjit për KGJK, Ky institucion përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjedhën në këtë mënyrë: a) pesë anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit; b) katër anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy nga katër anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës; c) dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar; d) dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.

Nisur nga kjo, sikurse theksohet edhe në opinionin e shfaqur nga Komisioni i Venedikut lidhur me Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnje dhe Hercegovinë (2014), marrë parasysh numrin e vogël të popullsisë paraqet dispozitë jofleksibile, edhe në situatën tonë rezervimi i kuotave për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, mund të dëmtojë funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë. Gjithashtu përzgjedhja e 8 nga 13 anëtarët e KGJK-së nga Kuvendi shton edhe më shumë skepticizmin për një rol të pavarur praktik që mund të bëjë KGJK. Në opinion e njëjtë të Komisionit të Venedikut në rastin e Bosnjë dhe Hercegovinës (2014), theksohet se roli i madh i Parlamentit nuk mund të shmang politizimin e Këshillit dhe se duhet kufizuar minimalisht roli i tij në përcaktimin e shumicës së përbërjes së këtij organi të pavarur.

Rregullat ligjore të përcaktuara për përbërjen e KGJK-së, janë të gërshetuara me disa modele të cilat funksionojnë në Evropë. Disa nga anëtarët e KGJK-së bëhen ex-officio anëtar të KGJK-së, pasi pozitat që ata bartin gjatë ushtrimit të funksioneve të caktuara në sistemin gjyqësor ua garanton të drejtën e tillë konkurruese, ndërsa për anëtarët e tjerë, vendosin autoritetet jo gjyqësore sikurse është Kuvendi i Kosovës, sipas kushteve të përcaktuara ligjërisht. KGJK nuk ka përbërje homogjene vetëm nga komuniteti i gjyqtarëve, iu është dhënë hapësirë që anëtarë të zgjedhën dhe personat tjerë që nuk ushtrojnë funksione gjyqësore. Fakti që anëtarët e KGJK-së nuk përcaktohet të vijnë vetëm nga personat që bartin funksione

gjyqësore, por edhe anëtarë të jashtëm, kjo paraqet një kontroll shoqëror lidhur me punën e KGJK-së. Për të ruajtur pavarësinë institucionale, në aspektin formal nuk është paraparë që pjesë përbërëse e Këshillit të jenë dhe njerëz të cilët mbajnë pozita politike shtetërore. Modelet e funksionimit në Evropë, asnjëherë nuk e përjashtojnë mundësinë që pjesë të Këshillit të jetë dhe Ministri i Drejtësisë, qoftë në rolin e barabartë sikurse anëtarët e tjerë, apo dhe në rolin e pjesëmarrësit tjetër në mbledhjet e Këshillit.

Pothuajse të gjithë Këshillat Gjyqësor, me përjashtim të atij në Holandë, janë me një përbërje të gjerë prej 15 ose më shumë anëtarëve. Shumica e Këshillave përbëhen kryesisht nga gjyqtarë të seksioneve të ndryshme të gjyqësorit. Disa prej tyre, kryesisht gjyqtarë më të lartë, janë anëtarë të Këshillit Gjyqësor sipas detyrës zyrtare, ndërsa gjyqtarët tjerë zgjidhen nga gjyqtarët. Në Francë dhe Itali, Kryetari dhe Ministri i Drejtësisë zyrtarisht janë anëtarë të bordit. Ekzistojnë dallime përkitazi me anëtarët jo gjyqësorë. Zakonisht, këta anëtarë zgjidhen në mënyra të ndryshme nga grupe të palëve të interesit në administrimin e drejtësisë ose në Parlament (Voermans & Albers, 2003).

Sipas standardeve të tanishme ndërkombëtare, nuk mund të gjejmë ndonjë model uniform që parasheh përbërjen e këshillave gjyqësorë ose prokurorialë. Këtë qëndrim e ka shprehur edhe Komisioni i Venedikut në Opinionin nr. 712 mbi draft ligjin mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjë dhe Hercegovinës (2014, paragr. 27). Lidhur me përbërjen e këshillave gjyqësorë, një numër instrumentesh ndërkombëtare parashohin se në rastet kur krijohet një këshill gjyqësor, një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve të tij duhet të rekrutohen prej gjyqtarëve. Në këtë kontekst, Këshilli i Evropës në Rekomandimin CM/Rec (2010) 12, për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë (tutje: Rekomandimi për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë), parasheh që jo më pak se gjysma e anëtarëve të një këshilli të tillë duhet të jenë zyrtarë të zgjedhur prej kolegëve të tyre prej të gjitha niveleve të gjyqësorit, duke respektuar pluralizmin brenda gjyqësorit (2010, paragr. 27).

2.4. Pavarësia në vendimmarrje

Aftësia e pushtetit gjyqësor për tu mbrojtur nga ndërhyrjet e pavenda dhe të paarsyetuara në politikën e brendshme të funksionimit të pushtetit gjyqësor, është element i rëndësishëm në përcaktimin e pavarësisë së gjyqësorit. Me këtë lloj të pavarësisë, vendimet gjyqësore në asnjë formë nuk guxojnë t'i nënshtrohen procedurave të ndryshimit nga autoritetet jo-gjyqësore. Lidhur me këtë, janë një mori instrumentesh ndërkombëtare që trajtojnë pavarësinë e gjyqësorit, të tilla sikurse Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit (1985)[8], ku theksohet se çështja e ushtrimit të funksioneve gjyqësore është kompetencë vetëm e gjykatave dhe kjo nuk mund të bëhet objekt i ushtrimit nga autoritetet jo-gjyqësore, ndërsa parimi i pavarësisë në vendimmarrje përjashtohet në rastet kur përfshihet zbutja e dënimit, falja, apo shpallja e amnistisë sipas përcaktimeve ligjore (paragr. 4). Ndërsa, me instrumentin tjetër të emërtuar Parimet e Bangalorit për Sjellje Gjyqësore (2006)[9], pavarësia e gjyqtarit theksohet si vlerë e rëndësishme gjatë ushtrimit të funksionit të tij gjyqësor në funksion të pavarësisë së përgjithshme të vet sistemit gjyqësor si pushtet i pavarur shtetëror. Sipas parimeve të këtij instrumenti, pavarësia e gjyqësorit është kusht për sundimin e ligjit dhe garantimin fundamental të gjykimit të drejtë (PBSGJ, 2006, 1). Në këtë dokument gjithashtu parashihet që gjyqtari duhet të ushtrojë funksionin gjyqësor në mënyrë të pavarur bazuar në vlerësimin e tij dhe të fakteve dhe në pajtim me kuptimin e ndërgjegjshëm të ligjit, i pandikuar nga jashtë, nga ndonjë nxitje, presion, kërcënim apo ndërhyrje direkte apo indirekte dhe i pandikuar nga ndonjë pengesë apo çfarëdo arsye tjetër (PBSGJ, 2006, 1 § 1). Gjatë kryerjes së detyrave gjyqësore, gjyqtari duhet të jetë i pavarur nga kolegët e gjyqësorit për sa i përket vendimeve të cilat gjyqtari është i obliguar t'i sjellë në mënyrë të pavarur (PBSGJ, 2006, 1 § 1 dhe 4).

[8] Ky instrument është miratuar nga Kongresi i Shtatë i OKB-së mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve, mbajtur në Milano më 26 gusht deri më 6 shtator 1985 dhe e miratuar nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 29 nëntor 1985 dhe 40/146 13 dhjetor 1985.

[9] Ky instrument është miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së, me Rezolutën nr. 2006/23 mbi Fuqizimin e Parimeve Bazë për Sjellje Gjyqësore, 27 korrik 2006, E/RES/2006/23.

Nga kjo që përmendëm, mund të them se cenimi i pavarësisë në vendimmarrje të pushtetit gjyqësor mund të ndahet në dy lloje: a) ndërhyrja e jashtme në vendimmarrje të autoriteteve gjyqësore dhe b) ushtrimi i pushtetit gjyqësor nga autoritetet jo-gjyqësore. Pra, në të dyja rastet pavarësia në vendimmarrja duhet të jetë e pa-ndikuar dhe se gjyqtarët duhet të ndjehen të lirë dhe të papenguar në ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Pavarësia në vendimmarrja mund të cenohet në rastin e ndërhyrjes në pavarësinë individuale të gjyqtarëve dhe ndërhyrjen në pavarësinë institucionale të gjykatës si pushtet i pavarur shtetëror.

Në përputhje me këto instrumente ndërkombëtare, Kushtetuta e Kosovës garanton pavarësi për pushtetin gjyqësor, ku parashihet që pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat (nenin 102, paragr. 1). Në këtë mënyrë, nuk lejohet ndërhyrje në vendimmarrje nga autoritetet jo-gjyqësore, e as ushtrim të pushtetit gjyqësor nga autoritete tjera përveç gjykatave të themeluara me ligj. Pra, asnjë autoritet tjetër jo-gjyqësor nuk mund të ushtrojë funksione gjyqësore. Pushteti gjyqësor duke qenë pushtet i pavarur, por dhe në të njëjtën duke pasur *"monopol"* që si i vetëm të ushtrojë pushtetin gjyqësor, nuk lejon në asnjë rrethanë, qoftë kjo ndërhyrje e jashtme apo e brendshme, të diktojë mënyrën e vendimmarrjes, apo ndonjë pushtet jo-gjyqësor të marrë dhe të vendos në emër të pushtetit gjyqësor. Kompetencat dhe përgjegjësitë ndër-institucionale janë të precizuara me Kushtetutë dhe me ligje, gjë që nuk është lejuar hapësirë për ndonjë ndërhyrje të pavend në çështje të natyrës gjyqësore. Edhe pse jo në mënyrë të vazhdueshme, pushteti legjislativ në disa raste në Kosovë ka shfaqur tendencë të ndërhyjë në çështje të natyrës gjyqësore, përkatësisht në një nga seancat parlamentare është diskutuar për raste që kanë qenë në procedurë gjyqësore, apo raste gjyqësore që janë vendosur me aktgjykim të formës së prerë. Në këto raste, legjislativi nuk ka mundur të përmbahet nga ndërhyrjet e pavenda sikurse këto që i përmendëm, gjë që ka shkaktuar cenim të pavarësisë objektive të një pushteti të ndarë dhe të pavarur.

2.5. Pavarësia administrative dhe financiare

Një kriter tjetër për të matur pavarësinë institucionale të gjyqësorit është *edhe pavarësia administrative*. Kjo pavarësi nënkupton të drejtën e gjykatave që të vendosin vetë, lidhur me strukturën dhe organet e tyre, përfshirë këtu:

- të drejtën e zgjedhjes së kryetarit të gjykatës, administratorëve;
- udhëheqjen e procedurave të rekrutimit të personelit që ushtron funksione gjyqësore dhe jo-gjyqësore; si dhe
- çështje tjera të natyrës organizative.

Pra, organizmi i brendshëm administrativ duhet të jetë çështje e brendshme e gjykatave, në këtë rast e Këshillit Gjyqësor, pasi ndërhyrja e jashtme në organizimin e brendshëm administrativ, cenon pavarësinë institucionale të pushtetit gjyqësor dhe nuk lejohet interferim i tillë nga pushtetet jo-gjyqësore.

Në përputhje me këtë, funksionimi i brendshëm administrativ është kompetencë e KGJK-së e përcaktuar me Ligjin për KGJK-në.[10] Sipas nenit 4, paragr. 1 (8), një nga kompetencat dhe përgjegjësitë e KGJK-së është edhe organizimi dhe mbikëqyrja e funksionimit të duhur të gjykatave (Ligji për KGJK). Në Kushtetutë nuk ka ndonjë dispozitë që parasheh çështjen e organizimit, funksionimit apo juridiksionit të gjykatave, gjë që kjo çështje sipas dispozitës së nenit 103, paragr. 1 të Kushtetutës, është diskrecion i rregullimit ligjor. Ashtu sikurse e përmendëm më sipër, KGJK është organi i vetëm që merret me organizimin e brendshëm të

[10] Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 shtator 2010, ndërsa është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 84, më 3 nëntor 2010. Ligji ka pësuar ndryshime të vazhdueshme me një kronologji sikurse në vijim:

- Ligji Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 Gusht 2012.
- Ligji Nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 maj 2015.
- LIGJI Nr. 05/L -094 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -033 si dhe Ligjin Nr. 04/L-115, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 24 mars 2016.

gjykatave. Sipas Ligjit për KGJK-në dhe Ligjit për Gjykatat, gjykatat kanë varësi të drejtpërdrejt administrative me KGJK-në dhe ushtrojnë përgjegjësi dhe kompetenca të përcaktuara me ligj dhe detyra tjera të përcaktuara me akte nënligjore të nxjerra nga KGJK. Çështja e matjes së pavarësisë administrative të gjykatave dhe vet KGJK-së, mund të trajtojmë në shumë rrafshe. Është me rëndësi të themi se KGJK në aspektin formal nuk ka asnjë raport të çfarëdollojtë me asnjë institucion tjetër publik, që do të cenonte çështjen e kësaj pavarësie. Njëkohësisht gjykatat nuk kanë asnjë marrëdhënie administrative subordinuese me institucione të tjera jashtë gjyqësorit, përjashtimisht lidhjes ligjore me KGJK-në. Ky dimension mund të shihet edhe nga përmbajtja e dispozitave të ndryshme ligjore që i referohen gjykatave dhe KGJK-së, e tillë sikurse është neni 21 i Ligjit për KGJK, ku theksohet se KGJK mbikëqyr funksionimin e gjykatave dhe përcakton politikat dhe strategjitë për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave dhe se kryesuesi i këtij institucioni është zyrtari kryesor administrativ i gjykatave dhe së bashku me KGJK është përgjegjës për punën efektive dhe efikase të gjykatave në përgjithësi.

Në Ligjin për KGJK (neni 4) janë paraparë shumë çështje me rëndësi që ruajnë pavarësinë administrative të pushtetit gjyqësor, sikurse është përzgjedhja e kryetarëve të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore, si dhe mbikëqyrësve të degëve të gjykatave themelore. Gjithashtu ligji i adreson si kompetencë edhe inspektimin gjyqësor, nxjerrjen e rregulloreve të brendshme për gjykatave; administrimin e gjyqësorit dhe personelit të tij. Ndërsa, lidhur me menaxhimin e gjykatave janë paraparë rregulla ligjore në funksion të ruajtjes së pavarësisë gjyqësore. Bazuar në dispozitat e Ligjit për KGJK-në dhe Ligjit për Gjykatat, menaxhimin administrativ të të gjithë niveleve të gjykatave në Kosovë, e bëjnë kryetarët e tyre. Lidhur me këtë, KGJK ka nxjerrë Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave (2013) që parasheh që përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës. Këto kompetenca janë të përqendruara në organizimin e brendshëm të gjykatave, adresimin e çështjeve të lidhen drejtpërdrejt me mbarëvajtjen dhe menaxhimin adekuat. Marrë parasysh kompetencat ligjore të cilat iu kanë caktuar kryetarëve të të gjithë niveleve të gjykatave, është përjashtuar mundësia e menaxhimit administrativ të ndonjë autoriteti tjetër përveç atij gjyqësor. Mirëpo, edhe menaxhimi brenda gjykatës duhet të ushtrohet në mënyrë objektive dhe nuk duhet ta cenojë pavarësinë

individuale të gjyqtarëve, apo të shkaktojë interferim në menaxhimin e lëndëve që janë duke u gjykuar.

Për të ndihmuar dhe lehtësuar punën e gjykatave, sipas Ligjit për KGJK është paraparë funksionimi i një Sekretariati me funksione jo-gjyqësore, që do të merret me menaxhimin e buxhetit dhe administrimin administrativ të gjykatave. Sekretariati nuk është trup i pavarur, ai funksionon si pjesë përbërëse e KGJK-së, për të ndihmuar në administrimin e mirë të sistemit gjyqësor, duke propozuar rregulla të nevojshme administrative për zbatimin e akteve të KGJK-së. Sekretariati menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të gjyqësorit dhe alokimin e tij sipas ngarkesës në punë, mirëmbajtjen e regjistrave, sistemin e vlerësimit, sigurimin e disiplinimit dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Sekretariati nuk ushtron funksione gjyqësore dhe nuk është në administrim të drejtpërdrejt të KGJK-së (neni 27 paragr. 1, 2 dhe 6).

Për të gjithë gjykatat që veprojnë në Kosovë, është paraparë që të ketë nga një pozitë të administratorit. Administratorët janë shërbyes civil, gjë që marrëdhënia e punës rregullohet me Ligjin 03/L/149 për Shërbimin Civil (2010) (tutje: Ligji për Shërbimin Civil), ndërsa ata veprojnë nën autoritetin e kryetarit të gjykatës ku janë duke ushtruar funksionet e tyre administrative të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Administratorët e gjykatave menaxhojnë funksionet administrative të gjykatës, që lidhen me raportet statistikore; menaxhimin teknik të lëndëve; çështjet menaxhimit të stafit administrativë dhe çështje të tjera (Ligji për KGJK-në, neni 27).

Mund të themi se Sekretariati i KGJK-së dhe administratorët e gjykatave, edhe pse përfaqësojnë nivelin administrativ, prapë mbesin nën menaxhimin e KGJK-së. Kompetencat administrative të cilat ushtrohen nga këto trupa, e që janë të lidhura me punën e gjykatave, prapë se prapë mbesin në kompetencë të vet pushtetit gjyqësor, kjo për shkakun se nuk ushtrohen nga një autoritet tjetër jashtë këtij pushteti, por ekziston vetëm ndarja nga funksionet gjyqësore. Sipas rregullave kushtetuese dhe ligjore, KGJK ka ruajtur pavarësinë administrative për organizimin e brendshëm të administratës gjyqësore dhe administrimit të drejtësisë për qëllime të efikasitetit dhe efektivitetit.

Përveç pavarësisë në vendimmarrje dhe asaj administrative, *pavarësia financiare* është një nga elementet më të rëndësishme në pavarësinë e pushtetit gjyqësor, pasi një pushtet

gjyqësor, duhet të jetë edhe financiarisht i qëndrueshëm për të funksionuar i pavarur në raport me pushtetet tjera. Lidhur me këtë, Magna Karta e Gjyqtarëve (2010), thekson se: *"pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë"* (neni 2) dhe se gjyqësori në mes tjerash, duhet të gëzojë edhe pavarësi financiare (neni 3). Në të njëjtën pikëpamje me këtë instrument, KKGJE thekson rëndësinë që kështillat gjyqësorë të financohet duke mundësuar funksionim të duhur dhe t'i ketë mjetet e nevojshme për të vepruar në mënyrë të pavarur, si dhe kapacitetet për të organizuar buxhetin e vet në mënyrë efektive (Opinioni nr. 10 mbi strukturën dhe rolin e Këshillit Gjyqësor, KKGJE, 2007, paragr. 37). KKGJE thekson se financimi i gjykatave edhe pse është pjesë e buxhetit të shtetit, financimi i tillë nuk duhet të jetë subjekt i luhatjeve politike, pasi vendimet për shpërndarjen e buxhetit në gjykata duhet të përfshijë një procedurë që merr parasysh mendimet e gjyqësorit dhe respekton rreptësishtë pavarësinë e gjyqësorit. (Opinioni nr. 10 mbi strukturën dhe rolin e Këshillit Gjyqësor, KKGJE, 2007, paragr. 73).

Pavarësia financiare e pushtetit gjyqësor në Kosovë është e garantuar me Kushtetutë (neni 108, paragr. 5). Sipas kësaj dispozite, KGJK *inter alia* është përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin. Kjo dispozitë kushtetuese materializohet me nenin 6, paragr. 3 të Ligjit për KGJK-në, me ç'rast parashihet që kryesuesi i KGJK-së i propozon Kuvendit buxhetin për shpenzimet e veprimeve dhe të personelit të KGJK-së dhe të gjykatave.[11]

Sipas Kushtetutës, Ligjit për KGJK-në dhe Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (tani e tutje: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë), hartimi, propozimi dhe menaxhimi i buxhetit të KGJK-së është kompetencë e vet KGJK-së. Kjo rregull kushtetuese dhe ligjore, është bërë për t'iu shmangur cenimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor, me qëllim të mbajtjes së sistemit gjyqësor me

[11] Sipas Ligjit bazik për KGJK-në të vitit 2010, është paraparë që kryesuesi i propozon Ministrisë së Financave (Qeverisë) dhe Kuvendit buxhetin e propozuar të KGJK-së për shpenzimet e veprimeve dhe të personelit të Këshillit dhe të gjykatave (neni 6, paragr. 3 dhe neni 15). Rregulla ligjore që KGJK njëkohësisht t'i drejtohet Qeverisë dhe Kuvendit është perceptuar si cenim i pavarësisë së gjyqësorit dhe me ndryshimet ligjore që janë ndërmarrë me Ligji Nr. 05/L -033 për plotësim ndryshimin (2015) e Ligjit bazik për KGJK, është hequr obligimi për t'iu drejtuar Qeverisë për miratimin e buxhetit për gjyqësorin dhe ka mbetur që Kuvendi është adresa ku duhet drejtuar propozimet për buxhet që parashtrohen nga KGJK.

integritet, përball presioneve politike dhe formave tjera të cilat ndikojnë negativisht në besimin e publikut për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Pavarësia financiare është kuptimplotë përderisa për pushtetin gjyqësor sigurohet buxhet i mjaftueshëm për të ushtruar përgjegjësitë dhe autorizimet e përcaktuara, duke mos e rrezikuar atë nga cenimi i pavarësisë dhe paanshmërisë nga pushtetet tjera.

Buxheti i përgjithshëm i KGJK-së si organizatë buxhetore dhe programet e tij për vitin 2016 sipas Ligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, ka qenë 20,465,768 €, për gjithsej 2159 pozita, prej tyre 453 gjyqtarë dhe 1706 pozita administrative. Të hyrat gjyqësore, të cilat gjenerohen nga gjykatat, Sekretariati dhe Dhoma e Posaçme për periudhën janar-dhjetor 2016 përfshijnë shumën afër 8 milionë Euro. Plani i realizimit të hyrave është 89.61% në krahasim me planifikimin për vitin 2016 (afër 9 milionë) (shih: Raporti Vjetor 2016, KGJK, f. 40-41). Ndërsa për vitin 2018 me Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për KGJK-në është paraparë buxhet afër 24 milion Euro, gjë që krahasuar me vitin 2016, kjo është një rritje domethënëse.

3. Ekzistimi i mbrojtjes efektive të gjyqtarëve nëpërmes pavarësisë individuale

3.1. Roli dhe rëndësia e pavarësisë individuale të gjyqtarëve

Komisioni i Venedikut në një nga opinionet e saja, thekson se *pavarësia institucionale* i referohet ndarjes së pushtetit shtetëror dhe aftësisë së gjyqësorit që të veprojë i lirë pa ndonjë presion nga legjislativi apo ekzekutivi, ndërsa *pavarësia individuale* i referohet aftësisë së gjyqtarëve individual për të vendosur për raste të caktuara në mungesë të presionit politik apo presioneve tjera të brendshme apo të jashtme (Opinioni nr. 712 mbi draft ligjin mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjë dhe Hercegovinës, Komisioni i Venedikut, 2014, f. 11). Lidhur me rëndësinë e pavarësisë individuale në një nga opinionet e saj shprehet edhe KKGJE, ku thekson se *pavarësia e gjyqtarëve* nuk është privilegj në interesin e tyre, mirëpo kjo pavarësi është në dobinë e sundimit të ligjit dhe të qytetarëve që kërkojnë dhe presin drejtësi dhe se kjo

pavarësi lidhet drejtpërdrejt vetëm me aftësinë e gjyqtarëve për t'u lejuar të punojnë të lirë dhe pa presione të jashtme, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në gjykimin e lirë të tyre për vendosjen e çështjeve të caktuara mbi parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë. Më tutje, sipas këtij instrumenti theksohet se pushteti gjyqësor për të përmbushur rolin e tij kushtetues dhe ligjor, duhet të jetë i pavarur prej pushteteve tjera, me ç'rast duhet përjashtuar lidhjet e panatyrshme, apo ndërhyrjet e jashtme nga këto pushtete. Pra, pavarësia e gjyqësorit shërben si parakusht për paanësi, ku ndërhyrja ndikon në çdo aspekt të zhvillimit të karrierës profesionale të vet gjyqtarit, që nga emërimi, promovimi, trajnimi apo disiplinimi i tij (Opinion nr. 1 i KKGJE-së për Standardet e Pavarësisë së Gjyqësorit dhe Palëvizshmërinë e Gjyqtarëve, 2001, paragr. 10 dhe 11).

GJEDNJ i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtës së të pandehurit për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe të paanshme. Sikurse i përmendëm edhe më herët, këto standarde janë të shprehura në një mori rastesh të nxjerra nga kjo gjykatë, përfshirë këtu çështjet: *Campell dhe Fell kundër Britanisë së Madhe* (1984 paragr. 78) apo *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës* (1981, paragr. 55). Në të gjitha këto raste, gjykata përmend elementet të cilat përbëjnë të drejtën për tu gjykuar nga një "*gjykatë e pavarur*", përfshirë trajtimin e elementëve që përbëjnë pavarësinë institucionale ashtu edhe për ato individuale.

Krahas pavarësisë institucionale, në përputhje me parimet e sendërtuara nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura më sipër, çështja e garantimit dhe ruajtjes së pavarësisë individuale të gjyqtarëve është ngritur në parim të rëndësishëm në kuadër të rregullave kushtetuese dhe ligjore në Kosovë. Sipas nenit 102 paragr. 4 të Kushtetutës, garantohet pavarësia individuale e gjyqtarëve, ku parashihet se ata gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Ndërsa sipas nenit 3 paragr. 2 të Ligjit për Gjykatat (2010) theksohet se: "*Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike."* Edhe pavarësia individuale e gjyqtarëve sikurse pavarësia institucionale, është një çështje tejet komplekse, gjë që kjo pavarësi mund të shpjegohet dhe elaburohet në disa dimensione. Në instrumentet ndërkombëtare përmendën

një mori elementësh që definojnë çështjen e pavarësisë individuale të gjyqtarëve, nga të cilat më i rëndësishme është instrumenti *"Magna Karta e Gjyqtarëve"* (2010). Në këtë instrument theksohet se për të promovuar gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, pavarësia e gjyqësorit duhet të jetë e garantuar sa i përket aktiviteteve gjyqësore, e veçanërisht sa i përket rekrutimit, kohëzgjatjes së emërimit, promovimit, pa-ndërrueshmërisë, trajnimit gjyqësor, imunitetit gjyqësor, disiplinës, lirisë së shprehje dhe asociimit, pagës dhe financimit të gjyqësorit (parimi 4). Bazuar në këtë instrument, në vazhdim do të elaburojmë çështjen e pavarësisë individuale të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor në Kosovë.

3. 2. Ekzistimi i mbrojtjes së gjyqtarëve nga presionet e brendshme dhe të jashtme

Pavarësia e gjyqtarëve është e dyfishtë, si *pavarësi e brendshme* dhe si *pavarësi e jashtme*. *Pavarësia e brendshme* mund të kuptohet si mundësi që i ofrohet gjyqtarit për të ushtruar funksionet e parapara me ligj, në mënyrë të lirë dhe të papenguar nga autoritetet e brendshme gjyqësore. Pavarësia e brendshme, krahas pavarësisë së jashtme, është objekt i trajtimeve të shumta nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare, nga ku edhe dalin rregulla dhe parime të nduarnduarshme që përcaktojnë kriteret minimale për të ruajtur këtë pavarësi.

Lidhur me ruajtjen e pavarësisë së brendshme në përputhje me kriteret vendosura në instrumentet ndërkombëtare, Kushtetuta e Kosovës pozicionohet në favor të forcimit të pavarësisë individuale të gjyqtarëve, përfshirë forcimin e pavarësisë së brendshme të tyre. Ky vullnet shprehet me anë të dispozitës së nenit 102, paragr. 4, ku theksohet se: *"Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm"* (Kushtetuta e Kosovës, 2008). Në të njëjtën frymë, edhe sipas Ligjit për Gjykatat (2010) theksohet se *"gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike"* (neni 3, paragr. 2). Po sipas të njëjtit ligj, theksohet se *"gjyqtarët veprojnë në mënyrë objektive, të paanshme dhe të pavarur*" (neni 34). Dispozitat e përmendura kushtetuese dhe ligjore janë gjithëpërfshirëse dhe përcaktojnë pavarësinë e gjyqtarit, si brenda ashtu edhe jashtë gjyqësorit.

Ndërsa, ndërhyrjet e gjykatave të rangjeve më të larta kundrejt atyre më të ulëta, nuk janë të lejueshme përveç rasteve kur parashihet shprehimisht me ligj.

Lidhur me rregullat e vendosjes për një rast të caktuar, ligjet kanë precizuar qartë çështjen e shpërndarjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, si dhe kompetencave brenda për brenda gjyqësorit. Juridiksioni lëndor dhe territorial është qartësuar dhe nuk ka lënë hapësirë për ndonjë huti eventuale, ndërsa KPP i garanton gjyqtarit pavarësi edhe brenda gjyqësorit, duke mos i lejuar gjykatave të instancave më të larta të ndërhyjnë në gjykatat e rangjeve më të ulëta, përjashtimisht rasteve kur ato vendosin sipas mjeteve juridike të parapara me ligj. Një tjetër çështje me rëndësi që përbënë kriter për të përcaktuar pavarësinë e brendshme të gjyqtarit, sikurse është shpërndarja objektive e lëndëve tek gjyqtarët, është adresuar në përputhje të plotë sipas rekomandimet e instrumenteve ndërkombëtare. Sipas Rregullores mbi organizimin e brendshëm të gjykatave (2013) të nxjerrë nga KGJK, parashihen kritere objektive për caktimin dhe shpërndarjen e lëndëve gjyqësore tek gjyqtarët. Si rregull, caktimi i lëndëve tek gjyqtarët bëhet me short, me ç'rast të gjitha lëndët e pranuara nga gjykata brenda muajit kalendarik, ndahen në grumbuj sipas numrit te gjyqtarëve dhe llojit të lëmit juridik gjyqësorë. Tërheqja e shortit bëhet nga gjyqtari, respektivisht i autorizuari i gjyqtarit (neni 24, paragr. 1 dhe 2). Duke marrë parasysh shpejtësinë e digjitalizimit të administratës në përgjithësi, në një të ardhme jo edhe të largët, çështja e shpërndarjes së lëndëve gjyqësore tek gjyqtarët mund t'i nënshtrohet procedurës së digjitalizimit elektronik, ku edhe në këto raste, duhet ruajtur kriteret objektive dhe të paanshmërisë. Rregullorja e sipërpërmendur e lejon mundësinë e shpërndarjes së tillë, pasi të ketë marrë miratimin e KGJK-së.

Pavarësia e jashtme, për dallim nga pavarësia e brendshme, shprehet me anë të garancioneve të tilla që i sigurojnë gjyqtarëve paprekshmëri funksionale në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre. Në Rekomandimin e Këshillit të Evropës për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë (2010), çështjen e shpalljes të vendimit të arsyetuar dhe publikisht dhe ndalesën e njëkohshme që autoritetet jo-gjyqësore të mund të rishikojnë vendimin e dhënë dhe një sërë çështjesh tjera të cilat i adresohen pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ për t'u përmbajtur nga veprimet që mund të cenojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Në përputhje me me këto rregulla, pushteti gjyqësor në Kosovë paraqet pushtet të

pavarur, me ç'rast janë precizuar fushëveprimet e secilit pushtet. Sipas nenit 4 dhe 102 të Kushtetutës, janë vendosur rregullat fundamentale që rregullojnë fushëveprimin e secilit pushtet, gjë që nuk lejohet që pushteti ekzekutiv, apo legjislativ, të ndërhyjë në pushtetin gjyqësor. Gjyqësori gëzon pavarësi të zgjeruar ndaj presioneve të jashtme, pasi vendimet gjyqësore nuk mund të rishikohen nga pushtetet tjera.

Ndërsa, lidhur me arsyetimin dhe mënyrën e shpalljes së vendimeve gjyqësore, si rregull kjo është përcaktuar në kapitullin XX të KPP-së dhe me nenin 6 të Ligjit për gjykatat, ku kërkohet që vendimet gjyqësore shpallen publikisht dhe të arsyetuara. Mungesa e arsyetimit të vendimit gjyqësor, shpie ne procedurë të padrejtë, gjë që bie ndesh me nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 31 të Kushtetutës. Çështja e rishikimit të vendimeve gjyqësore nga autoritetet jo-gjyqësore, është e ndaluar, gjë që përveç organeve gjyqësore sipas kompetencës së përcaktuar ligjore, asnjë autoritet tjetër nuk mund të rishikojë apo anulojë vendimet gjyqësore të instancave gjyqësore.

Për të ndërtuar besimin e publikut për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme dhe për t'i lejuar që në mënyrë të papenguar gjyqtarët t'i ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore, duhet që pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, të kenë kujdes në qasjen që ndërtojnë në raport me pushtetin gjyqësor. Vendimet e nxjerra nga pushteti gjyqësor, nuk mund të vihen në diskutim nga pushtetet tjera, pasi kjo përbën cenim të pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe ndërhyrje e drejtpërdrejt në punën e gjyqtarëve, pasi ata duhet të jenë dhe të ndjehen të lirë dhe të papenguar. Pushtetet jo-gjyqësore, duhet t'i shmangen çfarëdolloj ndërhyrje që mund të shpie në cenimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve përball publikut, pasi besimi i publikut është një ndër kriteret themelore me anë të të cilave matet pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve dhe gjyqësorit në përgjithësi. Nga krahasimi i standardeve të zbatueshme, mund të thuhet se politika e funksionimit të pushtetit gjyqësor në Kosovë është harmonizuar edhe me Opinionin e Këshillit të Evropës për standardet e Pavarësisë së Gjyqësorit dhe Palëvizshmërinë e Gjyqtarëve (KE, 2001). Ligjërisht gjyqtarët tani kanë pavarësinë individuale dhe lirinë e plotë të vendosin për raste në mënyrë të paanshme, në pajtim me bindjen dhe çmuarjen e lirë të fakteve dhe në përputhje me rregullat e bazuara në ligj, dhe se nuk janë të detyruar të raportojnë për rastin e gjykuar brenda apo jashtë gjyqësorit. Standardet kushtetuese dhe ato

ligjore, gjyqtarit që ushtron funksionet e tij i garantojnë pavarësi dhe kushte për punë të paanshme.

3.3. Emërimi, promovimi, pagat dhe politikat e trajnimit

Meqenëse ushtrimi i funksionit të gjykimit paraqet një punë me mjaft përgjegjësi shoqërore, nevojitet që gjyqtarët të emërohen dhe të revokohen në mënyrë, kushte dhe procedurë që mundëson ardhjen në shprehje të aftësisë profesionale dhe të etikës morale për kryerjen e funksionit gjyqësor (Sahiti & Murati, 2016, f. 123). Pra, mënyra e emërimit të gjyqtarëve në kriteret përcaktuese për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit është jashtëzakonisht e rëndësishme. Një numër i instrumenteve ndërkombëtare kanë për objekt të trajtimit çështjen e këtyre kritereve, me ç'rast kanë vendosur parime dhe rregulla të caktuara lidhur me mënyrën dhe kriteret bazë për t'u emëruar një person si gjyqtar. Sipas instrumentit ndërkombëtar Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985), theksohet se personat e zgjedhur për të ushtruar detyrën e gjyqtarit duhet të jenë persona me integritet dhe aftësi, të trajnuar në mënyrë të adekuate dhe me kompetencë sipas ligjit, me ç'rast përzgjedhja e tyre duhet të të bazohet mbi bazën e parimeve të drejta (parimi 10). Ndërsa, lidhur me mënyrën e avancimit të gjyqtarëve, theksohet se ky proces duhet të bazohet në kritere objektive, e veçmas i bazuar në aftësi, integritet dhe përvojë profesionale (parimi 13). Lidhur me këtë, edhe instrumenti tjetër ndërkombëtar Magna Karta e Gjyqtarëve (2010), thekson se mënyra e rekrutimit dhe emërimit përbënë një nga kriteret që përcaktojnë çështjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Në të njëjtën frymë edhe Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve (1998), mënyrën e emërimit të gjyqtarëve e ka potencuar si një ndër kriteret bazë në përcaktimin e një gjykate të pavarur.

Mënyra e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve është një çështje e rëndësishme edhe për KGJK-në si organ përgjegjës për menaxhimin e procesit të emërimit të gjyqtarëve në pozita dhe funksione të përcaktuara në bazë të ligjit. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes, bazat e emërimit dhe promovimit, si dhe procedura e revokimit, janë të rregulluara me Kushtetutë,

Ligjin për gjykatat dhe Ligjin për KGJK-në. Në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të sipërpërmendura, KGJK është përgjegjëse për të udhëhequr në mënyrë të pavarur me çështjen e rekrutimit dhe mandatit të gjyqtarit.

Procedura e rekrutimit, si dhe çështja e kritereve dhe kushteve për tu përzgjedhur për gjyqtarë, janë të përcaktuara me Ligjin për KGJK dhe Ligjin për gjykatat, ku të dyja këto ligje parashohin kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta. Edhe pse ekzistojnë zgjidhje të ndryshme në përzgjedhjen e gjyqtarëve, sikurse është mundësia për t'u zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, përzgjedhja nga një autoritet i pavarur, apo modele të tjera, nga analiza e dispozitave të përmendura në këto ligje, mund të themi se zgjidhjet e pranuara për mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarëve në Kosovë, përbëjnë bazë solide që ata të mund të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Sigurisht që vetëm faza fillestare e përzgjedhjes nuk do të mund t'i kompletonte në mënyrën e duhur profesionalisht, gjë që për këtë janë paraparë edhe trajnimet para fillimit të ushtrimit të funksioneve gjyqësore, po ashtu edhe gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore. Këto kritere janë në përputhje me instrumentet e sipërpërmendura ndërkombëtare, pasi rekrutimi i gjyqtarëve është ruajtur vetëm në kompetencë të KGJK-së, ndërsa autoritetet tjera për përzgjedhjen e gjyqtarëve nuk kanë ndonjë autorizim të caktuar, përjashtimisht presidentit që emëron gjyqtarët pas propozimit për emërim të dërguar nga KGJK. Çështja e dekretimit të gjyqtarëve nga ana e Presidentit nuk mund të shihet si ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit, pasi bazuar në rregullat aktuale kushtetuese dhe ligjore, Presidenti nuk ka ndonjë diskrecion të veçantë për të refuzuar në mënyrë të paarsyetuar kandidat të caktuar. Lidhur me këtë, edhe pse GJEDNJ mënyrën e emërimit të gjyqtarëve përmend si kriter themelor të pavarësisë, megjithatë nuk përjashton mundësinë që emërimet të bëhen dhe nga organet tjera jo-gjyqësore, por në këtë rast kushtëzon që pavarësia të jetë e dukshme, pavarësisht mënyrës së emërimit të gjyqtarëve (shih: Campell dhe Fell v. Britania e Madhe, GJEDNJ, 1984, paragr. 79). Kohëzgjatja e detyrës së gjyqtarit në Kosovë është e përcaktuar me Kushtetutë dhe është e ndarë në dy periudha, ku mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar, ndërsa në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në pensionim. Periudha trevjeçare e mandatit fillestar, edhe pse nuk emërtohet si periudhë provuese, por për shkak të kohëzgjatjes mund të mund të quhet si e tillë. Sipas rregullës

kushtetuese aktuale të përmendur më sipër, pas përfundimit të mandatit fillestar, gjyqtari mund të ri-emërohet dhe të ketë mandat të përhershëm deri në moshën e pensionimit. Megjithatë, mandati i gjyqtarit nuk është i absolutizuar në kohë, pasi në përputhje me rregullat e përcaktuara ligjore, mandati mund t'i ndërpritet para përfundimit të mandatit fillestar apo atij të përhershëm. Sikurse tek procedurat e emërimit, sipas Kushtetutës (neni 105, paragr. 2) kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga KGJK dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve.

Çështjen e periudhës provuese është një nga çështjet e diskutueshme, përveç tjerash edhe nga shumë instrumente ndërkombëtare që trajtojnë pavarësinë e gjyqësorit, gjë që shprehen qëndrime skeptike lidhur me zgjidhjet që janë pranuar nga shtetet për të rregulluar kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit. Lidhur me këtë, Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve (1998), edhe pse nuk shpreh optimizëm me rezultatet pozitive që mund të derivojnë nga një periudhë provuese e tillë, megjithatë nuk rekomandon që një praktikë e tillë të mos zbatohet. Kufizimi i mandatit fillestar në tri vjet, objektivisht mund të ngrejë dyshime lidhur me çështjen se sa mund të jetë gjyqtari i pavarur dhe i paanshëm, përderisa emërimi fillestar është në afat të tillë kohor, me ç'rast siguria e vazhdimit të mandatit pasues të tij është në pikëpyetje. Lidhur me këtë, në Raportin për emërimet gjyqësore (2007) të nxjerrë nga Komisioni i Venedikut, konsiderohet se caktimi i periudhave provuese mund të dëmtojë pavarësinë e gjyqtarëve, pasi ata mund të ndihen nën presion për të vendosur raste në një mënyrë të veçantë.

Një tjetër çështje me rëndësi është edhe kompetenca profesionale e gjyqtarit. Kjo kërkesë buron nga shumë instrumente ndërkombëtare, përkatësisht në Opinionin e KKGJ për trajnimin fillestar (2003), theksohet se gjyqtarët duhet të sigurojnë se posedojnë një shkallë të lartë të kompetencës profesionale (parimi 9) dhe se në çdo vend, legjislacioni mbi statusin e gjyqtarëve duhet të parashoh trajnim për gjyqtarët (parimi 12). Rëndësia e kompetencës profesionale të gjyqtarit lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e tij që gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore të jetë i pavarur dhe i paanshëm. Sipas Ligjit për KGJK-në, Akademia e Drejtësisë në bashkërendim me KGJK përcakton politikat, standardet dhe udhëzimet për rregullimin e trajnimit të gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe stafit tjetër gjyqësor (neni 50). Në funksion të përcaktimit të një regjimi programor që ofron kompetencë profesionale për ushtrimin e

funksioneve gjyqësore, Akademia e Drejtësisë ka nxjerrë Rregulloren nr. 03/2017 për trajnimin fillestar (2017) dhe Rregulloren nr. 02/2013 për programin e trajnimit të vazhdueshëm (2013), që zbatohen gjatë udhëheqjes së politikës së trajnimit ndaj gjyqtarëve. Rregullorja për trajnimin fillestar parasheh kohëzgjatjen e trajnimit, çështjet kurrikulare për t'i ofruar kompetencë profesionale gjyqtarit të emëruar, si dhe politikat e vlerësimit të performancës. Përveç trajnimit fillestar, është paraparë që gjyqtarët sipas nevojës mund t'i nënshtrohen edhe trajnimit të vazhdueshëm profesional, me qëllim të arritjes së shkathtësive dhe kompetencave të domosdoshme profesionale, gjë që shprehet edhe në Ligjin për KGJK (neni 34, paragr. 5). Të dy format e trajnimit kanë për qëllim ofrimin e arsimimit ligjor dhe arsimimit të domosdoshëm në fushën e zbatimit të ligjit, me qëllim të kompletimit të pozitës së gjyqtarit, si funksion i rëndësishëm në një shoqëri ku sundon rendi dhe ligji. Është e rëndësishme të thuhet se çështjet kruciale të formësimit profesional lidhen drejtpërdrejt me integritetin profesional dhe atë moral, gjë që bënë të mundshëm ndërtimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Çështjet e rëndësishme, sikurse është etika profesionale dhe profesionalizmi, janë objekt trajtimi dhe investimi në këtë profesion të rëndësishëm.

Lidhur me analizimin e rregullave kushtetuese dhe atyre ligjore për çështjen e trajnimit të gjyqtarëve, na jep mundësi të themi se, parashihen aktivitete të mjaftueshme që gjyqtarët të përfitojnë profesionalisht nga politika e trajnimit. Me anë të këtyre rregullave, tentohet të ndikohet që profesioni i gjyqtarit të jetë në prove profesionale mënyrë permanente sipas kritereve të arsyeshme, me qëllim që ai të kryejë funksionin e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale.

3.4. Liria e shprehjes dhe liria e asociimit gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore

Liria e shprehjes dhe *liria e asociimit* janë dy liri të garantuara me instrumente të shumta ndërkombëtare, përkatësisht me nenin 19 dhe 20 të DUDNJ-së, nenin 19 dhe 22 të PDCP-së, apo me nenin 10 dhe 11 të KEDNJ-së. Edhe pse këto liri janë universale dhe u takojnë të gjithëve pa dallim, në përputhje me kriteret objektive ligjore të njëjtat mund të pësojnë

kufizime të caktuara. Nëse analizojmë kontekstualisht nëse këto liri janë të përshtatshme edhe për gjyqtarët, atëherë këtë çështje duhet trajtuar nga disa perspektiva. Instrumentet ndërkombëtare që merren veçanërisht me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, theksojnë se edhe gjyqtarët kanë të drejtë si të gjithë qytetarët e tjerë për liri të shprehjes, besimit, asociimit dhe pjesëmarrjes në tubime, me kusht që gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, duhet të përmbahen duke ruajtur integritetin e funksionit të tyre, si dhe paanësinë dhe pavarësinë e gjyqësorit (Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit, 1985, parimi 8 dhe Parimet e Bangalorit për sjellje gjyqësore, 2006 , parimi 4.6).

Në kuadër të rendit tonë juridik, liria e shprehjes është e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës, ndërsa sipas nenit 55 dhe 56 të këtij akti, kjo liri nuk është një e drejtë absolute, pasi ajo mund të jetë objekt i kufizimeve për të arritur një qëllim legjitim. Kufizimit të lirisë së shprehjes për gjyqtarë i jepet arsyeshmëri me anë të instrumentit *"Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit"* (1985), pasi sipas këtij instrumenti theksohet se gjyqtarët si bartës të funksioneve gjyqësore, kanë përgjegjësi të shumëfishtë të kujdesen dhe të jenë të denjë për t'i ushtruar ato funksione. Shprehjet e pakujdesshme të gjyqtarëve duke pretenduar lirinë e shprehjes, mund t'i shpie në situata që cenojnë besimin e publikut, apo të nxisin dyshime për mungesë të paanësisë dhe pavarësisë. Lidhur me këtë, çështjen e lirisë së shprehjes së gjyqtarëve, shumica e shteteve e kanë të rregulluar me ligje dhe kode etike për sjelljen e gjyqtarëve.

Në kontekstin tonë, çështja e kufizimit të lirisë së shprehjes për gjyqtarë është objekt trajtimi në shumë akte. Sipas nenit 34, paragr. 4 të Ligjit për gjykatat parashihen disa kufizime për gjyqtarë, sikurse përcaktohet se ata *"nuk duhet të komentojnë në media përmbajtjen, provat dhe vendimet e cilësdo lëndë, duke mos u përfshirë në çfarëdo komunikimi ex-parte me askënd për lëndët."* Në mënyrë të detajuar kufizimet për lirinë e shprehjes për gjyqtarë janë të parapara në *"Kodin nr. 01/238 të Etikës Profesionale për Gjyqtarë"* (2016) të nxjerrë nga KGJK (tani e tutje: Kodi i etikës profesionale për gjyqtarë). Në këtë dokument ligjor parashihen kriteret themelore që gjyqtari duhet t'i përmbush, për të siguruar që ai ka vlera përkatëse për të shërbyer dhe ushtruar funksionin e gjyqtarit duke respektuar parimin e pavarësisë, paanshmërisë, barazisë, integritetit, profesionalizmit dhe konfidencialitetit.

Sipas Kodit të etikës profesionale për gjyqtarë, theksohet se të ruajtur parimin e pavarësisë, gjyqtari duhet të përmbahet nga çfarëdo sjellje që mund të nxisë dyshime për politizim, si dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve zyrtare apo private të tij, ai duhet të minimizojë mundësinë e përjashtimit nga procedura gjyqësore (parimi 1.1 dhe parimi 2.2). Në këtë dokument theksohet se për të respektuar parimin e barazisë, gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij nuk duhet qoftë me fjalë, gjeste apo sjellje të shfaq anshmëri apo paragjykim ndaj kujtdo qoftë. Edhe pse gjyqtari sikur çdo qytetar tjetër, ka të drejtë ta shpreh lirshëm mendimin, besimin fetar apo të marrë pjesë në takime që kanë të bëjnë me ushtrimin e këtyre lirive, mirëpo gjatë realizimit të këtyre të drejtave duhet të sillet gjithmonë në atë mënyrë që të ruajë dinjitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit (parimi 3.1 dhe parimi 4.3).

Sipas këtij Kodi, parashihet që gjyqtari në marrëdhëniet e tij personale si dhe me pjesëtarët e komunitetit të drejtësisë, duhet t'i shmanget situatave që mund të vënë atë në dyshim për paanshmërinë e tij (parimi 2.4). Në mënyrë të zgjeruar në këtë dokument parashihet sjellja e gjyqtarit në raport me publikun dhe mediat, si dhe çështjet që lidhen me konfidencialitetin. Gjyqtari sipas këtij Kodi e ka për obligim të ruajë konfidencialitetin e të gjithë rasteve dhe nuk duhet të bëjë komente publike në përputhshmëri me detyrimet ligjore (parimi 6). Në të gjithë rastet kur bënë paraqitje publike, gjyqtari duhet të promovojë profesionin e gjyqtarit, duke pasur për detyrim që të përmbahet nga çfarëdo komentimi publik lidhur me performancën ose efikasitetin e gjyqtarëve, bartësve të funksioneve gjyqësore apo sistemit gjyqësor në përgjithësi. Gjyqtari i cili është i autorizuar për dhënien e informatave të caktuara, duhet të jetë objektiv dhe i saktë në deklarimet e tij, të jetë i kujdesshëm në mbrojtjen e të dhënave personale dhe familjare të palëve, të dëmtuarve, të pandehurve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë (parimi 6).

Duke marrë parasysh natyrën e funksionit të gjyqtarit, kufizimet e sipërpërmendura për lirinë e shprehjes të cilat janë paraparë në Kodin e etikës profesionale për gjyqtarë, janë në përputhje me nenin 55 dhe 56 të Kushtetutës. Për më shumë, ky dokument është në harmoni me *"Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit" (1985) dhe me "Kartën Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve" (1998).*

Sikurse liria e shprehjes, ashtu edhe liria e asociimit është e garantuar me Kushtetutë (neni 44). Kjo liri ngërthen në vete të drejtën e secilit person që pa pasur nevojë të sigurojë leje, të mund të themelojë një organizatë, të jetë ose jo anëtar i një organizatë, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet vetëm me ligj. Debati për të lirinë e asociimit dhe kufizueshmërinë e saj tek gjyqtarët, nuk është asnjëherë shterues. Sikurse e përmendën mundësinë e kufizimit të lirisë së shprehjes tek gjyqtarët, me të njëjtin kriter mund të vendoset për të kufizuar edhe lirinë e asociimit. Sipas *Parimeve bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit* (1985), theksohet se gjyqtarët duhet të jenë të lirë të formojnë dhe t'i bashkohen asociacionit të gjyqtarëve apo organizatave të tjera për t'i prezantuar interesat e tyre, për të promovuar trajnimin e tyre profesional si dhe të ruajnë pavarësinë e tyre gjyqësore (parimi 9). Ndërsa sipas *Magna Karta e Gjyqtarëve* (2010), theksohet se gjyqtarët kanë të drejtë të jenë anëtarë të shoqatave kombëtare ose ndërkombëtare të gjyqtarëve, që merren me mbrojtjen e gjyqësorit në shoqëri (parimi 12). Pa u kufizuar vetëm në instrumentet që i përmendëm më sipër, çështja e lirisë së asociimit të gjyqtarëve edhe në instrumente tjera adresohet vetëm në kontekst të lirisë së gjyqtarit për të themeluar një organizatë apo për të marrë pjesë në aktivitete apo veprimtari të drejtpërdrejta që lidhen me funksionin e gjyqtarit. Ndjeshmëria e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, që përfshinë në mënyrë permanente respektimin e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, kufizojnë në masë të madhe mundësinë që individi t'i gëzojë në mënyrë më të gjerë liritë e dhëna.

Mundësia e asociimit të gjyqtarit për ndonjë aktivitet, veprimtari apo organizatë, në Kosovë iu nënshtrohet rregullave kushtetuese, ligjore dhe etike. Sipas nenit 106 të Kushtetutës përcaktohet se se gjyqtari nuk mund të ushtrojë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, përfshirë aktivitetet politike (paragr. 1), apo të ushtrojë ndonjë funksion tjetër që bie në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së rolit të gjyqtarit (paragr. 2). Lidhur me këtë, sipas Ligjit për gjykatat, gjyqtarët nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë partie politike, lëvizjeje apo çfarëdo organizate tjetër politike, e as të marrë pjesë në çfarëdo lloj veprimtarie politike. Gjyqtarët nuk do të kërkojnë e as nuk do mbajnë asnjë lloj të zyrës politike (neni 35, paragr. 2).

Ndërsa, sipas Kodit të etikës profesionale për gjyqtarë, theksohet që gjyqtari për të ruajtur parimin e barazisë dhe paanësisë nuk duhet të jetë pjesë e organizimeve të caktuara. Gjyqtari duhet të përmbahet nga anëtarësia në grupime dhe organizata ose pjesëmarrje në diskutime publike në të cilat, sipas opinionit të publikut, nxit dyshime në paanshmërinë e gjyqtarit ose gjyqësorit në përgjithësi. Gjyqtari nuk mund jetë anëtar i ndonjë subjekti politik, apo të merr pjesë në tubime apo manifestime politike (parimi 2.2.3). Sipas këtij Kodi, liria e asocimit i lejohet gjyqtarit në raste që të formojë apo të jetë anëtar i shoqatave të gjyqtarëve apo shoqatave tjera ku përfaqësohen interesat e gjyqtarëve (parimi 4.9). Qëllimi i Kodit për këtë pjesë, shpreh vullnetin që të kufizojë mundësinë e asociimit të gjyqtarit me çfarëdo veprimtarie apo aktiviteti që bie në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e të qenit gjyqtar, gjë që e njëjta qasje mund të shihet edhe në rregullat e përmendura kushtetuese dhe ligjore. Ky refleksion është në përputhje me qasjen që mund të gjendet në instrumentet ndërkombëtare që merren me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

3.5. Imuniteti i gjyqtarëve

Imuniteti i gjyqtarëve, së bashku me kriteret tjera që i trajtuam gjerë më tani, është dimension i rëndësishëm që garanton në mënyrë të prekshme pavarësinë dhe paanshmërinë e funksionit të gjyqtarit. Imuniteti gjyqësor ka për qëllimin parandalimin e ushtrimit arbitrar të pushtetit shtetëror, nga brenda dhe jashtë gjyqësorit, duke i siguruar gjyqtarit paprekshmëri gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore nga ndikimet e mundshme publike apo politike. Për shkak të peshës dhe rëndësisë që ka imuniteti për gjyqtarët, kjo çështje është bërë objekt trajtimi nga shumë instrumente ndërkombëtare. Për të ushtruar funksionet gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, instrumentet ndërkombëtare që garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, rekomandojnë apo obligojnë shtetet që t'u sigurojnë gjyqtarëve imunitet në kryerjen e detyrave të tyre. I tillë është instrumenti ndërkombëtar *Magna Karta e Gjyqtarëve* (2010), që kërkon që pavarësia e gjyqësorit duhet të jetë e garantuar sa i përket aktiviteteve gjyqësore dhe në mënyrë të veçantë *inter alia* për imunitetin gjyqësor (parimi 4).

Ndërsa sipas instrumentit *Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit* (1985), kërkohet nga shtetet që gjyqtarët duhet të vishën me imunitet si masë mbrojtëse nga paditë civile për dëmet monetare për veprimet e gabuara ose lëshimet gjatë ushtrimit te funksioneve gjyqësore (parimi 16). Ndërsa sipas *Opinionit nr. 3 mbi parimet dhe rregullat e etikës, sjelljes së papërshtatshme dhe objektivitetin e gjyqtarit* (KKGJE, 2002), theksohet se gjyqtarët nuk mund të kenë imunitet për veprat penale që kryejnë, qoftë edhe gjatë ushtrimit të detyrës së tyre (paragr. 52). Kjo qasje shkon në kufizim të imunitetit për gjyqtarë, gjë për të cilën shumica e shteteve tani janë duke ofruar vetëm imunitetin funksional për gjyqtarë. Pra, imuniteti i gjyqtarit në këto instrumente, shfaqet në formë të ngushtë, d.m.th. gjyqtari mund të gëzojë imunitetet vetëm për fushëveprimin e funksionit që është duke ushtruar, ndërsa e zhvesh nga imuniteti i pakufizuar.

Ndërsa, në rrafshin e brendshëm, imuniteti i gjyqtarit në Kosovë, është i lidhur me dispozitat kushtetuese, ku sipas nenit 107, parashihet gjyqtarët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre (Kushtetuta e RKS, neni 107). Çështja e llojit të imunitetit, imunitet ky absolut apo funksional, ka qenë pjesë e një debati të gjerë publik gjatë vitit 2011 në vendin tonë. Për të qartësuar çështjen e llojit të imunitetit, Qeveria e Kosovës paraqiti pranë Gjykatës Kushtetuese kërkesë pasi konsideroi se ekzistonte nevoja për interpretimin dhe sqarimin e çështjes së imunitetit të deputetëve të Kuvendit, Presidentit dhe anëtarëve të Qeverisë sepse *"kjo çështje ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën."* Kjo gjykatë sqaroi se imuniteti i garantuar me Kushtetutë për pozitat që garantohet është imunitet funksional, pasi kufizohet vetëm në paprekshmërinë e personit brenda fushëveprimit të funksionit që ushtron ai (Gjykata Kushtetuese. Rasti nr. K0 98/11 - Aktgjykim për kërkesën e Qeverisë lidhur me imunitetin, 2011, paragr. 54). Marrë parasysh ngjashmërinë e përmbajtës së normave kushtetuese që rregullojnë çështjen e imunitetit për të gjithë personat që ushtrojnë funksione publike në Kosovë, ky vendim është akt i mjaftueshëm për të qartësuar llojin e imunitetit edhe për gjyqtarë.

Imuniteti funksional që gëzojnë gjyqtarët me Kushtetutë, i liron ata nga përgjegjësia në procedurë gjyqësore vetëm për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë. Imuniteti lidhur me ushtrimin e detyrave dhe funksioneve gjyqësore, nuk kufizohet vetëm gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, por vazhdon edhe pas kohës kur personi nuk është duke ushtruar këtë funksion. Për shkak të karakteristikave të punës të cilën bëjnë gjyqtarët dhe ofrimit të garancive që duhet dhënë atyre për të ushtruar funksionet gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ata gëzojnë imunitet që do t'u mundësojë hapësirë të përshtatshme për t'u ndjerë të lirë dhe të pavarur nga ndikimet e jashtme, qoftë nga ekzekutivi, legjislativi, ndjekja penale nga prokuroria, ushtrimi i padive civile apo shkarkimi nga funksioni që ata ushtrojnë.

Jashtë fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet. Sipas nenit 107, paragr. 2 të Kushtetutës, në të gjitha rastet kur *"gjyqtarët të kenë shkelur ligjin me qëllim, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni."* Ndërsa, sipas nenit 107, paragr. 3 të Kushtetutës, në rast se ndaj një gjyqtari është ngritur aktakuzë nga prokuroria, apo është ndaluar apo arrestuar nga policia, është obligim kushtetues i këtyre organeve për ta njoftuar pa vonesë KGJK-në. Kjo kuptohet se imuniteti i gjyqtarit është imunitet funksional dhe vlen vetëm në kuadër të fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar dhe nuk i krijon paprekshmëri për t'i hetuar apo gjykuar veprat penale të cilat mund t'i ketë kryer. Kushtetuta vesh gjyqtarin vetëm me imunitet nga ndjekja penale brenda fushëveprimit të tij si gjyqtarë, duke përjashtuar imunitetin jashtë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit. Jashtë fushëveprimit të tij si gjyqtar, sikurse për të gjithë qytetarët e tjerë, ndaj tij vlejnë dhe zbatohen normat procedurale dhe materiale penale. Pra, Kushtetuta nuk garanton paprekshmëri lidhur me ndjekjen penale të gjyqtarëve për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre. Ata nuk gëzojnë imunitet as me ndjekjen penale për veprat penale të cilat dyshohet t'i kenë kryer para, gjatë apo pas ushtrimit të funksionit të tij të gjyqtarit.

Për dallim nga rregullimi kushtetues i imunitetit të gjyqtarit në Republikën e Kosovës, gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë gëzojnë imunitet të plotë. Në Shqipëri imuniteti për gjyqtar është i paraparë sipas nenit 137, paragr. 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë (1998), ku theksohet se gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Kuvendit, me përjashtim të rasteve kur ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Në këto raste organi kompetent, qoftë policia apo Prokuroria njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998). Ndërsa, sipas nenit 137, paragr. 3 dhe 4, theksohet që gjyqtarët e tjerë mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Ndërsa, gjyqtari mund të ndalohet ose të arrestohet pa miratimin e KLD-së vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij dhe në këto raste organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se KLD nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998).

Gjyqtarët gëzojnë imunitet funksional edhe nga paditë civile vetëm brenda fushëveprimit të tyre në kuadër të përgjegjësive dhe detyrave të gjyqtarit. Sikurse e përmendëm, imuniteti i gjyqtarit është i paraparë sipas nenit 107 të Kushtetutës. Imuniteti funksional nga paditë civile, sikurse edhe për imunitetin nga ndjekja penale, nuk kufizohet vetëm gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, por është i pakufizuar në periudhë kohor dhe vlen edhe pas pushimit të funksionit.

Gjyqtarët për shkak të natyrës së tyre të punës, mund të ndjehen të pambrojtur edhe për shkak të presioneve për ushtrim të padive civile. Për të garantuar pavarësi dhe paanshmëri në ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe për t'i siguruar pavarësi nga ndërhyrjet e jashtme, me qëllim që gjyqtari të veprojë pa presion dhe detyrim të caktuar, gëzon imunitet të plotë brenda fushëveprimit të tij si gjyqtarët përderisa është duke ushtruar përgjegjësitë dhe detyrat e tij në këtë funksion, ndërsa jashtë fushëveprimit si gjyqtar, nuk gëzon imunitet.

Sipas *Opinionit nr. 3 mbi parimet dhe rregullat e etikës, sjelljes së papërshtatshme dhe objektivitetin e gjyqtarit* (KKGJE, 2002), theksohet se gjyqtarët duhet të gëzojnë lirinë absolute nga përgjegjësia lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij. Gabimet e mundshme gjyqësore të cilat mund të jenë pjesë e lëshimeve gjatë zbatimit të procedurës përkatëse, mund të

adresohen gjatë ushtrimit të mjeteve juridike të cilat i ka në dispozicion pala pretenduese (paragr. 55) Megjithatë, praktikat e disa vendeve evropiane i kanë vënë në përgjegjësi gjyqtarët në rastet kur ata dështojnë të marrin veprimet për të cilat janë të obliguar t'i ndërmarrin brenda një afati të caktuar kohor, apo bëjnë neglizhencë në lidhje me çështjen për të cilin janë caktuar për të gjykuar. Në shumë raste është vështirë e matshme çështja e përgjegjësisë dhe pasojave të cilat mund t'i adresohen gjyqtarit për çështje të tilla nga palët pretenduese. Në rastet e cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, GJEDNJ i ka vënë përgjegjësi sistemit të drejtësisë së shtetit përkatës, dhe jo përgjegjësi individuale gjyqtarit. Në rastin tjetër, vendimet e gabuara të cilat bien në kundërshtim me ligjin penal material, janë objekt i trajtimit nga organet e ndjekjes, gjë që objektivisht nuk kap vetëm përgjegjësinë civile, edhe pse përgjegjësia civile mund të vendoset si procedurë e përbashkët me procedurën penale dhe çështja lidhur me dëmin material apo moral të zgjidhet së bashku me çështjen kryesore penale, që njihet si procedurë e ad-hezionit. Nëse i referohemi *Kartës Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve* (KE, 1998), ky instrument parashihet që shteti do të kompensojë dëmet që janë pësuar si rezultat i sjelljes së gabuar të gjyqtarit ose ushtrimin e paligjshëm të funksioneve të tij përderisa vepron si gjyqtar. Kjo nënkupton se shteti është garantues i kompensimit të viktimës (paragr. 5.2).

3.6. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve

Janë një mori instrumentesh ndërkombëtare që kanë për objekt trajtimi kriteret, parimet, procedurat dhe standardet që lidhen me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, ndërsa çështja e adresimit të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve vazhdon të mbetet çështje tejet e ndjeshme. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, është një ndër kriteret që varet pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit. Adresimi i saktë dhe zgjidhja e çështjeve disiplinore të gjyqtarëve brendapërbrenda gjyqësorit sipas procedurës së drejtë disiplinore, shfaq vullnetin që gjyqësori po përpiqet për t'u mbajtur i pavarur dhe i paanshëm. Sipas Kartës Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve (KE, 1998), theksohet se secili subjekt duhet të ketë mundësinë që të

paraqesë një çështje të caktuar pa formalizma të veçantë, një autoriteti të pavarur një kundërshtim lidhur me keqadministrimin e drejtësisë (neni 5.3). Ndërsa, sipas *Magna Karta e Gjyqtarëve* (2010), theksohet që procedurat disiplinore ndaj një gjyqtari duhet të shqyrtohen para një organi të pavarur me mundësi të adresimit të tyre të mëtutjeshëm përpara një gjykate (parimi 6). Gjithashtu edhe sipas *Parimeve Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit* (1985), theksohet që gjyqtarët do t'i nënshtrohen pezullimit apo largimit nga funksioni i gjyqtarit vetëm për arsye objektive të paaftësisë apo sjelljes që i bën ata të paaftë për t'i kryer detyrat e tyre (parimi 18). Ndërsa, të gjitha procedurat disiplinore, pezullimet apo largimet duhet të përcaktohen në pajtim me kriteret e vendosura paraprakisht, ku pavarësisht llojit të vendimit, të njëjtat duhet të kenë mundësi t'i nënshtrohen rishikimit nga një organ më i lartë (parimi 19 dhe 20).

Në përputhje me kriteret ndërkombëtare të përmendura më sipër, sipas nenit 108, paragr. 3 të Kushtetutës, KGJK si institucion që kujdeset për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, është përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve. Me zgjidhjet të cilat janë dhënë në Ligjin për KGJK-në, vet ky organ nuk udhëheq, e as administron me çështjet disiplinore, për këto qëllime është paraparë themelimi i një organi të pavarur që do të merret me këto çështje, por që do të jetë nën autoritetin e tij. Për këto arsye, sipas nenit 43 të Ligjit për KGJK-në, Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) është themeluar si organ i ndarë dhe i pavarur që i shërben si KGJK-në ashtu edhe Këshillit Prokurorial. Kjo instancë është përgjegjëse për inicimin dhe zhvillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe prokurorëve të shtetit aty ku ekziston bazë e arsyeshme për të besuar që sjellja e pahijshme mund të ketë ndodhur, si dhe për ofrimin e rekomandimeve dhe paraqitjes pranë Komisionit Disiplinor të provave në mbështetje të veprimit disiplinor (Neni 45, paragr. 1, Ligji për KGJK-në). Në funksion të kryerjes së mandatit të tij ligjor, kjo instancë fillon hetime sipas informacioneve të cilat i vijnë asaj në rrugët e përcaktuara ligjore, gjithashtu vet ka të drejtë të mbledhë prova lidhur me rastet që është hapur hetime të caktuara. Të gjithë informacionet të cilat lidhen me sjelljen e pahijshme të gjyqtarëve, si brenda ashtu edhe jashtë gjyqësorit, duhet të jenë objekt i shqyrtimit nga organet disiplinore. Procedura disiplinore nuk duhet nënkuptuar si një proces me qëllim të stigmatizimit të gjyqtarëve, por është një mundësi që gjyqësori të mund të mbahet i pavarur dhe i paanshëm. Sikurse edhe përmendet në rregullat ligjore, në rast

të ekzistimit të dyshimit të bazuar se një subjekt ka bërë sjellje në kundërshtim me etikën e gjyqtarit, ZPD paraqet pranë Komisionit Disiplinor të KGJK-së rastin me të gjithë dëshmitë dhe përshkrimet relevante. Komisioni Disiplinor është organ kolegjial me natyrë mikste në vendimmarrje. Ky komision duhet të përbëhet nga 3 anëtar të KGJK-së, dy nga të cilët duhet të jenë gjyqtar, ku kryesuesi i këtij komisioni duhet të jetë gjyqtar (Ligji për KGJK-në, neni 33).

Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të sillen me etikë të lartë dhe të reflektojnë profesionalizëm, pasi secili veprim i tyre që mund të cenojë parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjatë ushtrimit të këtij funksioni, është i ndaluar dhe për këtë ndiqet procedurë përkatëse disiplinore. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve është çështje serioze, ngaqë nga kjo pjesë varet edhe vet kredibiliteti dhe besimi i publikut në gjyqësor. Adresimi i çështjeve të natyrës disiplinore duhet të jetë i saktë dhe i drejtë, njëkohësisht kjo çështje duhet shikuar nga shumë pikëpamja, ngaqë në njërën anë kjo kërkon kujdes për të ruajtur besimin e publikut në gjyqësor, ndërsa në anën tjetër shprehet tendencë që gjyqtarët të mos i nënshtrohet sistemit disiplinor për të shqyrtuar përgjegjësinë e tyre disiplinore. Në analizim të dispozitave ligjore lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, mund të shohim se sjellja e pahijshme e gjyqtarit është zgjidhur sipas modelit të parimit të legalitetit, ku veprimet apo mosveprimet disiplinore janë paraparë në mënyrë të qartë, gjë që mosrespektimi i tyre do të përbënte shkelje disiplinore të caktuar.

KGJK në përputhje me nenin 34, paragr. 3 të Ligjit për KGJK, ka nxjerrë *Rregulloren nr. 04/2016 për caktimin e sjelljeve të pahijshmen* (2016). Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktohen sjelljet e pahijshme të gjyqtarëve, kategorizimi i këtyre sjelljeve, si dhe përcaktimi në parim i sanksioneve disiplinore për shkeljet e kryera për të cilat gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore (Rregullore për caktimin e sjelljeve të pahijshme, KGJK, 2016, neni 1). Sipas kësaj rregulloreje, sjelljet e pahijshme të gjyqtarit kategorizohen në:

a) sjellje të pahijshme të lehta;

b) sjellje të pahijshme të rënda; dhe

c) sjellje të pahijshme shumë të rënda (neni 2.2).

Shkelje të pahijshme shumë të rënda konsiderohen:

1) shkelje shumë e rëndë konsiderohet anëtarësimi në një subjekt politik;

2) shkelje shumë e rëndë konsiderohen edhe sjellje të tjera që diskreditojnë shumë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si dhe imazhin e sistemit gjyqësor;

3) përsëritja e sjelljes së rëndë brenda dy viteve përbënë shkelje shumë të rëndë (shih: Rregullore për caktimin e sjelljeve të pahijshme, KGJK, 2016, neni 7).

Pasi që Komisioni Disiplinor merr vendim për inicimin e procedurës disiplinore, gjyqtari nën hetim do të njoftohen për bazën e procedurës disiplinore dhe do të ftohen që të paraqitet në një seancë të mbyllur, ku ata mund edhe të vet-përfaqësohen apo të caktojnë avokat mbrojtës (Ligji për KGJK). Procedura që zhvillohet pranë Komisionit Disiplinor është tejet dinamike, në të janë të gërshetuara karakteristikat e procedurës kontradiktore, ku në njërën anë në anën e ndjekjes paraqitet ZPD, ndërsa në anën tjetër paraqitet gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore. Në procedurën e provave, gjyqtari mund të kundërshtojë provat e prezantuara nga zyra e ZPD-së dhe ka mundësi të paraqesë argumente shtesë për dyshimet për të cilat kjo zyrë ka ngritur kundër tij. Është e drejtë e gjyqtarit kundër të cilit zhvillohet procedura që t'i ofrohet gjithë mundësia për të paraqitur çështjen e tij pranë këtij komisioni në një kontekst kohor të përshtatshëm dhe të përzgjedh argumentet sipas bindjes së lirë të tij (Rregullore nr. 189/2013 për punën e Komisionit Disiplinor, KGJK, 2013, neni 13).

Sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komisioni ka për obligim të përcaktojë përgjegjësinë disiplinore ndaj gjyqtarit dhe në përputhje me kriteret e domosdoshme ligjore duhet të përcaktojë dhe masën e përshtatshme për këto shkelje. Normalisht sikurse në cilëndo procedurë, gjyqtari duhet të njoftohet me shkrim në mënyrë të detajuar për vendimin që është marrë në rastin ndaj tij, si dhe duhet t'i ofrohet mundësi që të kundërshtojë tek një instancë me e lartë administrative. Dy-shkallshmëria e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit është e harmonizuar me parimet që dalin nga neni 20 të Parimeve Bazë të Pavarësisë së Gjyqësorit (1985) dhe nenin 5.1 të Kartës Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve (1998). Në të gjithë rastet kur konstatohet përgjegjësia e rëndë disiplinore e gjyqtarit, ndaj të cilit duhet të shqiptohet masa e largimit nga funksioni i gjyqtarit, procedurat e tilla duhet të udhëhiqen në mënyrë të kujdesshme, duke i respektuar të drejtat e garantuara kushtetuese dhe ligjore. Edhe procedura disiplinore me anë të parimeve të saj të drejta, garanton secilit subjekt të drejta të plota në funksion të paraqitjes së rastit dhe gjykimit të drejtë.

Sikurse e përmendëm, rregullat aktuale ligjore që janë paraparë për përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të gjyqtarëve janë në harmoni me instrumentet ndërkombëtare që përcaktojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore është shumë me rëndësi për të mbajtur një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, kjo procedurë është e rëndësishme për të adresuar dhe zgjidhur çështjet e rëndësishme në funksion të ruajtjes së integritetit të gjyqësorit.

4. Gjykata si institucion apolitik

E drejta e të pandehurit për tu gjykuar nga një gjykatë të pavarur, nuk lidhet vetëm me çështje të thjeshta formale, pasi natyra e çështjes është përmbajtësore dhe ndërlidhet me të gjithë faktorët të cilët mund të ndikojnë apo dobësojnë pavarësinë e gjyqësorit. Lidhur me këtë, marrë parasysh marrëdhënien mes vete tri pushteteve, ndërvarjen e përgjegjësive dhe shprehjen e tendencave të caktuara për ndikimet politike në sistemin e drejtësisë, me qëllim të ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së pushtetit gjyqësor, shumica e shteteve kanë themeluar këshille gjyqësore, si institucione për të mbajtur gjyqësorin të pavarur dhe të paanshëm. Sikurse edhe në rastin tonë, këto këshille gjyqësore do të duhej të ishin pengesë e rëndësishme për të politizuar apo cenuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit në përgjithësi.

Në Kushtetutë janë dhënë disa zgjidhje ku parashihet mes tjerash që gjykata duhet të jetë apolitike (neni 102, paragr. 2). Lidhur me këtë, gjykatat kanë për obligim kushtetues të gjykojnë sipas Kushtetutës dhe ligjit, gjë funksionimi i tyre duhet të jenë i pavarur dhe i paanshëm, duke mos lejuar ndikimet e çfarëdollojta, përfshirë dhe ndikimet politike. KGJK sipas Kushtetutës (neni 108, paragr.1) është institucion që kujdeset për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor, ndërsa sipas Ligjit për KGJK (neni 3), ky institucionet përkufizohet si institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi të pavarur, të drejtë, apolitik, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm. Lidhur me

këtë, përbërja e KGJK-së, është një tjetër çështje e rëndësishme që meriton trajtim, mirëpo pasi e njëjta është elaboruar në trajtimet e mëhershme, në këtë pjesë nuk do të ndalemi më shumë.

Mënyra e rekrutimit dhe përzgjedhjes së gjyqtarëve, është një tjetër kriter që mat ndikimin që mund të ketë politizimi i sistemit të drejtësisë. Shumica e sistemeve gjyqësore në Evropë, kanë unifikuar procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes së gjyqtarëve, duke përjashtuar rekrutimin dhe përzgjedhjen e tyre nga parlamenti dhe qeveria dhe duke ia lënë në dorë këshillave gjyqësor, si trupa ta pavarur. Emërimet e mundshme gjyqësore nga Qeveria, janë vlerësuar se shtojnë frikën e politizimit të gjyqësorit si pushtet i pavarur, gjë që dëmton rëndë pavarësinë e gjyqësorit në raport me pushtetet tjera, duke ndikuar kështu negativisht në perceptimin për gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm. Lidhur me këtë, në disa demokraci të vjetra, ekzistojnë sisteme në të cilat pushteti ekzekutiv ka ndikim të fortë në emërimet në gjyqësor. Sistemet e tilla mund të funksionojnë mirë në praktikë dhe të lejojnë një gjyqësor të pavarur, sepse ekzekutivi është i kufizuar me kultura dhe tradita juridike, të cilat janë zhvilluar për një kohë të gjatë. Demokracitë e reja, megjithatë, ende nuk kanë pasur mundësi për të zhvilluar këto tradita, të cilat mund të parandalojnë abuzimin. Prandaj, të paktën në demokracitë e reja janë të nevojshme dispozita kushtetuese si një masë mbrojtëse për të parandaluar abuzimin politik nga pushtetet e tjera shtetërore në emërimin e gjyqtarëve (Opinion për ndryshimet e fundit në ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Venedikut, 1998, paragr. 5, cituar sipas Raportit nr. 403/2006 për emërimet gjyqësore, Komisioni i Venedikut, 2007, paragr. 22).

Me qëllim të ruajtës së pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë, sipas nenit 108, paragr. 3 të Kushtetutës, KGJK është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore, ndërsa Presidenti si autoritet politik, sipas nenit 84, paragr. 16 dhe nenit 104, paragr. 1, ka për kompetencë vetëm të emërojë dhe shkarkojë gjyqtarët sipas propozimit të KGJK-së. Nga analiza e rregullave kushtetuese dhe ligjore që ndërlidhen me KGJK-në, mund të vërejmë se asnjë nga pozitat gjyqësore nuk i është në diskrecion për t'u rekrutuar nga institucionet tjera përveç KGJK-së, gjë që kjo është në përputhje me frymën që promovohet nga KKGJE dhe Komisioni i Venedikut (shih: Raportin nr. 403/2006 për emërimet gjyqësore, 2007), ku në mënyrë të përsëritur

kërkohet që për emërimin në pozita gjyqësore duhet vendosin vetëm institucionet që kujdesen për pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor, sikurse janë këshillat gjyqësorë.

Çështja e ruajtjes nga de-politizimi i gjykatës dhe gjyqtarit, është pjesë përbërëse e Ligjit për Gjykatat. Sipas nenit 35, paragr. 2 të Ligjit për Gjykatat, parashihet që gjyqtarët nuk mund të jenë pjesëtarë të një partie politike, lëvizjeje apo çfarëdo organizate tjetër politike, e as të marrë pjesë në çfarëdo lloj veprimtarie politike. Kjo ndalesë është absolute, gjë që lidhet për gjithë kohëzgjatjen e ushtrimit të funksioneve gjyqësore.

KAPITULLI V

E DREJTA PËR TU GJYKUAR PARA GJYKATËS SË PAANSHME, TË THEMELUAR ME LIGJ, E DREJTA PËR BARAZI PARA GJYKATËS DHE MBROJTJA GJYQËSORE

1. Gjykata si institucion i paanshëm

1.1. E drejta e të pandehurit për gjykim të paanshëm

Paanshmëria dhe pavarësia janë dy parimet fundamentale që ndërtojnë konceptin e pavarësisë së gjyqësorit dhe janë të mishëruara në shumë instrumente ndërkombëtare që garantojnë gjyqësor të pavarur. Sipas *Magna Karta të Gjyqtarëve* (2010), theksohet se gjyqësori paraqet një nga tre autoritetet e çdo shteti demokratik, misioni i të cilit është që të garantojë vetë ekzistencën e sundimit të ligjit dhe në këtë mënyrë, të sigurojë zbatimin e ligjit në mënyrë të paanshme, të drejtë, të ndershme dhe efikase (parimi 1). Sipas të njëjtit instrument, theksohet se pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë (parimi 2). Parimi i paanshmërisë është objekt trajtimi në shumë instrumente të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, atë mund të gjejmë në një mori të instrumenteve ndërkombëtare, kushtetuta, ligje dhe kode etike.

Sipas Kodit të etikës profesionale për gjyqtarë, lidhur me parimin e paanshmërisë theksohet se gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet t'i trajtojë të gjithë palët në procedurë në mënyrë të barabartë, pa favorizime, pa anime dhe pa paragjykime. Ai duhet të jetë dhe të duket i paanshëm. Paanshmëria ka të bëjë jo vetëm me vendimin, por edhe me procedurën e marrjes së vendimit (parimi 2). Pra, një gjykim do të mund të kuptohej si i paanshëm, në rast të mungesës së simpatisë, antipatisë, animit, paragjykimit, jo-objektivitetit etj., të meta të cilat në procedurë penale, sipas rregullit, mund të përjashtohen me institutin e përjashtimit të gjyqtarit. Në anën tjetër, edhe vet mënyra e zhvillimit të procesit penal mund të jetë indikacion për diçka që konsiderohet si argument për mungesë të paanshmërisë (Sahiti & Murati, 2016, f. 121).

Pavarësia e gjyqësorit para-supozon paanësinë e plotë për sa i përket gjyqtarëve. Kur bëhet gjykimi i çfarëdo pale gjyqtarët duhet të jenë të paanshëm, pa ndonjë lidhje, prirje apo paragjykim që ka ndikim ose mund të shihet si ndikuese në aftësinë e tyre për të gjykuar në mënyrë të pavarur. Në këtë aspekt, pavarësia e gjyqësorit është një elaborim i parimit fundamental që thotë *"asnjë njeri nuk mund të gjykojë në rastin e tij"*. Ky parim gjithashtu ka rëndësi shumë më të madhe përtej ndikimit në palët e përfshira në cilindo kontest. Jo vetëm palët e përfshira në ndonjë kontest mirëpo edhe shoqëria si tërësi duhet të jetë në gjendje t'i besojë gjyqësorit. Pra, gjyqtari nuk duhet thjeshtë të jetë i lirë për sa i përket ndonjë lidhjeje të papërshtatshme, prirjeje apo ndikimi, ai ose ajo duhet gjithashtu t'i lënë përshtypje vrojtuesit të pranueshëm se janë të lirë prej këtyre lidhjeve. Përndryshe, besimi në pavarësinë e gjyqësorit mund të nënvlerësohet (Opinion nr. 1 për standardet e Pavarësisë së Gjyqësorit dhe Palëvizshmërinë e Gjyqtarëve, 201, f. 12).

Sipas *Opinionit nr. 1 për standardet e pavarësisë së gjyqësorit dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve* (KE, 2001) theksohet që pavarësia e gjyqësorit para-supozon paanësi të plotë për gjyqtarë. Sipas këtij instrumenti theksohet se gjyqtarët duhet të jenë të paanshëm, pa ndonjë lidhje, prirje apo paragjykim të çfarëdollojtë përderisa janë duke ushtruar funksionin e gjyqtarit. Në këtë aspekt, pavarësia e gjyqësorit është shpjegim i postulatit të njohur *"askush nuk mund të gjykojë në rastin e vet."* Ky parim ka rëndësi shumë më të madhe, përtej ndikimit tek palët e përfshira në cilindo çështje gjyqësore. Jo vetëm palët e përfshira në ndonjë çështje gjyqësore, edhe publiku i gjerë duhet të jetë në gjendje t'i besojë gjyqësorit (paragr. 12).

E drejta për gjykim të paanshëm është një nga të drejtat themelore të të pandehurit në procedurë penale. Kjo e drejtë është dimension që garantohet me instrumente të rëndësishme ndërkombëtare, sikurse është neni 14 (1) i PDCP-së, apo neni 6 (1) i KEDNJ-së, akte këto që garantojnë të pandehurit trajtim të paanshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në të njëjtën frymë, sipas nenit 31, paragr. 2 të Kushtetutës, garantohet e drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Gjithashtu, edhe KPP garanton çdo personi të dyshuar ose të akuzuar për vepër penale se ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme (neni 5, paragr. 1).

Sipas Ligji për gjykatat, theksohet se gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit duhet të jenë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person, përfshirë edhe organet publike (neni 3, paragr. 2). Ndërsa, sipas nenit 34, paragr, 1 të këtij ligji theksohet që gjyqtarët duhet të veprojnë në mënyrë objektive, të paanshme dhe të pavarur. Gjithashtu sipas Ligji për gjykatat përcaktohet që gjyqtarët nuk duhet të kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mundet apo mund të perceptohet si ndërhyrje në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre apo që përndryshe nuk është në përputhje me detyrat e një gjyqtari apo dispozite të Kodit të Mirësjelljes për Gjyqtarë (neni 35, paragr. 1).

1.2. Kriteret për vlerësimin e paanshmërisë

Paanshmëria e gjyqtarit është dimension konkret, gjë që për ta vlerësuar sjelljen e gjyqtarit janë ndërtuar dy lloj të kritereve, të cilat përfshihen në kriterin objektiv dhe në kriterin subjektiv. Kriteri objektiv dhe kriteri subjektiv është bërë objekt i trajtimit të gjerësishëm në një mori të rasteve nga jurisprudenca GJEDNJ-së. Në çështjen *Kyprianou kundër Qipros*, GJEDNJ thekson se ka rëndësi thelbësore në një shoqëri demokratike që gjykatat ta frymëzojnë besimin tek publiku se procedura penale e zhvilluar pranë tyre është e paanshme, gjë që paanshmëria nënkuptohet si mungesë e paragjykimeve ose animeve të çfarëdollojta. Lidhur me këtë, ekziston qasja subjektive dhe objektive për të përcaktuar paanësinë, gjë që qasja subjektive përpiqet të konstatojë bindjen personale ose interesin e një gjyqtari të caktuar për një rast të veçantë, ndërsa qasja objektive, përcakton nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm përderisa është duke ushtruar funksionin e tij në një rast të caktuar (Kyprianou v. Qipro, GJEDNJ, 2005, paragr. 474). Në çështjen *Bajrush Gashi kundër Gjykatës Supreme*, Gjykata Kushtetuese në të njëjtën frymë me vendimin e sipërpërmendur të GJEDNJ-së, konsideron se paanësia e një gjykate sipas nenit 31 të Kushtetutës, apo nenit 6 të KEDNJ-së duhet të përcaktohet sipas kriterit subjektiv dhe objektiv. (Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme, 2012). Çështjen e paanshmërisë së gjyqtarit, KPP adreson në mënyrë të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, si për kriterin subjektiv, ashtu edhe për atë objektiv.

Kriteri subjektiv është kriter që përcakton sjelljen e gjyqtarit në raport me palët në procedurë gjyqësore. Lidhur me elementët të cilat mund të vënë në pikëpyetje paanshmërinë e gjyqtarit në një çështje të caktuar, është në diskrecion e vet atij që të shpreh mungesën e paanshmërisë në këto raste. Ndërsa, në rastet kur vet palët kontestojnë paanshmërinë e gjyqtarit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, barra e të provuarit për këtë pretendim ngelet tek vet pala. Për të dyja rastet duhet ndjekur procedurë përkatëse ligjore.

Në procedurë penale paanshmëria e një gjyqtari duhet të prezumohet derisa të provohet të kundërta në një procedurë të drejtë dhe objektive (Kyprianou v. Qipro, GJEDNJ, 2005, paragr. 475). Rrethanat subjektive të gjyqtarit për ndonjë rast konkret, janë rrethana të brendshme të tij, gjë për të cilat në mënyrë taksative nuk përmendën në dispozitat e KPP-së. Lidhur me këtë, KPP thekson se gjyqtari mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në një rast konkret, nëse përpos rasteve që përcaktohen taksativisht me KPP, prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij ose që duken të papërshtatshme (KPP, neni 39 paragr. 3). Çështja e adresuar në KPP sipas përshkrimeve të sipërpërmendura, është harmonizuar me konkluzionet që kanë derivuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së ndër vite.

Kriteri objektiv i matjes së paanshmërisë së gjyqtarit është kriter i hapur dhe i matshëm. Ky kriter është i shprehur me dispozitat e KPP-së, me ç'rast listohen taksativisht rastet kur gjyqtari bëhet i padenjë për të ushtruar funksionin gjyqësor për çështje konkrete. Për elaborim të këtij kriteri sipas KPP-së, gjyqtari duhet të përjashtohet në rastet kur: 1) është i dëmtuar me vepër penale; 2) është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar; 3) është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit; 4) në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, përfaqësues ligjor apo përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; apo 5) ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet sipas nenit 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (KPP, neni 39, paragr. 1).

Përveç këtyre rasteve, sipas dispozitave të KPP-së parashihet që gjyqtari duhet të nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përjashtimisht situatës nëse gjyqtari që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues (KPP, neni 39, paragr. 2).

Kriteret që i përmendëm më sipër, e të cilat janë pjesë e dispozitave të KPP-së, manifestojnë brengën e ligjvënësit për t'i hequr të gjitha dyshimet e arsyeshme sa i përket paanshmërisë së gjykatës. Në situatat kur sipas kritereve objektive përmbushen bazat për përjashtimin e gjyqtarit, në njërën anë është obligim i gjykatës dhe i vet gjyqtarit që të fillohet procedura përkatëse për përjashtim, ndërsa në anën tjetër është e drejtë e të pandehurit që të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit për cilin ekzistojnë bazë për përjashtim, apo ka dyshime serioze për paanshmërinë apo papërshtatshmërinë e tij në çështjen konkrete (KPP, neni 40). Zhvillimi i procedurës penale përderisa ekzistojnë rrethanat për përjashtimin e një gjyqtari, procedurën penale si tërësi e bënë të padrejtë. Përjashtimi i gjyqtarit mund të kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë zhvillimit të procedurës penale, në rast se ekzistojnë baza për përjashtimin e gjyqtarit në fillim të procedurës penale, ato nuk do të mund të amnistohen dhe të hiqen gjatë zhvillimit të procedurës penale, pasi procedura penale nga procedura penale me dyshime në paanshmëri, nuk mund të bëhet në zhvillim e sipër procedurë penale pa dyshime në paanshmëri.

Përveç rasteve të cilat përshkruhen në KPP e që lidhen me të dy kriteret për vlerësimin e paanshmërisë, ekzistojnë edhe rregullat etike të sjelljes për gjyqtar që janë të parapara me anë të Kodit të etikës profesionale për gjyqtarë. Ky dokument është akt i detyrueshëm ligjor që buron nga Ligji për Gjykatat dhe Ligji për KGJK-në. Me Ligjin për gjykatat, gjyqtarët janë të obliguar që ta respektojnë Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë (neni 35). Sikurse mund të shohim në këtë akt, rregullat e sjelljes së gjyqtarëve janë të sendërtuara mbi parimet bazë të etikës profesionale si në vijim: pavarësia; paanshmëria; barazia; integriteti; profesionalizmi dhe përgjegjësia në punë; konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat. Paanshmëria si vlerë fundamentale e sjelljes etike të gjyqtarit është parim i rëndësishëm që duhet ta posedojë

gjyqtari gjatë kryerjes së funksionit të tij dhe të ruaj atë edhe gjatë kohës sa nuk është duke ushtruar në mënyrë aktive funksionet gjyqësore. Parimi i paanshmërisë për gjyqtarë, parasheh që gjyqtari që gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet t'i trajtojë të gjitha palët në procedurë në mënyrë të barabartë, pa favorizime, anime dhe paragjykime, ku ai duhet të jetë dhe duhet të duket i paanshëm. Paanshmëria nuk lidhet vetëm me vendimin, por edhe me procedurën e marrjes së vendimit (parimi 2). Kodi parasheh gjithashtu që gjyqtari duhet të vet-kufizohet lidhur me ruajtjen e paanshmërisë së tij dhe integritetin e funksionit që e ushtron, si gjatë ushtrimit të funksionit, njashtu edhe në jetën private, ndërsa, nuk duhet t'i komentojë publikisht apo privatisht lëndët që janë në procedurë gjyqësore (parimi 2.4). Ky dokument gjyqtarit i jep diskrecion të plotë që të kërkojë përjashtimin e tij në një çështje të caktuar, përveç kësaj, në këtë akt theksohet që gjyqtari mund të kërkojë përjashtimin e tij, nëse ka dyshime ose supozime se tek publiku krijon përshtypjen për mungesë të paanshmërisë, apo e vlerëson vet se nuk është në gjendje të vendos për lëndën në mënyrë të paanshme (parimi 2.5).

1.3. Procedura dhe vendimi për përjashtim të gjyqtarit

Në rastet kur pretendohet se gjyqtari i caktuar për një rast konkret, ekzistojnë rrethana të ligjshme që mund të cenojnë parimin e paanësisë, ndaj gjyqtarit mund të fillohet procedura për t'u përjashtuar nga ai rast. Cenimi i të drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e paanshme dhe nga një gjyqtar i vetëm apo trup gjykues i paanshëm duhet të argumentohet me bindshmëri të plotë nga pala pretenduese. Edhe paanshmëria sipas kritereve objektive dhe sidomos paanshmëria sipas kritereve subjektive, duhet të dëshmohet me argumente kredibile dhe të bazuara. Barra e të provuarit për pretendimet e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar në mënyrë të paanshme, bie mbi pretenduesin. Lidhur me këtë, në çështjen *Bajrush Gashi kundër Gjykatës Supreme*, Gjykata Kushtetuese thekson që duhet të përcaktohet nëse, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime se a mundet një gjyqtar i caktuar të jetë i drejtë dhe i paanshëm në një rast të caktuar dhe se gjykatat në një shoqëri demokratike duhet që besimin ta frymëzojnë në publik, dhe mbi të gjitha, në të akuzuarin, sa u përket procedurave penale. Si

rrjedhojë, cilido gjyqtar për të cilin ka arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë të paanshmërisë duhet të tërhiqet (Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme, GJK, 2012, paragr. 47).

Procedura për përjashtimin e gjyqtarit mund të iniciohet sipas detyrës zyrtare nga vet gjyqtari apo gjyqtari porot në procedurë për të mitur ose me iniciativën e palës proceduralo-penale (Sahiti & Murati, 2016, f. 126). Sipas nenit 40 paragr. 1 dhe 2 të KPP-së, gjyqtari posa të mësojë se ekzistojnë ndonjë arsye ligjore për përjashtim, ai duhet ndërpresë çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë duhet të njoftojë kryetarin e gjykatës ku ushtron funksionet gjyqësore. Në qoftë se gjyqtari konstaton se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij për shkak të dyshimit personal për mungesën e paanshmërisë të vlerësuara si shkaqe fakultative apo sipas kritereve subjektive, ai për këtë e njofton kryetarin e gjykatës dhe derisa të merret vendim për përjashtim, gjyqtari mund të ndërmerr vetëm ato veprime të cilat janë domosdoshmërisht të nevojshme për të penguar shtyrjen ose vonesën e palejueshme të çështjes, mirëpo asnjëherë nuk mund të merret në themel me çështjen kryesore. Sipas nenit 41 paragr. 1 dhe 2 të KPP-së, përveç vet gjyqtarit, përjashtimin mund ta kërkojë i pandehuri, si dhe prokurori si palë në procedurë penale. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit sapo të kenë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përjashtim, dhe kërkesën mund ta bëjë më së largu deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa në rast të përjashtimit sipas kritereve subjektive, apo fakultative, përjashtimin e kërkon para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Sipas nenit 41 paragr. 3, 4 dhe 5 të KPP-së, kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme, pala mund ta bëjë në ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë ose në përgjigje në ankesë. Pala mund të kërkojë përjashtimin vetëm të gjyqtarit që e trajton çështjen, dhe me rastin e paraqitjes së kërkesës detyrohet që të përshkruajë rrethanat me të cilat e mbështet pretendimin për ekzistimin e bazës ligjore për përjashtim.

Me qëllim të ndalimit për tu abuzuar me kërkesa të përsëritura për përjashtim të gjyqtarit, sipas nenit 41, paragr. 5 të KPP-së theksohet që për shkaqet e paraqitura në kërkesën e mëparshme për përjashtim e cila është refuzuar, nuk mund përsëriten kërkesat. Shqetësimet për abuzime me kërkesa të përsëritura i ka trajtuar edhe Gjykata Kushtetuese në shumë raste të paraqitura pranë saj, me ç'rast ka theksuar se kërkesat e pabazuara, të paargumentuara dhe ato të përsëritura nuk obligojnë instancat më të larta gjyqësore që të nxjerrin vendime vetëm

mbi bazën shfaqjes së pakënaqësive të caktuara. Sa për elaborim, në çështjen *Feti Islami kundër Gjykatës Supreme,* kjo gjykatë thekson se me vet faktin se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e lëndës, në vetvete nuk mund të përbëjë bazë për argumentim të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (Feti Islami v. Gjykata Supreme, GJK, 2011, paragr. 30). Të drejtën e të pandehurit për tu gjykuar nga një gjykatë e paanshme, duhet parë nën dritën e fakteve objektive që mund të argumentohen për padenjësinë e një gjyqtari për të gjykuar në një çështje penale. Zaten, përderisa palët nuk arrijnë të argumentojnë paanshmërinë e ndonjë gjyqtari, janë të prirura të bëjnë kërkesa të vazhdueshme me qëllim të prolongimit të një çështjeje, duke lënë nën hije gjithmonë çështjen kryesore. Lidhur me këtë, sikurse është e drejtë e të pandehurit për tu gjykuar nga një gjyqtarë dhe gjykatë e paanshme në mënyrë të vazhdueshme, njëkohësisht është e drejtë e të pandehurit që të ushtrojë mjete juridike në kërkim të së drejtës së tij për tu gjykuar nga një gjykatë dhe gjyqtarë të paanshëm.

Lidhur me vendimet për kërkesat e parashtruara për përjashtim dhe vet-përjashtim të gjyqtarit, sipas zgjidhjeve të dhëna, KPP u jep mundësi të gjithë kryetarëve të gjykatave ku gjyqtarët ushtrojnë funksionet gjyqësore, të mund të vendosin për këto çështje.

Sipas nenit 42, paragr. 2 dhe 3 të KPP-së, para marrjes së aktvendimit për përjashtim, duhet të dëgjohet gjyqtari apo kryetari i gjykatës, e në rast nevoje zhvillohen edhe hetime të tjera. Kundër aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankesë. Aktvendimi me të cilin kërkesa për përjashtim refuzohet mund të kundërshtohet me ankesë të posaçme, e kur një aktvendim i tillë është marrë pas ngritjes së aktakuzës, atëherë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit. Në qoftë se kërkesa për përjashtim është bërë pa e caktuar identitetin e gjyqtarit dhe pa i qartësuar rrethanat në të cilat mbështetet pretendimin për ekzistimin e bazës për përjashtim ose kërkesa për përjashtim fakultativ është parashtruar para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkesa hidhet në tërësi ose pjesërisht me aktvendim ndaj të cilit nuk mund të ushtrohet ankesë. Aktvendimin e tillë e merr kryetari i gjykatës, kurse në shqyrtim gjyqësor trupi gjykues (Sahiti & Murati, 2016, f. 127).

2. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë kompetente dhe të themeluar me ligj

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë kompetente dhe të themeluar me ligj është një nga të drejtat themelore që gëzon i pandehuri në procedurë penale. Çështja e themelimit të gjykatës me anë të ligjit është e përcaktuar në shumë dispozita të instrumenteve ndërkombëtare, të tilla sikurse i kemi përmendur edhe më herët, neni 14 § 1 i PDCP-së, neni 6 § 1 i KEDNJ-së, apo parimi 5 i Parimeve Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit të OKB-së (1985). Kjo e drejtë bazohet në legjitimitetin që duhet të ketë një gjykatë përderisa pranë saj zhvillohet ndonjë procedurë e caktuar penale, gjë që nuk lejohet të themelohet ndonjë gjykatë veçanërisht për çështjet që përfshijnë një rast të veçantë, apo të ushtrohen nga juridiksione që nuk kanë legjitimitet për të ushtruar funksione gjyqësore. E drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj, nuk kërkon vetëm legjitimitetin e gjykatës, por përfshinë edhe legjitimitetin e gjyqtarit që gjykon çështjen. Për të shpjeguar këtë çështje, po përmendim çështjen *Fatullayev kundër Azerbajxhanit*, ku GJEDNJ thekson se shpjegimi i termit *"gjykatë e themeluar me ligj",* është të garantojë *"që pushteti gjyqësor në një shoqëri demokratike nuk varet nga gjykimi i ekzekutivit, por që është i rregulluar nga ligji që del nga Parlamenti."* Fraza *"gjykatë e themeluar me ligj"* mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e një *"gjykatë",* por edhe përbërjen e trupit gjykues në secilin rast (Fatullayev v. Azerbajxhani, GJEDNJ, 2010, paragr. 144). Pra, përveç kërkesës për rregullsi të gjykatës si institucion që ushtron pushtet gjyqësor, kjo e drejtë përfshinë të drejtën e të pandehurit të gjykohet nga një gjyqtar apo trup gjykues i përcaktuar sipas ligjit dhe kompetent për të ushtruar funksionet gjyqësore.

Sipas nenit 31, paragr. 2 të Kushtetutës, shprehimisht përcaktohet se drejta e të pandehurit të gjykohet nga një gjykatë e themeluar me ligj është pjesë themelore e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ndërsa, sipas nenit 103, paragr. 1, përcaktohet se organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj (Kushtetuta e Kosovës, 2008). Ligji për gjykatat shprehimisht përcakton strukturën organizative dhe kompetencat e gjykatave për tërë territorin e Kosovës. Sistemi i gjykatave i përcaktuar me Ligjin për Gjykatat, sipas nenit 8 përbëhet nga: gjykatat themelore, Gjykata e

Apelit dhe Gjykata Supreme. Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore. Me qëllim të veprimeve më efikase të gjykatës përkatëse, brenda Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore mund të themelohen Departamente dhe Divizione (Ligji për gjykatat, neni 8) Ligji për Gjykatat përcakton për secilën Gjykatë, kompetencën lëndore dhe territoriale. Tejkalimi i juridiksionit lëndor apo territorial që nuk mund të arsyetojë bazat e përcaktuara me ligj, cenon të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë kompetente e themeluar me ligj.

Sipas nenit 103, paragr. 7 të Kushtetutës, përcaktohet se gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo mund të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme. Me këtë dispozitë përjashtohet çdo mundësi që mbi bazën kushtetuese që aktualisht është e zbatueshme të mund të themelohen gjykata që të ushtrojnë juridiksione të jashtëzakonshme. Përderisa janë në fuqi këto dispozita kushtetuese, themelimi i gjykatave të tilla paraqet cenim të normave kushtetuese që përcaktojnë organizimin e pushtetit gjyqësor në Kosovë.

2.1. E drejta për t'u gjykuar nga një gjyqtar apo trup gjykues kompetent

E drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj, përveç të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë kompetente, njëkohësisht përfshinë edhe të drejtën që të gjykohet nga një gjyqtar apo trup gjykues kompetent sipas kritereve të përcaktuara ligjore. Sikurse e përmendëm, kjo çështje është sqaruar në vendimin e dhënë nga GJEDNJ në çështjen *Fatullayev kundër Azerbajxhanit* (2010). Një gjyqtar mund të jetë kompetent dhe t'i plotësojë kriteret e përcaktuara ligjore, nëse ai është emëruar dhe mban pozitën e tij sipas procedurave të rregullta ligjore, gjithashtu kjo e drejtë përfshin dhe ushtrimin e autorizimeve në përputhje me kushtet dhe kriteret ligjore të zbatueshme. Në përputhje me këtë, Kushtetuta, KPP, Ligji për KGJK, Ligji për gjykatat, si dhe aktet e tjera të zbatueshme për gjyqësorin, parashohin kushtet dhe kriteret të cilat duhet t'i plotësojë një gjyqtar për t'u emëruar dhe për të ushtruar funksionet gjyqësore. Gjyqtari që ushtron funksione gjyqësore gjatë detyrës së tij zyrtare, ka një fushëveprim që lidhet me shumë elemente, të cilat mund të jenë elemente këto të natyrës

funksionale, të kompetencës, të përvojës apo edhe të një mori elementësh tjera të rëndësishme. Meqenëse në pjesët e mëparshme kemi trajtuar çështjen e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve, në këtë pjesë do të ndalemi më shumë vetëm lidhur me ushtrimin e funksionit të tij në aspektin organizativ dhe sistemor në kuadër të gjyqësorit.

Duke qenë se kompetencat, përgjegjësitë dhe autorizimet për gjyqtarë janë objekt i rregullimit në rrafshin kushtetues dhe ligjor, të njëjtat janë të precizuara në mënyrë të qartë. Bazuar në dispozitat e KPP-së, kompetencat e gjyqtarëve janë të ndara në mënyrë të plotë ndërmjet tyre, me ç'rast mund të shohim se në procedurën paraprake vepron gjyqtari i procedurës paraprake deri sa ndaj të pandehurit të ngritët aktakuza. Shqyrtimi i urdhrave dhe vendimeve të marra nga gjyqtari i kësaj procedure është adresuar në mënyrë të saktë nga KPP, ku parashihet gjithashtu se të njëjtat mund të shqyrtohen nga instance më të larta bazuar në ushtrimin e mjeteve juridike nga palët e autorizuara. Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore. Rasti vendoset nga gjyqtari profesional i cili shërben si gjyqtar i vetëm gjykues. Ndërsa në procedurën penale në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore, aktgjykimi merret nga tre gjyqtarë profesionist, njëri nga ta kryeson trupin gjykues. Sipas nenit 28 të KPP-së, Gjykata e Apelit gjykon mbi ankesat penale në kolegj prej tre gjyqtarësh, gjithashtu Gjykata Supreme gjykon mbi ankesat penale në kolegj prej tre gjyqtarësh. Lidhur me këtë, mund të shohim se caktimi i gjyqtarëve i nënshtrohet një kriteri objektiv, gjë që KPP ka adresuar sipas kritereve objektive këtë çështje. Përveç kësaj, palëve u është lënë si mundësi që në cilëndo rrethanë të mund të kërkojnë në mënyrë të argumentuar shqyrtimin e paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqtarit për ndonjë rast të caktuar.

Shpërndarja e gjyqtarëve sipas kompetencës së tyre në pozicione të caktuara brenda një gjykate, si dhe shpërndarja e lëndëve tek gjyqtarët i nënshtrohet disa kritereve që përcaktohen me aktet nënligjore të nxjerra nga KGJK. Sipas nenit 11 të Rregullores nr. 15/2016 për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve (KGJK, 2016), kryetari i gjykatës duhet të hartojë planin vjetor për caktimin e gjyqtarëve sipas kompetencës të bazuar në: a) specializimet e gjyqtarëve, b) përvojën në lëmin përkatëse, c) nevojën për të siguruar gjykimin efikas të lëndëve, d) zgjidhjen e lëndëve të grumbulluara nga vitet paraprake, e) performancën e gjyqtarit, si dhe f) historikun disiplinor. Për të respektuar parime të drejta mbi mënyrën e ndarjes së lëndëve

gjyqësore tek gjyqtarët, sipas nenit 24 të Rregullores mbi organizimin e brendshëm të gjykatave (2013) të nxjerrë nga KGJK, parashihet shorti si një nga kriteret objektive për caktimin dhe shpërndarjen e lëndëve gjyqësore tek gjyqtarët. Duke marrë parasysh digjitalizimin e shpejt të administratës, çështja e shpërndarjes së lëndëve gjyqësore tek gjyqtarët mund t'i nënshtrohet procedurës së digjitalizimit elektronik, ku edhe në këto raste, gjatë shpërndarjes së lëndëve në mënyrën e tillë, duhet ruajtur kriteret objektive dhe të paanshmërisë. Rregullorja e sipërpërmendur e lejon mundësinë e shpërndarjes së tillë, pasi të ketë marrë miratimin e KGJK-së.

Në të gjithë rrethanat për të cilat argumentohet se gjyqtari i caktuar nuk është kompetent sipas legjislacionit në fuqi për të gjykuar një çështje të caktuar, i njëjti duhet të ndërrohet dhe në rast se vendimi është marrë nga një gjyqtarë që do të duhej të ndërrohej, vendimi i njëjtë nuk duhet të prodhojë pasoja juridike. Nëse ekzistojnë rrethana për përjashtim të gjyqtarit sipas Kapitullit III të KPP-së, i njëjtë për shkak të jo-kompetencës duhet të përjashtohet dhe të caktohet gjyqtar kompetentë. Nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, caktimi dhe zëvendësimi i gjyqtarit të dorëhequr apo të përjashtuar duhet t'i nënshtrohet procedurave të përcaktuara paraprakisht. KPP ka adresuar situatat nëse procedura penale është zhvilluar në kundërshtim me parimet e trajtuara më sipër, pasi sipas nenit 384 paragr. 1 dhe 2 si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konsiderohet inter alia edhe:

1) përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose është përjashtuar nga gjykimi dhe

2) në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet. Zgjidhjet të cilat janë pranuar në KPP janë në përputhje të plotë me të drejtën e të pandehurit që të gjykohet nga një gjykatë të themeluar me ligj dhe të njëjtat janë të harmonizuara me standardet e trajtuara ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë.

3. E drejta për barazi para gjykatës

Pavarësisht cilësive personale, secili personin gëzon të drejtën të trajtohet i barabartë para gjykatës. Sikurse e kemi trajtuar, e drejta për barazi dhe ndalimi i diskriminimit është objekt i trajtimit të shumë instrumenteve ndërkombëtare, duke filluar nga DUDNJ, PDCP, KEDNJ, Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe instrumente të tjera.

Në përputhje me këto instrumente, e drejta për barazi është e garantuar me Kushtetutën. Në preambulë të saj theksohet se populli i Kosovës, është i përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit (Kushtetuta e Kosovës, 2008). Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimi është një nga vlerat e shtetit që garantohet me neni 7. Barazia para ligjit si një e drejtë themelore, garantohet me dispozitën e nenit 24, ku përcaktohet e drejta për barazi, që garanton se *"të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim"* (Kushtetuta e Kosovës, 2008). Sipas nenit 24, paragr. 2 të Kushtetutës, theksohet që askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare ose shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Mbrojtja nga diskriminimi është e garantuar edhe me Ligjin nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi (2015). Ky ligj është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare që burojnë nga OKB, Këshilli i Evropës, apo Bashkimi Evropian, ku qytetarëve u sigurohet mbrojtje nga diskriminimi dhe mjete efektive juridike për të adresuar diskriminimin dhe qasjen e pabarabartë që cenon dispozitat ligjore të zbatueshme kundër diskriminimit. Sipas këtij ligji parashihet se do t'u ofrohet mbrojtje nga veprimet dhe mosveprimet e institucioneve të të gjitha niveleve, të cilat nuk ofrojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë (neni 2, paragr. 1.11). Në situatat të cilat paraqesin diskriminim, ligji parasheh adresimin procedural të pretendimeve të caktuara, ku Avokati i

Populllit, dhe më pas gjykatat sipas juridiksionit përkatës, janë institucionet të cilat do të trajtojnë rastet për të cilat pretendohet se ka pasur shkelje të së drejtës për barazi (neni 12 dhe 14).

Një nga dimensionet e veçanta të së drejtës për barazi, është edhe e drejta për barazi para gjykatës. Koncepti i të drejtës për barazi sikurse theksohet në nenin 14 § 1 të PDCP-së, se të gjithë personat janë të barabartë para gjykatave dhe organeve të drejtësisë është parim i rëndësishëm. Në përputhje me këtë dispozitë, edhe Ligji për gjykatat e adreson të drejtën e të gjithë personave të trajtohen nga gjykatat në mënyrë të barabartë dhe se: *" ... askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal"* (neni 7.) Në të njëjtën dispozitë të këtij ligji parashihet që çdo person ka qasje të barabartë në gjykata.

E drejta për barazi është e lidhur kushtëzuar me gëzimin e të drejtave tjera, pasi pavarësisht përmbajtjes në vetvete e njëjta nuk mund të veprojë si e drejtë e pavarur. Duke qenë e tillë, e drejta për barazi dhe ndalimi i diskriminimit lidhen drejtpërdrejt me gëzimin apo mohimin e të drejtave të tjera të mbrojtura. Pavarësisht se personi gëzon një mori të drejtash procedurale të garantuar me instrumente ndërkombëtare, kushtetutë dhe me akte tjera në fuqi, ai në procedure penale do të mund të jetë viktimë e shkeljes të së drejtës për barazi, në rast se të drejtat e garantuara për shkak të statusit të tij social do t'i cenoheshin me veprim apo mosveprim. Lidhur me procedurën penale, duhet sqaruar se e drejta për barazi para gjykatës në kontekstin që jemi duke e trajtuar, dallon nga *"barazia e armëve"* që gëzojnë palët në procedurë penale, pasi e drejta për *"barazi të armëve"* ndërlidhet vetëm me barazinë e palëve në procedurë, përkatësisht për mundësitë që gëzon i pandehuri përball prokurorit në këtë procedurë, dhe jo sikurse e drejta për barazi dhe ndalimi i diskriminimit që lidhen me të qenit me një status të caktuar social sikurse i përmendëm më sipër.

Duke interpretuar nenin 14, lidhur me neni 6 të KEDNJ-së, në çështjen *Anakomba Yula kundër Mbretërisë së Belgjikës*, GJEDNJ vjen me një vendim të rëndësishëm për çështjet e diskriminimit që lidhen me të drejtën për të qenë i barabartë përpara gjykatës pavarësisht

statusit shoqëror. Pretenduesja një kongoleze e cila nuk ka shtetësi dhe vendbanim të ligjshëm në Mbretërinë e Belgjikës, nga instancat e brendshme të këtij shteti kërkoi ndihmë juridike për një çështje që ishte duke e ndjekur në gjykatë. Juridiksioni gjyqësor belg në shkallë të parë dhe të apelit refuzoi kërkesën me arsyetimin se ajo nuk ka shtetësi vendase dhe se legjislacioni belg nuk parasheh ndihmë juridike edhe për personat që nuk janë shtetas, ose së paku nuk kanë leje qëndrimi të ligjshëm në këtë shtet. Në vendimin për këtë çështje përshkruhet se ajo iu drejtua Prokurorit të shtetit, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të përkatësisë së saj kombëtare. Prokurori i shtetit nuk ushtroi asnjë mjet juridik për të atakuar vendimin e refuzimit dhe vlerësoi se gjykatat belge kanë aplikuar drejt normat juridike në fuqi. Më pas, ajo vendosi t'i drejtohet GJEDNJ-së për të interpretuar nenin 14 lidhur me nenin 6 të Konventës. Gjykata vendosi njëzëri se ka pasur shkelje të nenit 14 lidhur me nenin 6 dhe se ndihma juridike e kërkuar nuk iu është ofruar të njëjtës nga shkaku se ajo nuk është shtetase belge. Gjykata ka vlerësuar se kjo përbën shkelje të parimit të barazisë para gjykatës nacionale dhe si e tillë ka elemente të cilat ndalohen me nenin 14 të KEDNJ-së (Anakomba Yula v. Belgjika, 2009, paragr. 8-11). Ky vendim është shndërruar në një precedent që shërben për trajtimin e rasteve të njëjta ose të ngjashme në praktikat e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Nga kjo që përshkruam, GJEDNJ gjeti elemente të trajtimit të pabarabartë të një jo-shtetase në raport me shtetasit e tjerë, pasi teorikisht mund të supozohet se ajo nuk është trajtuar e barabartë përball gjykatës për shkak të përkatësisë së saj kombëtare. Gjykata e Apelit në në këtë rast, në arsyetimin e vendimit të saj refuzues përmend legjislacionin vendor belg për ndihmë juridike, duke potencuar se ndihma juridike në rastet kur qytetarët janë jashtë vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, kanë lidhur marrëveshje që nga shteti kërkues të mund të gëzojë një të drejtë të tillë.

4. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut

Të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut që garantohen qoftë me instrumente ndërkombëtare, apo me akte të brendshme shtetërore, janë objekt i mbrojtjes gjyqësore. Në këtë rast, gjykata është autoriteti kompetent për të gjykuar çështjet e cenimit të lirive të të

drejtave të njeriut, pasi sipas nenit 102, paragr. 1 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor në Kosovë ushtrohet nga gjykatat. Gjykatat e themeluara me ligj, kanë juridiksion gjyqësor për t'i trajtuar gjithë çështjet të cilat ngritën pranë tyre sipas procedurave përkatëse ligjore. Sipas nenit 54 të Kushtetutës parashihet që secili gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar, si dhe të drejtën në mjete efektive juridike.

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut është obligim i cili duhet të përmbushet nga autoritetet shtetërore, me ç'rast subjektet e së drejtës duhet të gëzojnë të gjitha mundësitë për të arritur dhe ruajtur të drejtat e garantuara. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut nuk është koncept vetëm formal, kjo ka një përmbajtje që kërkon përmbushje që nga fillimi i procedurës gjyqësore përkatëse e deri në përfundimin e çështjes. Sipas nenit 7, paragr. 3 të Ligjit për gjykatat, parashihet që secili person ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të garantuara. Një nga funksionet themelore të gjykatave është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjë që mbrojtja gjyqësore e të drejtave përfshin të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe të drejtën për të ushtruar mjete efektive juridike gjatë zhvillimit të procedurës penale, me qëllim të realizimit të drejtave të garantuara. Mjetet juridike që gëzojnë subjektet duhet të jenë konkrete.

4.1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga të drejtat themelore që përbënë thelbin e të drejtë për gjykim të drejtë. Kjo e drejtë nuk përmendet shprehimisht në dispozitat e KEDNJ-së, mirëpo GJEDNJ bazuar në objektin dhe qëllimin e KEDNJ-së këtë të drejtë e cila synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut e proklamon si një nga elementet themelore të së drejtës për gjykim të drejtë, (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 351). E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, shtetit i krijon obligime për të siguruar mënyrën që të drejtat e garantuara të jenë të qasshme dhe gjykata të bëjë drejtësi efektive. Gjykatat duhet pajisur me kompetenca juridiksionale që t'u lejojë palëve trajtimin e çështjeve në themel, ligj dhe fakt. Shteti duhet të krijojë qytetarëve të gjithë lehtësitë për të pasur qasje tek drejtësia. KEDNJ synon mbrojtjen

reale dhe konkrete të individit, pasi shtetet duhet të sigurojnë të drejtën efektive për akses tek drejtësia (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, fv. 352-353).

Sipas nenit 54 të Kushtetutës shprehimisht garantohet e drejta për mbrojtje gjyqësore. Përveç të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës në rast cenimi të ndonjë të drejtë të garantuar, gjithashtu garantohet edhe e drejta për mjete efektive juridike. Sipas nenit 7, paragr. 3 të Ligjit për gjykatat, parashihet e drejta e çdo personi që t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Për të siguruar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, shteti duhet krijuar sistem për ndihmë gjyqësore, të vazhdojë thjeshtimin e procedurës nga autoritetet korrektuese në përcjelljen e ankesave nga të paraburgosurit dhe/ose të burgosurit tek autoritetet gjyqësore, apo edhe shpenzimet gjyqësore që duhet t'i paguajnë palët e që mund të cenojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 353). Në kontekst të sigurimit të lehtësuar për qasje në drejtësi, Kushtetuta sipas nenit 31, paragr. 6 parasheh të drejtën për ndihmë juridike. Kjo e drejtë ka si qëllim që të pandehurit që nuk ka mundësi financiare të arritshme t'i mundësohet qasja në drejtësi. Konkretizimi i dispozitës kushtetuese për ndihmë juridike bëhet nëpërmes Ligjit nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas (2012). Sipas nenit 1 të këtij ligji, është të krijojë një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurë gjyqësore, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare (Ligji për ndihmë juridike falas).

Të drejtat e garantuara mund te realizohen në rrugë gjyqësore. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatat e përcakton një mundësi të tillë. Përveç gjykatave të rregullta, mbrojtja e të drejtave të njeriut mund të jetë dhe objekt i trajtimit nga Gjykata Kushtetuese. Për trajtimin e çështjeve të natyrës kushtetuese nga kjo gjykatë, duhet plotësuar disa kushte formale të përcaktuara me nenin 113, paragr. 7 të Kushtetutës dhe me nenin 21 të Ligjit 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (2009). Parimisht, Gjykata Kushtetuese duhet të jetë autoriteti i fundit që kontrollon kushtetutshmërinë e respektimit të një të drejte të garantuar me KEDNJ dhe Kushtetutë. Kjo gjykatë paraqitet si institucion subsidiar, pasi vjen në shprehje vetëm atëherë kur instancat e rregullta gjyqësore nuk do të jetësojnë të drejtat e garantuara.

Të drejtat e garantuara të cilat nuk do të mund të realizon pranë organeve të përcaktuara me ligj, nuk kanë asnjë kuptim, pasi kuptimi i garantimit të të drejtave konkrete nënkupton të drejtën që ato të jenë të zbatueshme dhe jo thjesht të drejta formale dhe abstrakte. Lidhur me këtë, disa vendime të GJEDNJ-së kanë përsëritur se të drejtat e garantuara duhet të jenë të qasshme dhe efektive, në të kundërtën vet qëllimi i të drejtave nuk do të arrihet nëse ato nuk do të jetësohen praktikisht. Në shumicën e rasteve është obligim i personit që dëshiron t'i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e të drejtave të tij, që t'i drejtohet gjykatës përkatëse, duke argumentuar cenimin e të drejtës apo pasojave tjera të shkaktuara nga mohimi i asaj të drejte. Marrë parasysh organizimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, sipas Ligjit për gjykatat, gjykatat kanë kompetenca lëndore dhe territoriale të ndryshme, ndërsa për realizmin e disa të drejtave të garantuara janë përcaktuar dhe afate kohore strikte jashtë të cilave asnjëherë nuk mund të vendoset. Juridiksioni lëndor dhe territorial i secilës gjykatë dhe degë të saj, është i përcaktuar me ligj dhe në rast se do të gabohej juridiksioni, sipas rregullave ligjore në fuqi, individi nuk mund të pësojë përveç rasteve kur përmbajtësisht nuk mund të korrektohet një veprim i tillë i gabuar. Barra e të provuarit në këto raste bie mbi palën pretenduese, në këtë rast mbi personin që pretendon për cenimin e ndonjë të drejte të garantuar. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, apo e drejta për qasje në drejtësi do të cenohet çdoherë kur do të jenë përgjegjëse autoritetet shtetërore, në të kundërtën, është përgjegjësi e vet personit për pasojat që mund t'i ketë shkaktuar, gjë të cilat nuk mund t'i vishen autoriteteve shtetërore.

4.2. E drejta për mjete efektive juridike

E drejta për mjete efektive juridike, është e drejtë themelore që garanton qasjen në drejtësi dhe kërkim të saj. Të drejtat e garantuara si qëllim në vetvete, pa i siguruar mjete për t'i adresuar ato, nuk do të ketë kuptim, pasi garantimi formal i të drejtave nuk është qëllimi i akteve që i garantojnë të njëjtat. Për këto qëllime, secili akt që garanton të drejta të caktuara, përcakton drejtpërdrejt ose tërthorazi mjetet juridike për t'i realizuar të njëjtat. Lidhur me këtë,

sipas nenit 13 të KEDNJ-së, garantohet që çdokujt që i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi nacional, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare. në përputhje me këtë dispozitë të Konventës, sipas nenit 54 të Kushtetutës, parashihet që përveç të drejtës për mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, garantohet e drejta në mjete efektive juridike nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur. E drejta për mjete efektive juridike, përveç të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, përfshin dhe të drejtën që mjetet të jenë efektive.

E drejta për mjete efektive juridike ka qenë objekt i trajtimit në shumë çështje pranë Gjykatës Kushtetuese. Lidhur me këtë po përmendim rastin *Valon Bislimi kundër MPB-së, KGJK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë*, ku parashtruesi paraqiti pranë kësaj gjykata, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërinë së shkeljes së supozuar duke pretenduar se i është shkelur e drejta për tu larguar nga vendi pasi që i është refuzuar lëshimi i pasaportës, pasi ai thekson se Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyre të padrejtë dhe të gabueshme i ka interpretuar dispozitat ligjore duke mos ia lëshuar certifikatën e cila është e domosdoshme që MPB të lëshojë pasaportën. Me tutje, parashtruesi ankohet se MPB nuk ka bazë juridike për t'ia privuar te drejtën e tij kushtetuese në mungesë të certifikatës që nuk është nen hetime duke theksuar se kufizimi nuk është i bazuar në ligj, por sipas tij është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe praktikës, përfshirë këtu keqinterpretimin e një memorandumi të mirëkuptimit të lidhur ndërmjet MPB-së, KGJK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme me arsyetimin se parashtruesit iu ka shkelur liria e lëvizjes, dhe vlerëson se praktika e bazuar në këtë memorandum asnjëherë nuk është shqyrtuar me mbrojtje dhe përpikëri të mjaftueshme procedurale nga autoritete përkatëse, ku dhe e pengoi parashtruesin që ta gëzonte të drejtën e tij për mjete efektive juridike e cila është në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës dhe në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009 - 2010, Gjykata Kushtetuese, 2011, f. 319). Gjykata Kushtetuese për këtë rast thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për mjete efektive juridike parasheh garantimin ose disponueshmërinë (në nivel

kombëtar) të një mjeti juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me KEDNJ, në çfarëdo forme që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit. Qëllimi i kësaj të drejte është të kërkojë sigurimin e një mjeti juridik vendor për ta trajtuar substancën e një *"pretendimi të diskutueshëm"* sipas KEDNJ-së dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike (Valon Bislimi v. Ministria e Punëve të Brendshme, KGJK dhe Ministria e Drejtësisë, GJK, 2010, paragr. 91).

Në një rast tjetër të parashtruar nga Gëzim dhe Makfire Kastrati në cilësinë prindërve të të ndjerës Diana Kastrati (D.K.) kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe KGJK-së, parashtruesit kanë pretenduar se vajza e tyre e cila pas disa mosmarrëveshjeve që pasuan më kërcënime për jetë nga ish-partneri i saj, kishte kërkuar urdhër për mbrojtje emergjente nga Gjykata Komunale në Prishtinë, ku kjo e fundit nuk iu është përgjigjur D.K.-së, duke mos aprovuar e as refuzuar kërkesën e saj, ku pas disa ditësh, D.K. kishte humbur jetën tragjikisht si pasojë e plagëve të marra me armë zjarri nga ish-partneri i saj. Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në nenin 113 paragr. 7 të Kushtetutës, duke pohuar se Gjykata Komunale nuk ka vepruar sipas Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtjen nga dhuna në familje. Parashtruesit nuk kanë pretenduar se shkelja është pasojë e një vendimi gjyqësor, por nga mosveprimi i gjykatës, rrjedhimisht me këtë mosveprim ka bërë shkelje të nenit 25 (E drejta për jetë), nenit 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), nenit 32 (E drejta për mjete juridike) dhe 54 (Mbrojtja gjyqësore e të drejtave) të Kushtetutës. Parashtruesit pretendojnë se KGJK jo vetëm që nuk adresoi rastin e D.K.-së dhe shkeljen e të drejtave të saj, mirëpo nuk ofroi mjete juridike për rastet e ardhshme të dhunës në familje, kur viktimat kërkojnë veprime nga gjykatat, por ato nuk veprojnë. Gjykata në vlerësimin e meritave të kërkesës konkludoi se Gjykata Komunale ishte përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, Më tej, konstatoi se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtine në kërkesën e së ndjerës D.K. për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga KGJK-ja për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta, atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën dhe parashtruesit e kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenet 32 dhe 54 të

Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së (shih: Buletini i Praktikës Gjyqësore 2013, Gjykata Kushtetuese, 2014, f. 306)

Gjykata Kushtetuese për këtë rast thekson se përmasa e obligimit sipas të drejtës për mjete efektive juridike ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së parashtruesit të kërkesës; megjithatë, mbrojtja përkatëse juridike që kërkohet me këtë duhet të jetë *"efektive"* në praktikë dhe në ligj. *"Efektiviteti"* i një *"mjeti juridik"* brenda kuptimit të vet të drejtës nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për parashtruesin e kërkesës. As *"autoriteti"* i përmendur në atë dispozitë nuk është medoemos e thënë të jetë autoritet gjyqësor, por nëse nuk është, kompetencat e tij dhe garancitë që i ofron janë përkatëse për të përcaktuar nëse mjeti juridik para tij është efektiv. Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk i kënaq në tërësi kriteret e të drejtës për mjete efektive juridike, tërësia e mjeteve juridike të parapara me ligjin e vendit mund ta bëjë një gjë të tillë (Gëzim dhe Makfire Kastrati v. Gjyk. Komunale në Prishtinë dhe KGJK, GJK, 2013, paragr. 69).

Në rastet kur subjekti në mënyrë të vullnetshme nuk mund t'i realizojë të drejtat e tij, e drejta për mjete efektive juridike është një instrument shtesë që mund të disponojë për të realizuar të drejtat e tij. Përmbajtësisht, kjo e drejtë ka kuptim të pavarur në vetvete, por bëhet më e rëndësishme kur nëpërmes saj realizohen dhe të drejtat e tjera të garantuara.

KAPITULLI VI

E DREJTA PËR GJYKIM PUBLIK DHE BRENDA AFATIT TË ARSYESHËM

1. E drejta për gjykim publik

1.1. Historiku dhe kuptimi i gjykimit publik

Edhe pse elementet e gjykimit publik mund t'i hasim në të gjithë sistemet e procedurës penale, si në sistemin akuzator, inkuizitor, ashtu dhe në sistemin mikst, nuk mund të përcaktohet saktësisht se nga cila periudhë kjo formë e gjykimit është prezentë në procedurën penale. Rregullat e procedurës penale, sikurse edhe për gjykim publik, deri në periudhat e mëvonshme kanë qenë rregullime sipas modelit të rregullave zakonore dhe se të njëjtat nuk iu janë nënshtruar një regjimi juridik të caktuar, sikurse mund të gjejmë në kohën bashkëkohore. Në këtë kontekst, studiuesit nuk kanë mendim unik për periudhën e paraqitjes së gjykimit publik. Kjo ndoshta ndodh për shkakun e prezencës së hershme të saj dhe gjykimi publik është marrë si një fakt pranuar më herët, apo edhe se shqyrtimi publik i dëshmitarëve ishte një karakteristik e përbashkët të ligjit romak në kohën e Hadrianit, ndërsa në periudhat e më vonshme kjo më nuk ishte e pranishme dhe vetëm Anglia u dha qytetarëve të saj të drejtën për një gjykim publik (Shapiro, 1951, fv. 782 - 783). Në periudhat e mëvonshme, historia e gjykimit publik fillon me pushtimin e Anglisë nga William Pushtuesi në vitin 1066. Në Angli në fillim të kësaj periudhe ndaj personit është zbatuar drejtësia nga fisi që i takonte ai, pasi në këtë kohë gjykohej se nëse një person ka kryer një të keqe kundër një anëtari tjetër të komunitetit fisnor, konsiderohej se kishte kryer një të keqe kundër gjithë fisit. Kështu, individi u gjykua nga i gjithë fisi. Në kohërat më të hershme, gjyqet në Angli u mbajtën në publik, por këto nuk duhet nënkuptuar si modele të gjykimit publik sikurse në kuptimin e tanishëm bashkëkohor, kjo ndodhi për shkak të rrethanave dhe mënyrës në të cilën u zhvilluan gjykatat, gjë që impononte domosdoshmërisht një gjykim publik të tillë (Legal History: Origins of the Public Trial, 1960, f. 251).

Në historinë e procedurës penale britanike, përmendet se Sir Thomas Smith, duke shkruar mbi ligjet e Anglisë në vitin 1565, foli për të drejtën për një gjykim publik. Sir Matthew Hale në vitin 1670 shkroi për përsosmërinë e gjykimeve në Angli që kur gjykatat ishin të hapura për publikun. Jenks thekson se *"të gjitha gjykimet mbahen në gjykata të hapura në të cilat publiku ka qasje të lirë."* Për më tepër, në Angli është konstatuar se e drejta zakonore e një gjykimi publik ka të bëjë si me çështjet civile ashtu dhe me ato penale. Përveç Anglisë, në të drejtën e procedurës penale në SHBA, e drejta për një gjykim publik ose *"të hapur"* u shfaq së pari në *"Kornizën e Qeverisë së Pensilvanisë"* në vitin 1682 dhe në Kartën e Ligjeve Themelore të Nju Jorkut në vitin 1676. Më vonë u shfaq në Kushtetutën e Pensilvanisë dhe Karolinën e Veriut në vitin 1776, ndërsa Vermonti miratoi një dispozitë të ngjashme për gjykim publik në vitin 1787 (Quick, 1955, fv. 21-22). Më futjen në fuqi të amandamentit VI në Kushtetutën e SHBA-ve (1791), garantohet që *"Në të gjitha ndjekjet penale, personi i akuzuar gëzon të drejtën që ndaj tij të zhvillohet një proces gjyqësor i shpejtë dhe i hapur."*

Në përpjekjen për të avancuar liritë dhe të drejtat e njeriut në kontekstin ndërkombëtarë, e drejta për gjykim publik zuri vend të rëndësishëm në dispozitat e shumë instrumenteve ndërkombëtare. DUDNJ-ja ishte instrumenti i parë ndërkombëtarë që garantonte të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik dhe praninë e publikut gjatë gjykimit dhe dhënies së aktgjykimit (neni 10). Edhe sipas nenit 14 § 1 të PDCP-së, parashihet që çdokush ka të drejtë të gjykohej publikisht dhe parashihen rrethanat në të cilat mund të shmanget nga e drejta për gjykim publik, sikurse përmendet rasti i rrezikimit të sigurisë kombëtare, interesit të palëve, në procedurë penale për të mitur etj. Gjithashtu edhe sipas KEDNJ parashihet sipas nenit 6, ku garantohet e drejta për gjykim publik.

Prania e publikut në procedurë gjyqësore është një nga të drejtat themelore në procedurë penale. E drejta për gjykim publik nënkuptohet si e drejtë e pjesëmarrjes së publikut në shqyrtim gjyqësor, pavarësisht se në procedurë penale publiku nuk e ka cilësinë e palës, subjektit, apo pjesëmarrësit tjetër në formën e përcaktuar me ligj. Pra, procedurat zhvillohen publikisht dhe janë të hapura për publikun. Rëndësia e pranisë së publikut gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore është e shumëfishtë. Në rastin *Pretto dhe të tjerët kundër Italisë*, GJEDNJ thekson se karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore mbron palët ndër-

gjyqëse kundër administrimit në fshehtësi të drejtësisë pa shqyrtim publik, gjë që gjykimi publik përbënë një nga mënyrat ku mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë të dukshme administrimin e drejtësisë, publiciteti kontribuon në arritjen e e një gjykimi të drejtë, garancia e të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike brenda vet kuptimit të KEDNJ-së (Pretto dhe të tjerë v. Italia, 1983, GJEDNJ, paragr. 21). Pra, është shumë e rëndësishme që shoqëria të arrijë dhe ta ruaj besimin e saj në administrimin e drejtësisë. Në të vërtetë, drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por gjithashtu ajo duhet parë se si po bëhet (Aquilina, 2014, f. 133).

Procesi gjyqësor si tërësi unike, nuk është vetëm pjesë e një procedure që zhvillohet në shqyrtime gjyqësore. Procedurës gjyqësore shqyrtuese parimisht i paraprinë procedura hetimore, që menaxhohet nga prokurori i shtetit dhe mbikëqyret nga gjyqtari procedurës paraprake. Lidhur me këtë, KPP nuk përmban ndonjë dispozitë që lejon qasjen e publikut në dosjen hetimore. Publiku ka të drejtë të jetë i pranishëm në gjykatore ku zhvillohet procesi gjyqësor, mirëpo nuk ka të drejtë të ndërhyjë në procedurë, pas aty është pjesëmarrës pasiv, pa ndonjë të drejtë që të kontribuojë për çështjen penale. Pasi çështjes penale në një formë apo tjetrën, mund t'i kontribuojnë palët, gjyqtari i vetëm apo trupi gjykues, dëshmitarët, ekspertët apo dhe pjesëmarrësit e tjerë, publiku merr pjesë në formë të kufizuar vetëm në prezencë fizike. Mirëpo, pavarësisht kësaj, publiku ka të drejtë të dijë dhe të shoh se si administrohet procesi gjyqësor dhe drejtësia.

Publiciteti në procedurë penale mund të jetë: i përgjithshëm, i kufizuar dhe i palëve. Publiciteti i përgjithshëm nënkupton të drejtën e qytetarëve që të prezantojnë në shqyrtim gjyqësor me rastin e ndriçimit dhe zgjidhjes së një çështje penale konkrete. Kjo mundëson një lloj kontrolli të gjyqësorit më rastin e gjykimit, i shërben interesit të përgjithshëm, sepse nëpërmes tij zgjerohet njohuria për ligjet dhe forcohet besimi në jurisprudencë, i ofrohet garanci të pandehurit për gjykim të drejtë, si dhe ndikon në mënyrë preventive në kriminalitet. Ndërsa publiciteti i kufizuar ekziston kur në shqyrtim gjyqësor, përveç personave pa të cilët nuk mund të mbahet shqyrtimi gjyqësor, merr pjesë edhe një numër i kufizuar i personave të tretë. Dhe në fund, publiciteti i palëve nënkupton prezantim në procedurë penale vetëm të palëve, pra pjesëmarrësve të domosdoshëm në një procedurë penale. Ky lloj i publicitetit, vjen në

shprehje në hetime, kurse në shqyrtim gjyqësor çdoherë, pavarësisht a është përjashtuar publiku, apo jo (Sahiti & Murati, 2016, fv. 97-99).

1.2. E drejta për gjykim publik sipas Kushtetutës së Kosovës

E drejta për gjykim publik është e konceptualizuar në Kushtetutë, ku parashihet se: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj"* (neni 31, paragr. 2). Kjo është një nga të drejtat që mund të kufizohen në procedurë penale, gjë që Kushtetuta parasheh alternativat për rrethanat kur nuk do të mund të realizohej kjo e drejtë. Sipas këtij akti, gjykimi parimisht është publik, ndërsa me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut apo mediave, pasi prania e tyre paraqet rrezik për rendin publik ose sigurinë nacionale, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e privatësisë së palëve, (neni 31, paragr. 2). Natyra parimore e Kushtetutës, nuk ka përcaktuar rregulla normative më të hollësishme për rastet që përbëjnë domosdoshmëri për përjashtimin e publikut, përveç atyre të përmendura më sipër. Pra, kjo është në diskrecion të organeve përkatëse, të përcaktojë rastet me akte tjera kur publiku mund të përjashtohet nga gjykata.

Sipas dispozitave të përmendura më sipër, Kushtetuta ka si qëllim që të pandehurit t'i garantohet gjykim publik, duke i dhënë mundësi publikut që të shoh si bëhet drejtësia, njëkohësisht duke mos lejuar cenimin e paanshmërisë së gjykatës, apo kjo shërben edhe për ruajtjen e integritetit të gjykatës, si institucion i hapur dhe transparent me publikun. E drejta për gjykim publik si një e drejtë kushtetuese, reflekton rëndësinë që ka i dhënë shoqëria gjykimit publik, si dimension i rëndësishëm i të drejtës për gjykim të drejtë, me qëllim të rritjes dhe ruajtjes së besimit të publikut në drejtësi dhe organet e saj. Ndërsa, sipas dispozitë së nenit 56 të Kushtetutës, nuk lejohet shmangie nga e drejta për gjykim të drejtë, rrjedhimisht edhe nga e drejta për gjykim publik.

1.3. E drejta për gjykim publik sipas KPP-së

Në fazën paragjyqësore, përkatësisht hetimore, informacionet e marra mund të mos bëhen publike dhe ato mund t'i nënshtrohen kufizimit të publicitetit të palëve, duke përjashtuar çdo lloj publiciteti. Arsye për këtë është filtrimi i informacioneve dhe dëshmive të administruara e të cilat jo edhe krejtësisht mund të shfaqen si pjesë e dosjes së akuzës penale. Sikurse dihet, sipas ligjit hetimet zhvillohen në mënyrë konfidenciale dhe nuk janë të hapura për publikun. Pavarësisht kësaj, të dhëna të caktuara nga hetimet, me kujdes në respektimin e të drejtave të të dyshuarit, mund të bëhen të ditura për të, apo për publikun. Mbyllja për publikun në këtë stad ndodh për shkakun se shumë informacione të grumbulluara, nga forma dhe përmbajtja mund të mos jenë të sakta dhe të ligjshme. Pra, veprimet e ndërmarra hetimore, udhëhiqen mbi parimin e fshehtësisë zyrtare dhe mund të dëmtohen në rastet kur përmbajtja e ndonjë urdhri apo veprimi mund të kuptohet nga publiku i gjerë (Barton, 1982, f. 131). Pasi në fazën hetimore nuk organizohet procedura shqyrtuese, të gjithë provat e administruara gjatë kësaj faze, përsëri në shqyrtim gjyqësor mund të shqyrtohen pasi palët kanë të drejtë t'i ekzaminojnë të gjithë dëshmitë e administruara në bazë të së cilës është ngritur aktakuza.

Nëse analizojmë nenin 213 KPP-së, mund të shohim të drejtën e të dyshuarit dhe të pandehurit për qasje në shkresat e lëndës, duke paraparë publicitetin e palëve, ku prokurori është i obliguar të zbulojë dosjen dhe t'u krijojë qasje të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Mund të shikohet materiali i marrjes në pyetje të të pandehurit, apo dhe ekspertizat përkatëse. Pas përfundimit të hetimit, mbrojtja ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata. Pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit ose të pandehurve të cekur në aktakuzë mund t'u sigurohet kopjet e shkresave të lëndëve (KPP, neni 213). Disa materiale mund dhe t'i refuzohen për të pasur qasje nëse rrezikojnë hetimet, jetën ose shëndetin e njerëzve, nëse të njëjtat mund të redaktohen duke i fshehur informacione të caktuara që i vlerëson të tilla prokuroi i shtetit, atëherë veprohet ashtu. Në këtë rast mbrojtja ka të drejtë të ankohet tek gjyqtari i procedurës paraprake duke

ushtruar mjetin juridik të ankesës dhe vendimi i gjykatës është i fundit për këtë çështje. Ashtu sikurse parashihet edhe me dispozitat e KPP-së (neni 2013)vendimet përkatëse varen nga masat për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe privatësisë së tyre si dhe për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale, siç parashihet me ligj.

Përveç të pandehurit, sipas nenit 214, paragr. 1, edhe i dëmtuari, përfaqësuesi ligjorë apo i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimës kanë të drejtë të shikojnë, kopjojnë ose fotografojnë shkresat dhe provat materiale që i disponon gjykata ose prokurori i shtetit nëse ka interes legjitim për të bërë një gjë të tillë. Ndërsa, lidhur me të drejtën e publikut për të pasur qasje në dosjen e administruar nga prokuroria apo gjykata, KPP hesht mbi të drejtën e publikut për të pasur në dorë dokumentet e fazës paragjyqësore. Edhe pse nuk përjashtohet mundësia që publiku të ketë të ditura disa çështje nga hetimet, ky akt nuk sqaron për cilat dokumente mund të jenë të qasshme për publikun. Qasja e tillë e ndërtuar në këtë stad, duhet nënkuptuar se publiku përjashtohet nga e drejta për të pasur qasje të plotë në dosjen hetimore për shumë arsye, ku mund t'i përmendim natyrën konfidenciale të hetimeve, të drejtat e personave të përfshirë në hetime, informacionet të cilat janë të ndaluara me ligj për tu kuptuar nga publiku dhe rrethana tjera relevante.

Në stadin tjetër të procedurës penale, atë të shqyrtimit gjyqësr, KPP përmban një numër të madh të dispozitave që trajtojnë të drejtën për gjykim publik. Këto dispozita u japin mundësi publikut të shohin se si bëhet drejtësia, pavarësisht se në procedurë janë në cilësinë e palës, subjektit, apo pjesëmarrësit tjetër në formën e paraparë me ligj. Parimisht, sipas nenit 293 paragr. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, përcaktohet se shqyrtimi gjyqësor është i hapur dhe mund të marrin pjesë personat madhor dhe se mundësia e heqjes së të drejtës që publiku të jetë prezentë gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, mund të kufizohet në disa raste të përcaktuara me ligj. Prania fizike e publikut gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është një e drejtë absolute dhe buron nga natyra e rastit konkret që shqyrtohet dhe mund të jetë objekt i kufizimeve të caktuara.

Sipas nenit 294, parashihet se që nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare,

mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për:

1) ruajtjen e fshehtësisë zyrtare;

2) ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi i hapur;

3) ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit;

4) mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;

5) mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose

6) mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, sikurse parashihet në KPP. Edhe në procedurën e apelit, publiku mund të përjashtohet nga seanca e kolegjit të apelit që mbahet me prani të palëve vetëm nën kushtet e përmendura në KPP-së (neni 390, paragr. 5).

Përjashtimi i publikut nuk zbatohet për palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësin, përveç nën kushtet e dispozitave për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose të dëshmitarëve, siç parashihet në KPP. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të lejojë që në shqyrtimin gjyqësor në të cilën është përjashtuar publiku të marrin pjesë zyrtarë të caktuar, akademikë, figura publike dhe, me kërkesën e të akuzuarit, mund të lejojë pjesëmarrjen e bashkëshortit ose bashkëshortit jashtëmartesor si dhe të afërmit e tij. Çdo herë paralajmërohen personat që marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor të mbyllur se detyrohen të ruajnë fshehtësinë e informatave të cilat i kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor dhe se zbulimi i informatës së tillë përbën vepër penale (KPP, neni 295). Vendimin për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të mbyllur e merr gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim, i cili duhet të arsyetohet dhe të shpallet publikisht. Aktvendimi për mbajtjen e seancës së mbyllur mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit (KPP, neni 296).

Rregullat kushtetuese dhe ligjore për publicitet, janë në përputhje me pjesën normative që përmban KEDNJ-së. Sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së çmohet rëndësia e gjykimit publik, si dhe shpallja publike e vendimit, por lë hapësirë që publiciteti të kufizohet, apo të ngelet vetëm në publicitet të palëve, gjithherë në rastet kur taksativisht përmend në Konventë, apo në shkallën

që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

1.4. Prania e mediave në gjykatore

Përderisa gjykimi ka karakter publik, e drejta e mediave për të përcjellë shqyrtimin gjyqësor është një e drejtë që buron nga e drejta për gjykim publik. Prania e mediave gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor i ka anët pozitive dhe negative. Anët pozitive të pranisë së mediave në përcjelljen dhe monitorimin e proceseve gjyqësore është e shumëfishtë, pasi me anë të saj përçohet tek publiku i gjerë zhvillimet që ndodhin gjatë shqyrtimit publik kundër të pandehurit, duke u mundësuar atyre informacione dhe të dhëna relevante. Për shkak të mungesës fizike të hapësirave në gjykatore, jo të gjithë të interesuarit mund të jenë pjesë e publikut me praninë fizike të tyre, apo arsye tjera, mediat me raportimin e tyre do të ndihmonin të merren informacione nga këto procese. Por mediat sikurse shprehet autori Simons (2009) mund të ndikojnë negativisht me raportimin tendencioz dhe joprofesional, kjo sidomos është e shprehur në gjykimet kundër krimeve të luftës., pasi në shumë raportime, të paraburgosurit i thërrasin si *"kriminelë"*, ndërsa është interesim i vogël i një audience të kufizuar, për të raportuar për mënyrën e njëmendtë se si funksionojnë gjykatat sikurse situatat: si mblidhen provat; si është përgatitur aktakuza; sa e vështirë ose e rrezikshme mund të jetë mbledhja e provave ose dëshmitë e ballafaqimit; si duhet të sigurohet mbrojtja e duhur e të akuzuarit (f. 85)

Edhe pse sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, është paraparë që vendimi gjyqësorë duhet të jepet publikisht, prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë. Lidhur me këtë, praninë e shtypit dhe publikut KEDNJ e sheh të njësuar, pasi nuk parashihet ndonjë dallim substancial mes

mediave dhe publikut, gjë që mund të konkludohet se në të gjithë rastet kur vendoset për përjashtimin apo mos përjashtimin e publikut, në mënyrë analoge mund të vendoset edhe për mediat dhe anasjelltas. Sipas KPP-së, parashihet që fotografimi, filmimi, regjistrimi televiziv dhe regjistrime të tjera përpos regjistrimit zyrtar të shqyrtimit gjyqësor lejohen, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kufizon të njëjtat me aktvendim të arsyetuar me shkrim (neni 301, paragr. 3). KPP nuk përmban dispozitë të veçantë për rastet kur mediat mund të përjashtohen dhe për këtë arsye dhe arsyen se KEDNJ nuk bënë dallim në mes pranisë së mediave dhe publikut, dispozitën e përmendur të KPP-së për kufizim për fotografimin, filmimin, regjistrimin televiziv ose regjistrimet tjera, duhet interpretuar në mënyrë ekstensive, sikurse për rregullat që parashohin përjashtimin e publikut.

1.5. Shpallja e aktgjykimit dhe publikimi i tij

Pasi gjykata merr aktgjykim për një rast të caktuar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet ta shpall atë menjëherë. Në rastet kur nuk ka mundësi që në të njëjtën ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të merret aktgjykimi, shpallja e aktgjykimit mund të shtyhet më së shumti tri ditë. Gjatë shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në prani të palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjorë, të përfaqësuesve të autorizuar dhe të mbrojtësve, në seancë të hapur lexon dispozitivin dhe shkurtimisht prezanton arsyet e dhënies së aktgjykimit. Shpallja e aktgjykimit bëhet edhe në rastet kur nuk janë të pranishëm: pala, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues mund të urdhërojë që të akuzuarit i cili nuk është i pranishëm fizikisht në gjykatore, t'ia komunikojë gojarisht aktgjykimin ose t'ia dërgojnë atë me shkrim (KPP, neni 366, paragr. 1, 2 dhe 3). Në situatat kur publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor, dispozitivi i aktgjykimit gjithmonë duhet të lexohet në seancë të hapur në prani të publikut ndërsa kur duhet të lexohen arsyet e shkurtra ku është bazuar aktgjykimi trupi gjykues vendos se a do ta përjashtojë publikun dhe deri në ç'masë e përjashton atë. (KPP, neni 366, paragr. 5 dhe 6).

Edhe pse vendimet gjyqësore publikohen në prani të publikut dhe bazuar në parimin e publicitetit të gjykimit, gjykata do të kishte për detyrë të krijojë qasje për vendimet e marra edhe në formë të shkruar, KPP nuk përmban ndonjë dispozitë që obligon gjykatat që vendimet e formës së prerë të jenë në dispozicion të publikut për qasje të lirë. Lidhur me këtë, vendimet gjyqësore mund të pësojnë kufizim për qasje të publikut në to, vetëm në rastet kur është e parashikuar për përjashtimin e publikut nga gjykimi dhe këto dispozita duhet interpretuar në mënyrë analoge sikurse për publikimin e aktgjykimit. Lidhur me këtë, ekzistojnë disa rregulla që parashohin mënyrën e publikimit të aktgjykimeve, sipas Ligjit nr. 05/l -032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat (2015), theksohet se brenda gjashtëdhjetë ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, gjykatat duhet t'i publikojnë ato në faqet e tyre zyrtare të internetit, duke ruajtur çdoherë të drejtat e garantuara me ligj, sikurse është privatësia dhe të drejtat e tjera. Lidhur me ruajtjen e të dhënave personale dhe informatave tjera që nuk duhet t'i ofrohen publikut, me anë të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016 për anonimizimin dhe publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme (KGJK, 2016), parashihet mënyra e anonimizimit dhe publikimit të aktgjykimeve të plotfuqishme në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së ku janë të përfshira të gjithë gjykatat, në interes të qasjes publike në aktgjykimet e gjykatave për promovimin e transparencës së gjyqësorit.

Në këtë kontekst, në rastin *Raza kundër Bullgarisë*, GJEDNJ ka trajtuar një çështje ku përfshihet kufizimi i publikimit të vendimit gjyqësor me pretekst te rrezikimit të sigurisë kombëtare. Gjykata njeh shprehimisht se përdorimi i materialit konfidencial mund të jetë i pashmangshëm kur rrezikohet siguria kombëtare, prandaj, ndonjëherë mund të jetë e nevojshme të klasifikohen disa ose të gjitha materialet e përdorura në procedurat që prekin çështje të tilla dhe madje edhe pjesë të vendimeve të marra në to. Sipas gjykatës, publikimi i vendimeve gjyqësore synon të sigurojë përcjelljen e punës së gjyqësorit nga publiku dhe përbën një mbrojtje themelore kundër arbitraritetit. Në të vërtetë, edhe në rastet e padiskutueshme të sigurisë kombëtare, të tilla si ato që lidhen me aktivitetet terroriste, autoritetet e vendeve që kanë pësuar, apo janë në rrezik të sulmeve terroriste kanë zgjedhur të mbajnë sekret vetëm ato pjesë të vendimeve të tyre, zbulimi i të cilave do të rrezikonte sigurinë kombëtare ose të tjerëve, duke ilustruar kështu se ekzistojnë teknika të cilat mund të sigurojnë shqetësimet

legjitime të sigurisë, pa mohuar plotësisht garancitë themelore procedurale siç është publiciteti i vendimeve gjyqësore (Raza v. Bullgaria, GJEDNJ, 2010, paragr. 23). Meqenëse praktika e GJEDNJ është e zbatueshme në Kosovë, ky rast do të mund të shërbente si udhëzim për gjyqësorin tonë, me qëllim që njëkohësisht të arrihen shumë qëllime, sikurse është e drejta e publikut për tu informuar, por edhe duke ruajtur të dhënat tjera të cilat janë të natyrës konfidenciale dhe që të njëjtat nuk do të duheshin të jepen për qasje tek publiku.

Shpërndarja publike e aktgjykimit të dhënë me shkrim, përveç që është një e drejtë e publikut për të kuptuar se si po administrohet drejtësia, kjo formë në bazë të dispozitave penale materiale parashihet edhe si dënim plotësues. Lidhur me këtë, sipas nenit 62, paragr. 1 dhe 2 të KPK-së, theksohet se publikimi i aktgjykimit mund të bëhet me urdhër, si dënim plotësues së bashku me dënimin kryesor ose alternativ. Në këto raste, publikimi i aktgjykimi nuk i nënshtrohet anonimizimit, pasi qëllimi i publikimit është që të krijojë efekte psikologjike tek personi i dënuar që t'i nënshtrohet një *"stigmatizimi"* publik. Megjithatë, publikimi i aktgjykimeve në formë fragmentare, nuk është në interes të arritjes së qëllimeve të drejtësisë, pasi publikimi i aktgjykimit nuk duhet të jetë me detyrim, por si një e drejtë e publikut për të ditur se si administrohet drejtësia. KPP ka adresuar si shkelje esenciale të dispozitave procedurale rastet kur publiku është përjashtuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Pra, i pandehuri ka të drejtë ta marrë vendimin e gjykatës në përputhje me ligjin, pasi kjo e drejtë përfshin obligimin e gjykatave për t'i ofruar arsyet për vendimet e tyre me shkaqe të arsyeshme në të dy rrafshet, atë procedural dhe material. E drejta për tu njoftuar me arsyet që shtyn gjykatën të merr një vendim gjyqësorë të caktuar, përfshin të gjitha sqarimet bindëse dhe të konstruktuara mirë ligjërisht.

2. E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm

2.1. Rëndësia dhe konceptualizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm parashihet si objekt trajtimi në një mori instrumentesh ndërkombëtare dhe paraqitet si një nga të drejtat themelore për të pandehurin në procedurë penale. Gjykatat dhe sistemi gjyqësor në përgjithësi, duhet të ruajnë integritetin e vet institucional, duke vepruar me shpejtësi në emër të drejtësisë dhe duke i trajtuar çështjet që ngrihen pranë tyre me profesionalizëm, duke i zgjidhur ato brenda afateve optimale kohore. Gjykatat nuk duhet të kenë si objektiv vetëm funksionimin e saj si qëllim të vetëm, ato duhet t'i kushtojnë rëndësi të posaçme besueshmërisë që publiku duhet të ketë në institucionet e drejtësisë, si një nga detyrat e rëndësishme të saj. Trajtimi i çështjeve brenda afateve kohore të arsyeshme, ruan dhe ngrit besueshmërinë dhe kredibilitetin e institucioneve të drejtësisë përball publikut. Rëndësinë e përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, mund të kuptohet nga hapësira që ka zënë ky element i rëndësishëm i gjykimit të drejtë në instrumentet ndërkombëtare. Sipas nenit 14 § 2 (c) të PDCP-së, të pandehurit i garantohet e drejta për t'u gjykuar pa vonesa të tepruara. Sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, garantohet e drejta e të pandehurit për t'u gjykuar në afat kohor të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe të themeluar me ligj. Marrë në konsideratë natyrën e përgjithshme të dispozitave të këtyre instrumenteve ndërkombëtare, e drejta për gjykim brenda afatit kohor të arsyeshëm përfshin të gjitha llojet e procedurave gjyqësore, qofshin ato civile apo penale. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjeve penale, këto dispozita normative të këtyre instrumenteve fokusohen më shumë te çështjet e natyrës penale, pasi këto çështje lidhen më me drejtpërdrejt me dinjitetin, lirinë dhe vlerat tjera të personalitetit të njeriut.

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, i vë kufizime restriktive bartësve të sistemit të drejtësisë, duke kërkuar nga ta efikasitet në udhëheqjen dhe përfundimin e çështjeve penale. Lënia e çështjeve në mëshirën e organeve të drejtësisë, pa i vendosur dhe kërkuar afate strikte për përfundimin e tyre, mund të shndërrojë procedurën penale në një procedurë arbitrare, gjë që shkakton shkeljen dhe mohimin e të drejtat themelore të të pandehurit. Drejtësia duhet të

vijë brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe nuk duhet zgjatur pafundësisht që të shndërrohet në procedurë penale abuzuese dhe të shpërdoruar përball autorizimeve dhe kompetencës së dhënë ligjore. Pushteti gjyqësor është pushtet i pavarur shtetëror, dhe i njëjti nuk i nënshtrohet asnjë pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, e as nuk mund të vihet në dilemë kredibiliteti i punës së tij. Pavarësia e pushtetit gjyqësor është e garantuar me Kushtetutë të secilit shtet dhe nuk mund të kontestohet nga pushtetet tjera shtetërore. Përfundimi i çështjeve brenda afatit të arsyeshëm u jep të gjithëve siguri juridike dhe largon nga stigma të cilën e përcjellë gjatë kësaj periudhe. Drejtësia e cila vendoset brenda afatit kohor të arsyeshëm ndihmon në vendosjen e drejtë të çështjes penale, pasi zgjatja e paarsyeshme krijon çdoherë mundësi për të dyshuar për rregullsinë e procesit, pasi dëshmitarëve mund t'i zbehet kujtesa, mund të mos jenë të gatshëm të dëshmojnë, apo në rastin më të keq nuk janë fizikisht të qasshëm nga autoritetet shtetërore.

Lidhur me këtë, Kosova ka adoptuar një mori rregullash të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke i bërë pjesë të rendit juridik në mënyrë të drejtpërdrejt. Në këtë mënyrë, në aspektin formal juridik nuk ka mungesë të ndonjë dispozite që është pjesë e normave të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe që do të duhej të ishte e zbatueshme në vendin tonë. Sipas Kushtetutës, parashihet se: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik ... brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur ..."* (neni 31, paragr. 1), ndërsa sipas KPP-së përcaktohet se: *"Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme"* (neni 5, paragr. 1). Gjithashtu, edhe sipas Ligjit për gjykatat parashihet se: *"Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor"* (neni 7, paragr. 2).

Për momentin e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm për një çështje penale, ekzitojnë disa qëndrime. Lidhur me këtë, GJEDNJ ka nxjerrë vendime që kanë përcaktuar kritere të përgjithshme për kohën e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm. Përmbajtja e vendimeve nuk është standard i njëjtë, pasi natyra rasteve të trajtuara ndryshon nga njëri rast tek rasti tjetri, por kjo nuk do të thotë se përfundimet arritura janë kundërthënëse mes vete. Në çështjen *Mc Farlane kundër Irlandës*, kjo gjykatë thekson që në çështjet penale nocioni *"kohë e arsyeshme"* e paraparë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, fillon të zbatohet sapo një person *"të akuzohet"*, ndërsa nocioni *"akuzë",* mund të përkufizohet si *"njoftimi zyrtar i dhënë një*

individi nga autoriteti kompetent për një pretendim se ai ka kryer një vepër penale", një përkufizim që gjithashtu korrespondon me kriterin nëse *"gjendja e tij (të dyshuarit) është prekur ndjeshëm"* (Mc Farlane v. Irlanda, GJEDNJ, 2010, paragr. 143). Pra, me termin akuzë nuk duhet nënkuptuar si dimension formal sikurse parashihet me dispozitat e KPP-së, por kjo nënkupton faktin e vënies në dijeni të të dyshuarit apo të akuzuarit të veprës penale. Ndërsa në çështjen *T. kundër Britanisë së Madhe*, kjo gjykatë thekson se nocioni *"afat i arsyeshëm",* mbulon të gjithë procedurat penale, duke përfshirë edhe procedurat e apelimit dhe përcaktimin e dënimit (T.v. Britania e Madhe, GJEDNJ, 1999, paragr. 108).

E drejta e të pandehurit për të gjykuar pa vonesa, lidhet drejtpërdrejt me fillimin e çështjes kundër tij. Gjatë gjithë zhvillimit të procedurës, duhet kujdesur që çështja penale të trajtohet me profesionalizëm dhe mbrojtja të gëzojë gjithë kohën e nevojshme për mbrojtje efektive juridike.

2.2. Kriteret përcaktuese për gjykim në afat të arsyeshëm

Gjykimi në kohë të arsyeshme është një definicion konkret, gjë që mund të elaburohet varësisht nga rrethanat e çështjeve përkatëse, duke marrë parasysh disa kritere themelore. Në këtë kontekst, GJEDNJ ka nxjerrë kritere, që parimisht bazuar në to të llogaritet një gjykim në afat të arsyeshëm. Në çështjen *Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane*, theksohet se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave që vijnë nga fusha e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së duhet të vlerësohet në secilin rast sipas rrethanave të veçanta. Lidhur me çështjet penale, GJEDNJ për këtë qëllim ka marrë në konsideratë, ndër të tjera:

a) kompleksitetin e çështjes,

b) sjelljen e të pandehurit dhe

c) sjelljen e autoriteteve kompetente (Buchholz v. Gjermania, GJEDNJ, 1981, paragr. 49).

Bazuar në praktikën tonë gjyqësore, nuk është krijuar ndonjë standard që do të përcaktonte kritere për vlerësimin e afatit të arsyeshëm. Bazuar edhe në detyrimet

kushtetuese, kriteret e vendosura nga GJEDNJ janë të zbatueshme dhe merren në konsideratë edhe tek procedura jonë penale.

Shumë faktorë merren parasysh për të përcaktuar nëse një çështjeje ka natyrë komplekse. Në zgjidhjet të cilat janë dhënë në KPP, janë përkufizuar çështjet të cilat konsiderohen komplekse. Sipas nenit 19, paragr. 1 dhe 2 të KPP-së, përcaktohet se një çështje e ndërlikuar – duhet nënkuptuar çdo vepër penale që përfshin por nuk kufizohet në më shumë se dhjetë të pandehur, aktivitet të organizuar kriminal, korrupsion, ose hetimi i së cilës kërkon prova të shumta mjeko-ligjore, analiza kontabiliteti ose bashkëpunim ndërkombëtar. Një rast i ndërlikuar do të ishte një procedurë penale në të cilën hetohet apo gjykohet një rast i ndërlikuar. Një çështje tjetër që mund të bëjë ndërlikojë çështjen penale është dhe shumësia e fakteve të cilat duhet vërtetuar për çështjen konkrete penale. Numri i madh i dëshmive të cilat prezantohen për të vërtetuar faktet juridike relevante, përfshirë këtu numër i caktuar i dëshmitarëve, dokumente, ekspertiza dhe mjete tjera provuese, çojnë çështjen penale konkrete përtej çështjeve penale të zakonshme. Gjithë ky aktivitet detyrimisht imponon dhe kohë të mjaftueshme që çështjet të trajtohen me profesionalizëm brenda një kornize kohore optimale.

Sjellja e të pandehurit në çështjen penale, është rrethanë që mund të përcaktojë nëse gjykimi ka përfunduar brenda afatit kohor të arsyeshëm. Nuk ka ndonjë normë që obligon të pandehurin të bashkëpunojë aktivisht me organin e akuzës në çështjen penale kundër tij, përkundrazi, i pandehuri është palë e barabartë me prokurorin e shtetit, dhe i garantohen mundësi të njëjta për të paraqitur çështjen e tij. I pandehuri, mund të mos shfrytëzojë të drejtat dhe privilegjet që i garantohen në procedurën penale, dhe të ndihmojë zbardhjen dhe vërtetimin e fakteve në çështjen kundër tij. Lidhur me këtë, në çështjen *Yagci dhe Sargin kundër Turqisë*, të ngritur pranë GJEDNJ-së, të pandehurit ankues, kanë paraqitur shqetësimet e tyre për stërzgjaten e procedurave gjyqësore përtej afatit kohor të arsyeshëm, duke iu cenuar të drejtat që burojnë nga neni 6 i KEDNJ-së. Në përgjigjen e dhënë nga Qeveria e Turqisë, kritikohen avokatët e të pandehurve për kontributin e tyre në zgjatjen e procedurës dhe përdorimin e taktikave vonuese. Ndërsa, të pandehurit në anën tjetër kanë pohuar se kishin bashkëpunuar gjithmonë me gjykatat përkatëse. Në këtë rast, GJEDNJ theksoi që neni 6 i

KEDNJ-së, nuk kërkon që personi i akuzuar për një vepër penale të bashkëpunojë në mënyrë aktive me autoritetet gjyqësore. Në të gjitha rastet, të pandehurit nuk mund të fajësohen për shfrytëzimin e plotë të mundësive të parashikuara nga ligji kombëtar në mbrojtjen e tyre (Yagci and Sargin v. Turqia, GJEDNJ, 1995, paragr. 64-66). Përveç kësaj, sjellja e të pandehurit i cili nuk paraqitet vullnetshëm në çështjen penale kundër tij, asnjëherë nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore si shkaktare të vonesave dhe zvarritjeve të procedurës. Me vet faktin e bojkotimit dhe mosparaqitjes në çështjen penale ku personi është i dyshuar apo i akuzuar, shuan të drejtën e tij për të përdorur më vonë arsyetim për zvarritjen e procedurës si cenim i të drejtës për t'u gjykuar në kohë të arsyeshme.

I pandehuri, apo mbrojtësi i tij, edhe pse nuk e kanë obligim të kontribuojnë në zbardhjen dhe vërtetimin e fakteve, të njëjtit kanë përgjegjësi të mos bëhen destruktiv gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, duke bërë që procesit t'i shkaktohen vonesa dhe zvarritje që do të cenonin vet konceptin e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme. Sjelljet e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, duke bërë kërkesa dhe kërkuar kohë më të madhe se sa mund të ofrohet, mund të dërgojë çështjen penale qëllimisht në zvarritje. Veprimet e caktuara të palës mbrojtëse nuk mund t'i adresohen autoriteteve gjyqësore si shkaktare të vonesave të caktuara, të cilat mund të bien ndesh me vet parimin e zhvillimit të procesit penal në kohë të arsyeshme. Është obligim i gjyqtarit të vetëm dhe trupit gjykues që udhëheqin me çështjen penale, për të menaxhuar duke pasur gjithë vëmendjen për arsyeshmëritë e kërkesave që vijnë nga palët.

Sjellja e autoriteteve kompetente - Organet që marrin pjesë në procedurë penale e kanë obligim ligjor që veprimet e tyre lidhur me çështjen penale t'i përfundojnë brenda afateve të arsyeshme. Veprimet fillestare të policisë në procedurë parapenale, zhvillimi i hetimeve, gjykimi i çështjes penale dhe procedura e apelit, duhet të kryhen brenda afatit të arsyeshëm. Pavarësisht afateve të të parapara, është detyrë e organeve që udhëheqin procedurën penale, që çështjet konkrete t'i përfundojnë brenda një afati kohor të arsyeshëm, në të kundërtën do të cenohet e drejta për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm. Në çështjen *Bunkate kundër Holandës*, GJEDNJ ka shprehur mendimin se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet duke iu referuar kritereve të përcaktuara në praktikën gjyqësore dhe në dritën e rrethanave të rastit konkret. Pra, është detyrë e shteteve që zbatojnë KEDNJ për të organizuar

sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që gjykatat e tyre të përmbushin secilën prej çështjeve të parashtruara pranë tyre (Bunkate v. Holanda, GJEDNJ, 1993, paragr. 22). Neglizhenca e paarsyeshme e shkaktuar nga organet procedurale gjatë fazave të zhvillimit të procedurës penale, dëmton në thelb të drejtën për gjykim të drejtë. Përfundimi i çështjeve brenda afatit të arsyeshëm, është një nga elementet themelore të drejtës për gjykim të brenda afatit të arsyeshëm.

2.3. Zhvillimi i procedurës së hetimit jo-formal dhe formal sipas afatit të arsyeshëm

Parimisht, procedurës penale i paraprinë procedura parapenale. Procedura parapenale është procedurë në të cilën bëhet zbulimi i veprës penale dhe kryerësit të saj. Procedura parapenale nuk është procedurë penale, ngase në këtë procedurë nuk krijohet marrëdhënia penalo-procedurale. Për këtë arsye në procedurë parapenale nuk kemi subjekt në kuptimin procedural penal penal (Sahiti & Murati, 2016, f. 303). Procedurës penale mund t'i paraprijnë veprimet fillestare të policisë ose mbledhja e informatave sipas dispozitave të KPP-së, gjë që teoria e të drejtës së procedurës penale me të drejtë e emërton procedurë parapenale. Veprimet fillestare policore, kanë si karakteristikë themelore mbledhjen e të dhënave relevante në lidhjen me veprën penale dhe kryerësin e dyshuar për veprën penale dhe hyjnë në procedurën parapenale pasi ende nuk ka dyshim të arsyeshëm për veprën penale dhe për kryerësin e veprës penale. Sipas nenit 70 paragr. 4 të KPP-së, policia obligohet që posa të kuptojë se ka dyshim të arsyeshëm që është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda njëzet e katër orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale. Në lidhje me veprën penale dhe kryerësin e saj, duke u bazuar në të dhënat dhe provat e mbledhura, sipas nenit 81 të KPP-së, policia përpilon kallëzim penal të policisë në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave. Pas paraqitjes së kallëzimit penal nga ana e policisë, apo në forma tjera, prokurori i shtetit sipas nenit 102 të KPP-së mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të

arsyeshëm se po ndodh ose ka gjasë të ndodh në një të ardhme të afërt vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare Në aspektin formal, sipas nenit 104 hetimi çdo herë fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit (KPP).

Sipas nenit 164, paragr. 1, kur prokurori i shtetit autorizon hetimin, policia arreston dhe ndalon personin. Sipas nenit 164, paragr. 6 dhe 7, sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit dhe jo më vonë se gjashtë orë nga koha e arrestimit, prokurori i shtetit i lëshon personit të arrestuar vendimin me shkrim mbi ndalimin. Brenda njëzetekatër orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit. Ndalimi nga nuk mund të kalojë dyzet e tetë orë nga koha e arrestimit. Sipas nenit 164, paragr. 10, sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda dyzetetetë orëve nga arresti, gjyqtari i procedurës paraprake mban seancën dëgjimore por jo më vonë se brenda dyzet e tetë orëve nga seanca, gjyqtari i procedurës paraprake nxjerr aktvendim lidhur me caktimin apo jo të paraburgimit të të pandehurit. Gjyqtari i procedurës paraprake duhet të shqyrtojë nëse mund të urdhërohen masa më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

Sipas nenit 190, paragr. 1, 2, 3 dhe 4 të KPP-së, para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se: 1) katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim; 2) tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me pesë (5) e më shumë vjet burgim. Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar, e zvarritja e procedurës nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj (neni 190 paragr. 3, KPP). Kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake, vazhdimi i paraburgimit mund të vazhdohet edhe për gjashtë (6) muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj (KPP, neni 190 paragr. 4).

Edhe pse në aspektin normativ është e përcaktuar në mënyrë takstative, duke trajtuar dhe me afate strikte kohëzgjatjen e paraburgimit, është në diskrecion të gjyqtarit të vetëm ose trupit gjykues, se pavarësisht aspektit normativ të mund vendos për gjithë rastet veç e veç në

mënyrë të pavarur, duke analizuar dhe marrë parasysh gjithë rrethanat që lidhen me veprën, kryerësin dhe rrethanat e tjera relevante lidhur me çështjen penale. Këto afate të gjata që janë dhënë, mund dhe të shndërrohen në mundësi për t'u abuzuar dhe pamundësi të kontrollit adekuat në lidhje me trajtimin e vet personit të paraburgosur përderisa është nën mbikëqyrjen e organeve shtetërore.

Për dallim nga sistemi ynë i procedurës penale, mund të shohim se në Holandë koha e plotë e paraburgimit është 104 ditë, në Mbretërinë e Bashkuar, 182 ditë dhe në Gjermani është 6 muaj. Këto juridiksione përcaktojnë kriteret sipas të cilave këto periudha kohore mund të zgjaten, por ka një kontroll të fortë gjyqësor mbi veprime të tilla dhe prokurori është i obliguar të paraqesë me parashtresë të arsyetuar kur kërkon një shtyrje të tillë. Duke vendosur periudha më të shkurtra për paraburgim dhe duke vendosur një barrë të vazhdueshme ndaj prokurorisë për të kërkuar dhe argumentuar shtyrjen, ligji vë nën presion autoritetet për të përmbushur detyrat e tyre pa vonesa të panevojshme (Yanev, 2012, f. 445).

Pasi që Prokurori i shteti nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve, bazuar në dispozitën e nenit 156 të KPP-së, çdo tre muaj, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së tij shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngritët aktakuza. Nga koha e nxjerrjes së aktvendimit, hetimi përfundon brenda dy viteve. Nëse brenda kësaj periudhe nuk përfundohet, përjashtimisht rasteve që gjatë zhvillimit të tij, sipas nenit 159, paragr. 1 të KPP-së, hetimi nuk është pezulluar, atëherë hetimi për shkak të përfundimit të afatit kohor duhet të pushohet. Ndërsa, sipas nenit 159, paragr. 2, parashihet që pavarësisht kohëzgjatjes prej 2 vjet, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë muaj të hetimit, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme.

KPP i mëparshëm, edhe pse kohëzgjatjen e hetimit e ka pasur 2 vjet, procedura ka qenë e ngarkuar me kërkesa të vazhdueshme për zgjatje të afateve të cilat ka qenë dashur t'i autorizojë gjykata pas kërkesës së parashtruar nga prokurori. Lidhur me zbatimin e dispozitave për kohëzgjatjen e hetimeve, nuk duhet asnjëherë të keqpërdoren autorizimet në lidhje më

kohëzgjatjen e hetimeve. Rastet duhet trajtuar në kontekst të rrethanave që e karakterizojnë çështjen penale dhe asnjëherë nuk duhet mbështetur në mundësinë diskrecionale që japin normat procedurale. Afati kohor prej dy viteve dhe shtyrja dhe për gjashtë muaj të tjerë, duhet ndodh vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara mirë, ndërsa rastet tjera do të gjykohen vetëm brenda kontekstit kohor që do t'i duheshin si të domosdoshme për të përfunduar veprimet e domosdoshme në çështjen penale dhe asnjëherë nuk do të mund të gjejnë hapësirë për shtyrje deri në prag të përfundimit të afatit ligjor për hetime. Afati i arsyeshëm nuk cenohet vetëm me tejkalimin e afatit ligjor të dhënë për kohëzgjatjen e hetimeve, por cenohet edhe në rastet kur çështja penale nuk përfundohet brenda afatit të arsyeshëm marrë parasysh gjithë rrethanat e rastit, edhe pse afati kohor ligjor nuk ka përfunduar.

2.4. Zhvillimi i procedurës së gjykimit dhe apelit sipas afatit të arsyeshëm

Sipas nenit 242, paragr. 3 dhe 4 të KPP-së, gjyqtari kompetent cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas ngritjes së aktakuzës. Sipas nenit 245, paragr. 5, gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë midis 30 - 40 ditë pas shqyrtimit fillestar. Ndërsa, sipas nenit 285, paragr. 2, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimin gjyqësor brenda një muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar lidhur me kundërshtimin e provave (KPP, 2013)

Sipas nenit 314, paragr. 1 (1) dhe (2), nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë ditëve. Nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindenjëzet (120) ditësh. Sipas nenit 314, paragr. 2 të, pavarësisht këtyre afateve, shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar kur ekzistojnë rrethana të cilat

kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në: 1) numër të shumtë të dëshmitarëve; 2) dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë 3) numri i provave është jashtëzakonisht i madh dhe 4) siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet për tridhjetë (30) ditë për secilin aktvendim të bazuar në rrethanat e përmendura më sipër. Mosvënia strikte e afateve kohore sikurse është përcaktuar në fazën e hetimeve një afat të përgjithshme prej maksimalisht 2 viteve, mund të shndërrojë shqyrtimin gjyqësor në një proces maratonik që nuk mund t'i shihet fundi. Mundësia që ligji procedural u ka lejuar bartëseve të procesit gjyqësor për të menaxhuar dhe krijuar mundësi për shtyrje të tilla, edhe pa qëllime të caktuara mund të dërgojë procesin gjyqësor në proces të padrejtë me vet faktin e mosrespektimit të afatit të arsyeshëm.

KPP nuk përcakton asnjë afat ligjor brenda cilës periudhë gjykata e ka për obligim të merr aktgjykim për çështjen penale. Si rregull është përcaktuar që pasi gjykata merr aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e shpall menjëherë. Sipas nenit 366, paragr. 1, kur gjykata nuk ka mundësi që në të njëjtën ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të merr aktgjykimin, shpalljen e aktgjykimit e shtyn më së shumti tri ditë dhe e cakton kohën dhe vendin e shpalljes së tij. Sipas nenit 369, paragr. 1, aktgjykimi i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e tij, kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në raste të tjera brenda tridhet (30) ditëve nga dita e shpalljes. Kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

Edhe pse vendosja e afateve ligjore për përfundimin e çështjeve penale, përgjithësisht vlerësohet si e papërshtatshme, megjithatë duhet që të menaxhohet mirë me kohën dhe të mos cenohen të drejtat e të pandehurit për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm kohor. Edhe pse janë përcaktuar afate, mundësitë të cilat u janë dhënë gjyqtarëve për të shtyrë çështjen për arsyet e përmendura në ligj, do të krijojë çdoherë zvarritje.

Kundër aktgjykimit të marrë në nga shkalla e parë, afati i paraqitjes së ankesës është brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. KPP nuk përmban ndonjë dispozitë që obligon gjykatën e shkallës së parë që brenda një afati të caktuar kohor të

përcjellë në Gjykatën e Apelit ankesën e paraqitur nga palët se bashku me dosjen e lëndës. Përmendet vetëm mundësia e paraqitjes së përgjigjes në ankesë, për pretendimet ankimore nga palët. Sikurse është përcaktuar saktësisht afati kohor për mbajtjen e shqyrtimit të parë dhe të dytë, në të njëjtën mënyrë do të duhej të ekzistojë një dispozitë që do të duhej respektuar e cila do të përcaktojë afatin kohor brenda të cilit gjykata e shkallës së parë do të ishte e obliguar të dorëzojë dosjen e çështjes së gjykuar gjyqësore nga kjo gjykatë dhe afatin kohor brenda të cilës do të duhej që Gjykata Apelit të mbajë seancën dëgjimore. Lidhur me zhvillimin e seancave dhe procedurës që zhvillohet në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë nuk është e lidhur me afate kohor për të përfunduar çështjen e saj. E vetmja dispozitë që e lidh në afat kohor është e përcaktuar në nenin 405, paragr. 2, ku përcaktohet se: *"Në qoftë se i akuzuari është në paraburgim, Gjykata e Apelit ia dërgon vendimin dhe shkresat gjykatës themelore jo më vonë se tre (3) muaj nga dita e marrjes së shkresave nga kjo gjykatë"* (KPP, 2013).

2.5. Lirimi në pritje të gjykimit dhe cenimi i parimit të sigurisë ligjore

Instrumentet ndërkombëtare të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, përfshirë DUDNJ-në, PDCP-në dhe KEDNJ-në, obligojnë shtetet të cilat kanë pranuar detyrimet nga këto akte ndërkombëtare, që proceset gjyqësore të cilat zhvillohen të garantojnë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm pavarësisht kufizimit ose jo të lirisë ndaj personave që zhvillohet procedura penale. Përveç rregullave të përgjithshme, këto instrumente përmbajnë rregulla të veçanta që i kushtojnë rëndësi sidomos personave që iu është kufizuar liria nga masat e sigurisë. Rastet e tilla prodhojnë ndjeshmëri më të madhe në krahasim me rastet kur personat mbrohen në liri. Lidhur me natyrën e këtij trajtimi, sipas nenit 9 § 3 të PDCP-së, parashihet se çdo person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një vepre penale duhet që pa ndonjë vonesë të paraqitet para gjyqtarit kompetent dhe të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm kohor apo të lirohet në pritje të gjykimit. Masa e ndalimit të personave në pritje të gjykimit nuk duhet të jetë një rregull e pazëvendësueshme, pasi lirimi mund të kushtëzohet me garancione tjera. Edhe KEDNJ, sikurse edhe PDCP parasheh të drejta të njëjta për të pandehurin

lidhur me afatin e arsyeshëm dhe të drejtën e tij për tu liruar në pritje të gjykimit, kushtëzuar me garancione të caktuara. Në përputhje me kriteret e vendosura me këto instrumente, sipas Kushtetutës parashihet që secili person që arrestohet, ka të drejtën që të paraqitet në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit (Kushtetuta, neni 29, paragr. 2).

E drejta e personit për t'u mbrojtur në liri garantohet me të drejtën e tij për t'u prezumuar si i pafajshëm dhe në të drejtën e tij për liri personale. Personat të cilëve u është kufizuar liria, duhet të jenë të trajtuar me prioritet nga organet e drejtësisë që trajtojnë çështjen e tij dhe ta shpejtojnë procedurën brenda afateve të arsyeshme. Sipas nenit 161, paragr. 1 (1), (2) dhe (3) të KPP-së, përcaktohet se e drejta e të pandehurit për liri dhe siguri përcakton prezumimin në favor të qëndrimit në liri. Privimi nga liria urdhërohet nga gjykata vetëm nëse prokurori i shtetit paraqet prova që mbi-peshojnë prezumimin nga e drejta e të pandehurit për liri dhe siguri. Kur urdhërohet heqja e lirisë, policia, prokurori i shtetit ose gjykata përdor kufizimet më të vogla të mundshme ndaj lirisë. Lidhur me këtë, në çështjen *Tomasi kundër Francës*, GJEDNJ nxori konkluzion që shpreh përgjegjësinë për autoritetet shtetërore që ato të sigurojnë që në një rast të caktuar, paraburgimi nuk duhet të kalojë afatin e arsyeshëm kohor. Për këtë qëllim gjykata duhet të shqyrtojnë të gjitha rrethanat që argumentojnë ose kundërshtojnë ekzistencën e një kërkese të vërtetë të interesit publik të arsyeshëm, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë dhe shmangien e respektimit të së drejtës për liri personale (Tomasi v. Franca, GJEDNJ, 1992, paragr. 84). Respektimi i afatit të arsyeshëm duhet trajtuar varësisht nga rrethanat e rasteve veç e veç. Sipas nenit 5 paragr. 3 të KPP-së, përcaktohet se çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme. Në këtë kontekst, nëse gjykimet nuk përfundojnë brenda afateve të arsyeshme dhe personi i dyshuar apo i akuzuar i është kufizuar liria, atëherë duhet shqyrtuar seriozisht mundësinë që të njëjtit t'i krijohet mundësi për lirim në pritje të gjykimit. Në favor të qëndrimit në liri është e drejta e tij për t'u konsideruar i pafajshëm dhe e drejta për liri dhe siguri.

Përderisa prokuroria hap një hetim kundër një individi për shkak të një akuze penale kundër tij, ky person e gjen veten në një pozitë të *"pasigurisë"* Për qëllime të efikasitetit të

procedurës penale, ndaj tij mund të merren masa të caktuara shtrënguese, duke u vendosur nën kufizime që të mos largohet nga vendi i tij i banimit ose të mbahet në paraburgim gjatë hetimit për arsye tjera të ligjshme. Edhe nëse asnjëra nga masat e parapara ligjore nuk i caktohen, i dyshuari asnjëherë nuk lirohet nga dyshimi dhe frika për lirinë dhe të ardhmen e tij. Prandaj, në një shoqëri të qeverisur nga sundimi i ligjit, procedurat e gjata penale në mënyrë të pashmangshme bien ndesh me parimin e sigurisë juridike e cila, ndër të tjera, garanton *"mundësinë për të ditur paraprakisht se si autoritetet do të përdorin fuqitë e tyre shtrënguese"* (Yanev, 2012, f. 448).

Nga perspektiva e personit të akuzuar, një situatë e tillë përbën një barrë të rëndë, sepse presioni i ndjekjes penale shpesh është i madh. Në fakt, ka pasur ankesa lidhur me shkeljen e nenit 3 të KEDNJ-së të dërguara në GJEDNJ nga ankues të ndryshëm që pretendonin se kishin vuajtur trajtim çnjerëzor dhe degradues si rezultat i natyrës së zgjatur të procedurës penale kundër tyre. Prandaj është e kuptueshme pse GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se çdo shtet anëtar ka për detyrë që të sigurojë që *"personat e akuzuar nuk duhet të qëndrojnë shumë gjatë në një gjendje të pasigurisë sa i përket rezultatit të akuzave penale kundër tyre"* (Yanev, 2012, f. 448). Përfundimi i çështjes penale brenda afatit të arsyeshëm është karakteristikë e një procesi të ndershëm penal. Çështja e mbajtjes së personit nën *"dyshim"* dhe *"akuzë penale"* është një çështje delikate, ajo përfshin efekte negative që mund të jenë të paparashikueshme dhe të pariparueshme. Është obligim i organeve shtetërore që çështjet penale t'i përfundojnë brenda afateve të arsyeshme, duke u munduar që të arrihet përmbushja e kritereve të së drejtës së procedurës penale, me vëmendje të vazhdueshme për kujdesin për mos-shkaktim të dëmeve morale dhe materiale për personat ndaj të cilëve zhvillohet procedura penale.

2.6. Cenimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe adresimi i tij

Në shumë vendime të nxjerra nga kërkesat e parashtruara nga persona që kanë pretenduar cenim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, GJEDNJ ka konstatuar shkelje nga shtetet kontraktuese në dëm të interesave të pandehurve në procedurat e

zhvilluara nga këto shtete. Kjo gjykatë ka vendosur standarde të cilat obligojnë shtetet që të drejtat e garantuara nuk duhet të jenë thjesht të drejta abstrakte dhe të paarrira, por ato duhet të jenë konkrete dhe efektive. E drejta për t'u gjykuar brenda afatit kohor të arsyeshëm është një nga të drejtat themelore në procedurë penale, andaj tej-zgjatja e procedurave për shkak të fajit të autoriteteve shtetërore pa ndonjë arsye të fuqishme, cenon të drejtën e garantuar me Konventë. Gjykata thekson se shumica e juridiksioneve nacionale që kanë pranuar obligimet nga KEDNJ, nuk ka paraparë në legjislacionet e tyre mjete juridike efektive për të mbrojtur të drejtë për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm. Mungesa e këtyre mjeteve ka bërë që e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm të jetë juridikisht e pamundshme për t'u realizuar në rast se e njëjta shkelet, apo shkeljet përsëriten.

Për mungesë të mjeteve efektive lidhur me shqyrtimin e tej-zgjatjes së procedurave, GJEDNJ ka theksuar se neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive) i KEDNJ-së garanton një zgjidhje efikase përpara autoriteteve vendase për shkelje të nenit 6 § 1, për të shqyrtuar çështjen brenda një kohe të arsyeshme. Mjetet efektive në dispozicion të palëve ndër-gjyqëse në një sistem gjyqësor vendas për ngritjen e pretendimeve rreth tej-zgjatjes së procedurave janë *"efektive"*, sipas kuptimit të nenit 13 të Konventës, nëse ato *"parandalojnë"* shkeljen e pretenduar ose vazhdimin e saj, ose sigurojnë një adresim të përshtatshëm për çdo shkelje të mundshme që tashmë ka ndodhur. Prandaj neni 13 ofron një alternativë: një mjet ankimi është efektiv nëse mund të përdoret ose për të përshpejtuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t'u siguruar palëve ndër-gjyqëse një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur tashmë (Gjonboçari dhe të tjerë v. Shqipëria, GJEDNJ, 2008, paragr. 74-75).

Një mjet efektiv juridik që do të mund të adresonte cenimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procedurës penale nuk mund të gjendet në dispozitat ligjore të KPP-së. Mjetet juridike të cilat mund t'i disponojë i pandehuri nuk përfshijnë të drejtën për të adresuar pretendimin për cenim e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Vet mungesa e mjetit juridik përbën shkelje për të drejtat e të pandehurit në procedurë penale. Sikurse e përmendëm në rastin Gjonboçari etj. kundër Shqipërisë, mungesa e mjeteve juridike e bënë të pamundshme për të përshpejtuar marrjen e një vendimi

nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t'u siguruar një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur tashmë.

Zgjidhja më e mirë është parandalimi i cenimit të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Atje ku sistemi gjyqësor ka mangësi në lidhje me kërkesën mbi kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, krijimi i një mjeti ankimi për të përshpejtuar procedurat me qëllim parandalimin e tej-zgjatjes së tyre është zgjidhja më e mirë. Ky mjet ankimi do të ofronte pa diskutim një avantazh mbi një mjet ankimi që rregullon vetëm kompensimin, meqenëse ai parandalon shkelje të mëtejshme në lidhje me të njëjtin lloj të procedurave, pra nuk rregullon shkeljen thjesht a posteriori siç ndodh me një mjet ankimimi me qëllim kompensimin. Disa shtete e kanë kuptuar situatën në mënyrë të duhur, duke zgjedhur kombinimin e dy tipeve të mjeteve të ankimimit, njëra e krijuar për përshpejtimin e procedurave dhe tjetra për të rregulluar kompensimin (Gjonboçari dhe të tjerë v. Shqipëria, GJEDNJ, 2008, paragr. 76). Mungesa e këtij mjeti juridik, ka detyruar GJEDNJ që me shumë vendime, të vendos parime të cilat obligojnë shtetet që të krijohet bazë juridike e nevojshme për t'u garantuar mjetet juridike formale dhe efektive.

Në këtë kontekst, në kapitullin XXXVI të KPP-së gjendet dispozitat që rregullojnë procedurën për kompensim dëmi, rehabilitim dhe për ushtrimin e të drejtave të tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye. Në këtë kapitull KPP nuk ka paraparë ndonjë dispozitë që parashikon kompensimin e personave që kanë pësuar nga cenimi i të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm. Mosekzistimi i mjeteve juridike për të adresuar dhe kërkuar kompensim për një të të drejtë të garantuar, përbën shkelje të të drejtave themelore procedurale. E drejta e kompensimit është dimension a posteriori dhe nuk parandalon cenimin e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm sikurse mund të jetë mjeti juridik që kërkon përshpejtimin e çështjes penale brenda afatit të arsyeshëm. KPP duhet të përmbajë dispozita ligjore që sigurojnë mjete efektive juridike për të realizuar të drejtën e tyre për kompensim nga cenimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në përputhje me detyrimet që dalin nga KEDNJ dhe praktika e GJEDNJ-së që janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.

Nga ky trajtim mund të themi se në asnjë rregull të procedurës penale ose procedurave tjera nuk janë paraparë mjete juridike efektive për të realizuar të drejtën për gjykim në afat të

arsyeshëm. Mungesa e një mjeti juridik efektiv për të përshpejtua të drejtën e të pandehurit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe të drejtën për tu kompensuar për tej-zgjatjen e procedurave jashtë afatit të arsyeshëm kohor, cenon të drejtën e të pandehurit për të pasur gjykim të drejtë. Pra, mungesa dy mjeteve juridike efektive është një dobësi që gjenden në të drejtën e procedurës penale në Kosovë dhe bie ndesh me obligimet që dalin nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

PJESA E TRETË

ELEMENTET E VEÇANTA TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË

KAPITULLI VII

E DREJTA E TË PANDEHURIT PËR T'U MBROJTUR

1. Shqyrtime të përgjithshme

Neni 6 § 3 i KEDNJ-së përmban disa elementë të cilat i akordohen mbrojtjes, të cilat përbëjnë raste të veçanta të parimit për proces të rregullt ligjor. Këto të drejta të posaçme nuk mund të shkëputen nga *"trungu i përbashkët që janë lidhur"* (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 373). Të drejtat që janë përcaktuar me nenin 6 § 3 të KEDNJ-së përfshijnë: a) e drejta për t'u informuar për akuzën; b) e drejta për të përfituar disa lehtësi të përshtatshme për mbrojtjen; c) e drejta që të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe d) e drejta për të marrë pjesë në kërkimin e provës dhe f) e drejta për t'u asistuar nga një përkthyes.

2. E drejta për t'u informuar për akuzën

E drejta për t'u informuar për akuzën është një e drejtë e posaçme që gëzon i pandehuri në kuadër të së drejtës së tij për gjykim të drejtë në procedurën penale. *"E drejta për t'u njoftuar menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme, në një gjuhë të cilën e kupton i pandehuri, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet kundër tij"*, është e drejtë e garantuar me instrumente ndërkombëtare, përkatësisht me nenin 14 § 3 (a) të PDCP-së, me nenin 6 § 3 (a) të KEDNJ-së. Në rrafshin nacional, kjo e drejtë është e përcaktuar me nenin 30 paragr. 1 të Kushtetutës së Kosovë, si dhe me nenin 152 (zbatimi i marrjes në pyetje të të pandehurit në procedurën paraprake) dhe nenin 167 (njoftimi i personit të arrestuar për të drejtat e tij) të KPP-së. Lidhur me të drejtën e të pandehurit për t'u informuar për akuzën, sipas nenit 16 të KPP-së, përcaktohet se: *"Gjykata detyrohet të njoftojë të pandehurin ose pjesëmarrësin tjetër në procedurë për të drejtat që i përkasin sipas KPP-së, si dhe për pasojat e mosveprimit të tij*

nëse ai, për shkak të mosdijes, nuk ndërmerr veprimin e duhur në procedurë ose nuk shfrytëzon të drejtat e tij." Pra, për të drejtën për t'u njoftuar me akuzën dhe të drejtat tjera të përcaktuara, gjykata e ka për obligim që sipas detyrës zyrtare të njoftojë çdo herë të pandehurin në procedurë penale.

Lidhur me shpjegimin e nocionit *"akuzë"* që përfshihet në thelb të kësaj të drejte, nënkuptojmë *"njoftimin zyrtar nga autoriteti kompetent për pretendimin që lidhet me kryerjen e një vepre penale"* (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 373). Shpjegimi për nocionin *"akuzë"* i trajtuar më sipër nuk është shterues, ky nocion shikuar në një kontekst më të gjerë, përfshin cilindo veprim që merret ndaj një personi në procedurë penale, qofshin veprime këto të ndërmarra gjatë veprimeve fillestare të policisë, procedurës paraprake, apo gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Pra, cilido ballafaqim që ndodh në mes autoriteteve shtetërore që zbatojnë dispozitat procedurale, ndaj cilitdo person të dyshuar apo të akuzuar, duhet të cilësohet si *"akuzë"* në kuptimin e gjerë. Termi *"akuzë"* nuk lidhet me përshkrimin ligjor që mund të gjendet në instrumentet ligjore, por lidhet kontekstualisht me ballafaqimin e personit me autoritetet shtetërore, ku mund vihen në pikëpyetje liritë dhe të drejtat e tij të garantuara.

Natyra e akuzës është cilësimi juridik që u bëhet fakteve në aktakuzë, ndërsa shkaku i akuzës janë faktet materiale për të cilat akuzohet i pandehuri. Kërkesat lidhur me afatin, gjuhën që duhet të jetë e kuptueshme për të akuzuarin dhe karakterin e hollësishëm të akuzës janë kërkesa të cilat duhet interpretohen rast pas rasti (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 373). Është detyrim i organit procedural që t'i komunikojë të pandehurit bazat reale dhe juridike të akuzës. Komunikimi i bazave reale të akuzës supozon dy elemente: së pari, komunikimin e veprimit apo mosveprimit, i cili i ngarkohet të pandehurit, së dyti, njoftimi me provat me të cilat provohen faktet të cilat përbëjnë figurën e veprës penale. I pandehuri duhet të njoftohet për bazën juridike të akuzës (cilësimin juridik). Ndaj të pandehurit nuk mund të zhvillohet procesi gjyqësor pa e njoftuar për veprën penale për të cilën akuzohet dhe për bazat që e arsyetojnë dyshimin për veprën penale që i ngarkohet. I pandehuri për këtë të drejtë njoftohet nga organet të cilat zbatojnë në rastet konkrete procedurën penale, nëse bëhet fjalë për hetim këtë e bënë policia dhe prokurori i shtetit, ndërsa në rastet kur çështja lidhet me shqyrtim gjyqësor, këtë e bënë gjyqtari i vetëm gjykues, apo kryetari i trupit gjykues (neni 345 § 2 lidhur me nenin

152 § 3). Edhe pse KPP nuk ka përcaktuar saktësisht se cila është përmbajtja konkrete e të drejtës që të pandehurin të njoftojë me akuzën përderisa arrestohet apo merret në pyetje gjatë zhvillimit të procedurës penale, për të arritur qëllimin e informimit të duhur për veprën penale për të cilën ngarkohet i pandehuri, njoftimi duhet të përmbajë përshkrimin faktik të veprës, dispozitat e legjislacionit penal për të cilat besohet se do të zbatohen si dhe emërtimin ligjor të veprës penale (Sahiti, Murati, & Elshani, 2014, f. 417). Kjo e drejtë është një parim fundamental, shtrirja e së cilës matet nga praktika. Nga e drejta për t'u informuar për shkaqet e akuzës lidhet: a) efikasiteti i mbrojtjes; b) efektiviteti i pjesëmarrjes në procesin penal; c) ri-cilësimi i veprës penale dhe fakteve; d) gabimet në procedim të akuzës (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 373).

Njoftimi për akuzën reflekton tek i pandehuri dhe në cilësinë e mbrojtjes që ai do të mund të paraqiste në rastin e tij (Sahiti, Murati, & Elshani, 2014, f. 417). Detyrimi i autoriteteve që të njoftojë të pandehurin menjëherë, apo në kohë sa më të shpejt, varet dhe cilësia e mbrojtjes që do t'i ofrohet të pandehurit në procedurë penale. Cilësia e mbrojtjes nuk varet vetëm nga njoftimi si dimension formal, por njoftimi duhet të jetë përmbajtësisht i pasur me informacionet relevante që përbëjnë dosjen e akuzës ndaj të pandehurit.

Parimi i pjesëmarrjes efektive në procedurën penale lidhet më mundësinë e çdo të pandehuri që pavarësisht situatës apo statusit të tij personal, të mund t'i gëzojë të drejtat e tij të përcaktuara me instrumentet ligjore në fuqi. Ashtu edhe siç e kemi përmendur më herët, të drejtat e garantuara për të pandehurin në procedurë penale duhet të jenë të arritshme dhe lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave nuk mund të pësojë askush. Të drejtat e çdo të pandehuri në procedurë penale duhet t'i nënshtrohen para së gjithash kritereve të barazisë dhe mos-diskriminimit dhe ofrimit të mundësive për çdo të pandehur që ato të drejta të jenë efektive. Në çështjen *Vaudelle kundër Francës*, GJEDNJ thekson se masat mbrojtëse të veçanta procedurale mund të kërkohen për të mbrojtur interesat e personave të cilët për shkak të aftësisë së kufizuar mendore nuk janë plotësisht të aftë të veprojnë për vete (Vaudelle v. France, GJEDNJ, 2001, paragr. 60). Në të njëjtën frymë masa të veçanta mund të kërkohen dhe për të miturit, apo edhe për personat e tjerë, me qëllim që informimi për akuzën ndaj cilitdo të

pandehur të jetë efektiv dhe jo thjesht formal dhe të arrijë qëllimin e plotë të përmbajtjes së akuzës.

Ri-cilësimi të veprës penale dhe fakteve nga ana e prokurorit të shtetit mund të ketë për pasojë cenim të të drejtave të mbrojtjes, apo të drejtës së të pandehurit për t'u njoftuar me akuzën dhe përmbajtjen e saj. Njoftimi me akuzën nuk është çështje e zgjidhur nëse i pandehuri njoftohet fillimisht për akuzën kundër tij dhe përmbajtjen e saj, por ai duhet njoftuar për çdo ndryshim të përmbajtjes së akuzës në çdo fazë të procedurës penale. Me nenin 350 të KPP-së parashihet mundësia e ndryshimit të aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor, ku me paragr. 3 të këtij neni përcaktohet se nëse trupi gjykues lejon ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e aktakuzës së re, atëherë cakton afatin kur prokurori i shtetit detyrohet të paraqesë aktakuzën e re. Të akuzuarit i dërgohet kopja e aktakuzës së re. Nëse prokurori i shtetit në afatin e caktuar nuk paraqet aktakuzë të re, gjykata vazhdon shqyrtimin gjyqësor në bazë të aktakuzës së mëparshme. Përderisa merret aktgjykimi nga gjykata përkatëse, me nenin 360 paragr. 3, është përcaktuar se *"Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës."* Kjo rregull i ofron fleksibilitet gjykatës që në përputhje me gjendjen e vërtetuar faktike gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor të jep aktgjykim të drejtë. Mirëpo, nxjerrja e aktgjykimit me ndryshime për të cilat i pandehuri nuk është i njoftuar, mund të përbëjë shkelje të së drejtës për t'u informuar për të drejtat e akuzës. Lidhur me këtë çështje, praktika e GJEDNJ-së ka nxjerrë në pah një tjetër vështirësi lidhur me kompetencën e gjyqtarit për të ri-cilësuar faktet. Çështja nuk lidhet me ndalesën e gjyqtarëve për të për të bërë ri-cilësim, përderisa vërtetohet se ri-cilësimi i deritashëm nuk ishte i duhur dhe se duhet ri-cilësim i përshtatshëm, por kërkohet nga gjyqtarët që në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, të pandehurit duhet t'i jepet mundësia për t'u informuar për një ndryshime të mundshëm dhe për të dhënë shpjegime (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 374). Në çështjen *Pélissier and Sassi kundër Francës*, GJEDNJ përcaktoi se gjykatat e rregullta janë të lidhura me cilësimin e veprave penale për të cilat janë të njoftuar të akuzuarit, në rastet kur cilësimi i veprave penale ndryshon, atëherë ata duhet të njoftohen sikurse njoftohet i pandehuri për të drejtën e tij për t'u natyrën dhe shkaqet e akuzës të përcaktuar me nenin 6 § 3 (a) të KEDNJ-së, me qëllim që të përgatisë mbrojtjen. Pra, qëllimi i njoftimi duhet të jetë efektiv dhe i përshtatshëm dhe të

përmbajë mundësi për të pandehurin për të dhënë mendimin e tij për një situatë të re juridike dhe faktike (Pélissier and Sassi v. Franca, GJEDNJ, 1999, paragr. 62).

Gabimet në procedim të akuzës mund të jenë shumë herë rrethana që detyrojnë prokurorin të arsyetojë para gjykatës dhe para të pandehurit të bëjë sqarimet për lëshimet e bëra, pavarësisht të çfarë natyre, qofshin ato edhe lëshime të natyrës teknike, apo lajthitje të caktuara përderisa është shkruar teksti i aktakuzës. Edhe në këto raste, i pandehuri në cilësinë e palës gëzon të drejtën të njoftohet për gjithë ndryshimet e bëra. Përmirësimi i gabimeve dhe lëshimeve të caktuara mund të ketë konsekuenca të mëdha, nëse të njëjta mbesin në formën të cilën nuk duhet të qëndrojnë. Mundësia e korrigjimit të parashtresave (aktakuzat, propozimet për ndjekje, aktvendimet e prokurorëve, mjetet juridike dhe deklaratat e njoftimet tjera) është përcaktuar sipas nenit 442 (KPP, 2013). Ndërsa sipas nenit 371, është përcaktuar mundësia e përmirësimit të gabimeve të imta të cilat kanë mund të ndodhin në aktgjykimin e shqiptuar (KPP, 2013).

3. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur

3.1. Rëndësia dhe funksionet e të drejtës për t'u mbrojtur

Funksioni i mbrojtjes në procedurën penale i takon vet të pandehurit. Bazuar në parimin e *"barazisë së armëve",* i pandehuri dhe prokurori janë palë të barabarta përball gjykatës, dhe është e drejtë e vet të pandehurit për të zgjedhur mënyrën se si do të paraqesë çështjen e tij para gjykatës, përfshirë këtu dhe të drejtën e tij për të pasur avokat mbrojtës, apo të vet-përfaqësohet atëherë kur mbrojtja nuk është e detyruar. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur, buron nga parimi i *"barazisë së armëve"* në procedurë penale. I pandehuri ka të drejtë të shprehet dhe të jep mendim sipas vullnetit të lirë të tij gjatë gjithë fazave të zhvillimit të procedurës. Prezumimi i pafajësisë si garancion kushtetues dhe ligjor, i jep të pandehurit privilegjin që të jetë i shkarkuar nga barra e provave dhe nuk e ka për obligim që në procedurë

penale të bëjë përpjekje që të dëshmojë pafajësinë e tij. I pandehuri sipas përcaktimeve ligjore funksionin e mbrojtjes mund të ushtrojë vet apo nëpërmes mbrojtësit.

Instrumentet ndërkombëtare, sikurse është KEDNJ që është drejtpërdrejt e zbatueshme nëpërmes dispozitës së nenit 22 të Kushtetutës, sipas nenit 6 § 3 (c), përcakton se çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë inter alia që të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë. Ndërsa, sipas nenit 14 § 3 (b) të PDCP-së, garantohet që secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të barabartë, si garancione minimale të ketë kohë të mjaftueshme dhe mundësi për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikoj me një avokat të zgjedhur prej tij. Në përputhje me këto instrumente ndërkombëtare, sipas nenit 30, paragr. 5 të Kushtetutës, çdokush që akuzohet për vepër penale, në mes të drejtave tjera minimale gëzon dhe të drejtën që të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas. Sipas nenit 53 paragr. 1 të KPP-së, të dyshuarit dhe të pandehurit i jepet të drejtë që të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Pra, i pandehuri me anë të një avokati mbrojtës mund të shfrytëzojë të drejtën e tij për t'u mbrojtur. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur me avokat mbrojtës është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore. Lidhur me funksionin e avokatit mbrojtës, sipas Ligjit nr. 04/L-193 për Avokati (2013) në Kosovë, avokatia paraqitet si profesion i lirë dhe i pavarur që merret me dhënien e ndihmës juridike personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e lirive, të drejtave dhe të interesave të tyre në pajtim me rendin juridik.

E drejta e zbatueshme e procedurës penale, lidhur me mënyrën e përfaqësimit të të pandehurit në procedurë penale dhe ushtrimin e funksionit të mbrojtjes në emër të tij, ka përcaktuar rregulla dhe zgjidhje diverse. E drejta e të pandehurit për të angazhuar mbrojtës, mbetet një e drejtë absolute e të pandehurit, ndërsa mos-angazhimi i mbrojtësit nga i pandehuri ka kufizime të caktuara. Sipas nenit 57 paragr. 1 të KPP-së, në mënyrë shprehimore përcakton rastet kur mbrojtja është e detyruar sikurse në vijim:

1) nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses;

2) gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;

3) nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;

4) në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm dhe

5) në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim me së paku një vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi.

Sipas nenit 43, paragr. 1 të Kodit nr. 03/L-193 të Drejtësisë për të Mitur (2010), i mituri duhet të ketë mbrojtës që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës.

Përjashtimisht rasteve të përmendura më sipër, i pandehuri në procedurë penale mund ta përfaqësojë vetveten, pa ndihmën e mbrojtësit. Mbrojtja jo e detyruar në teorinë e procedurës penale njihet si mbrojtje fakultative, dhe tek kjo lloj i mbrojtjes është në diskrecion të pandehurit të angazhojë apo jo mbrojtës (Sahiti & Murati, 2016, f. 158). Në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar, gjykata në emër të interesave të drejtësisë sipas dispozitave ligjore, apo edhe vet i pandehuri mund të angazhojë mbrojtës. Edhe në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar, përveç mundësisë që ka vet i pandehuri të angazhojë mbrojtës, ai mundet dhe me vet kërkesën e tij që ia paraqet gjykatës të angazhojë mbrojtës nëse procedura zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë ose më shumë vjet, ose këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t`i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij (KPP, neni 23, paragr. 1).

Sipas nenit 10 paragr. 2 të KPP-së, i pandehuri nuk ka detyrim të paraqesë mbrojtjen e vet dhe as të përgjigjet në ndonjë pyetje, dhe nëse mbrohet, nuk është i detyruar të akuzojë

vetveten ose të afërmit e tij e as të pranojë fajësinë. Kjo e drejtë nuk përfshin rastin kur i pandehuri hyn vullnetarisht në marrëveshje për të bashkëpunuar me prokurorin e shtetit. Dhe është e drejtë e tij kushtetuese që të mos jep asnjë deklaratë (Kushtetuta e Kosovës, 2008, neni 29, paragr. 3), duke i dhënë si mundësi të qëndrojë në heshtje.

3.2. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur vet, pa mbrojtës

Parimisht, në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar, i pandehuri mund të mbrohet vet. Sikurse e përmendëm më sipër, KPP përmend vetëm rastet kur mbrojtja është e detyruar, ndërsa rastet e mbrojtjes fakultative janë gjithë situatat procedurale kur në mënyrë taksative nuk janë përmendur në KPP-së. Sipas legjislacionit aktual, në rastet kur mbrojtja e të pandehurit nuk është e detyruar, e drejta e të pandehurit që të mos angazhojë avokat mbrojtës dhe ta përfaqësojë vetveten në procedurë penale nuk është një e drejtë absolute. Përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, sipas nenit 53, paragr. 3 të KPP-së, të pandehurin obligohen që nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata.

Disa legjislacione procedurale lejojnë vet-përfaqësimin gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale, megjithatë shumë autorë përmendin se vet-përfaqësimi i të pandehurit bart dhe rreziqe tjera të cilat prolongojnë vet punën e gjykatës dhe pamundësojnë që i pandehuri t'i përfaqësojë interesat e tij në aspektin më të mirë profesional. Gjyqtarët me të drejtë mund të dyshojnë se ata që duan të përfaqësojnë vetveten, thjesht shpresojnë të pengojnë rezultatin përfundimtar të gjykimit të tyre dhe ndoshta të diskreditojnë vet gjykatën. Motivi i të pandehurit për t'u vet-përfaqësuar mund ta shfrytëzojnë pavarësisht nga motivet taktike, personale ose politike të të pandehurve ose thjesht shfrytëzimin e një të drejte që ua mundëson ligji. Gjyqtarët mund të kenë frikë se të pandehurit e akuzuar politikë, shpresojnë të

bëjnë tallje të drejtësisë, duke ngritur çështje të parëndësishme në gjykim dhe duke përdorur gjykimin e tyre për të publikuar fyerjet ndaj sistemit të drejtësisë. Mundësia e abuzimit të drejtës nga i pandehuri për t'u vet-përfaqësuar, mund të ndodh si në rastet e gjykimeve politike dhe jopolitike (Brick, 1971, fv. 1497 - 1498).

Rreziku i vet-përfaqësimi dhe abuzimi me këtë mundësi që lejojnë disa juridiksione procedurale penale, është trajtuar gjerësisht. Vet-përfaqësimi është një e drejtë e pakufizuar që gëzojnë të pandehurit në procedurë penale që zhvillohet pranë gjykatave penale ad hoc për krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe Ruandë. Sipas nenit 21 të Statutit të TPNJ-së garantohet e drejta e të pandehurit që të vet-përfaqësohet. Vet-përfaqësimi në rastet e gjykimit të krimeve të luftës, sigurisht që është i padëshirueshëm për shumë arsye, në mes tjerash për këto arsye: gjykata mund të keqpërdoret si skenë politike; i pandehuri mund të mos ketë një mendim objektiv për lëndën që duhet të paraqesë dhe për rrjedhojë mund të mos e zhvillojë paraqitjen e mbrojtjes sipas interesit më të mirë ligjor të tij; i pandehuri mund të mos jetë në gjendje t'ia dalë vëllimit të madh të materialeve; çdo sanksion i vendosur për shkeljet e vendimeve gjyqësore mund të ketë pasoja të tërthorta të padëshirueshme për zhvillimin e gjykimit (Bonomy, 2007, fv. 348 – 359).

I pandehuri të drejtën e tij për mbrojtje mund ta delegojë me vullnetin e tij tek një mbrojtës profesionist, apo në rastet e mbrojtjes së detyrueshme kur nuk angazhon mbrojtës, gjykata ia cakton sipas detyrës zyrtare. I pandehuri i vet-përfaqësuar ka kredencialet me fuqi të njëjtë, ashtu sikurse i ka mbrojtësi që vepron në emër të tij. Sipas dispozitës së nenit 256 të KPP-së, në shqyrtimin e dytë, të drejtë për të paraqitur materiale për shqyrtimin kryesor në emër të të pandehurit ka vetëm mbrojtësi, ndërsa të pandehuri të vet-përfaqësuar kur mbrojtja nuk është e detyrueshme nuk i është dhënë mundësi e njëjtë. Kjo përbën cenim të parimit të *"barazisë së armëve".*

Vet-përfaqësimi i të pandehurit mund të dëmtojë parimet themelore në procedurë penale, duke pamundësuar realizimin e vet të drejtës për gjykim të drejtë. Të drejtat e garantuara të të pandehurit në procedurë penale nuk ofrojnë në vetvete garancione të caktuara, nëse të njëjtat nuk do të shfrytëzohen, apo përdoren në mënyrë të gabuar. Përderisa barazia e palëve në procedurë penale është një nga parimet themelore procedurale, i

pandehuri i gjendur përball një prokurori profesionist, nuk do të mund të shfrytëzojë në mënyrën më të mirë përparësitë dhe mundësitë procedurale të cilat i ofrohen atij si palë dhe nga kjo mund dëmtojë vet interesat e tij, apo në instancë fundit edhe interesat e drejtësisë në përgjithësi.

Në rastet kur mbrojtja nuk është e detyrueshme, e drejta jonë e procedurës penale nuk përmban ndonjë dispozitë të detyrueshme që në rastet kur i pandehuri ka vendosur të mos ketë avokat mbrojtës dhe gjatë procedurës penale nuk ndërmerr veprime aktive për të përfaqësuar vetveten, apo veprimet e ndërmarra më shumë janë në kundërshtim me interesat e tij, që gjykata me vet-iniciativë t'ia caktojë një mbrojtës. Sikurse është e përcaktuar tek rastet e mbrojtjes së detyrueshme, do të ishte e rrugës që KPP të përmbante dispozitë të posaçme që pavarësisht vullnetit të të pandehurit, edhe në rastet kur mbrojtja nuk është e detyrueshme, gjykata të ketë tagrin që pas vlerësimit të rastit, duke e bazuar gjykimin e saj çdo herë nën dritën e interesave të drejtësisë, të pandehurit t'i caktohet një mbrojtës me qëllim që ai të mos pësonte nga mungesa e përfaqësimit adekuat.

3.3. E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur me mbrojtës

Sipas nenit 30, paragr. 5 të Kushtetutës, parashihet që çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon në mes tjerash dhe të drejtën të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas. Lidhur me këtë, të dyshuarit dhe të pandehurit KPP i jep të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale (KPP, neni 53, paragr. 1). I pandehuri ka të drejtë të mbrohet personalisht në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar ose në gjithë rastet e tjera me ndihmën e mbrojtësit, sipas zgjedhjes së tij (KPP, neni 11, paragr. 2). Këto zgjidhje janë të harmonizuara me *Parimet Themelore për Rolin e Avokatëve* (1990), ku theksohet që të gjithë personat kanë të drejtë të shfrytëzojnë ndihmën e avokatit sipas përzgjedhjes së tyre për të realizuar të drejtat e tyre dhe për të mbrojtur ato në të gjitha fazat e procedurave penale

(parimi 1). Sistemi jonë juridik njeh dy lloje të mbrojtjes, mbrojtja në rastet e detyrueshme dhe mbrojtja fakultative.

Çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje (KPP, neni 11, paragr. 6). Çdo person i privuar nga liria menjëherë njoftohet në gjuhën që ai e kupton përveç arsyes së arrestit të tij, njoftohet gjithashtu dhe për të drejtën në mbrojtës sipas zgjedhjes së tij (KPP, neni 13, paragr. 1). Ndërsa, para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjetër kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë gjatë marrjes së tij në pyetje (KPP, neni 53, paragr. 2). Po qe se vetë i dyshuari apo i pandehuri në rastet kur mbrojtja është e detyrueshme nuk angazhon mbrojtës, përfaqësuesi i tij ligjor, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra dhe prindi birësues mund të angazhojnë mbrojtës për të, por jo kundër vullnetit të tij (KPP, neni 53, paragr. 8). Në rast se as edhe dikush nga personat e mësipërm nuk i angazhon të dyshuarit apo të pandehurit mbrojtës, gjykata ose një organ tjetër kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Edhe në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar, i pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike para se të merret në pyetje për herë të parë (KPP, neni 58, paragr. 2).

E drejta për të pasur avokat mbrojtës, duhet të jetë një e drejtë e pakufizuar, pavarësisht fazave të zhvillimit të procedurës penale. Në çështjen *Salduz kundër Turqisë*, GJEDNJ kishte gjetur shkelje të parimit të gjykimit të drejtë pasi që të pandehurit i ishte pamundësuar t'i sigurohej një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje nga policia dhe prokuroria. Më pas gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, atij i ishte mundësuar qasja në avokat mbrojtës dhe iu ishin ofruar gjithë garancionet procedurale, duke iu dhënë mundësi të thërras dëshmitar në emër të tij dhe për të paraqitur çështjen sipas mënyrës së tij. Gjykata në vendimin e saj, edhe pse nuk supozon se si do të kishte rrjedhë procedura penale kundër të pandehurit që nuk iu ishte ofruar avokat mbrojtës në fazën fillestare, konstaton se mossigurimi i avokatit mbrojtës kur kërkohet në cilëndo fazë të procedurës penale, përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ

(Salduz v. Turqia, GJEDNJ, 2008, paragr. 54). Deri në nxjerrën e vendimit në rastin *Salduz kundër Turqisë*, e drejta për ndihmë për avokat mbrojtës në shumicën e legjislacioneve evropiane nuk kishte rregulla dhe praktikë të unifikuar.

Në Belgjikë, legjislacioni mund siguronte ndihmë juridike vetëm pas marrjes në pyetje nga gjyqtari hetues. Të dyshuarit ishin të privuar nga çdo qasje për një avokat për të gjithë periudhën 24 orësh të marrjes në pyetje nga policia apo edhe në rastin e paraqitjes për shqyrtim nga gjyqtari hetues (Giannoulopoulos, 2016, fv. 109 - 110). Ndërsa me ndryshimet në legjislacion belg pas rastit Salduz, të dyshuarit i jepet të drejtë për t'u konsultuar në mënyrë konfidenciale me një avokat nga fillimi i marrjes në pyetje, përfshirë dhe kohën para marrjes në pyetje për herë të parë nga policia (Giannoulopoulos, 2016, f. 113).

3.4. Përshtatshmëria e mbrojtjes dhe mbrojtja efektive

Përshtatshmëria e mbrojtjes nënkuptohet kur i pandehuri ka kohë të mjaftueshme dhe lehtësi të nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe i është dhënë mundësi e barabartë për të paraqitur rastin e tij, sikurse prokurorit të shtetit si palë në procedurën penale. E drejta e të pandehurit për kohë dhe lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes është një e drejtë e garantuar që përcaktohet me instrumentet ndërkombëtare, nisur nga neni 14 § 3 (b) i PDCP-së; neni 6 § 3 (b) i KEDNJ-së dhe instrumente të tjera. Në përputhje me këto instrumente, sipas nenit 30 paragr. 3 të Kushtetutës, është përcaktuar e drejta e të pandehurit që të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, ndërsa sipas nenit 11 paragr. 1 të KPP-së, parashihet që i pandehuri ka të drejtë në kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij. Nocioni *"kohë e mjaftueshme"* për përgatitjen e mbrojtjes, është term parimisht i papërcaktuar dhe ka varësi nga rasti në rast. Sigurisht, veprat penale të cilat janë më komplekse, kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes do të ishte më e madhe se sa tek disa vepra penale më të lehta. Për këto arsye, përkufizimi i kohës së mjaftueshme është relativ dhe varet nga rasti në rast.

Një element tjetër që e përbënë përshtatshmërinë e mbrojtjes, është dhe lehtësirat e nevojshme të cilat i atribuohen mbrojtjes. Lehtësirat e përshtatshme korrelojnë me mundësinë që i pandehuri ose mbrojtësi i tij të kenë qasje në dosjen akuzuese dhe cilëndo të dhënë që përdoret në çështjen penale kundër të pandehurit. Sipas nenit 213, paragr. 1 dhe 2 të KPP-së është përcaktuar e drejta e të dyshuarit dhe të pandehurit për qasje në shkresat e lëndës në mënyrë të kufizuar, ku parashihet që gjatë veprimeve fillestare të policisë, i dyshuari duhet të ketë qasje në dëshmitë që janë duke u mbledhur me kërkesë të tij, ndërsa me fillimin e hetimit, prokurori i shtetit është i detyruar që t'i sigurojë cilitdo të pandehur apo mbrojtësve të tyre qasje në shkresat e lëndës. Ndërsa, sipas nenit 213, paragr. 3 të KPP-së, parashihet që në asnjë fazë të hetimit mbrojtjes nuk mund t'i mohohet shikimi i shkresave lidhur me procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit, shikimi i materialit të marrë nga i pandehuri apo materialit që i përket atij, shikimi i materialit lidhur me veprimet hetimore në të cilat është lejuar ose është dashur të lejohet pjesëmarrja e mbrojtësit ose shikimi i ekspertizave. Përfundimi hetimit apo ngritja e aktakuzës, përbënë një stad kur prokuroria hapet për të pasur qasje më të gjerë në dëshmi. Sipas nenit 213, paragr. 4 dhe 5 të KPP-së parashihet që pas përfundimit të hetimit, mbrojtja ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit ose të pandehurve të cekur në aktakuzë mund t'u sigurohet kopja ose kopjet e shkresave të lëndëve.

Sipas nenit 213, paragr. 6 të KPP-së, mbrojtjes i lejohet nga prokurori i shtetit që të shikojë, të kopjojë ose të fotografojë shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte të tjera materiale në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes ose të cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen nga prokurori i shtetit si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij, varësisht nga rasti. Kërkesa mund të refuzohet nëse vlerësohet se mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Për këtë në instancë të fundit mund të vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas kërkesës së mbrojtësit.

Në lidhje me qasjen në dosjen penale, KPP rezervon veçmas të drejtat të caktuara për të dyshuarin apo të pandehurin dhe veçmas për avokatin mbrojtës të të pandehurit. Sigurisht, e drejta për qasje në dosjen penale për të pandehurin nuk duhet të jetë e kufizuar pa arsye dhe

nuk duhet që në disa raste t'i rezervohet vetëm mbrojtësit të të pandehurit. Ky mohim i qasjes së të pandehurit që pavarësisht mbrojtësit të ketë qasje të pavarur në dosjen e lëndës, veçanërisht do të cenonte të drejtat e mbrojtjes të pandehurit që nuk përfaqësohet me mbrojtës, apo mbrojtja e tij nuk është efektive. Praktika e GJEDNJ-së ka lëvizur kohë pas kohë, drejt lejimit të qasjes së vet të pandehurit në dosjen penale në çështjen kundër tij. Kjo është shprehur sidomos në çështjen *Öcalan kundër Turqisë*, ku gjykata thekson se do të ketë parasysh praktikën e saj gjyqësore në atë mënyrë që sipas parimit të *"barazisë së armëve"*, si një nga karakteristikat e konceptit më të gjerë të një procesi të drejtë, secilës palë duhet t'i sigurohet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij në kushte që nuk e vënë atë në një disavantazh kundrejt kundërshtarit të tij (Öcalan v. Turqia, GJEDNJ, 2005, paragr. 140). E drejta e aksesit në dosje i takon njëkohësisht të akuzuarit dhe avokatit të tij dhe duhet të ekzistojë mundësia që kjo e drejtë të ushtrohet realisht (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 376).

Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe e drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtje efektive, pasi mbrojtja efektive është kuptimi i njëmendtë i të drejtave të dhëna në procedurë penale. Ashtu sikurse përmendet në shumë raste në praktikën e GJEDNJ-së (shih: Allenet De Ribemont v. France, 1995, paragr. 35 dhe Sejdinovič v. Italia, 2006, paragr. 94-95), e drejta për gjykim të drejtë nuk është e mjaftueshme të jetë vetëm një e drejtë teorike dhe abstrakte, por ajo duhet të jetë një e drejtë e njëmendtë, përkatësisht e drejtë konkrete dhe efektive. Lidhur me këtë, në rastin *Salduz kundër Turqisë*, GJEDNJ thekson se, edhe pse jo absolute, e drejta e çdo personi të akuzuar për një vepër penale për t'u mbrojtur në mënyrë efektive nga një avokat, përfshirë këtu edhe atë nëse është caktuar zyrtarisht, është një nga karakteristikat thelbësore të gjykimit të drejtë (Salduz v. Turqia, GJEDNJ, 2008, paragr. 51). Ndërsa, parimi 6 i Parimeve Themelore për Rolin e Avokatëve, parasheh qe avokati i angazhuar për të mbrojtur interesat e të pandehurit në procedurë penale duhet të jetë me përvojë dhe me kompetencë në përpjesëtim me natyrën e veprës penale që i vihen në barrë, me qëllim që t'i sigurojë atij ndihmë juridike efektive, pa pagesë në rast se i mungojnë mjetet materiale për të paguar për shërbimet e tilla. Meqenëse e drejta për mbrojtje efektive do të trajnohet vazhdimisht në këtë kapitull, ne nuk do të ndalemi më shumë për të trajtuar të njëjtën.

3.5. Mbrojtësi me shpenzime publike tek mbrojtja e detyruar dhe jo e detyruar

Sipas nenit 30, paragr. 5 të Kushtetutës, të akuzuarit i garantohet e drejta që të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të, atij i garanton gjithashtu nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas. Ndërsa sipas nenit 11 paragr. 3 të KPP-së, i pandehuri i cili nuk mund t'i paguajë shpenzimet e mbrojtjes dhe për këtë arsye nuk mund të angazhojë mbrojtës, me kërkesë të tij i caktohet një mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë, në përputhje me llojin e veprës penale, që paguhet nga mjetet e buxhetit kur interesat e drejtësisë këtë e kërkojnë. Kjo që përmendëm më sipër, është në harmoni me instrumentet ndërkombëtare, pasi sipas dokumentit *Parimet Themelore për Rolin e Avokatëve* (1990), theksohet që shtetet duhet të sigurojnë fonde të mjaftueshme dhe burime të tjera për shërbime juridike ndaj të varfërve (neni 3).

Sipas nenit 57 paragr. 2 dhe 3 të KPP-së, theksohet se në qoftë se i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, apo mbetet pa mbrojtës gjatë procedurës, e angazhimin nuk e bën askush në emër të tij, gjykata ose një organ tjetër kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

Sipas nenit 58 paragr. 1 (1) dhe (2) të KPP-së, parashihet mbrojtje me shpenzime publike edhe në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar. Për të përfituar nga mbrojtja e tillë, paraprakisht i pandehuri duhet të plotësojë disa kushte. E para, kërkesën për mbrojtje në rastet kur mbrojtje nuk është e detyruar duhet të vijë vetëm nga i pandehuri. Për kërkesën e tij mund të vendoset pozitivisht në rast se: (1) nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë 8 ose më shumë vjet; (2) këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t`i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.

Për mundësitë sikurse më sipër, i pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike para se të merret në pyetje për herë të parë (KPP, neni 58, paragr. 2,). Kërkesa për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, mund të bëhet gjatë gjithë

procedurës penale. Kryetari i gjykatës ose organi kompetent i cili zbaton procedurën në fazën paraprake vendos për kërkesën dhe cakton mbrojtës. Nëse policia ose prokurori i shtetit refuzon kërkesën e të pandehurit për t'i caktuar mbrojtës me shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike, i pandehuri duhet të plotësojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohet se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor (KPP, neni 58, paragr. 3 dhe 4).

Sipas nenit 8 paragr. 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-017 për mbrojtje juridike falas (2012), janë tri kritere të cilat duhet plotësuar i pandehuri që bënë kërkesë për avokat mbrojtës me fonde publike, ato janë: (1) kriteri kualifikues; (2) kriteri financiar dhe (3) kriteri juridik. Në kriterin financiar, përfshihet ndihma juridike primare dhe ndihma juridike sekondare. Ndihma juridike primare u ofrohet të gjithë personave të cilët përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose janë në situatë të ngjashme me personat që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale. Ndihma juridike sekondare u ofrohet të gjithë personave, të ardhurat e përgjithshme familjare të të cilave janë më të vogla se sa të ardhurat mesatare familjare. Sipas kriterit kualifikues, në ofrimin e ndihmës juridike falas kanë të drejtë: (1) shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët janë me vendbanim në territorin e Republikës së Kosovës; (2) të gjithë personave me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës; (3) personat e tjerë të përcaktuar me ligj, apo me rregullat e të drejtës ndërkombëtare, të cilat e obligojnë Republikën e Kosovës dhe (4) personat të cilëve ju ofrohet ndihma juridike falas në bazë të reciprocitetit (Ligji për mbrojtje juridike falas, 2012, neni 7). Kriteret kualifikuese të mësipërme në përmbajtje janë diskriminuese, ato përjashtojnë të pandehurit të cilët nuk kanë shtetësi, qëndrim të rregullt, apo shtetasit e atyre shteteve me të cilat Kosova nuk ka marrëveshje për ofrimin e ndihmës juridike. Kriteret e tilla përjashtuese të cilat bien ndesh me gjithë-përfshirjen cenojnë parimin e mos-diskriminimit dhe barazisë. Sipas nenit 24 të Kushtetutës, e drejta për barazi përmblidhet: *"Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."*

Norma kushtetuese e përcaktuar në nenin 31, paragr. 6, se: *"ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi"* (Kushtetuta e Kosovës, 2008), nuk ka si qëllim që i pandehuri me legjislacion plotësues, sikurse është Ligji për ndihmë juridike falas, pavarësisht përkatësisë apo bindjeve të tij, të përjashtohet nga përfitimi në ndihmë juridike falas. Ndihma juridike falas duhet të ketë karakter gjithëpërfshirës dhe jo diskriminues. Dispozitat që përmban ky ligj, është e ngjashme me dispozitat e Ligjit për ndihmë juridike në Belgjikë të përmendur në çështjen *Anakomba Yula kundër Belgjikës* (GJEDNJ, 2009). Lidhur me të drejtën për t'u trajtuar të barabart përball gjykatës, në çështjen *Anakomba Yula kundër Belgjikës*, GJEDNJ përcaktoi se kriteret përjashtuese përbëjnë diskriminim dhe se personit të cilat paraqiten përball gjykatës, duhet të gëzojnë të drejta të njëjta pavarësisht statusit apo dallimeve në çfarëdo elementi (shih: Anakomba Yula v. Belgjika, 2009).

Mbrojtja e ngarkuar për t'i përfaqësuar interesat e të pandehurit në procedurë penale, pavarësisht nëse është bërë me fonde publike apo me angazhimin e të pandehurit, nuk duhet të jetë formale dhe t'i mungojnë elementet e efektivitetit. Pasi, vetëm vendosja e një avokati mbrojtës sa për të përmbushur obligimin ligjor, nuk është qëllimi i normës juridike në vetvete, ajo duhet të arrijë qëllimin e njëmendtë që mbrojtja duhet të jetë efikase dhe efektive, në të kundërtën ajo nuk përfaqëson interesat e drejtësisë dhe dëmton të pandehurin në procedurë penale duke mos ushtruar të drejtat dhe privilegjet të cilat ua ofron ligji dhe Kushtetuta. Në rastin *Salduz kundër Turqisë*, GJEDNJ thekson se e drejta e çdo personi të akuzuar për një vepër penale për t'u mbrojtur në mënyrë efektive nga një avokat, përfshirë këtu edhe atë nëse është caktuar zyrtarisht, është një nga karakteristikat thelbësore të gjykimit të drejtë (Salduz v. Turqia, 2008, paragr. 51).

Ndërsa në rastin *Sejdoviç kundër Italisë*, gjykata thekson se neni 6 § 3 (c) nuk specifikon mënyrën e ushtrimit të drejtës për avokat mbrojtës. Është në duar të shteteve për zgjedhjen e mënyrës në sistemet e tyre gjyqësore, detyra e gjykatës është të konstatojë vetëm nëse mënyra që ata kanë zgjedhur është në përputhje me kërkesat e një gjykimi të drejtë. Nuk duhet harruar KEDNJ është hartuar për të *"garantuar jo të drejta që janë teorike apo iluzore, por të drejta që janë praktike dhe efektive"* dhe se dhënia e avokatit nuk siguron në vetvete efikasitetin e

ndihmës. Gjykata e kanë për obligim ndërhyrjen çdoherë kur avokati mbrojtës nuk ofron mbrojtje efektive (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 94-95).

3.6. E drejta për komunikim konfidencial ndërmjet të të pandehurit dhe mbrojtësit

I dyshuari, apo i pandehuri gëzon të drejtën të komunikojë ndërmjet vete në kushte të konfidencialitetit të plotë. Sikurse e përmendëm në rastin *Salduz kundër Turqisë*, e drejta për mbrojtje duhet të jetë efektive, që nënkupton se mbrojtjes duhet krijuar kushte të përshtatshme, përveç të ketë qasje në dosjen akuzuese, gjithashtu duhet të ketë komunikim të papenguar me klientin e tij dhe nuk do të ishte e mjaftueshme vetëm caktimi i një avokati mbrojtës si detyrim formal, por kësaj të drejte duhet krijuar mundësi që mbrojtja të jetë efektive dhe praktike. Gjithashtu edhe në instrumentin ndërkombëtar *Parimet Themelore për Rolin e Avokatëve* (1990) të nxjerrë nga OKB, parashihet se të gjithë personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të burgosur do t'u ofrohen mundësi adekuate si dhe kohë e lehtësi për vizita, komunikim dhe këshillim me avokatin, pa vonesë, pengesa apo censurë dhe në konfidencialitet të plotë. Konsultimet e tilla mund të bëhen brenda hapësirës së të pamurit, por jo edhe të të dëgjuarit, të zyrtarëve të zbatimit të ligjit (parimi 8).

Në përputhje me këtë, sipas nenit 166 paragr. 3 të KPP-së, parashihet që personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në mënyrë konfidenciale me mbrojtësin e tij gojarisht dhe me shkrim. Komunikimi ndërmjet tyre mund të vëzhgohet, por jo të dëgjohet nga zyrtari i policisë. Sipas standardeve ndërkombëtare, komunikimin ndërmjet mbrojtësit dhe të pandehurit është një nga elementet themelore të cilat materializojnë të drejtën për avokat mbrojtës. Monitorimi i bisedave ndërmjet avokatit dhe të pandehurit, pa asnjë dyshim nuk garanton komunikim në kushte normale, pasi vet interesimi i zbatuesve të ligjit për të regjistruar në çfarëdo forme komunikimin e tillë, mund të nënkuptohet se procesi nuk është fer dhe i drejtë. Nëse i pandehuri gjendet në paraburgim, ai ka të drejtë të pakufizuar dërgimin e kërkesave, ankesave ose komunikimin me mbrojtësin e tij. Kjo e drejtë është përcaktuar se nuk mund të kufizohet as edhe nga gjyqtari i procedurës paraprake, bazuar në dispozitën e nenit

200, paragr. 4 të KPP-së. Komunikimi ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit nuk mund t'i nënshtrohet restriksioneve të caktuara, për të cilat mund të vendoset gjerësisht sipas nenit 200 të KPP-së për subjektet e tjerë. I pandehuri gëzon të drejtën e vizitës nga avokati mbrojtës dhe lejohet që vizitat të mund të jenë të pakufizuara por edhe kohëzgjatja e tyre nuk duhet t'i nënshtrohet kufizimeve jo të natyrshme. Vizita e avokatit mbrojtës tek i pandehuri i paraburgosur, siguron përgatitjen e mbrojtës më të mirë për të pandehurin.

Përveç rasteve kur personi arrestohet, mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht me të pandehurin gojarisht ose me shkrim sipas kushteve që garantojnë fshehtësinë (KPP, neni 61 paragr. 2), që nënkuptohet gjatë gjithë procedurës penale garantohet një komunikimi i tillë. Komunikimi ndërmjet të pandehurit dhe avokatit mbrojtës nëse regjistrohet nga zbatuesit e ligjit është e kundërligjshme, nëse ky komunikim do të përdoret si provë kundër të pandehurit, ajo është e papranueshme. Përveç detyrimit që kanë organet shtetërore që marrin pjesë ne procedurë ndaj raportit *"i pandehur – avokat",* sipas Ligjit nr. 04/L-193 për avokati (2013) në Kosovë, theksohet se çdo avokat është i detyruar t'i përmbahet ligjit dhe së drejtës si dhe të sillet në pajtim me etikën e nderit të profesionit gjatë ushtrimit të profesionit. Gjithashtu është i detyruar të ruajë fshehtësinë profesionale kundrejt klientit të tij. Ai nuk mund të bëjë publik ose të përcjellë informata personale dhe konfidenciale të klientit të tij (nenit 11, paragr. 1 dhe 4). Sipas nenit 126, paragr. 1 dhe 2 të KPP-së, parashihet që avokati mbrojtës i cili përfaqëson interesat e të pandehurit në procedurë penale nuk mund të merret në pyetje si dëshmitar në çështjen ku akuzohet vet i pandehuri, përveç rasteve nëse vet i pandehuri kërkon një gjë të tillë. Avokati mbrojtës hyn në grupin e dëshmitarëve të privilegjuar.

4. E drejta për t'u asistuar nga një përkthyes apo interpret

4.1. Rëndësia dhe funksionet e të drejtës për t'u asistuar nga një përkthyes apo interpret

Është e drejtë themelore e pandehurit që të flet me gjuhën apo mënyrën e tij dhe njëkohësisht të njoftohet nga organet procedurale me gjuhën apo mënyrën e kuptueshme nga

ai. Kjo e drejtë e të pandehurit buron nga neni 14 § 3 (f) të PDCP-së, neni 6 § 3 (g) të KEDNJ-së dhe një mori instrumentesh tjera të rëndësishme ndërkombëtare. E drejta për të pasur përkthyes në procedurën penale në Kosovë është e garantuar me nenin 30 paragr. 4 të Kushtetutës, me nenin 14, paragr. 2 të KPP-së dhe me dispozita tjera të këtij akti. Në të gjithë instrumentet ligjore të përmendura më sipër, përcaktohet që përkthimi si një e drejtë e të pandehurit duhet të jetë pa pagesë dhe duhet të mbulojë procedurën penale si tërësi. Në tri dispozita të ndryshme të KPP-së, përkatësisht në nenin 5, paragr. 4, në nenin 10, paragr. 1, në nenin 13, paragr. 1 dhe në nenin 167, paragr. 1 dhe 3, përcaktohet e drejta e personit që privohet nga liria, që menjëherë njoftohet në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzës kundër tij në gjuhën që ai e kupton.

E drejta e të pandehurit për përkthyes apo interpret është e lidhur me të drejtën për t'u njoftuar për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, pra me të drejtën për tu mbrojtur, pasi njoftimi me akuzën dhe përmbajtjen e saj, përcakton efikasitetin e mbrojtjes përgjatë zhvillimit të procedurës penale I pandehuri që nuk flet me gjuhën apo mënyrën në të cilën zhvillohet procedura penale, sipas nenit 30 paragr. 1 të Kushtetutës duhet: *"të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij."* Njoftimi për akuzën duhet të jetë i njëmendtë dhe të arrijë qëllimin e saktë për të cilin i pandehuri duhet të dijë në lidhje me përmbajtjen e akuzës kundër tij.

Në rastet kur i pandehuri nuk flet apo nuk kupton gjuhën me të cilën gjykata zhvillon procedurën penale në çështjen kundër tij, ka të drejtë të shprehet në mënyrën apo gjuhën të cilën e flet dhe e kupton. Me qëllim të lehtësimit të komunikimit ndërmjet të pandehurit dhe organeve që marrin pjesë në procedurë penale, varësisht nga cilësitë personale të personit të pandehur, ai gëzon të drejtën për të pasur përkthyes apo interpret. Sikurse përmendet në Rregulloren nr. 16/2015 për emërimin e interpretëve dhe përkthyesve gjyqësor të nxjerrë nga KGJK (2015), me termin përkthyes duhet nënkuptuar personin e emëruar që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të përkthimit të dokumenteve të shkruara gjyqësore dhe jo-gjyqësore, ndërsa me termin interpret duhet nënkuptuar personin e emëruar që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të interpretimit (gjuhës së shenjave) në një procedurë gjyqësore.

E drejta e të pandehurit për të pasur përkthyes apo interpret në procedurë penale shfaqet si parakusht i realizimit të të drejtave tjera që gëzon i pandehuri në procedurë, pasi nëpërmes të drejtës për përkthyes apo interpret, i pandehuri realizon të drejtat tjera sikurse është: e drejta për t'u njoftuar me akuzën; e drejta për mbrojtje efektive; e drejta për barazi përpara gjykatës; e drejta për *"barazi të armëve"* dhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.

Përdorimi i gjuhës që kupton i pandehuri, plotëson kërkesën procedurale për të drejtën për barazi para gjykatës të përcaktuar me nenin 14 § 1 të PDCP-së, ku parashihet që: *"Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë."* Standardi i barazisë përpara gjykatës presupozon barazi të plotë për çdo të pandehur në procedurë penale. E drejta për barazi përpara gjykatës është e shprehur në nenin 31, paragr. 1 të Kushtetutës, ku parashihet që *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave",* me nenin 7 të Ligjit për Gjykatat në Kosovë, ku përcaktohet se: *"Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."* Në rastet kur të pandehurit nuk i ofrohet përkthyes, ai është në disavantazh me një të pandehur tjetër që flet gjuhën me të cilën gjykata zhvillon procedurën, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën për barazi përpara gjykatës.

E drejta e të pandehurit për përkthyes është e lidhur me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Pra, i pandehuri duhet të ketë mundësinë që të kundërshtojë arrestin me mjete juridike në dispozicion sipas gjuhës të cilën e kupton. Përveç kësaj, kufizimit gjuhësore nuk duhet të jenë pengesë që i pandehuri të mos ketë mundësi të dëgjohet nga gjykata, apo të mos mund t'i shfrytëzojë të drejtat e tij si i pandehur në kushte të njëjta sikurse një i pandehur tjetër që flet ndonjë nga gjuhët zyrtare që i përdorë gjykata. Mohimi i përdorimit të gjuhës së të pandehurit në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij, sipas nenit 384, paragr. 1 (3) të KPP-së, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale.

Një çështje e rëndësishme është edhe përdorimi i gjuhëve zyrtare nga ana e të pandehurve, për shkak të karakteristikave kulturore dhe politike mund të ndodh që në një vend

përdoren dy ose më shumë gjuhë si gjuhë zyrtare. Në të gjitha këto raste, është e domosdoshme ofrimi i të gjitha garancive që të mos ndjehet mungesa e përdorimit të një gjuhe të caktuar. Lidhur me këtë, edhe në Kosovë sipas nenit 5 të Kushtetutës, gjuhë zyrtare është gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Marrë parasysh statusin e barabartë kushtetues, të pandehurit që paraqiten në procedurë penale gëzojnë të drejtën për të përzgjedhur gjuhën e tyre. Sipas nenit 12, paragr. 1 të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve (2007), gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore dhe se gjykatat dhe organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale dhe në procedurat e tjera gjyqësore, sigurojnë që çdo person që merr pjesë në procedurat penale si dhe në procedura të tjera gjyqësore mund të përdorë gjuhën zyrtare të cilën ai e zgjedh. Sipas këtij ligji, gjykatat zhvillojnë procedurat në gjuhën zyrtare apo në gjuhët zyrtare të zgjedhura nga palët në procedura. Me kërkesën e palës në procedura, pajisjet duhet të sigurohen për përkthim simulant, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën (Ligjit për përdorimin e gjuhëve, neni 13, paragr. 1). Ndërsa, sipas KPP-së, parashihet që deklaratat, ankesat dhe parashtresat tjera mund të dorëzohen në gjykatë në gjuhën shqipe ose serbe (neni 14, paragr. 4).

Pra, Kushtetuta, si dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve parashohin se i pandehuri që flet ndonjë nga gjuhët zyrtare, ka të drejtë të plotë të përdorin gjuhën që përzgjedhin, duke obliguar organet gjyqësore që t'i sigurojnë atyre përkthyes të përshtatshëm në procedurë penale. Përveç kësaj, të pandehurit nuk duhet të pësojnë në asnjë rrethanë nga përdorimi i gjuhës zyrtare të përzgjedhur, qoftë në pamundësi për të mos pasur përkthim të plotë të materialeve të akuzës, apo përkthimet tjera të cilat i pandehuri i konsideron të rëndësishme për çështjen e tij. Çështja e zgjedhjes nga i pandehuri për të përdorur ndonjë nga gjuhët zyrtare, nga ndonjë nga gjuhët të cilat nuk janë të zyrtarizuara, përmban disa konsekuenca të caktuara të cilat e privilegjojnë personin që përzgjedh ndonjërën nga gjuhët zyrtare. Në këto raste, atij i përkthehen në mënyrë të plotë qoftë në formë gojore, apo në formë të shkruar, gjitha korrespodencat që ka me organet që zbatojnë procedurën penale, ndërsa përkthimet për personat që nuk flasin ndonjë nga gjuhët zyrtare përqendrohet vetëm për çështjet relevante.

4.2. E drejta për përkthyes kompetent dhe vëllimi i përkthimit apo interpretimit

E drejta e të pandehurit për të lehtësuar komunikimin me anë të përkthyesit apo interpretit nuk është e plotësuar mjaftueshëm, nëse përkthyesi apo interpreti nuk është kompetent për të ushtruar një detyrë të tillë, apo në çfarëdo mënyre tjetër i pandehuri nuk përfiton nga kjo e drejtë. Lidhur me këtë, në nenin 14, paragr. 2 të KPP-së, parashihet që përkthimi duhet të sigurohet përmes një përkthyesi të pavarur. Termi *"përkthyes i pavarur",* sigurisht do të mund të shpjegohej për kompetencën të cilin duhet të ketë përkthyesi përderisa asiston të pandehurin në procedurë penale, duke qenë i kualifikuar për të ofruar një shërbim të tillë për palët të cilët në procedurë penale kanë nevojë për lehtësimin e komunikimit, qoftë me ndihmën e përkthyesit, apo të interpretit. Përkthyesi / interpreti duhet të jetë mjaftueshëm i aftësuar që palëve t'u plotësojë kërkesat për aq sa atyre nuk u shkelet ndonjë e drejtë e garantuar procedurale. Në këtë kontekst, sipas dispozitës së nenit 215 të KPP-së, janë përcaktuar kualifikimet që duhet t'i kenë interpretët ose përkthyesit, duke kërkuar përkthyes kompetentë sipas përvojës dhe kualifikimeve relevante. KGJK-ja në vitin 2015 ka nxjerrë Rregulloren nr. 16/2015 për emërimin e interpretëve dhe përkthyesve gjyqësore. Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e emërimit, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes dhe interpret gjyqësor.

Rëndësia e të drejtës për të pasur përkthyes kompetent është e shumëfishtë. Lidhur me këtë, në çështjen *Kamasinski kundër Austrisë*, GJEDNJ thekson se duke pasur parasysh detyrimin për të zbatuar të drejtën e garantuar për përkthyes / interpret (neni 6 § 3 (e) të KEDNJ-së), kjo e drejtë duhet të jetë praktike dhe efektive dhe detyrimi i gjykatës kompetente nuk është i kufizuar vetëm në emërimin e një përkthyesi, por shtrihet në një shkallë të kontrollit të mëvonshëm mbi përshtatshmërinë e interpretimit / përkthimit të ofruar (Kamasinski v. Austria, GJEDNJ, 1989, paragr. 74). Përkthimi ose interpretimi cilësor, ndihmon që për llogari të të pandehurit t'i përcjelljen deri tek gjykata të gjithë qëndrimet apo bindjet që ka i pandehuri në raport me akuzën dhe qëndrimet e tij në çështjen penale dhe anasjelltas. Gabimet të cilat mund t'i bëjë interpreti ose përkthyesi, e të tillat mund të jenë edhe të qëllimshme, lëshime të

paqëllimshme nga pakujdesia apo lajthitja, por edhe nga mungesa e përgatitjes dhe përvojës profesionale të mjaftueshme, janë çështje të cilat arsyetojnë atë që jemi duke diskutuar. Për këto qëllime, interpreti ose përkthyesi duhet të jetë kompetent për të ushtruar këto detyra, pasi ai ndihmon realizimin e komunikimit ndërmjet subjekteve në procedurë penale. Përkthyesi ose interpreti duhet paralajmëruar se deklarimi i rremë i tyre, përbënë vepër penale sipas nenit 392, paragr. 1 të Kodit Penal (2013).

Një çështje tjetër me rëndësi është edhe vëllimi i interpretimit apo përkthimit që ofron gjykata. Për të krahasuar standardet ndërkombëtare me ato të vendit tonë po përmendim çështjen *Kamasinski kundër Austrisë*, ku GJEDNJ thekson se duke pasur parasysh detyrimin për të zbatuar të drejtën e garantuar për përkthyes / interpret (neni 6 § 3 (e) të KEDNJ-së), gjykata nuk shkon aq larg sa të kërkojë përkthim me shkrim të të gjitha provave ose dokumentet zyrtare në procedurë. Ndihma për interpretimin e ofruar duhet të jetë e tillë që të mundësojë që i pandehuri të ketë njohuri të çështjes kundër tij dhe të mbrojë veten, veçanërisht duke qenë në gjendje t'i paraqesë gjykatës versionin e tij të ngjarjeve (Kamasinski v. Austria, GJEDNJ, 1989, paragr. 74). Asistenca për përkthim dhe interpretim pa pagesë shtrihet në të gjithë aktet procedurale që i pandehuri duhet t'i kuptojë në mënyrë që të mbrohet në mënyrë korrekte. Si rrjedhim, përkthimi nuk lidhet me përkthimin e tërësisë së dosjes së shkruar (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 390)

Nëse e analizojmë në këtë kontekst edhe vëllimin e të drejtës për përkthim dhe interpretim nga gjykata në vendin tonë, sipas nenit 14, paragr. 2 të KPP-së parashihet që personi që merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Në këtë dispozitë nuk përmendet vëllimi në të cilën i pandehuri përfiton nga e drejta për përkthim falas. Varësisht nga kompleksiteti i çështjes penale që gjykohet, mund të kërkohet angazhim më i madh për të asistuar gjuhësisht me përkthim apo me interpretim për të pandehurin, gjë që kërkohet asistim gojor gjatë marrjes në pyetje apo gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Përveç kësaj, dosja e akuzës dhe dokumentet tjera që përbëjnë dosjen e çështjes penale mund të jetë voluminoze, gjë që kërkon angazhim dhe shpenzime shtesë për përkthyes ose interpret. KPP nuk ofron ndonjë zgjidhje për këto

çështje, përjashtimisht përmbajtjes së nenit 73, paragr. 4, ku parasheh që gjatë intervistës në veprimet fillestare të policisë, përcaktohet që i dyshuari duhet të ketë të drejtën për një përkthyes gojor ose përkthimin e dokumenteve relevante pa pagesë. Në këtë rast kërkohet vetëm përkthimi *"dokumenteve relevante"* dhe jo gjithë dokumentet të cilat mund t'i përmbajë dosja, dukë nënkuptuar se dëgjimi verbal mundësohet si i tërë, ndërsa pjesa e dokumenteve me shkrim përkthehet në pjesët ku vlerësohet me relevancë të posaçme. Zgjidhjet të cilat i përmendëm që ekzistojnë në KPP, janë në harmoni me praktikën e GJEDNJ për këtë çështje.

Sipas nenit 14 paragr. 6 të KPP-së, parashihet që shtetasi i huaj që ndodhet në paraburgim mund t'i dorëzojë gjykatës parashtresat në gjuhën e tij para, gjatë dhe pas shqyrtimit gjyqësor vetëm sipas kushteve të reciprocitetit. Kjo dispozitë është në kundërshtim me të drejtën për barazi që kërkohet nga neni 31, paragr. 1 të Kushtetutës dhe nenin 7 të Ligjit për Gjykatat. Kushtëzimi i të drejtës për përkthyes falas me reciprocitet ndërshtetëror, shkelë të drejtën për barazi të përcaktuar me aktet ligjore në fuqi, pasi e drejta e të pandehurit për t'u dëgjuar nga gjykata nuk duhet të jetë objekt i kushtëzimeve të çfarëdollojta. Neni 14, paragr. 5 i KPP-së, është gjithashtu në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit për gjuhët në Kosovë. Ky ligj përcakton se çdo person që merr pjesë në procedura penale, i cili nuk flet ose nuk kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtë të paraqesë shkresat, të dëshmojë dhe të dëgjojë faktet e rastit dhe të çdo dëshmie kundër tij apo saj, në gjuhën e folur nga ai apo ajo. Gjykatat apo organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurën penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për këta persona.

5. E drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim

5.1. Kuptimi dhe funksionet e të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim

E drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim, është një nga të drejtat themelore në procedurën penale. I pandehuri, gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale ka të drejtë të jetë i pranishëm në gjykim, duke u paraqitur pranë gjykatës ku trajtohet çështja e tij. E

drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim, buron nga parimi i *"barazisë së armëve"* dhe është pjesë përbërëse e të drejtës për t'u mbrojtur vet ose me avokat mbrojtës. Prezenca e të pandehurit në gjykim dallon varësisht nga sistemet juridike, pasi disa sisteme juridike prezencën e të pandehurit në gjykim e shohin në kontekstin e *"të drejtës"* së të pandehurit që të paraqitet në gjykatë dhe jo si një detyrim, ku të njëjtin sistem e ka përvetësuar Republika e Shqipërisë, ndërsa sistemet tjera juridike, praninë e të pandehurit në gjykim e shohin si të drejtë dhe njëkohësisht edhe si kusht të domosdoshëm për t'u zhvilluar procedura penale. Kosova bënë pjesë në sistemet juridike që praninë e të pandehurit në procedurë penale e sheh si kusht të domosdoshëm për t'u zhvilluar gjykimi. Prezenca e të akuzuarit në procedurë penale përfshin një mori përparësish për të pandehurin dhe kjo nënkupton se i pandehuri është i njoftuar me akuzën kundër tij dhe do të njoftohet me të drejtat që mund t'i gëzojë në procedurë penale. E drejta për të kuptuar natyrën e akuzës kundër tij dhe e drejta për t'u ballafaquar me palën kundërshtare varen nga prania e tij në gjykim.

Sipas nenit 14 § 3 (d) të PDCP-së, përcaktohet prania e të akuzuarit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Prania e të pandehurit në procedurë, përbën një nga elementet e parimit të gjykimit të drejtë dhe është i pranuar gjerësisht në Statutet e gjykatave penale ndërkombëtare, përfshirë këtu Gjykatën Penale për krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe Ruandë dhe Gjykatën e Përhershme Penale Ndërkombëtare. Për dallim nga PDCP, dispozitat e KEDNJ-së nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të veçantë që përcakton praninë obliguese të të pandehurit në procedurë penale si kusht për t'u zhvilluar procesi gjyqësor. Përkundër pjesës normative, GJEDNJ konsideron se qëllimi i nenit 6 të Konventës nënkupton dhe praninë fizike të të pandehurit. Prania e të pandehurit ka rëndësi të madhe për procesin penal të rregullt, ligjor dhe të drejtë. Detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykatë, është një prej elementeve kryesore të nenit 6. Është e vërtet se një mbrojtje e mirë supozon jo vetëm praninë e avokatit siç parashikohet në Konventë, por dhe praninë fizikë të të akuzuarit (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 370).

Në praktikën e GJEDNJ-së, e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim është trajtuar në shumë raste. Në rastin *Sejdovic kundër Italisë*, GJEDNJ thekson se edhe pse kjo e drejtë nuk është theksuar shprehimisht në nenin 6 § 1 të KEDNJ-së, objekti dhe qëllimi i nenit të

marrë si tërësi tregojnë se një person *"i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të marrë pjesë në seancë."* Për më tepër, dispozitat e nenit 6 § 3 (c), (d) dhe (e) i garantojnë të akuzuarit të drejtën që: (c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; (d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; (e) të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq; dhe është e vështirë të parashihet se si i pandehuri mund t'i ushtrojë këto të drejta pa qenë i pranishëm (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 81).

5.2. Gjykimi në mungesë të të pandehurit

Gjykimet në mungesë janë procese gjyqësore të cilat zhvillohen pa praninë e të pandehurit edhe përkundër përpjekjeve të autoriteteve për të siguruar praninë e tij në procedurë penale. Edhe përkundër rëndësisë që ka vet prania e të pandehurit në procedurë penale, mungesa e tij sipas disa sistemeve juridike nuk përbën pengesë që të zhvillohet procesi gjyqësor. GJEDNJ njeh të drejtën që procedura penale të zhvillohet edhe në mungesë të akuzuarit me kusht që përpara procesit gjyqësor të bëhen përpjekje të cilat do të mund të vejnë në dijeni vet të akuzuarin për natyrën e akuzës që është ngritur kundër tij, duke tentuar që gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale të sigurohet prania e tij fizike në proces gjyqësor. Sistemet juridike shtetërore nuk janë unike për nga rregullimet të cilat i kanë dhënë pranisë fizikë të të pandehurit në procedurë penale, por edhe vet instrumentet ndërkombëtare nuk flasin në të njëjtën gjuhë, gjë që janë përcaktuar zgjidhje të ndryshme për këtë.

Në rastin *Sejdovič kundër Italisë*, GJEDNJ ka trajtuar rastin e gjykimit në mungesë, duke vendosur një praktikë të veçantë dhe për gjykimet në mungesë. Nga vlerësimi i gjykatës dalin katër parime të përgjithshme lidhur me gjykimin në mungesë, përkatësisht:

a) e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të pasur një gjykim të ri;

b) heqja dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim;

c) e drejta e personit për t'u informuar në lidhje me akuzat kundër tij dhe

d) përfaqësimi ligjor i të akuzuarit të gjykuar në mungesë (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 83).

Edhe pse procedurat që zhvillohen në mungesën e të akuzuarit nuk janë në vetvete në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së, mohimi i drejtësisë megjithatë padyshim ndodh kur personi i dënuar në mungesë nuk mund të dëgjohet nga gjykata. Në shtetet të cilat gjykimi mund të zhvillohet në mungesë, Konventa i lë shtetet kontraktuese një diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjeteve të llogaritura për të siguruar që sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6. Në mënyrë të veçantë, mjetet procedurale të ofruara nga ligji dhe praktika e brendshme duhet të tregohen efektive, kur personi i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për të mbrojtur veten e as nuk ka kërkuar të largohet nga gjykata (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 83).

Përderisa trajtohet parimi i heqjes dorë nga e drejta e paraqitjes në gjykim, gjykata thekson se as letra dhe as shpirti i nenit 6 të KEDNJ-së nuk e pengojnë një person të heqë dorë nga vullneti i tij i lirë, qoftë shprehimisht apo heshtur, të drejtën për garancitë e një gjykimi të drejtë (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 86).

GJEDNJ thekson të drejtën e personit të akuzuar për vepër penale që të informohet për akuzat kundër tij, si një nga parimet e përgjithshme që duhet përcjellë gjykimet në mungesë. Sipas kritereve të përcaktuara në nenin 6 § 3 (a) të KEDNJ-së, të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale kanë të drejtë *"të njoftohen menjëherë në një gjuhë që kupton dhe në detaje për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij."* Kjo dispozitë tregon nevojën për vëmendje të veçantë që duhet t'i kushtohet njoftimit me *"akuzën".* Një aktakuzë luan një rol vendimtar në procesin penal, pasi që nga momenti i njoftimit, i pandehuri formalisht vihet në dijeni për bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 89).

Ndërsa, për përfaqësimin me avokat të të pandehurve në gjykimet në mungesë, gjykata thekson se edhe pse jo absolute, e drejta e të gjithë atyre që akuzohen për një vepër penale për t'u mbrojtur në mënyrë efektive nga një avokat, i caktuar zyrtarisht nëse është nevoja, është një nga karakteristikat themelore të një procesi të drejtë. Personi i akuzuar për një vepër penale

nuk humb përfitimin e kësaj të drejte vetëm për shkak të mosardhjes në gjykim. Është e një rëndësie vendimtare për drejtësinë e sistemit të drejtësisë penale që të akuzuarit të mbrohen në mënyrë adekuate, si në shkallë të parë ashtu edhe në apel (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 92). Është e nevojshme që gjykatat të sigurojnë se gjykimi ishte i drejtë dhe, rrjedhimisht, avokati që merr pjesë në gjykim për qëllimin e dukshëm të mbrojtjes së të akuzuarit në mungesë të tij i jepet mundësia për ta bërë këtë (Sejdinovič v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 83).

Standardet të cilat janë vendosur nga gjyqësore e GJEDNJ-së, u është vënë përgjegjësi shteteve palë të Konventës që t'i respektojnë këto kritere dhe nën dritën e kësaj praktike obliguese të vendosin dhe rastet e njëjta dhe të ngjashme. Përkundër mundësisë që gjykimet të zhvillohen në mungesë, ato asnjëherë nuk guxojnë të cenojnë parimet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, pasi është detyrë e shteteve që vazhdimisht të kujdesen për respektimin e këtij parimi të rëndësishëm juridik, duke bërë që pavarësisht mungesës së të pandehurit në procedurë penale, procesi i tij të zhvillohet drejtë dhe ndershëm.

Shqipëria është një nga vendet e pakta evropiane që mund të zhvillojë gjykime në mungesë të të pandehurit. Sipas nenit 351, paragr. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995), në rastet kur i pandehuri i lirë ose i paraburgosur nuk paraqitet në seancë ndonëse është njoftuar dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për t'u mos u paraqitur, gjykata, pasi dëgjon palët, deklaron mungesën e tij. Në këtë rast ai përfaqësohet nga mbrojtësi. Sipas nenit 352, paragr. 1 dhe 2 parashihet që në rastet kur i pandehuri kërkon ose jep pëlqimin që shqyrtimi gjyqësor të bëhet në mungesë të tij, ose duke qenë i burgosur, refuzon të marrë pjesë, përfaqësohet nga mbrojtësi. Në rastin kur i pandehuri, i cili pasi është paraqitur, largohet vetë nga salla, konsiderohet i pranishëm, me kusht që të përfaqësohet nga mbrojtësi (Ligji nr. 7905, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 1995). Sipas nenit 352, paragr. 4, njihet dhe gjykimi në mungesë ku parashihet se *"Gjykimi në mungesë mund të bëhet edhe kur provohet që i pandehuri fshihet"* (Ligji nr. 7905, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 1995). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) nuk përmban rregulla që ndalojnë gjykimet në mungesë të të pandehurit. Me zgjidhjet ekzistuese në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i është dhënë përparësi

efikasitetit të procedurës, duke krijuar hapësirë që proceset gjyqësore ndaj të pandehurve që nuk paraqiten në procese gjyqësore të zhvillohet pa pengesa. Rregullat procedurale të tilla në praktikën juridike shqiptare shpeshherë janë bërë objekt i trajtimit gjyqësor nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, qoftë në rrafshin e kontrollit të respektimit të rregullave gjatë procedurës përkatëse, apo përputhshmërinë e vet rregullave procedurale me Kushtetutë, KEDNJ dhe praktikën e GJEDNJ-së.

5.3. Prania e të pandehurit në procedurën penale

Sipas dispozitave të KPP-së prania e të pandehurit në procedurë penale paraqitet si kusht për t'u zhvilluar procesi gjyqësor, pra nuk mund të fillojë gjykimi nëse nuk sigurohet prania fizike e të pandehurit në vendin ku do të mbahet gjykimi. Deri në ngritjen e aktakuzën, përkatësisht deri në fillimin e shqyrtimit fillestar, edhe pse është e nevojshme prania e të pandehurit dhe sidomos gjatë fazës së hetimeve, KPP nuk ka vënë pengesa që hetimet të mos vazhdohen pa praninë e të pandehurit. Pra, hetimet zhvillohen pa praninë e të pandehurit dhe në momentin që krijohen kushte që të sigurohet prania e tij, qoftë paraqitja vullnetare apo me masa shtrënguese, atëherë procedurat përkatëse vazhdohen me praninë e tij edhe gjatë fazës së procedurës paraprake.

Lidhur me praninë fizike të të pandehurit në procedurë penale ekzistojnë dispozita të shumta. Secila përmban rregulla të ndryshme të cilat kërkojnë zbatim konkret sipas situatave. Nëse i referohemi dispozitës së nenit nenit 173, paragr. 1 të KPP-së, mund të shohim se aty parasheh nëntë masa për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë penale, përkatësisht në procedurën paraprake. Duhet thënë se përveç për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë penale, këto masa mund të përdoren dhe për pengimin e ri-kryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Nëse përmbushen kushtet ligjore, i pandehuri edhe gjatë fazës së hetimeve mund të arrestohet dhe i njëjti gëzon të drejtat e të pandehurit, por masat më të rënda çdo herë caktohen sipas kritereve të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

Sikurse edhe e kemi theksuar rolin e gjyqtarit të procedurës paraprake, i njëjti edhe gjatë caktimit të masave në procedurë paraprake është gjyqtari kompetent, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari kompetent është gjyqtari që gjykon çështjen. Sipas nenit 245, paragr. 1 të KPP-së, përcaktohet se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit. Gjithashtu në shqyrtimin e dytë, parimisht marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit. Lidhur me këtë rregull, sipas nenit 254 paragr. 1 të KPP-së mund të ketë përjashtim, nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar për shqyrtimin e dytë. Ndërsa, sipas nenit 285, paragr. 4 të KPP-së, parashihet që nëse i pandehuri nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin fillestar apo në shqyrtimin e dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të nxjerr aktvendim për pezullimin e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së të pandehurit. Shqyrtimi gjyqësor rifillon kur arrestohet i pandehuri.

Në shqyrtim gjyqësor thirret inter alia edhe i akuzuari. Të akuzuarit i dërgohet thirrja në mënyrë të rregullt dhe i jepet në afat tetë ditë para shqyrtimit gjyqësor me qëllim që të ketë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes. Gjyqtari pasi hap seancën, sipas KPP-së duhet të shikojë a janë prezent personat pa të cilët nuk mund të zhvillohet gjykimi, nëse jo duhet shikuar a i janë dorëzuar ftesat në mënyrë të rregullt. Në rastet kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe mungesën nuk e arsyeton, gjyqtari kompetent lëshon urdhër-arrest për të. Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor (KPP, neni 307, paragr. 2). Përderisa nuk sigurohet prania e të pandehurit në shqyrtim gjyqësor, seancat e shqyrtimit gjyqësor nuk mbahen.

KPP orientimin përcaktues e ka në sigurimin e pranisë së të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor. Sikurse mund ta shohim tek rregullat procedurale që lidhen me praninë e të pandehurit në shqyrtimin e parë dhe shqyrtimin e dytë, por edhe në seancën dhe shqyrtimin e apelit, KPP nuk është e vendosur që prania e të pandehurit duhet të jetë e domosdoshme dhe kusht për tu zhvilluar procedura penale, por këtë dimension e sheh si të mirëseardhur, gjë që

mos pjesëmarrja e të pandehurit, nuk bënë pjesë në shkeljen e rregullave imperative në procedurë penale. Ndërsa, qasje ndryshon sa i përket pranisë së të pandehurit në shqyrtim gjyqësor, ku KPP është këmbëngulëse që prania medoemos duhet të sigurohet dhe se fillimi ose vazhdimi i gjykimi kushtëzohet me praninë e të pandehurit në këtë stad të procedurës penale. Lidhur me këtë, KPP e konsideron shkelje esenciale të dispozitave procedurës penale zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor pa praninë e të pandehurit.

E drejta jonë e procedurës penale ka përqafuar zgjidhjen që është në përputhshmëri me PDCP dhe nuk është përpjekur t'i përafrojë zgjidhjet me praktikat e vendosura nga GJEDNJ. Megjithatë, zgjidhja e tanishme nuk do të thotë se nuk e pengon efikasitetin e procedurës penale dhe për krimet të cilat janë kryer, për shkak të pamundësisë fizike që të pandehurit të jenë prezentë në gjykatore, ndaj tyre nuk mund të zhvillohet gjykimi. Të tilla krime janë edhe ato të cilat janë bërë gjatë kohës së luftës në Kosovë, ku si pasojë e shkeljes së rregullave të së drejtës humanitare ushtria dhe policia serbe ka shkaktuar mijëra viktima. Nga gjykimi objektiv nuk mund të shprehemi se ka pasur krime vetëm nga njëra anë, por duhet të themi hapur se ndaj personave shqiptarë që ka pasur dyshime se kanë qenë të përfshirë në krime të luftës, shumica absolute iu kanë nënshtruar procedurave gjyqësore të zhvilluara nga administrata ndërkombëtare e UNMIK, EULEX apo dhe TPNJ. Por e njëjta gjë nuk ka ndodhur edhe për palën e kundërt, gjë që drejtësia e cila nuk mund të vihet për krimet e kryera të luftës, dëmton arritjen e paqes, viktimat dhe drejtësinë restorative në përgjithësi. Edhe pse kanë qenë parasysh rrethanat e tilla që po i përmendim, kjo zgjidhje ka qenë e diskutueshme që nga paslufta në të gjithë rregullat e të drejtës së procedurës penale. Sigurisht e njëjta është ndikuar nga faktori ndërkombëtar që ka insistuar që e njëjta të mbetet si pjesë e përmbajtjes e rregullave të së drejtës së procedurës penale.

5.4. Nxjerrja e të pandehurit nga seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe zhvillimi i procedurës penale pa praninë e tij

Në disa raste prania e të pandehurit në procedurë penale mund të jetë fakultative. KPP ka dhënë zgjidhje që mund të përjashtojnë detyrimin e gjykatës që gjatë gjithë zhvillimit të

procesit gjyqësor patjetër të sigurojnë që i pandehuri duhet të jetë fizikisht në sallën ku zhvillohet procedura penale. Prishja e rendit dhe mosbindja ndaj urdhrave të gjykatës, mund të jetë shkak që i pandehuri përkohësisht të largohet nga gjykatorja ku zhvillohet procesi. KPP (neni 302) ka adresuar rastet kur i akuzuari që merr pjesë në shqyrtim gjyqësor prish rendin ose nuk u bindet urdhrave të gjyqtarit për mbajtjen e rendit, atij i tërhiqet vërejtje dhe nëse vërejtja e dhënë është e pasuksesshme, gjyqtari mund të urdhërojë që i akuzuari të nxirret jashtë gjykatores.

Lidhur me këtë urdhër të gjyqtarit, sipas KPP (neni 302) i akuzuari mund të nxirret përkohësisht nga gjykatorja, por nëse ai është marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, atëherë mund të nxirret gjatë tërë kohës së shqyrtimit të provave. Para përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari thërret të akuzuarin dhe e njofton për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, e nëse ai vazhdon të prishë rendin, i njëjti përsëri mund të nxjerrët nga seanca. Në këtë rast, seanca përfundon pa praninë e të akuzuarit, kurse aktgjykimin ia komunikon gjyqtari në praninë e procesmbajtësit.

Është me rëndësi të thuhet se masat e mësipërme janë masa disiplinore. Qëllimi i tyre është vetëm të sigurohet funksionimi dhe puna normale e trupit gjykues dhe në përgjithësi të ruhet dinjiteti i gjykatës dhe respekti ndaj vet procesit gjyqësor. Kjo nuk përbën elemente të cilat cenojnë të drejtën për gjykim të drejtë. Para së gjithash, i pandehuri duhet t'i bindet rregullave procedurale të cilat janë të zbatueshme në gjykatore dhe duhet të sillet me dinjitet me secilin pjesëmarrës në gjykatë dhe të mbaje disiplinë gjatë pranisë së tij në gjykatore. Masat e tilla shqiptohet për aq sa është e nevojshme dhe e domosdoshme për t'u siguruar rendi dhe funksionimi normal i gjykatës. Si rregull, kur i akuzuari që merr pjesë në shqyrtim gjyqësor prish rendin ose nuk u bindet urdhrave të gjyqtarit për mbajtjen e rendit, sipas parimit të proporcionalitetit si masë më të vogël shqiptohet vërejtje, e nëse vërejtje më nuk është proporcionale dhe është e pasuksesshme, masa e nxjerrjes jashtë gjykatores për të akuzuarin bëhet duke vepruar sipas kriterit të nevojës së domosdoshme.

Kufizimet e të drejtës për të marrë pjesë në gjykim publik sikurse i trajtuam më sipër, duhet parë nën dritën e rregullave kushtetuese. Kushtetuta lejon devijimin e disa nga të drejtave, përkatësisht kufizimin e tyre, por njëkohësisht përcakton disa kritere themelore që

duhet ndjekur gjatë kufizimit të këtyre të drejtave. Ky akt kërkon nga organet ligj-zbatuese që në të gjitha rastet kur kufizohet ndonjë e drejtë, duhet pasur në konsideratë esencën dhe se qëllimi për këtë kufizim duhet të jetë legjitim, nën kushtet e domosdoshmërisë, ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

Prania e të pandehurit në procedurë penale mund të jetë jo e domosdoshme me rastin e shqiptimit të urdhrit ndëshkimor. Lidhur me këtë, KPP rregullon institutin procedural të urdhrit ndëshkimor, me të cilin është hapur mundësia e përfundimit të çështjes penale me vendim gjyqësor pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe pa i vënë në pikëpyetje të drejtat e të pandehurit. Qëllimi i zgjidhjes së tillë ligjore është përshpejtimi i zgjidhjes së çështjes penale e cila është objekt gjykimi në procedurë gjyqësore. Në procedurë për dhënien e urdhrit ndëshkimor nuk mund të shqiptohet dënimi me burgim (Sahiti & Murati, 2016, f. 467).

5.6. Prania e të pandehurit në seancën e kolegjit të apelit

Lidhur me praninë e të pandehurit në seancën e kolegjit të apelit, sipas KPP-së ekzistojnë zgjidhje fleksibile. Edhe pse KPP ka përqafuar konceptin e pranisë së domosdoshme të të pandehurit përgjatë zhvillimit të procedurës penale, sipas disa zgjidhjeve që mund t'i shohim në KPP, prania e të pandehurit në të gjithë stadet e procedurës penale nuk është e domosdoshme. Sipas KPP-së (neni 390, paragr. 1 dhe 2) në rastet kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e kolegjit të apelit i dërgohet prokurorit kompetent të shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, ndërsa nëse i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të merr pjesë në seancë, pjesëmarrja i mundësohet atij. Ndërsa sipas nenit 390, paragr. 3 dhe 4 të KPP-së, seanca e kolegjit fillon me raportim të gjyqtarit raportues mbi faktet. Kolegji mund të kërkojë nga palët dhe mbrojtësi që prezantojnë në seancë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë. Palët dhe mbrojtësi mund të propozojnë që për plotësim të raportit të lexohet ndonjë shkresë dhe mund të japin shpjegime të nevojshme për qëndrimet e tyre në ankesë apo përgjigje në ankesë, pa përsëritur përmbajtjen e raportit. Mosardhja e palëve të njoftuara me

rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit.

Mundësia që jep KPP që palët të mos jenë të pranishëm në seancën e kolegjit, pa hequr dorë shprehimisht apo duke paraqitur rrethana tjera të arsyeshme për mungesën e tyre, mund të shkelë parimin e *"barazisë së armëve"*. Të drejtat e garantuara me KPP duhet të jenë efektive dhe praktike, ato asnjëherë nuk duhet t'u japin mundësi të cilat cenojnë vet ndershmërinë e procesit gjyqësor dhe autoritetin e gjykatës. Prania e palëve në seancën e kolegjit të apelit dhe sidomos prania e të pandehurit duhet të jetë e domosdoshme. Edhe pse niveli i kontradiktoriteti nuk është sikurse gjatë shqyrtimit gjyqësor, atëherë kur i pandehuri personalisht, apo me anë të avokatit mbrojtës mund të sfidojë dëshmitë e paraqitura nga pala e akuzës, në këtë fazë i pandehuri duhet patjetër të merr pjesë. Duhet ditur se prania e të pandehurit në seancën para kolegjit të apelit nuk është më pak e rëndësishme se sa prania në cilëndo fazë tjetër të procedurës penale. Është e drejtë themelore e të akuzuarit që të dëgjohet nga gjykata, dëgjim që nuk mund të jetë vetëm me shkrim, apo me anë të avokatit mbrojtës, por edhe me paraqitje verbale gjatë gjithë prezencës fizike të tij.

KPP nuk përmban asnjë dispozitë që mundëson që i pandehuri të heq dorë nga prania e tij në në seancën para kolegjit të apelit, gjë duhet të jetë obliguese jo vetëm për të pandehurin, që gjendet në paraburgim apo vuajtje të dënimit, por edhe në rastet nëse i pandehuri ka ndonjë masë tjetër përveç masës së paraburgimit, nuk ka masë siguruese apo edhe është në arrati.

Përveç seancës së kolegjit, KPP përcakton se mund të mbahet shqyrtimi në gjykatën e apelit. Sipas nenit 392 të KPP-së, shqyrtimi para Gjykatës së Apelit mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëritën provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës themelore në rigjykim. Në shqyrtim të Gjykatës së Apelit thirren i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit, si dhe dëshmitarët dhe ekspertët të cilët gjykata me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare vendos t'i pyesë. Në qoftë se i akuzuari

gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Apelit ndërmerr masa të nevojshme për të siguruar praninë e të akuzuarit në shqyrtim.

KPP edhe pse parasheh kontradiktoritetin në seancën para kolegjit të apelit dhe shqyrtimi para kolegjit të apelit, në këtë pjesë hesht dhe në mënyrë shprehimore nuk kërkon praninë fizike të të pandehurit si kusht për t'u zhvilluar seanca para kolegjit të apelit dhe shqyrtimi para kolegjit të apelit. Dispozitat të cilat i përmban KPP, nuk janë në tërësi me vet frymën dhe germën e tij si akt, pasi vet KPP, ka si qëllim themelor normativ që të sigurohet prania e të pandehurit gjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale, duke mos bërë asnjë përjashtim. Duke i dhënë mundësinë që palët të shprehin qëndrimet e tyre për ankesën e palës kundërshtare dhe në të njëjtën kohë duke mos kushtëzuar praninë e palëve në këtë fazë të procedurës, vet normat e tilla si rregulla mund të shihen si abstrakte dhe asnjëherë si norma konkrete, të zbatueshme dhe praktike.

Për të elaboruar çështjen që trajtuam më sipër, në rastin *Hermi kundër Italisë*, GJEDNJ për të drejtën e të pandehurit për të qenë i pranishëm në apel, thekson se megjithëse nuk është përmendur shprehimisht kjo e drejtë në nenin 6 § 1 të Konventë, objekti dhe qëllimi i këtij neni të marrë si tërësi tregojnë se një person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të marrë pjesë në seancë. Për më tepër, neni 6 § 3 (c), (d) dhe (e) i KEDNJ-së, garantojnë një mori të drejtash, sikurse është: e drejta për t'u mbrojtur vet apo me mbrojtës; e drejta për t'i pyetur dëshmitarët e akuzës; e drejta për të pasur përkthyes; dhe është e vështirë të thuhet se si ai mund t'i ushtrojë këto të drejta pa qenë i pranishëm. Në rastin e njëjtë, gjykata thekson se përderisa palët janë ankuar për faktet, është detyrë e gjykatës që palët patjetër të thonë fjalën e tyre me rastin e mbajtjes së seancës së apelit. Ndërsa, ankesa që kërkon ekzaminimin e aktgjykimit vetëm në pjesën e zbatimit të ligjit, nuk kërkohet domosdoshmërisht prania e palëve në seancën e apelit, edhe pse prania e palëve është e dobishme për vet ndershmërinë e procedurës dhe respektin ndaj gjykatës (Hermi v. Italia, GJEDNJ, 2006, paragr. 59-61). Edhe pse vendimi i sipër trajtuar shprehimisht nuk e detyron asnjë shtet që të vendos si kusht të domosdoshëm praninë e të pandehurit në seancën dhe shqyrtimin para kolegjit të apelit, po shpreh konsideratën se prania e të pandehurit në këtë stad të procedurës penale, mundëson shfrytëzimin e të drejtave të dhëna për të pandehurin në procedurë penale, duke plotësuar

parimet fundamentale të së drejtës së procedurës penale, sikurse është parimi i *"barazisë së armëve"* dhe parimi i kontradiktoritetit, e veçanërisht kur kontestimet ankimore lidhen me gjendjen faktike.

KAPITULLI VIII

PREZUMIMI I PAFAJËSISË, *"BARAZIA E ARMËVE"* DHE E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE

1. E drejta për prezumim të pafajësisë

1.1. Kuptimi dhe funksionet e të drejtës për prezumim të pafajësisë

Prezumimi i pafajësisë nënkuptohet si parim që çdo person i dyshuar dhe i akuzuar për vepër penale, duhet të trajtohet i pafajshëm përderisa të vendoset për fajësinë e tij me aktgjykim të formës së prerë. Ky parim duke u ngritur në parim juridik procedural në shumicën e akteve procedurale të brendshme dhe atyre ndërkombëtare, është njëri ndër elementet themelore që përbën të drejtën për gjykim të drejtë. Lidhur me këtë, sipas nenit 6 § 2 të KEDNJ parashihet e drejta që i pandehuri të prezumohet i pafajshëm në të gjithë stadet e procedurës penale, derisa vendoset për çështjen e tij me aktgjykim të formës së prerë. Në çështjen *Telfner kundër Austrisë*, GJEDNJ jep disa shpjegime të rëndësishme për prezumimin e pafajësisë, ku ndër të tjera kërkon që anëtarët e gjykatës gjatë kryerjes së detyrave, nuk duhet të fillojnë me idenë e paragjykuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Gjykata bënë të qartë se barra e të provuarit i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të akuzuarit (Telfner v. Austria, GJEDNJ, 2001, paragr. 15). Ndërsa, në çështjen *Funke kundër Francës*, kjo gjykatë thekson se ka pasur shkelje të së drejtës për tu prezumuar i pafajshëm pasi autoritetet franceze kanë detyruar individin të zbulojë dokumente të caktuara në kundërshtim me vullnetin e tij. Në këtë rast, gjykata thekson se e drejta për të heshtur dhe e drejta për tu mos u vet-inkriminuar, është pjesë e rëndësishme e të drejtës për tu prezumuar i pafajshëm (Funke v. Franca, GJEDNJ, 1993, paragr. 44). Nga praktika e GJEDNJ-së mund të nxjerrim katër elemente të rëndësishme që e përbëjnë të drejtën për tu prezumuar i pafajshëm:

a) *"barra e provës"* bie mbi prokurorin e shtetit dhe se i pandehuri është i liruar nga obligimi për të dëshmuar pafajësinë e tij;

b) parimi *in dubio pro reo*;

c) e drejta për të heshtur dhe

d) e drejta për tu mos u vet-inkriminuar.

Në dukje të parë, parimi i prezumimit të pafajësisë mund të gjykohet si lehtësisht e zbatueshme, por brenda saj përfshihen një mori elementesh që këtë të drejtë për nga përbërja e bëjnë një dimension kompleks. Konceptualizimi i të drejtës për tu prezumuar i pafajshëm në kuadër të rendit juridik shtetëror, harmonizimi i saj me instrumentet ndërkombëtare, si dhe respektimi praktik dhe efektiv i saj, janë një nga sfidat kryesore.

Pra, prezumimi i pafajësisë është një e drejtë njerëzore universalisht e pranuar, që ndalon paragjykimin e fajësisë ndaj të akuzuarit. Detyrimi i të akuzuarin për të provuar pafajësinë e tij, është në kundërshtim me frymën e një rendi demokratik dhe në ktë rast prezumimi i pafajësisë paraqet një bazë qendrore për njohjen dhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor ndaj arbitraritetit të shtetit (Hoctor, 2004, f. 304-307, cituar nga Cole, 2010, f. 262-263). Cenimi i lirisë, stigma shoqërore dhe dëmi psikologjik që pëson një person i akuzuar në procedurë penale, bënë që supozimi i pafajësisë të jetë vendimtar për një shoqëri të përkushtuar ndaj drejtësisë (R v Oakes, 1986, Kanada, cituar sipas Cole, 2010, f. 263).

Prezumimi i pafajësisë zë vend të rëndësishëm në Kushtetutë. Sipas nenit 31, paragr. 5 të këtij akti parashihet që: *" ... çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij, në pajtim me ligjin."* Ndërsa sipas nenit 3, paragr. 1 të KPP-së, është paraparë që: *" ... çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës."* Dispozitat e KPP-së për prezumimin e pafajësisë përveç që i garantojnë këtë të drejtë personit të akuzuar, ato zgjerohen duke përfshirë edhe personin që dyshohet për kryerjen e një vepre penale. Në thelb, edhe dispozitat kushtetuese edhe ato ligjore garantojnë të drejtën që i pandehuri, pavarësisht stadit të procedurës penale, në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, përderisa nuk është vendosur me aktgjykim të formës së prerë, duhet të konsiderohet i pafajshëm.

Prezumimi i pafajësisë përfshin edhe fazën e hetimeve, kjo është paraparë me nenin 33 të Kodit të Etikës së Policisë së Kosovës, ku kërkohet që hetuesit policor të cilët janë duke hetuar një vepër penale, pavarësisht që për veprën e njëjtë, është ngritur apo jo aktakuzë në

kuptimin formal, sipas këtij dokumenti, këto organe e kanë për obligim të respektojnë këtë parim, gjë që personat që dyshohet për ndonjë vepër penale të konsiderohen të pafajshëm. Me anë të prezumimit të pafajësisë të pandehurit në procedurë penale duhet t'i garantohen kushte të përshtatshme në mënyrë që të trajtohet dhe të ndjehet i pafajshëm, duke filluar nga faza e hetimeve, shqyrtimit gjyqësor, ushtrimit të mjeteve juridike, e deri në marrjen e aktgjykimit në formë të prerë. Zyrtarët e zbatimit të ligjit, përfshirë këtu: hetuesit, prokurorët, gjyqtarët, oficerët korrektues dhe të tjerë, duhet të lirohen nga paragjykimet negative se i pandehuri është fajtor për veprën penale që i ngarkohet, përderisa procedura e nisur ndaj tij nuk ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë.

1.2. Koncepti i *"barrës së provës"* në procedurë penale

Çështja e barrës së provës tanimë është adresuar në kontekstin ndërkombëtar dhe është objekt i rregullimeve në një mori instrumentesh me karakter global dhe rajonal. Këtë mund të hasim në nenin 11 të DUDNJ-së, nenin 14 § 2 të PDCP-së apo në nenin 6 § 2 të KEDNJ-së, ku secila nga këto instrumente parashohin të drejtën e të pandehurit të konsiderohet i pafajshëm për ndonjë vepër penale, përderisa sipas ligjit të vërtetohet fajësia e tij. Për faktin se fajësia e personit të pandehur duhet të provohet nga organi i akuzës, rrjedhimisht i pandehuri është i liruar të vërtetojë dhe të provojë pafajësinë e tij përpara gjykatës.

Janë një mori argumentesh përse *"barra e provës"* i takon prokurorisë. *Së pari*, kjo qëndron në faktin se pala që pretendon ndonjë akuzë, ka për obligim të provojë të njëjtën. *Së dyti*, avantazhi që ka prokurori ndaj të pandehurit në procedurë, përkatësisht lehtësirat që ka prokurori për të provuar ndonjë akuzë, i mundësojnë prokurorit aktivitetin e *"të provuarit"* duke shfrytëzuar një mori burimesh që nuk i ka i pandehuri, sikurse është angazhimi i policisë si organizatë profesionale kompetente, i ekspertëve, i marrjes në pyetje të dëshmitarëve, apo mbledhja profesionale e provave (shih: Cole, 2010, f. 265 - 267). *Së treti,* i pandehuri mund të goditet emocionalisht dhe të *"neutralizohet"* vetëm për faktin e ngarkesës që mund ta ndjejë lidhur për të dëshmuar se është i pafajshëm

Në përputhje me këto standarde, *"barra e provës"* në procedurën penale në Kosovë i takon prokurorit, si organ kompetent për hetim dhe ndjekje penale. Roli dhe kompetencat e Prokurorit të shtetit si *"bartës i të provuarit"* në procedurë penale janë të adresuara në rrafshin kushtetutues. Sipas Kushtetutës, Prokurori i shtetit përkufizohet si institucion i pavarur që ka autoritet dhe përgjegjësi për ndjekje penale ndaj personit që dyshohet apo akuzohet për kryerje të ndonjë vepre penale (neni 109, paragr. 1). "*Barra e provës"* i atribuohet Prokurorit të shtetit edhe për faktin se Kushtetuta përveç prezumimit të pafajësisë (neni 31, paragr. 5), ka konceptualizuar edhe dy të drejtat tjera që janë pjesë të rëndësishme të parimit të prezumimit të pafajësisë, sikurse është:

- e drejta që të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet (neni 30, paragr. 6), dhe

- e drejta e heshtjes (neni 29, paragr. 3).

Lidhur me prokurorin e shtetit si *"bartës i provës"*, në këtë kontekst sipas Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit (2010), theksohet se Prokurori i shtetit ka përgjegjësi ndjekjen penale, të iniciojë hetime penale, zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit, të paraqesë aktakuzën apo propozim akuzën, të zhvillojë ndjekjen penale (neni 2 dhe neni 4).

Prokurori i shtetit si palë në procedurë penale në cilësinë e institucionit shtetëror të paraparë me Kushtetutë dhe ligj, përfaqëson interesin publik dhe ka diskrecion të gjerë të mbledhë prova dhe të hetojë vepra penale ndaj të të pandehurit, njëkohësisht është i detyruar të mbajë kujdes të mos paragjykojë fajësinë e të pandehurit, apo nga puna të cilën e bënë, të mos ndikojë tek personat e tretë që të krijohen dyshime të ligjshme për trajtimin e caktuar të të pandehurit. Në këtë kontekst, Prokurorit të shtetit nuk i ndalohet të jep deklarata apo të ndaj informacione të caktuara me publikun, por duhet të jetë i kufizuar për përmbajtjen e mesazheve që përçon tek publiku, pasi ai ka për obligim të ruajë të drejtën e të pandehurit për tu prezumuar i pafajshëm. Në këto raste, publiku ka të drejtë që të jetë i informuar deri në masën sa është e domosdoshme që të mos jetë i përjashtuar nga e drejta për tu informuar.

Prezumimi i pafajësisë si një nga elementet themelore që përbën të drejtën për gjykim të drejtë e liron të pandehurin të dëshmojë pafajësinë lidhur me akuzën që i vishet atij. *"Barra e provës"* në të drejtën e procedurës penale i është ngarkuar palës së akuzës dhe se në asnjë

dispozitë nuk parashihet që i pandehuri duhet të argumentoj pafajësinë e tij. Për dallim nga e drejta e procedurës sonë penale, shumë shtete në raste të caktuara obligojnë të pandehurin të dëshmojë pafajësinë, gjë që më së shumti është e shprehur tek krimet pasurore. Në këtë kontekst, autorët Mole & Harby (2001) theksojnë se neni 6 § 2 i KEDNJ-së nuk ndalon rregullat që e bartin *"barrën e provës"* tek i pandehuri për të përcaktuar mbrojtjen e tij, nëse *"barra e përgjithshme"* e përcaktimit të fajësisë i mbetet organit të akuzës. Sipas tyre, neni 6 § 2 nuk ndalon domosdoshmërisht prezumimin e të drejtës ose faktit, por çdo rregull që zhvendos *"barrën e provës"* ose që zbaton një prezumim që operon kundër të të pandehurit duhet të kufizohet brenda *"kufijve të arsyeshëm që marrin në konsideratë rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe të respektojnë të drejtat që i takojnë mbrojtjes"* (f. 50). Debatet teorike lidhur me *"bartësin e provës"* sot e kësaj dite janë aktuale dhe qëndrimet janë pro dhe kundër.

Në çështjen *Grayson & Barnham kundër Britanisë së Madhe*, GJEDNJ thekson se si gjykatat britanike kanë vendosur me aktgjykim për dënimin e dy të akuzuarve për veprimtari kriminale të drogës dhe në vendimin përfundimtar kanë vendosur që një pjesë të pasurisë së tyre, e supozuar si pasuri e përfituar nga veprimtaria kriminale t'i konfiskohet. Të pandehurit pasi kanë ushtruar mjetet juridike në instancat e brendshme, në fund iu kanë drejtuar dhe GJEDNJ-së, duke pretenduar se në gjykimet e mëhershme është shkelur neni 6 § 2 (prezumimi i pafajësisë) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 (e drejta e pronës) të KEDNJ-së. Sipas pretendimeve, neni 6 § 2 është shkelur kur është konfiskuar pasuria e tyre pasi janë ngarkuar me barrën e provës që të dëshmojnë se pasuria e fituar është realizuar në rrugë ligjore dhe nuk buron nga veprimtaria kriminale që tanimë janë dënuar nga instancat gjyqësore. Ata pretendojnë se iu është cenuar prezumimi i pafajësisë, pasi që barra e provës është vendosur mbi ta padrejtësisht dhe në kundërshtim me neni 6 § 2. Pretendimi tjetër lidhet me shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi ata si pronar të ligjshëm nuk është respektuar e drejta e tyre e pronës Në këtë rast vërehet se GJEDNJ nuk e cilëson prezumimin e pafajësisë si garancion absolut dhe se masat mbrojtëse të cilat i marrin shtetet për çështje të caktuara, mund të vendosin kufizime të caktuara, mirëpo barra ndaj të akuzuarit nuk duhet t'i tejkalojë kufijtë e arsyeshëm. Në vendosjen meritore për rastin, gjykata në mënyrë unanime është deklaruar se nuk ka pasur shkelje të prezumimit të pafajësisë të paraparë me nenin 6 § 2 dhe të drejtës për mbrojtje të

pronës të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Grayson & Barnham v. Britania e Madhe, GJEDNJ, 2008).

Edhe pse sipas jurisprudencës së GJEDNJ e drejta për tu prezumuar i pafajshëm nuk është një e drejtë pakufizuar dhe në raste të caktuara për të arritur një qëllim të ligjshëm një e drejtë e tillë mund të kufizohet, në të drejtën e procedurës sonë penale e drejta e prezumimit të pafajësisë është detyrim absolut për organet e drejtësisë. Kjo mund të elaburohet me faktin se me asnjë rregull ligjore nuk është paraparë ndonjë përjashtim që i pandehuri duhet të argumentojë pafajësinë e tij. Në disa sisteme juridike, të pandehurit i vihet *"barra e provës"* për të provuar se është i papërgjegjshëm penalisht, apo është i lidhur me veprimtari tjera me karakter pasuror, tregtar, biznesi apo të tjera (karahso: Cole, 2010, f. 263 - 264), por në sistemin tonë të drejtësisë nuk ekzistojnë rregulla të atilla që *"barrë e provës"* t'i ngarkohet të pandehurit.

1.3. Rëndësia e parimit *in dubio pro reo*

Dënimet e gabuara të cilat mund të ndodhin në procedurën penale kanë qenë një nga çështjet të cilat i ka provokuar autorë të ndryshëm të teorisë së procedurës penale. Dënimet jo-meritore, duke mos përcaktuar saktë përgjegjësinë penale, apo pamjaftueshmëria e provave për t'i vërtetuar faktet juridike relevante, kanë prodhuar aktgjykime arbitrare dhe të paargumentuara dhe si rrjedhojë për mbrojtje nga arbitrariteti janë ndërtuar parime të drejtat të cilat tentojnë të garantojnë procedurë gjyqësore me parime të drejta. Për këto arsye, autori Murati (2006, f. 100) thekson se kur gjykata e jep aktgjykimin duhet të jetë e bindur se ka vërtetuar ekzistimin ose mosekzekutimin e një fakti të caktuar vendimtar në rastin konkret. Në qoftë se nuk është e bindur për këtë, atëherë zbatohet rregulla *in dubio pro reo*, kuptimi i së cilës përmblidhet në faktin se në rast dyshimi për ekzistimin ose mosekzekutimin e fakteve të caktuara vendimtare, duhet gjykuar në favor të të pandehurit. Me fjalë të tjera, me zbatimin e rregullës *in dubio pro reo*, dyshimi për ekzistimin e fakteve të caktuara në procedurë penale zgjidhet në favor të të pandehurit.

Për të kuptuar më drejtë kuptimin dhe rëndësinë e këtij parimi, po përmendim një konkluzion të dhënë nga Dhoma e Apelit të TPNJ-së ku thekëson se është e bindur se parimi *in dubio pro reo* si rrjedhojë e supozimit të pafajësisë dhe detyrimit të vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, gjen zbatim në përfundimet e nevojshme për përcaktimin e fajësisë të tilla si përbërësit e elementëve të krimit të akuzuar. Kjo përqasje është në përputhje me jurisprudencën e TPNJ-së dhe është logjike duke marrë parasysh se në kontekstin e çështjeve faktike, parimi është kryesisht vetëm një nga aspektet e kushtit të përcaktimit të fajësisë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm (shih: Prokurori v. Limaj et.al, TPNJ, 2007, paragr. 21).

Rregulla *in dubio pro reo* është objekt i përpunimit në jurisprudencën e GJEDNJ. Ky parim, së bashku me të drejtë për tu mos u vet-inkriminuar dhe të drejtën për të heshtur, është pjesë përbërëse e të drejtës për tu prezumuar i pafajshëm (shih: Telfner v. Austria, GJEDNJ, 2001, paragr. 15 dhe Funke v. Franca, GJEDNJ, 1993, paragr. 44). Kjo rregull është konsideruar si parim tipik procedural dhe mund të zbatohet vetëm tek çështjet penale, kjo sigurisht mund të jetë edhe arsyeja që kjo rregull qëndron vetëm në legjislacionet penalo-procedurale. Lidhur me këtë, sipas nenit 3 të KPP-së është paraparë në një dispozitë të vetme parimi i prezumimit të pafajësisë dhe rregulla *in dubio pro reo*. Sipas kësaj dispozite, rregulla *in dubio pro reo* përkufizohet si: *"Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas KPP-së dhe sipas Kushtetutës."*

Rregulla *in dubio pro reo*, parimisht gjen zbatim nga instancat e rregullta gjyqësore. Gjykatat e rregullta e kanë për obligim që gjatë gjykimeve të respektojnë këtë rregull dhe të kenë parasysh se çdo dyshim dhe mëdyshje që prodhon pasiguri për një qëndrim bindës që duhet të ketë gjykata rreth vërtetimit të ndonjë fakti juridik relevant, duhet të interpretohet dhe vendoset në favor të të akuzuarit. Sigurisht janë të shpeshta rastet e tilla në praktikën gjyqësore, gjë që gjyqtarët duke njohur rrethanat e rastit duhen pasur kujdes respektimin e plotë të lirive dhe të drejtave të të akuzuarit dhe në situatat kur ka dyshime të caktuara, ato çdoherë duhet të shkojnë në favor dhe jo në dëm të tij.

Lidhur me këtë, në çështjen *Shpresim Uka dhe Bekim Syla kundër Gjykatës Supreme*, përderisa palët kanë kontestuar aktgjykimet që janë marrë ndaj tyre nga instancat gjyqësore të

rregullta në Kosovë me pretendimet *inter alia* se është shkelur rregulla *in dubio pro reo* dhe se për shkak se ato nuk kanë interpretuar dyshimet e pretenduara në prova në favor të tyre. Gjykata Kushtetuese në këtë vendim shpreh qëndrimin se është përtej juridiksionit te saj që të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ato janë haptazi arbitrare. Kjo gjykatë nuk ndërhyn as në mënyrën se si gjykatat kanë pranuar provat si material dëshmues dhe nuk ndërhyn në diskrecionin e gjykatës në vlerësimin e vlerës provuese të tyre, pasi ky është rol ekskluziv i gjykatave të rregullta, madje edhe për situatat kur deklaratat e dëshmitarëve në shqyrtimin publik dhe nën betim janë në kundërshtim (Shpresim Uka dhe Bekim Syla v. Gjykata Supreme, GJK, 2016, paragr. 60-61).

1.4. E drejta për të heshtur dhe e drejta për t'u mos u vet-inkriminuar

1.4.1. Kuptimi dhe funksionet e të drejtës për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar

E drejta për të heshtur, është një e drejtë themelore që gëzon i pandehuri në procedurë penale. E drejta për të heshtur dhe privilegji që gëzon i pandehuri që të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet, është e lidhur ngushtë me parimin e prezumimit të pafajësisë. Prokuroria nuk mund ta detyrojë të akuzuarin për ta ndihmuar atë në asnjë mënyrë, ngase njohja e së drejtës për heshtje është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë që gëzon i pandehuri dhe barrën e provës që ka prokurori (Gray, 2013, f. 160). E drejta për heshtje ka karakter absolut dhe pavarësisht rrethanave të ndryshme e njëjta nuk mund të kufizohet. E drejta për të heshtur është një nga elementet themelore të cilat e përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë. Gjykimi i drejtë, shikuar ngushtësisht nuk është një garancion vetëm procedural, ajo është më e gjerë se sa përqendrimi në zhvillimin e procesit gjyqësor si pjesë e veçantë e procesit gjyqësor në tërësi, pasi gjykimi i drejtë përfshinë edhe fazën paraprake të hetimit për çështjen penale. Në zhvillimin e procedurës penale si tërësi, e sidomos gjatë fazës hetimore, vlen privilegji ose e drejta kundër vetë-inkriminimit (*parimi nemo*

tenetur) dhe e drejta e heshtjes (Kempen, 2014, f. 9). E drejta për të heshtur është mundësi të cilën e gëzon i pandehuri, ku sipas bindjeve të tij të brendshme, ai mund të deklarohet duke shpjeguar rrëfimin e tij për dyshimin apo akuzën që ngarkohet. E drejta e të pandehurit për të heshtur dhe privilegji që të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet, është ndërtuar për qëllime të drejtësisë procedurale që çdokujt t'i sigurohet të drejtat e garantuara procedurale.

E drejta e të pandehurit për të heshtur dhe rrjedhimisht privilegji i tij që *"të mos shtrëngohet të dëshmoj kundër vetvetes ose të pranojë se është fajtor"* zë vend të rëndësishme në nenin 14 § 3 (g) të PDCP-së. Ndërsa KEDNJ, nuk përmban ndonjë rregull që përcakton këtë të drejtë. Nga praktika e GJEDNJ-së, e drejta për të heshtur, edhe pse nuk gjendet në pjesën normative të tekstit të Konventës, kjo rregull është interpretuar gjerësisht dhe janë dhënë vendime të cilat kanë gjetur fajtor shtete që kanë detyruar personat e dyshuar për vepra penale për të dëshmuar për veprimet e tyre inkriminuese. Nuk ka asnjë dyshim që, edhe pse neni 6 nuk i përmend shprehimisht, e drejta për të mos folur gjatë marrjes në pyetje nga policia dhe e drejta për të mos u inkriminuar janë norma ndërkombëtare të pranuara në mënyrë të përgjithshme dhe që përbëjnë thelbin e nocionit të procesit të rregullt ligjor që sanksionohet me nenin 6 të KEDNJ (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 365). E drejta e të pandehurit për të heshtur cilësohet parimisht si e drejtë absolute. Disa shtete në lidhje me akuzat për krime të rënda përjashtojnë privilegjin e të pandehurit për të heshtur, duke i dhënë përparësi interesave të tjera shtetërore të cilat mund të lidhen me interesat publike. Në çështjen *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ theksoi se është e pamundur që njëri prej parimeve të procesit të rregullt ligjor të sakrifikohet me arsyen se çështja është e ndërlikuar dhe se bëhet fjalë për interesin publik; e drejta për të mos kontribuar në vet-inkriminim aplikohet *"në procedurat penale për të gjitha llojet e veprave penale, nga më e thjeshta tek e ndërlikuara"* (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 366).

Debatat teorike lidhur me qëndrimin e heshtur të të pandehurit në procedurë penale janë të shumta, e njëra ndër to ngrit diskutimin nëse heshtja mund të merret si provë kundër të pandehurit në procedurë penale. Lidhur me këtë, shumica mendojnë se heshtja e të pandehurit përderisa ai shfrytëzon këtë të drejtë në cilindo stad të procedurës penale, nuk mund të

përdoret si provë apo rrethanë rënduese kundër tij në procedurë penale. I pandehuri që zgjedh për të heshtur nuk mund të pësojë nga shfrytëzimi i kësaj të drejte dhe se nuk mund të nxjerrën konkluzione negative kundër një të pandehuri që zgjedh të drejtën për të heshtur, pasi imponimi i një pasoje të tillë cenon ushtrimin e së drejtës për t'u liruar nga detyrimi për të dëshmuar kundër vetvetes (Berger, 2012). Megjithatë, në trajtimet shkencore është pranuar gjerësisht se përderisa i pandehuri shfrytëzon të drejtën për të heshtur nuk mund të nxirret konkluzion në dëm të interesave të tij dhe të nënkuptohet se:

a) heshtja është pëlqim;

b) heshtja dëshmon pranimin e përgjegjësisë për veprën, apo se

c) heshtja përforcon konkluzionet e paraqitura nga organi i akuzës.

Nuk është e mundur që heshtja të merret si pëlqim për akuzën e ngarkuar, përderisa i pandehuri kundërshton ose nuk pranon shprehimisht fajësinë (Heydon, 1974, f. 62).

Organet që udhëheqin procedurën penale kanë për obligim që të dyshuarit dhe të pandehurit e veprës penale të njoftojnë në çdo kohë për të drejtat e tij në procedurë penale, përfshirë të drejtën e tij për t'u mos u deklaruar dhe për t'u mos u inkriminuar vet dhe anëtarët e familjes së tij. I pandehuri që dëshiron të deklarohet, nuk duhet të jetë i shtrënguar që të deklarohet kundër vullnetit të tij, sepse do t'i shkilen të drejtat e garantuara kushtetuese dhe ligjore. Nëse vullnetarisht nuk e shfrytëzon të drejtën për të heshtur, nuk e ka për detyrim që gjatë deklarimit të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij.

1.4.2. E drejta për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar sipas KPP-së

E drejta për të heshtur dhe ndalesa e mos-shtrëngimit për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë, është pjesë e rëndësishme e të drejtave themelore të të pandehurit në procedurë penale. Këto zënë vend të rëndësishëm në aktet ligjore në Kosovë dhe janë të harmonizuara me instrumentet dhe jurisprudencën ndërkombëtare. Sipas nenit 29, paragr. 3 të Kushtetutës, parashihet e drejta e të pandehurit për të heshtur, ku në këtë dispozitë theksohet se çdokush që privohet nga liria, *inter alia* duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos

japë asnjë deklaratë. Kjo e drejtë është sistemuar në të drejtën kushtetuese për *liri dhe siguri* dhe nuk është në përmbajtje të nenit 30 [Të Drejat e të Akuzuarit], apo të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]. Ndërsa, sipas nenit 30, paragr. 6 të Kushtetutës, parashihet se i akuzuari ka të drejtë *"të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet."* Privilegji i mos-inkriminimit është e drejtë e pranuar me kushtetutë dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën për të heshtur, si dy koncepte të rëndësishme të prezumimit të pafajësisë.

Sipas nenit 10, paragr. 2 dhe 3 të KPP-së, parashihet që i pandehuri nuk ka detyrim të paraqesë mbrojtjen e tij ose t'i përgjigjet në ndonjë pyetje, dhe nëse mbrohet, nuk është i detyruar të akuzojë vetveten ose të afërmit e tij e as të pranojë fajësinë ... ndalohet dhe dënohet që të imponohet pranimi i fajësisë ose ndonjë deklarim tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme. Përmbajtja e këtij neni gjerësisht përcakton një mori të drejtash të rëndësishme të cilat garantojnë pozitë të përshtatshme për të pandehurin në procedurë penale. Këto të drejta, sikurse të gjithë të drejtat e tjera të garantuara duhet të jenë praktike dhe efektive dhe jo teorike apo iluzore (Allenet De Ribemont v. Franca, GJEDNJ, 1995, paragr. 35).

E drejta e të pandehurit për të heshtur dhe privilegji për mos-inkriminim është paraparë si pjesë dispozitave të KPP-së. Sipas nenit 73 të KPP-së, në marrjen në pyetje nga policia, së pari duhet të informojë të dyshuarin për veprat penale, për të cilat dyshohet se ai i ka kryer dhe për të drejtat e tij të garantuar kushtetuese dhe ligjore, përfshirë të drejtë për të heshtur dhe refuzimin e inkriminimit për të dhe familjarët e tij. Ndërsa, sipas nenit 167, paragr. 1 dhe 2 të KPP-së, nga moment i arrestimit, personi gëzon *inter alia* të drejtën të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij. Çështja e dhënies së informatave mbi identitetin nga vet i pandehuri, ka qenë objekt i trajtimit të gjerë. Disa studiues janë ithtarë të konceptit se e drejta për të heshtur duhet të jetë absolute dhe ajo duhet të përfshijë një privilegj të pakufizuar të cilin duhet të gëzojë i pandehuri në procedurë penale, përfshirë edhe të drejtën për të heshtur edhe atëherë kur kërkohen vetëm të dhënat e tij mbi identitetin, pasi për t'i kërkuar të pandehurit emrin, moshën dhe vendin e tij të qëndrimit cenon *"të drejtën e tij për të heshtur në çdo kohë."* Ndërsa studiues të tjerë

konsiderojnë se, çështja e kërkesës për dhënie të informatave të tilla nga i pandehuri nuk është pyetje e cila cenon të drejtën për të heshtur, apo cenon prezumimin e pafajësisë së të pandehurit, por kjo pyetje është vetëm për qëllim të përcaktimit se personi i cili dyshohet apo akuzohet për vepër penale, është personi i njëjtë përpara gjykatës apo ndonjë organi tjetër të procedurës penale, qoftë në polici apo prokurori (George, 1968, fv. 1150-1151).

Gjatë zbatimit të marrjes në pyetje të të pandehurit në procedurë paraprake, në fillim të çdo marrjeje në pyetje, seancës për deklaratë në procedurë paraprake ose mundësisë hetuese të veçantë, prokurori i shtetit i lexon të pandehurit paralajmërim me anë të së cilës i tregon të drejtat dhe mundësinë që të mos deklarohet dhe të qëndrojë në heshtje, apo dhe gjatë deklarimit të mos e inkriminojë vetveten dhe anëtarët e familjes së tij. Edhe gjatë zhvillimit të procedurës penale pranë gjykatës, në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari kompetent e udhëzon të pandehurin për të drejtën për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklarohet, nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, e as të pranojë fajësinë; të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij; të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë (KPP, neni 246, paragr. 1).

Sipas dispozitës së nenit 16 të KPP-së, i pandehuri ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë është i detyruar të njoftohet për të drejtat që i përkasin sipas KPP-së, si dhe për pasojat e mosveprimit të tij nëse ai, për shkak të mosdijes, nuk ndërmerr veprimin e duhur në procedurë ose i nuk shfrytëzon të drejtat e tij. Njëra nga të drejtat e të pandehurit është e drejta që të mos deklarohet dhe të shfrytëzoj të drejtën e tij për të heshtur gjatë zhvillimit të procedurës penale. Gjithashtu, privilegji i mos-inkriminimit të të pandehurit për veten dhe anëtarët e familjes, në situatat kur ai do të deklarohet vullnetarisht, janë të drejta formale të cilat zënë vend të rëndësishëm në aktet ligjore. Ato u japin imunitet të pandehurit që kundër vullnetit të tij të mos deklarohen dhe në rastet kur deklarohet, ai mund të shpreh rezerva të natyrave të ndryshme, ku përfshihet dhe mundësia e mos-inkriminimit, duke mos pasur konsekuenca ligjore. Deklarimi jo e saktë i të pandehurit në procedurë penale, nuk ka pasoja negative për të, ai është i lirë që sipas bindjes së tij të brendshme, apo edhe i këshilluar profesionalisht nga mbrojtësi i tij, të deklarohet për dyshimin apo akuzën që i ngarkohet.

KPP nuk përmban ndonjë dispozitë të veçantë që sqaron çmuarjen e faktit në rastet kur i pandehuri shfrytëzon të drejtën për të heshtur. KPP hesht këtë pjesë, duke u dhënë diskrecion gjykatës dhe organeve të procedurës penale që mos-deklarimin e të pandehurit të mund të çmojnë sipas bindjeve të tyre të brendshme, vetëm për të fituar përshtypje të caktuara të cilat mund t'u shërbejnë për udhëheqjen e procedurës në drejtim të caktuar, por asnjëherë nuk mund të ndërtohet bindje se heshtja përbën provë dhe asaj t'i jepet vlerë provuese e caktuar. KPP mban qëndrimin se e drejta e heshtjes dhe privilegji i mos-inkriminimit, janë garancione procedurale dhe nuk mund të interpretohet në dëm të interesave të të pandehurit në procedurë penale. Mos-respektimi i këtyre të drejtave, shkakton padrejtësi procedurale dhe cenim të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të të pandehurit.

1.4.3. E drejta për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar e *"dëshmitarit bashkëpunues"* dhe urdhrat e nevojshëm për shqyrtimin e provave nga eksperti

E drejta e të pandehurit për të heshtur dhe për t'u mos u vet-inkriminuar, janë privilegje absolute të cilat nuk mund të kufizohen pavarësisht rrethanave që mund të paraqiten. Përjashtimisht, në zgjidhjet e dhëna në legjislacionet bashkëkohore, është paraparë që në procedurë penale përderisa vet i pandehuri pranon të dëshmojë në çështjen ku është i përfshirë vet ai, lejohet që i pandehuri i tillë të shpallet *"dëshmitar bashkëpunues"*. I pandehuri që mban këtë status në procedurë penale, nuk mund t'i gëzojë të drejtat e plota të cilat i garantohen atij si i pandehur. Kjo zgjidhje është e përfshirë në KPP në Kosovë, ku "*dëshmitari bashkëpunues"* i shpallur sipas 235 të KPP-së, të cilit ende nuk i është lexuar aktakuza në shqyrtim gjyqësor, që mund të ofrojë bashkëpunim organeve të ndjekjes me qëllim që të përfitojë nga favoret të cilat mund t'i bëhen atij në procedurën penale, nuk mund t'i gëzojë të gjitha privilegjet të cilat i ofrohen si i pandehur.

Në cilësinë e *"dëshmitarit bashkëpunues"*, nuk ka të drejtë të hesht, pasi sipas nenit 125, paragr. 4 të KPP-së, është përcaktuar që nëse *"dëshmitari bashkëpunues"* shfrytëzon të drejtën për të heshtur, nuk do të jetë më dëshmitarë bashkëpunues. Sipas dispozitës së njëjtë të KPP-

së, *"dëshmitarit bashkëpunues"* në dëshminë e tij duhet të thotë vetëm të vërtetën, pasi pasojat për deklarime të rreme tanimë përbëjnë vepër të veçantë penale të përcaktuar me nenin 392, paragr. 1 të KPK-së. *"Dëshmitari bashkëpunues"* nuk gëzon as të drejtën për t'u mos u vet-inkriminuar në dëshminë që ofron para autoriteteve gjyqësore, pasi vet natyra e ofrimit të bashkëpunimit, shpreh përfshirjen e tij në një vepër penale. Ai gëzon privilegjin e mos vet-inkriminimit vetëm për çështjet tjera jashtë objektit të çështjes penale për të cilën zhvillohet procedura penale, e të cilat nuk janë të përfshira në dosjen akuzuese.

Zgjidhjet e tilla ligjore që janë përfshirë në dispozitat e KPP-së ku i pandehuri në çështjen e njëjtë penale paraqitet në cilësinë e dëshmitarit, nuk cenojnë privilegjet e të pandehurit që mund t'i gëzojë në procedurë penale. Karakteristika kryesore e këtyre privilegjeve qëndron mbi faktin se ato nuk guxojnë të cenohen detyrimisht nga autoritetet shtetërore, ndërsa në rrethanat kur vet i pandehuri vullnetshëm heq dorë nga këto privilegje, nuk kemi cenim të tyre.

Sipas mendimeve të disa autorëve, e drejta për të heshtur apo e drejta për t'u mos u vet-inkriminuar mund të interpretohet gjerësisht dhe se kjo e drejtë nuk kufizohet vetëm në të drejtën e të pandehuri që të mos deklarohet, por i jep të drejtë atij që pa vullnetin e tij nuk mund të ndërhyhet për të ndërmarrë ndonjë veprim procedural, e që lidhet drejtpërdrejt me integritetin e tij personal, qoftë marrjen e mostrës së gjakut, indit trupor, ADN-në apo të ngjashme, për qëllime të kryerjes së ekspertizave profesionale. Kjo çështje lidhet me faktin se nëse i pandehuri nuk detyrohet të deklarohet apo të mos vet-inkriminohet, sipas analogjisë, i pandehuri barabarësisht ka të drejtë që të refuzojë një kërkesë të tillë, pasi ai në procedurë penale është subjekt i barabartë me prokurorin dhe se kjo mund të përbëje cenim të të drejtës për dinjitet që gëzon i pandehuri në procedurë penale dhe për shkak të ndërhyrjeve të caktuara ai nuk mund të jetë objektivisht palë e barabartë me prokurorin në procedurë penale. Autoritetet e ndjekjes duhet të ndërtojnë rastin me prova kundër të pandehurit me anë të përpjekjeve të veta të pavarura, dhe jo me anë të ndonjë detyrimi të caktuar që përfshin personalisht të pandehurin të kontribuojë në vet-inkriminim. Gjykata Supreme e SHBA-së ka konsideruar se privilegji kundër vetë-inkriminimit nuk zbatohet për provat e testimit të gjakut, shenjat e gishtave, ekzemplarët e dorëshkrimit dhe prova të tjera të natyrës së ngjashme (George, 1968, f. 1157).

Sipas nenit 139, paragr. 3 të KPP-së, është paraparë që nëse i pandehuri nuk jep pëlqimin me shkrim për të dhënë mostrën e gjakut, indin trupor, ADN-në apo të ngjashme, ose nuk jep pëlqimin me shkrim për t'iu nënshtruar ekzaminimit fizik të lëndimeve siç kërkohet në hetim, prokurori i shtetit kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për marrjen e mostrës që nevojitet apo për ekzaminimin. Pra, të pandehurit i ofrohet mundësia që vullnetarisht t'i jap gjurmët e tilla, nëse këtë nuk e bënë, atëherë zbatohen dispozitat përkatëse të KPP-së. Sikurse e përmendëm në çështjen e vendimit të Gjykatës Supreme të SHBA, nxjerra e mostrave të caktuara duhet të bëhet duke u bazuar në arsyeshmëri, propocionalitet dhe plotësisht në përputhje me arritjen e objektivave legjitime në procedurë penale. Rregullat ligjore të parapara me nenin 139 dhe 144 të KPP-së, janë në përputhje me nenin 26 [E Drejta e Integritetit Personal] të Kushtetutës së Kosovës.

1.5. Cenimi i prezumimit të pafajësisë

Kufizueshmëria për të mos i ngarkuar apo paragjykuar të pandehurit fajësi përpara se të vendoset me aktgjykim të formës së prerë, nuk është vetëm obligim i organeve gjyqësore, një obligim të tillë e kanë dhe instancat tjera, përfshirë këtu dhe mediat. Prezumimi i pafajësisë është dimension i gjerë, ku i pandehuri gëzon këtë të drejtë nga momenti kur autoritet shtetërore fillojnë ndonjë aktivitet të caktuar kundrejt personit që ka dyshime të ligjshme se është kryer i ndonjë vepre penale. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, gjyqtari përveç që ka për obligim të gjykojë me profesionalizëm dhe paanësi, ai njëkohësisht duhet të kujdeset që të pandehurit t'i respektohen të drejtat e garantuara në procedurë penale, përfshirë edhe nga kujdesin që duhet të kenë subjektët dhe pjesëmarrësit në procedurë penale për tu përmbajtur nga ndonjë kualifikim të atillë që cenon të drejtat e të pandehurit.

Përveç trajtimit me dinjitet, edhe gjatë mbajtjes së paraburgimit, si masë e caktuar nga gjyqtari i procedurës paraprake për sigurimin e pranisë së tij në procedurë penale, i pandehuri gëzon të drejtën për t'u trajtuar i pafajshëm, gjë që nuk guxon t'i nënshtrohet ndonjë regjimi të caktuar si pjesë të programeve për riedukimi, risocializim, rehabilim apo riintegrim. Në

përputhje me nenin 197 të KPP-së, mbajtja e paraburgimit duhet mbajtur në objekte të posaçme të paraburgimit, ose në pjesë të ndarë të institucionit për mbajtjen e dënimeve me burgim. Në përputhje me dispozitat ligjore pozitive, të pandehurit që i është caktuar masa e paraburgimit, në asnjë situatë nuk duhet të trajtohet si person i dënuar, qoftë duke imponuar mbajten në sallën e gjykatores uniformën që i ngjason personit të dënuar, apo disiplinim tjetër që është bërë me ndërhyrje të qëllimshme nga ana e organeve të zbatimit të ligjit. Për qëllime të sigurisë mund të merren masa të caktuara të cilat duhet të jenë të domosdoshme dhe proporcionale me qëllimin që duhet të arrihet.

Edhe pse e drejta për gjykim publik e përcaktuar me nenin 31, paragr. 3 të Kushtetutës, i jep të drejtë mediave të jenë prezent gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore dhe sikurse pjesa tjetër e publikut gëzojnë të drejtë të barabartë për të përcjellë seancat gjyqësore, ku ato publikisht për zhvillimet të cilat ndodhin në çështjet e caktuara gjyqësore mund t'i ndajnë me publikun e gjerë me anë të shpërndarjes së informacionit, me qëllim që të ruhen të drejtat e garantuara kushtetuese, veçanërisht e drejta e të pandehurit për t'u prezumuar i pafajshëm, mediat sikurse çdo bartës tjetër publik ka për obligim që të mos cenojë të pandehurit këtë të drejtë. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, garantohet liria e mediave, por kjo nuk është e pakufizuar dhe jashtë kësaj të abuzohet duke cenuar të drejtën e ligjshme të subjekteve sikurse është e drejta e të pandehurit për t'u prezumuar i pafajshëm. Për këto arsye, mediat duhet kujdesur që gjatë plasimit të informacionit të japin të dhëna të sakta, të qarta dhe të drejta, duke mos cenuar asnjë të drejtë të garantuar. Pavarësisht se liria e mediave mund të jetë mjaft e gjerë, prezumimi i pafajësisë për të pandehurin është e drejtë absolute dhe nuk legjitimon në asnjë rrethanë cenimin e saj për çfarëdo arsye.

Lidhur me këtë, në çështjen *Allenet De Ribemont kundër Francës*, GJEDNJ thekson se parimi i prezumimit të pafajësisë është mbi të gjitha një mbrojtje procedurale në çështjet penale për të pandehurin. Fushëveprimi i kësaj të drejte është më i gjerë, duke imponuar detyrime jo vetëm në gjykatat penale, por edhe nga autoritetet tjera. Fusha e aplikimit prezumimit të pafajësisë nuk kufizohet vetëm në rastin e cenimit të prezumimit të pafajësisë nga një autoritet gjyqësor, por edhe në cenimet që mund të vijnë nga autoritetet tjera publike. Qëndrimet e atilla nga cilido autoritet publik që pasqyrojnë një mendim se i pandehuri është

fajtor para se ai të jetë shpallur fajtor sipas ligjit, përbëjnë cenim të prezumimit të pafajësisë. (Allenet De Ribemont v. Franca, GJEDNJ, 1995, paragr. 35-36).

Pas përfundimit të procedurave gjyqësore, personi që lirohet nga akuzat gëzon të drejtën për t'u dëmshpërblyer. Shpërblimi i dëmit të shkaktuar për akuzat e ngritura dhe të paprovuara në procedurë penale kundër tij, është në funksion të respektimit të prezumimit të pafajësisë së të pandehurit. I pandehuri nuk e ka për obligim që të argumentojë se është i pafajshëm, sepse një gjë e tillë do të jetë në kundërshtim me prezumimin e pafajësisë. Sipas nenit 15 të KPP-së, e drejta në rehabilitim dhe kompensim, i takon çdo personi i cili është dënuar, arrestuar, ndaluar ose paraburgosur në mënyrë të paligjshme dhe i njëjti ka të drejtë në rehabilitim të plotë, kompensim të drejtë nga mjetet buxhetore dhe në të drejta të tjera të parapara me ligj.

2. E drejta për *"barazi të armëve"*

2.1. Kuptimi dhe funksionet e *"barazisë së armëve"* dhe kontradiktoritetit

"Barazia e armëve" dhe kontradiktoriteti (parimi kundërthënës) janë parimet bazë që ndihmojnë zhvillimin e procedurës penale ndershmërisht. *"Barazia e armëve"* është karakteristikë tipike e sistemit akuzator dhe me kalimin e kohës është recipuar në procedurat penale bashkëkohore të tipeve të përziera. *"Barazia e armëve"* shprehet nëpërmes postulatit *"audi alteram partem",* (krahaso: Sahiti & Murati, 2016, f. 93 dhe Cole, 2010, f. 310) ku gjyqtari duhet t'i dëgjojë të dyja palët, prokurorin dhe të pandehurin. Kjo rregull në Angli njihet si një nga të drejtat themelore, dhe mosrespektimi i saj e bënë procedurën e pavlefshme, ndërsa në SHBA ky parim është pjesë e konceptit të *"procesit të rregullt"* (Kelly, 1964, f. 103).

Procedura penale duhet të respektojë të drejtat dhe garancionet procedurale, pasi si qëllim kryesor është krijimi i shanseve të barabarta të palëve në procedurë për të paraqitur çështjen e tyre, pra, mundësi të barabarta ndërmjet të pandehurit përball prokurorit. Konsiderohet se palët janë të barabarta kur rregullat procedurale u mundësojnë atyre

pjesëmarrje dhe participim në procedurë, duke ju dhënë të drejta dhe autorizime të njëjta (Sahiti & Murati, 2016, f. 92).

"Barazia e armëve" është përpunuar gjerësisht në shumë çështje që janë ngritur pranë GJEDNJ-së. Në rastin *De Haes dhe Gijsels kundër Belgjikës* (1997), kjo gjykatë thekson se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit. Duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve (Mole & Harby, 2001, f. 40). Ndërsa në rastin tjetër *Delcourt kundër Belgjikës* (1970), gjykata konkludon se *"barazia e armëve"* nënkupton detyrimin për t'i dhënë çdo pale mundësi logjike për të paraqitur çështjen e saj ... në kushte që nuk e vendosin atë në situatë të disfavorshme në raport me kundërshtarin (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 368). Konkluzionet e nxjerra nga interpretimi i parimit të *"barazisë së armëve"* brenda nenit 6 të KEDNJ-së për çështjet që janë ngritur pranë GJEDNJ-së, nuk janë asnjëherë përmbledhje dhe konkluzione shteruese. Përderisa ngritën çështjet që në vetvete përmbajnë pretendime për cenimin e *"barazisë së armëv*e", gjykata përdorë si udhërrëfyes këto konstatime që janë nxjerrë nga vendimet e mëparshme, duke i përdorur ato si praktikat më të mira për të bërë interpretime sistematike dhe konsistente, lidhur me dispozitat e gjithmbarshme të Konventës dhe konkretisht të nenit 6 të saj.

Lidhur me këtë, edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në jurisprudencën e saj thekson se parimi i *"barazisë së armëve"* në mes të palëve në një rast, është një kusht thelbësor i shqyrtimit të drejtë. *"Barazia e armëve"* e cila duhet të respektohet gjatë tërë procesit të gjykimit, do të thotë që palët duhet të trajtohen në atë mënyrë, duke siguruar që ato të kenë pozitë procedurale të barabartë gjatë zhvillimit të gjykimit, dhe të jenë në pozitë të barabartë për të paraqitur rastin e tyre. Kjo do të thotë që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis à vis* palës kundërshtare (Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A. v. Gjykata Supreme, GJK, 2014, paragr. 41). I pandehuri i gjendur përball prokurorit që përfaqëson mekanizmin shtetëror dhe ka të gjitha mundësitë për të mbledhur dëshmi relevante për çështjen konkrete gjatë procedurës paraprake, e drejta për *"barazi të armëve"* të pandehurit i jep mundësi të bëjë mbrojtje efektive për interes të tij. Ky koncept nuk duhet

nënkuptuar si dimension abstrakt apo teorik, pasi e njëjta duhet të sigurohet praktikisht me garancione konkrete. E drejta e të pandehurit për t'u konsideruar palë e barabartë përball prokurorit si organ shtetëror, është në funksion të përmbushjes të së drejtës së të pandehurit për t'u konsideruar i pafajshëm, pasi trajtimi me barazi dhe ofrimi i mundësive të barabarta të të pandehurit përball prokurorit, rrit objektivitetin e procedurës gjyqësore konkrete dhe institucionit të gjykatës përgjithësisht.

Përkitazi me këtë, autori Krapac (2010, fv. 152-153) thekson se parimi i *"barazisë së armëve"* përmbush disa parime themelore të procedurës penale, pasi siç dihet procedura nuk guxon të drejtohet e as të udhëhiqet ashtu që të vije deri tek ndonjë diskriminim i paarsyeshëm në mes palëve. Parimi i *"barazisë së armëve"* dallon nga kontradiktoriteti, pasi koncepti i *"barazisë së armëve"* nënkupton të drejtën e palës që para çfarëdo veprimi të mund të paraqes qëndrimin dhe provat e tij nën kushte të cilat nuk e vendosin në një pozicion inferioriteti në raport me palën kundërshtare. Përndryshe parimi i kontradiktoritetit lidhet vetëm me aktivitetet e caktuara gjatë procedurës penale (p.sh. ngritja e aktakuzës, paraqitja e provave të aktakuzës dhe paraqitja e argumenteve të aktakuzës) mbi të cilat i pandehuri duhet të jetë i njoftuar në mënyrë të rregullt që të ketë rastin t'i kundërvihet me kundër-argumente.

"Barazia e armëve" është koncept që derivon nga pjesa normative e instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, përkatësisht në përmbajtjen e nenit 6 § 1 dhe 6 § 3 (d) të KEDNJ-së dhe nenit 14 § 3 (d), të PDCP-së. Çdo i akuzuar për një vepër penale sipas nenit 6 § 3 (d) të KEDNJ-së ka të drejtë: *"të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës."*

Në këtë kontekst, në çështjen *Bajrush Xhemajli kundër Gjykatës Supreme*, lidhur me përmbajtjen e nenit 6 § 1, 3 (d) të KEDNJ-së Gjykata Kushtetuese shpjegon se kjo dispozitë përbëhet nga tri elemente themelore:

a) të drejtën për të sfiduar dëshmitarët e prokurorisë (ose të ekzaminojë provat tjera të paraqitura nga prokuroria në mbështetje të rastit të tyre);

b) të drejtën, në rrethana të caktuara për të thirrur një dëshmitar sipas zgjedhjes për të dëshmuar në gjykatë, d.m.th. për mbrojtjen dhe

c) të drejtën për të pyetur dëshmitarët e prokurorisë në të njëjtat kushte si ato të ofruara për dëshmitarët e mbrojtjes (Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme, GJK, 2013, paragr. 83).

Në këtë çështje, kjo gjykatë konstaton se elementi i kontradiktoritetit është pjesë përbërëse e parimit të *"barazisë së armëve"*. Përkundër faktit që shprehimisht nuk përmendet në këtë dispozitë, gjykata shpreh opinionin se procedura kontradiktore përmban të drejtën për të sfiduar dëshmitarët e prokurorisë ose të ekzaminojë provat tjera të paraqitura nga prokuroria në mbështetje të rastit. Parimi i "*barazisë së armëve"* dhe parimi kontradiktor, edhe pse shumë herë perceptohen si parime të njëjta, përkundrazi kanë një dallim të theksuar, por megjithatë në aspektin konceptual *"barazia e armëve"* është dimension shumë më i gjerë se sa kontradiktoriteti dhe se kjo e fundit llogaritet si pjesë fundamentale e parimit të *"barazisë së armëve"*. *"Barazia e armëve"* shihet si shansi që duhet ofruar palëve në kushte të barabarësisë në procedurë penale, ndërsa kontradiktoriteti është dimension procedural që u jep mundësi palëve për të shqyrtuar qëndrimet e kundërta të palëve në procedurë, të shprehura nëpërmes kërkesave dhe dëshmive konkrete që mund t'i paraqesin, apo sfidimin edhe të veprimeve tjera të cilat i ndërmerr gjykata, ku vet palëve edhe në këtë rast u jepet mundësi për t'i kundërshtuar deri në masën që është e lejueshme bazuar në parimet e drejta procedurale.

Kontradiktoriteti është e drejtë që nënkuptohet që secilës palë në procedurë penale t'u ofrohet mundësi të shprehet mbi parashtrimet e palës së kundërt. Pra, flitet që procedurën penale e karakterizon parimi i kontradiktoritetit, do të thotë që duhet të strukturohet në mënyrë specifike në mënyrën e *"palëve".* P.sh. i pandehuri të jetë i njoftuar saktësisht me përmbajtjen e akuzës dhe provave kundër tij, të cilat gjykata mund t'i merr parasysh e të cilave i akuzuari mund t'i kundërvihet para se të merret vendimi. Ky parim nënkupton se është e drejtë e palës që dijë të gjitha veprimet që merren gjatë zhvillimit të procedurës penale dhe të dëgjohet nga gjykata, para vendimit të gjykatës palës duhet ofruar mundësia që të shprehet mbi faktet të administruara nga gjykata dhe ato të paraqitura nga pala e kundërt. Sipas Krapac (2010) është e drejtë themelore e të pandehurit të njoftohet në lidhje me veprimet në procedurë penale (e thirrur për të marrë pjesë gjatë seancave në gjykatë), si dhe t'i ofrohet mundësia e përdorimit të gjuhës me gjykatën. Se a do t'i shfrytëzojë pala t'i shfrytëzojë këto të

drejta varet nga i pandehuri. Gjykata nuk ka obligim që të nxisë të pandehurin që të ndërmerr aktivitetet të caktuara për të paraqitur çështjen e tij para gjykatës, p.sh. që të propozojë marrjen e provave (f. 149).

Në procedurën penale bashkëkohore, i pandehuri gëzon disa privilegje dhe përparësi, të cilat dallohen për nga vëllimi dhe brendia e tyre prej një procedure penale në tjetrën. Privilegjet dhe përparësitë që gëzon i pandehuri në procedurë penale, ekzistojnë në raport me prokurorin e shtetit si organ shtetëror dhe mundësojnë të pandehurit pozitë të barabartë me prokurorin si palë e kundërt (Murati, 2008, f. 78). Kjo mundëson barazi të palëve në procedurë penale, ku prokurori i shtetit përfaqëson funksionin e akuzës, ndërsa i pandehuri përfaqëson funksionin e mbrojtjes, ndërsa gjykata kryen funksionin e gjykimit. *"Barazia e armëve"* në procedurë penale tentohet të arrihet me anë të vënies në jetë të parimit të prezumimit të pafajësisë, të drejtës për tu mbrojtur, të drejtës për tu dëgjuar nga gjykata, të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim, (shiko: Trechsel, 2005, f. 89, cituar nga Cole, 2010, f. 311 - 312) si dhe me krijimin e lehtësive dhe përparësive të caktuara për të pandehurin, që ia krijojnë atij një pozitë të privilegjuar ndaj prokurorit të shtetit si palë kundërshtare. Privilegjet dhe favoret e të pandehurit parashikohen me ligje bashkëkohore të procedurës penale para së gjithash për hir të qëndrimit human ndaj të pandehurit, që ka si qëllim parësor arritjen e barazisë në raport me prokurorin (Murati, 2006, fv. 79-80). Favoret kryesore në KPP janë:

- rregulla *in dubio pro reo* (neni 3, paragr. 2);
- fjala përfundimtare e të akuzuarit në procedurë penale (355, paragr. 4);
- identiteti subjektiv dhe objekti i aktgjykimit me aktakuzën (neni 360);
- *reformatio in peius* (neni 395);
- *beneficium cohaesionis* (neni 397) etj., kurse përparësitë e të pandehurit ndeshën në procedurën sipas ankimit, sikurse është kthimi në gjendje të mëparshme (neni 447), si dhe në procedurën sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

2.2. Konceptualizimi i *"barazisë së armëve"* në Kushtetutë dhe KPP

Sipas nenit 31, paragr. 4 të Kushtetutës, parimi i *"barazisë së armëve"* është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ku theksohet se: *"çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet".*

Ndërsa sipas nenit 9 të KPP-së, parashihen zgjidhje të rëndësishme për parimin e *"barazisë së palëve"*. KPP parasheh që: *"i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë"* (neni 9, paragr. 1), ndërsa sipas paragr. 2 parashihen mes tjerash këto të drejta:

1) Të deklarohet dhe duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë;

2) T'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij;

3) Të kërkojë nga prokurori të thërret dëshmitarë në emër të tij;

4) Të ketë të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe

5) Të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.

Sikurse mund të shohim, dispozitat e KPP-së janë të harmonizuara me Kushtetutën si dhe me rregullat e instrumenteve ndërkombëtare, përkatësisht me KEDNJ dhe PDCP. Nga rregullat të cilat i përmendëm më sipër për *"barazinë e armëve"*, nuk mund të konkludohet se të njëjtat nuk shprehin përbërjen e plotë të të shpjeguarit të këtij parimi, pasi kuptimi dhe përmbajtja është shumë më ekstensive dhe se të drejtat tjera konkrete që e përbëjnë këtë parim janë pjesë e pandashme e gjithë përmbajtjes së KPP-së. Përkundër qëndrimeve të ndryshme teorike, *"barazia e armëve"* nuk kufizohet vetëm në disa elemente të thjeshta, thelbi i saj është përmbajtësor dhe kërkon garancione konkrete duke i ofruar të pandehurit mundësi të barabarta në raport me prokurorin. Lidhur me këtë, në çështjen *Vidal kundër Belgjikës*, GJEDNJ thekson se koncepti i *"barazisë së armëve"* nuk e shteron përmbajtjen e nenit 6 § 3 (d) (shih: Vidal v. Belgjika, GJK, 1992, paragr. 33). Në funksion të parimit për t'u konsideruar i

barabartë, të pandehurit duhet t'i mundësohet e drejta për t'u mbrojtur, ku përfshihet e drejta për të pasur avokat mbrojtës. Kjo e drejtë siguron një balancë më të përafërt ndërmjet prokurorit si profesionist në njërën anë dhe të pandehurit që supozohet se është laik e që interesat e tij përfaqësohen në procedurën penale nga një mbrojtës profesionist në anën tjetër. E drejta për mbrojtje në sistemin tonë, sipas natyrës së rastit është e domosdoshme dhe fakultative. E drejta për t'u mbrojtur nuk duhet të jetë vetëm teorike dhe abstrakte, ajo duhet t'i jep mundësi për mbrojtje efektive, ku përfshihet dhe kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, pa përjashtuar dhe mundësinë për qasje të barabartë në provat dhe argumentet të cilat i administron prokurori i shtetit apo dhe vet gjykata.

Gjithashtu, e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, llogaritet si një nga elementet të cilat janë në funksion të *"barazisë së armëve"*, pasi kjo ofron siguri për një vendim përfundimtar të drejtë dhe objektiv të çështjes penale. Në këtë kontekst, sistemet e ndryshme juridike kanë paraparë mundësinë e zhvillimit të procedurës penale në mungesë të të pandehurit, sikurse është paraparë në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (shih: Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995). Sipas nenit 351 dhe 352 të këtij instrumenti ligjor, në rastet kur i pandehuri në procedurën penale nuk paraqitet edhe përkundër që thirrja për paraqitje iu është dërguar në mënyrë të rregullt, apo nuk ka pasur mundësi tjetër të sigurohet pjesëmarrja e tij në procedurë penale, gjykata sipas detyrës zyrtare ia cakton sipas detyrës zyrtare një avokat mbrojtës për t'ia mbrojtur të drejtat e tij në procedurë penale. Lidhur me këtë, KPP nuk ka përqafuar këto zgjidhje dhe me të drejtë ka respektuar një standard të pranuar dhe të garantuar me instrumentet ndërkombëtare, edhe pse shumë çështje penale edhe përkundër pasojave të konsiderueshme të cilat janë shkaktuar nuk mund të zhvillohen pasi që nuk mund të sigurohet prezenca e të pandehurve si kusht i domosdoshëm për t'u zhvilluar gjykimi.

Përkundër parimit të *"barazisë së armëve"*, parimi i kontradiktoritetit si emërtim dhe parim i veçantë, shprehimisht nuk zë vend të posaçëm sikurse parimet tjera procedurale, por elementet që e përbëjnë këtë parim mund t'i hasim në dispozita të ndryshme të KPP-së. Ky parim është i mishëruar në vet parimin e *"barazisë së armëve"*, përkatësisht në dispozitat të cilat i japin mundësi të pandehurit për t'i komentuar dhe kundërshtuar dëshmitë e dëshmitarëve nëpërmes marrjes së tyre në pyetje në mënyrë të tërthortë, apo dhe mundësinë

të cilin e ka i pandehuri në faza të caktuara të procedurës penale t'i komentojë dhe kundërshtojë provat e paraqitura nga prokurori i shtetit, apo dhe ato të cilat janë marrë gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, e të cilat kanë mundur të vijnë si propozim i vet gjykatës me qëllim që çështja e caktuar penale të trajtohet mbi bazën e parimit për zbulimin e të vërtetës.

2.2.1. *"Barazia e armëve"* gjatë rrjedhës së procedurës penale

"Barazia e armëve" si parim i pranuar në procedurat penale bashkëkohore nuk gjen zbatim vetëm nga momenti i paraqitjes së aktakuzës, apo nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor, por nis së zbatuari nga momenti kur i pandehuri kupton se ndaj tij janë ndërmarrë veprime të caktuara që lidhen me dyshimin apo akuzën për përfshirje në ndonjë vepër penale. Pra, parimi i *"barazisë së armëve"* bëhet i zbatueshëm edhe gjatë zhvillimit të procedurës paraprake dhe nuk mund të kufizohet vetëm në paraqitjen e të pandehurit përpara gjykatës kur ndaj tij ngritët aktakuzë. Vet konceptimi i *"barazisë së armëve"* është t'i ofrojë mundësi të pandehurit të mos ketë pozitë të pafavorshme në raport me prokurorinë e shtetit, gjë që kjo përfshinë tërësinë e procedurave gjyqësore, përfshirë edhe procedurën paraprake.

Në përputhje me parimin e *"barazisë së armëve"* që buron nga neni 6 § 3 i KEDNJ dhe neni 31, paragr. 4 i Kushtetutës, KPP ka dhënë zgjidhje të atilla që garantojnë këtë parim të rëndësishëm procedural. Prokurori përkundër autorizimeve të cilat i ka në procedurë, është veshur me përgjegjësi shtesë që në situata të caktuara duhet të veprojë në raport me të pandehurin. Në pjesën e parë të KPP-së, është përcaktuar si rregull në nenin 7, paragr. 2, që gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Parimi i *"barazisë së armëve"* shprehet në nenin 11 të KPP-së, ku trajtohet përshtatshmëria e mbrojtjes. Vet emërtimi i këtij neni nënkupton që mbrojtja nuk duhet të jetë

thjeshtë formale dhe teorike, gjë që varësisht nga natyra e rastit ajo para së gjithash duhet të jetë efektive dhe e përshtatshme. Sikurse e përmendem më sipër, mbrojtja profesionale do të duhet të balancojë raportin e palëve në procedurë penale. Në përmbajtje të kësaj dispozite, të pandehurit i jepet të drejtë në kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, gjë që është në funksion të respektimit të parimit të *"barazisë së armëve"*, pasi mbrojtja nuk duhet të jetë thjeshtë formale apo sipërfaqësore, por duhet të jetë konkrete dhe efektive, gjë që kërkon kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe qasje në dëshmitë që vërtetojnë faktet si në dëm ashtu dhe në dobi të të pandehurit.

Sipas nenit 14, paragr. 2 të KPP-së përcaktohen rregullat për përdorimin e gjuhës në procedurë penale. Personi që merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Sipas neni 14 të KPP-së, obligohen organet gjyqësore që nga momenti i arrestimit dhe në vazhdimësi të procedurës penale, të pandehurit që nuk flet dhe kupton ndonjë nga gjuhët zyrtare në Kosovë, duhet siguruar përkthim adekuat. Përdorimi i gjuhës nuk është thjesht një e drejtë e një personi dhe mundësi diskrecionale e tij të shfrytëzojë atë apo jo. Është domosdoshmëri që procedura penale të zhvillohet ndershëm dhe të vihen në pah gjithë elementet relevantë, në këtë rast të dëgjohet i pandehuri dhe të ketë mundësi të paraqes çështjen e tij para gjykatës. *"Barazia e armëve"* nënkupton dhe të drejtën e të pandehurit vis-à-vis prokurorit të paraqet çështjen e tij sipas gjuhës që e kupton ai pa kushte. Sipas nenit 14, paragr. 6 të KPP-së, përcaktohet që për shtetasit e huaj që ndodhet në paraburgim, se ata mund t'i dorëzojnë gjykatës parashtresat në gjuhën e tij para, gjatë dhe pas shqyrtimit gjyqësor vetëm sipas kushteve të reciprocitetit. Kjo edhe mund të jetë një nga dispozitat të cilat e cenojnë parimin e *"barazisë së armëve"*. Përdorimi i gjuhës nga i pandehuri nuk duhet kufizuar me çështje të caktuara dhe të vendosen kushte. Duke ditur se reciprocitetit i paraprinë një marrëveshje ndërshtetërore, dhe në rastin më të keq shteti që i përket shtetasi nuk ka marrëveshje të njëjtë me shtetin e Kosovës, atëherë i pandehuri mund të jetë viktimë e cenimit të të drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur secili i pandehur çështjen e tij, është një nga elementet të cilat e ndërtojnë parimin e *"barazisë së armëve"* dhe se pamundësia e pandehurit për t'u dëgjuar

për shkak të gjuhës cenon *"barazinë e armëve"* ne procedurë, duke cenuar në këtë mënyrë edhe vet interesat e drejtësisë.

"Barazia e armëve" dhe kontradiktoriteti vërehen dhe në fazën e lëshimit të urdhrave dhe vendimeve nga gjyqtari i procedurës paraprake, ku palët në procedurë kanë mundësi të njëjta dhe t'i kundërshtojnë të njëjtat sipas procedurës përkatëse në përputhje me dispozitat që lidhen me neni 24 të KPP-SË. Materialet të cilat janë pjesë përbërëse e dosjes së akuzës, duhet t'i dorëzohen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës. Sipas dispozitës së nenit 244, paragr. 1 të KPP-së, jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit materialet ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit. Materialet e tilla janë sikurse në vijim:

1) Procesverbalet mbi deklarimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri;

2) Emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshmim dhe çdo deklarim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë;

3) Të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje;

4) Rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen;

5) Kallëzimet penale dhe raportet e policisë dhe

6) Përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.

Ndërsa, sipas nenit 244, paragr. 2 dhe 3 të KPP-së, përveç obligimit të mësipërm të cilin e ka prokurori ndaj të pandehurit, në këtë fazë gjithashtu edhe deklarimet e dëshmitarëve i vihen në dispozicion të pandehurit në gjuhën që ai e kupton dhe e flet. Gjithashtu, pas ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit çfarëdo materiali të ri të paraparë në nenin 244, paragr. 1, brenda dhjetë ditëve nga pranimi i tyre. Në këtë mënyrë, sigurohet dhe *"barazia e armëve"* në procedurë. Me praninë e prokurorit të shtetit dhe të pandehurit në shqyrtimin

fillestar, plotësohet dhe një kusht që palët të jenë të barabarta. Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues dhe njëherë kontrollon se nëse prokurori i ka dorëzuar gjithë materialet tek i pandehuri. Në përputhje me dispozitën e nenit 249 të KPP-së, i pandehuri mund t'i kundërshtojë provat mbi bazën e të cilave mbështetet aktakuza, ndërsa në kundërshtimin e paraqitur, prokurorit të shtetit i lejohet të paraqes përgjigje. Ndërsa, me dispozitën e nenit 250 të KPP-së, të pandehurit i mundësohet kërkesë për hudhjen e aktakuzës, në lidhje me këtë, prokurorit të shtetit përsëri i mundësohet të bëjë kundërshtim.

"Barazia e armëve" është e shprehur gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale dhe mundësia për të shprehur qëndrimet e veta palët në procedurë, janë të shumta dhe parimisht të barabarta, duke plotësuar qëllimin e parimit të kontradiktoritetit. Modeli i tanishëm i KPP-së me anime nga sistemi akuzator ka gjenezën nga viti 2004 kur hyri në fuqi Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, duke paraqitur për herë të parë për prokurorët, mbrojtësit dhe gjyqtarët e Kosovës modelin akuzator të drejtësisë penale (Funk, 2006, f. 7). Ndërsa me zgjidhjet e ofruara me KPP të hyrë në fuqi më 2013, është përforcuar edhe më shumë modeli akuzator i pranuar më herët. Pasi vet palët kanë në dorë çështjen që është objekt gjykimi, zgjidhjet e dhëna janë në funksion të përmirësimit të pozitës së të pandehurit në procedurë penale, duke i mundësuar atij të paraqes çështjen në mënyrën më të mirë të mundshme. Sikurse shprehet autori kroat Krapac (2010, f. 149), se a do t'i shfrytëzojë dhe sa do t'i shfrytëzojë këto të drejta, varet nga vet i pandehuri, pasi gjykata nuk ka obligim të nxisë të atë të ndërmerr veprime të caktuara për të paraqitur çështjen e tij para gjykatës, p.sh. që të propozojë marrjen e provave të caktuara apo veprime të tjera. Mirëpo, edhe pse gjykata parimisht paraqitet si arbitër i paanshëm, ajo përveç që përcakton korrektësinë e kërkesave të paraqitura nga palët, roli aktiv i saj mund të rritet në shqyrtimin gjyqësor, ku gjykata me vetiniciativë mundet të propozojë marrjen e ndonjë prove të caktuar, duke e vlerësuar si të domosdoshme, apo dhe të nevojshme, në rastet kur interesat e drejtësisë e kërkojnë të njëjtën. Është cilësi përcaktuese e sistemit akuzator që procedurat duhet të jenë në duar të palëve. Janë palët dhe jo gjykata, që vendosin se si do të paraqitet rasti, dukë përfshirë se cilat dëshmi do të paraqiten, cilët dëshmitarë do të thirren dhe cilat teori duhet argumentuar. Ky model i

procedurës penale i përqendruar tek individi, gjithashtu bart obligime shtesë, duke kërkuar një metodë më dinamike të përgatitjeve për gjykim dhe përgatitje të rastit (Funk, 2006, f. 7).

2.2.2. E drejta e të pandehurit për të propozuar dëshmitar, ekspertë dhe prova të tjera

I pandehuri në mënyrë të pavarur, ose në bashkëpunim me mbrojtësin e tij, ka të drejtë të propozojë dëshmitar, ose prova të tjera të cilat i vlerëson në dobi të tij. Duke ditur se sistemi i organizimit të gjykimit sipas të drejtës sonë të procedurës penale është e ndarë në disa etapa të veçanta, atëherë të pandehurit dhe mbrojtësit i lejohet të bëjë propozime të bazuara. Në procedurën paraprake, i pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të paraqes kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen e tij, nëse prokurori i shtetit refuzon, i pandehuri mund të kundërshtojë këtë vendim tek gjyqtari i procedurës paraprake. I pandehuri mund të merr dhe të paguajë vetë për ekspertizë, ndërsa eksperti duhet të veprojë në pajtim me nenin 138 të KPP-së dhe prokurori duhet të pranojë kopjen e raportit të ekspertit të mbrojtjes brenda 14 ditëve nga përfundimi i saj (KPP, neni 141, paragr. 1 dhe 2).

Sikurse prokurori, ashtu edhe i pandehuri ka të drejtë të propozojë dëshmitarë, ekspertë dhe prova të tjera. Kjo e drejtë, nuk është që të balancojë mundësitë ndërmjet palëve, apo kundërvënie ndaj prokurorit të shtetit, por ajo ka një qëllim përmbajtësor, sepse i jep shans të barabartë të pandehurit që të paraqesë çështjen e tij para gjykatës.

Gjithashtu, në shqyrtimin e dytë, sikurse përcaktohet me nenin 256 të KPP-së, mbrojtja në mes tjerash mund t'i paraqesë prokurorit të shtetit dëshmi apo materiale sikurse në vijim:

1) njoftimin për qëllimin e prezantimit të alibit, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër që e mbështet alibinë;

2) njoftimin për qëllimin e prezantimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo prove tjetër që e mbështet arsyen e tillë dhe

3) njoftimin për emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar.

Në lidhje me këtë dispozitë, ashtu edhe sikurse theksojnë Sahiti et al., autorë të Komentarit të Kodit të Procedurës Penale, kjo e drejtë i është dhënë vetëm mbrojtësit që përfaqëson të pandehurin, por jo edhe vet të pandehurit si palë në procedurë. Detyrimi i mbrojtjes për të njoftuar prokurorin e shtetit në këtë fazë të procedurës me materialin provues me të cilin disponon para së gjithash kontribuon në zhvillimin efikas dhe të shpejtë të procedurës penale (Sahiti et al. 2014, fv. 664-665). Paraqitja e materialeve nga mbrojtja i kontribuon *"barazisë së armëve"* në procedurë penale, pasi konceptualisht *"barazia e armëve"* duhet të jetë reciproke ndërmjet palëve dhe jo edhe si e njëanshme, duke shikuar çdoherë interesin e të pandehurit, por duhet shikuar dhe interesin e drejtësisë në përgjithësi.

Pamundësia që vet i pandehuri në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejt dhe jo nëpërmes mbrojtësit, të paraqes prokurorit të shtetit dhe gjykatës, dëshmi dhe informacione të tjera që i vlerëson të rëndësishme për çështjen e tij, mund të cenon drejtpërdrejt parimin e *"barazisë së armëve",* pasi në zgjidhjen e dhënë për këtë dispozitë, të pandehurit nuk i ofrohet mundësi në mënyrë të njëjtë ta paraqes çështjen e tij, sikurse prokurorit të shtetit. Pavarësisht se një mundësi e tillë ju ka dhënë mbrojtësit që të paraqes material provues në emër të të pandehurit, duhet ditur se KPP ka përcaktuar se jo në të gjithë rastet mbrojtja është obligative dhe nëse tek mbrojtja fakultative i pandehuri nuk ka angazhuar mbrojtës, atij mund dhe t'i cenohet e drejta në barazi të mjeteve, gjë që bie në kundërshtim me vet parimin e gjykimit të drejtë. Barazia e mjeteve si një nga elementet të cilat duhet përcjellë gjithë procedurën penale duhet të jetë e pakufizueshme.

Përkundër mundësisë që gëzon mbrojtësi në emër të të pandehurit të paraqesë materiale dhe dëshmi në shqyrtimin e dytë, në shqyrtimin kryesor palëve u jepet mundësi që të propozojnë dhe të paraqesin prova dhe fakte të reja të cilat nuk i kanë prezantuar gjatë zhvillimit të mëhershëm të procedurës penale. Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara (KPP, neni 288, paragr. 1). Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues aprovon kërkesën e parashtruar nëse dëshmitari i ri, eksperti i ri apo prova e re ka qenë e panjohur në kohën e shqyrtimit të

dytë, ose nuk e përsërit në mënyrë të konsiderueshme dëshmitarin, ekspertin apo provën tjetër dhe e drejta e të pandehurit në gjykim të drejtë mund të dëmtohet duke refuzuar kërkesën (KPP, neni 288, paragr. 1).

Gjyqtari e fton të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe e udhëzon se mund të paraqesë fakte, t'u shtrojë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje dhe të jep shpjegime rreth deklarimeve të tyre (KPP, neni 323, paragr. 1). Ndërsa, me dispozitën e nenit 329, paragr. 3, trajtohen rregullat e përgjithshme të paraqitjes së provave, dhe përcaktohet se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët dhe i dëmtuari mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe të përsërisin propozimet të cilat më herët janë refuzuar. Përveç të drejtës të propozojë dëshmitar, i pandehuri ka të drejtë që dëshmitarin e propozuar të merr në pyetje në seancën e shqyrtimit kryesor (KPP, neni 333, paragr. 1). Pas marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarit, pala e cila ka propozuar dëshmitarin, në këtë rast i pandehuri, ka mundësinë që t'i parashtrojë pyetje të cilat sqarojnë dëshminë e paqartë, shpjegojnë mospërputhjet në dëshmi, dyshimet lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo çfarëdo paragjykimi që dëshmitari mund të ketë (KPP, neni 335). Në rast se në shqyrtimin kryesor prezanton eksperti që është propozuar nga gjykata apo pala akuzuese, i pandehuri sipas nenit 341, ka të drejtë të merr në pyetje në mënyrë të tërthortë. Përveç kësaj, i pandehuri mund të bëjë pyetje dhe të bashkëpandehurve të tjerë që janë pyetur përpara tij. Gjithashtu deklarimet e mëparshme të bashkëpandehurve gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të përdoret nga i pandehuri në marrjen e tërthortë në pyetje të tyre (KPP, neni 347, paragr. 1 dhe 2).

Duhet theksuar se e drejta e të pandehurit për të propozuar dëshmitar, ekspert dhe prova të tjera nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe absolute. Propozimi duhet të jetë i bazuar dhe nuk duhet të bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të provave të përcaktuara me rregullat e KPP-së. Pavarësisht se palët kanë propozuar prova në shqyrtim gjyqësor, është përgjegjësi e gjyqtarit t'i trajtojë, apo dhe mund të refuzohen inter alia nëse:

1) marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme;

2) fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar;

3) prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme; ose

4) kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën (KPP, neni 258, paragr. 1 dhe 2).

Lidhur me këtë, GJEDNJ ka vendosur standarde të larta lidhur me refuzimin e marrjes së provave, sa që obligon juridiksionet nacionale që të ndjekin procedura të qarta dhe të ligjshme për çështjen e refuzimit të propozimeve për marrjen e provave të caktuara. Në çështjen *Vidal kundër Belgjikës*, ku GJEDNJ vendosi që autoritetet gjyqësore belge në kundërshtim me parimin e *"barazisë së armëve"* kanë kundërshtuar marrjen e dëshmive të katër dëshmitarëve të propozuar nga i pandehuri, pasi autoritet nuk kanë dhënë arsye për refuzim. Gjykata erdhi në përfundim se autoritetet gjyqësore edhe pse nuk janë të obliguara të dëgjojnë secilin dëshmitar të propozuar, mirëpo marrë parasysh parimin e *"barazisë së armëve"* ndërmjet palëve në procedurë, ato duhet që për refuzimin e propozimeve për dëshmitarë të japin arsye të bazuara. Në këtë rast gjykata nuk ka prejudikuar çështjen e rezultateve përfundimtare që do të ishin në rast se do të aprovohej kërkesa për të sjellë në gjykatore për të dëshmuar këta dëshmitar, por thekson se janë cenuar të drejtat e *"barazisë së armëve"*, pasi janë refuzuar arbitrarisht, pa dhënë shpjegime të qarta për arsyet pse këta dëshmitar janë refuzuar (shih: Vidal v. Belgjika, GJK, 1992, paragr. 9).

Ndërsa në rastin *Bajrush Xhemajli kundër Gjykatës Supreme*, kërkuesi ka kontestuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të marrë nga Gjykata Supreme, duke pretenduar se të gjithë instancat gjyqësore, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, i kanë cenuar atij të drejtën për të propozuar ekspertë, pas që në vazhdimësi i janë refuzuar kërkesat i tij, me pretendimet se është e panevojshme kur ekziston ekspertizë që prezanton të vërtetën faktike për çështjen që është objekt i gjykimit, ekspertizë kjo e marrë gjatë fazës së zhvillimit të hetimeve. I pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe me ushtrimin e mjeteve juridike, ka kontestuar në vazhdimësi të gjeturat e prezantuara në ekspertizën e vetme. Bazuar në kërkesën e të pandehurit, gjykatat kanë dështuar t'i garantojnë atij të drejtën për *"barazi të armëve"* në procedurë dhe është vendosur në pozitë të pabarabartë vis à vi prokurorit të shtetit. Gjykata, gjatë trajtimit meritor të rastit, inter alia konsideron se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, është shkelur për shkak se dështimi për t'i lejuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës për kundër-ekspertizë cenoi të drejtat e

mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurave në tërësi dhe e privuan parashtruesin nga mundësia për të paraqitur argumente në mbrojtjen e tij në të njëjtat kushte si të prokurorisë (Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme, GJK, 2013, paragr. 106). Për këto mangësi në trajtimin e provave në rastin e parashtruesit, gjykata ka konstatuar se, kur shikohet si tërësi drejtësia e procedurës penale në rastin e parashtruesit, nuk mund të thuhet se ai ka përfituar nga një *"gjykim i drejtë"* sipas nenit 6 te KEDNJ-se dhe sipas nenit 31 të Kushtetutës (Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme, GJK, 2013, paragr. 105).

2.2.3. Kontradiktoriteti në procedurat shqyrtuese të dëshmitarëve, ekspertëve dhe e drejta e të pandehurit për të kundërshtuar dhe komentuar provat

Sikurse e trajtuam më sipër, i pandehuri duhet të gëzojë mundësi të barabarta me prokurorin dhe se e drejta për *"barazi të armëve"* ndërmjet tyre duhet të vihet në pah gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale. Përveç të drejtës për *"barazi të armëve",* i pandehuri gëzon të drejtën t'i sfidojë dëshmitë e prezantuar nga prokurori në procedurë penale, duke pasur mundësi të përmbushet parimi i kontradiktoritetit apo siç njihet edhe ndryshe si parimi kundërthënës. Në pjesën e mësipërme përderisa trajtuam të drejtën e të pandehurit për të propozuar dëshmitar, ekspertë dhe prova të tjera, përmbushet parimi i *"barazisë së armëve"*, si një nga elementet themelore të gjykimit të drejtë, ndërsa në rastin e tanishëm, e drejta e të pandehurit që të sfidojë dëshmitë e propozuara nga prokurori, sikurse është pyetja e dëshmitarit, ekspertit dhe kundërshtimi dhe komentimi i provave të tjera, përveç përmbushjes së parimit të *"barazisë së armëve"*, shpreh edhe parimin e kontradiktoritetit.

GJEDNJ është shprehur në një mori vendimesh të nxjerra për konceptin e kontradiktoritetit në procedurë penale, gjë që ka vendosur disa standarde të vlefshme për të. Në çështjen *Krčmář dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (2000), kjo gjykatë thekson se:

"Koncepti i një procesi të drejtë gjyqësor nënkupton të drejtën për procedime kontradiktore, sipas të cilave palët duhet të kenë mundësinë jo vetëm që të bëjnë të ditur ndonjë dëshmi të nevojshme për pretendimet e tyre, por gjithashtu ato kanë të drejtë të kenë njohuri

dhe të komentojnë të gjitha provat ose vërejtjet e paraqitura, me qëllim që të ndikojnë në vendimin e gjykatës" (paragr. 40).

Në këtë kontekst, për të përmbushur parimin e kontradiktoritetit, KPP ka paraparë disa rregulla që lidhen me disa të drejt të pandehurit për shqyrtimin e parë, shqyrtimin e dytë, si dhe shqyrtimin kryesor. Sipas nenit 249, paragr. 1, i pandehuri para shqyrtimit të dytë, mund të paraqesë kundërshtimin e provave të përmendura në aktakuzë, duke u bazuar arsyet si në vijim:

1) provat nuk janë administruar në mënyrë të ligjshme;

2) provat janë në kundërshtim me rregullat e marrjes së provave sipas KPP-së dhe

3) ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pa-mbështetshme.

Për të përmbushur parimin e kontradiktoritetit, e veçanërisht parimin e *"barazisë së palëve"* në procedurë penale, KPP parasheh këto mundësi për të pandehurin:

- Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri sipas arsyeve të bazuara mund të paraqesë kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe ka të drejtë të paraqesë ankesë për vendimin lidhur me kërkesën e parashtruar (neni 250);

- Gjyqtari kompetent duhet të udhëzojë të pandehurin për të drejtat e tij (neni 323)

- Mund të propozojë dëshmitarë për të kundërshtuar dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria (neni 331)

- Të merr në pyetje në mënyrë të tërthortë dëshmitarin e propozuar nga prokuroria apo ekspertin përkatës (neni 334 dhe neni 341)

- T'i bëjë pyetje të bashkëpandehurve të tjerë që janë pyetur përpara tij dhe deklarimet e mëparshme të tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor mund t'i përdorë në marrjen e tërthortë në pyetje të tyre (neni 347).

- Gjatë zhvillimi të shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht në fjalën përfundimtare, i pandehuri ka të drejtë të paraqesë personalisht argumente për mbrojtjen e tij dhe mund të komentojë pretendimet e prokurorit dhe palës së dëmtuar. Prokurori dhe i dëmtuari kanë të drejtë të përgjigjen në mbrojtje, kurse mbrojtësi apo i akuzuari kanë të drejtë që këto përgjigje t'i komentojnë. Gjithmonë i fundit e merr fjalën i akuzuari (neni 355, paragr. 1, 3 dhe 4).

KPP ka përfshirë zgjidhje të qëndrueshme duke harmonizuar parimin e *"barazisë së armëve"* dhe njëkohësisht duke i dhënë hapësirë të nevojshme qëndrimeve kontradiktore. Ky koncept është përafruar me zgjidhjet ligjore që ekzistojnë në të drejtën e procedurës kontestimore kur palët kanë rastin në dorën e tyre.

2.2.4. Shqyrtimi i *"dëshmitarëve anonimë"* dhe efektet e dëshmisë së tyre

Çështja e përdorimit të dëshmive nga dëshmitarët ndaj të cilëve kërkohet t'u ruhet anonimiteti në procedurë penale, është nga nga temat më të diskutueshme në teorinë e procedurës penale, kjo pasi në shumë trajtime shfaqen shqetësime për të drejtat e mbrojtjes që i takon të pandehurit të parapara me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 14 të PDCP-së, apo nenin 31 të Kushtetutës. Motivimi i dëshmitarëve për të dëshmuar në një çështje penale, është një nga çështjet më të rëndësishme dhe prokurorët janë të interesuar që rastet që i ndërtojnë ata me dëshmitar të caktuar t'i paraqesin para gjykatës dhe me dëshmi mbështetëse të provojnë në gjykatë përgjegjësinë penale të të pandehurit. Frika nga hakmarrja dhe rreziku i drejtpërdrejt që mund t'i kanoset personalisht dëshmitarit, apo familjarëve të tij, përbënë dekurajim që dëshmitarët të paraqiten në gjykatore apo me identitetin e tyre të zbuluar të japin dëshmi për përfshirjen e dikujt në veprime të kundërligjshme.

Disa nga format e kriminalitetit, e veçanërisht krimi i organizuar mbart mundësinë e natyrshme të kërcënimit dhe frikësimit të dëshmitarëve, meqë i pandehuri apo bashkëpunëtorët e tij, haptazi ose më në mënyrë të fshehtë, kërcënojnë, frikësojnë ose shtrëngojnë dëshmitarët për të heshtur ose për të tërhequr deklaratat e dhëna në polici. Përveç kërcënimit të jetës së individëve dhe sigurisë personale, marrë parasysh rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit për ndjekjen dhe dënimin e suksesshëm të ndonjë të pandehuri, kërcënimi i dëshmitarëve komprometon vet sundimin e ligjit. Për të inkurajuar dëshmitarët për të dëshmuar, autoritetet shtetërore mund t'i përgjigjen kësaj dukurie në mënyra të shumta, të tilla janë mundësitë kur deklaratat e marra në procedurë paraprake mund të paraqiten dhe të mbështetën në gjykatë me prova tjera; dëshmitarët mund të shfaqen nga distanca dhe mund të

japin dëshmi me video-lidhje të drejtpërdrejta; mund të marrin pjesë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve apo mund t'i nënshtrohen marres së anonimitet të plotë (Campbell, 2008, f. 1). Këto janë disa nga zgjidhjet e mundura, edhe pse asnjëherë shteruese.

Për t'u siguruar që të pandehurit në procedurë penale i ofrohet gjykim i drejtë në përputhje me nenin 6 të KEDNJ, GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka vendosur disa standarde që kërkohen të respektohen nga autoritetet shtetërore, pasi pranueshmëria e dëshmisë së dëshmitarëve anonimë varet nga tri kushte:

1) duhet të ketë arsye të mjaftueshme për të garantuar anonimitetin e dëshmitarit;

2) duhet pakësuar maksimalisht cenimet e të drejtës për mbrojtje, që dëshmitari paraprakisht të dëgjohet nga një gjykatës i paanshëm që vendos urdhrin dhe të caktojë besueshmërinë e tij. Që mbrojtja të ketë të drejtën që drejtpërdrejt të merr në pyetje në prani të palëve dhe gjyqtarit, por nuk është e domosdoshme që mbrojtja të dijë dhe reagimet e dëshmitarit dhe

3) vendimi përfundimtar për çështjen penale nuk duhet bazuar vetëm dhe as në një masë të madhe në deklarata anonime (Pradel, Corstens, & Vermeulen, 2009, f. 387).

Një nga diskutimet lidhur me dëshminë e dëshmitarit që paraqitet me anonimitet të plotë, është ngritja e dilemave për besueshmërinë e dëshmitarit. Besueshmëria, që në disa raste mund të matet në rrafshin personal, është e pamundshme të jetësohet në rastet kur dëshmitari është anonim. Për faktin që mbrojtja është e kufizuar për të shqyrtuar besueshmërinë e dëshmitarit në këtë aspekt, mbrojtjes i cenohen të drejtat e saj në procedurë, përkatësisht i cenohet parimi i kontradiktoritetit, si një nga kriteret themelore të garantuara sipas nenit 6 § 3 (d) të KEDNJ-së. Kontradiktoriteti jetëson standardet për një procedurë penale të ndershme.

Në këtë kontekst, edhe në procedurën penale në Kosovë janë adresuar çështjet lidhur me sigurinë e dëshmitarëve. Zgjidhjet për këtë mund t'i gjejmë në KPP dhe Ligjin nr. 04/-L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve (2011). Në kapitullin XIII të KPP-së, parashihet mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, përkatësisht sipas nenit 221, paragr. 4 parashihet që gjyqtari mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin. KPP parsheh dy lloje të anonimitetit: anonimiteti për publikun (neni 223) dhe

anonimitetin ndaj të pandehurit dhe mbrojtësin e tij (neni 224). Arsyet e mjaftueshme të përmendura si kriteri i parë nga praktika e GJEDNJ për të siguruar pranueshmërinë e dëshmitarëve anonimë, janë adresuar në të dyja rastet e anonimitetit, ku përveç tjerash sipas KPP-së gjyqtari duhet që të çmojë rrezikun që i kanoset dëshmitarit apo anëtarëve të familjes, të vlerësojë rëndësinë e dëshmisë dhe besueshmërinë e dëshmitarit, si dhe të vlerësojë nevojën për të përcaktuar anonimitetin në raport me publikun dhe mbrojtjen. Në të dyja rastet, KPP parasheh një procedurë të veçuar gjatë së cilës gjyqtari ka për obligim të vërtetojë relevancën e dëshmisë për çështjen penale dhe të vlerësojë rrezikun real për të paraparë mbrojtje të domosdoshme për dëshmitarin.

Sipas nenit 331 të KPP-së, kërkohet që të gjithë dëshmitarët e propozuar nga palët, sipas një radhe të përcaktuar duhet të paraqiten për të dhënë dëshmitë e tyre në shqyrtim gjyqësor, gjë që nuk përjashtohet mundësia që të mos dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor dëshmitarët ndaj të të cilëve është urdhëruar anonimiteti nga publiku, apo nga i pandehuri apo mbrojtësi. Sikurse çdo dëshmitar tjetër, edhe këta i nënshtrohen rregullave për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të përcaktuar me nenin 332, 333, 334 apo 335 të KPP-së. Në këto raste, nuk guxon të rrezikohen të drejtat e mbrojtjes sa i përket shqyrtimit të dëshmitarit lidhur me kredibilitetin e dëshmisë së tij, apo besueshmërinë personale të tij si dëshmitarë. Në këto raste, pyetjet dhe kërkesat ndaj dëshmitarit anonimë, nuk duhen adresuar sa i përket zbulimit të identitetit të tij personal apo familjar. Përderisa i pandehuri apo mbrojtësi i tij janë të kufizuar sa i përket shqyrtimit të dëshmitarit për disa aspekte të shqyrtimit, KPP i ka marrë në konsideratë këto aspekte dhe ka vënë rregull në nenin 262, paragr. 3, ku parasheh që gjykata nuk mund të shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin. Në këtë rast, ligjvënësi ka vënë rezervat e veta vetëm tek dëshmitarët që janë anonimë nga i pandehuri dhe jo edhe ndaj atyre që janë anonimë edhe nga publiku, Është me rëndësi se kjo dëshmi nuk ka vlerë provuese të njëjtë sikurse për dëshmitarët të cilëve nga i pandehuri apo mbrojtësi në procedurë penale u dihet identiteti.

Me trajtimet e mësipërme, mund të shohim se KPP ka mishëruar praktikën e vendosur nga GJEDNJ lidhur me kriteret nën të cilat duhet vlerësuar dëshmia e dëshmitarëve anonimë, si

dhe ka konceptualizuar në masë të mjaftueshme dispozitat që janë relevante për mbrojtjen e dëshmitarëve, por edhe për mundësinë që gëzon mbrojtja për të ushtruar të drejtat e saj edhe kur ka kufizime të natyrës së tillë.

3. E drejta për mjete juridike

3.1. Funksionet dhe rëndësia e të drejtës për mjete juridike

E drejta e ushtrimit të mjetit juridik mund të shihet nëpërmes disa funksioneve. Funksioni parësor i mjeteve juridike është mbrojtja nga gabimet e mundshme të drejtësisë. Pasi i pandehuri mund të dënohet gabimisht, provat mund të mos vlerësohen siç duhet, të ketë lajthitje në ligj apo fakte, të ketë paragjykime apo tendencë për fabrikime të caktuara, apo me mjet juridik të paraqiten dëshmi shfajësuese të cilat janë kuptuar më vonë dhe arsye të tjera. Së dyti, nëse një i pandehur nuk ka marrë gjykim të drejtë, mjeti juridik ofron mundësi që gjithë pretendimet e tij t'i adresojë në një nivel më të lartë të drejtësisë për t'u trajtuar (Marshall, 2011, fv. 2-3). Funksioni dytësor i mjetit juridik mund të jetë se gjykatat e shkallës së parë bëhen më të qëndrueshme dhe profesionale përderisa kuptohet se vendimet e nxjerra mund të prishen nga instancat më të larta gjyqësore. Funksioni tretësor mund kuptohet që mjeti juridik shërben për funksione të rëndësishme institucionale. Ato sigurojnë legjitimitet në sistemin e drejtësisë penale si tërësi. Besimi i publikut në administrimin e drejtësisë rritet kur nuk ndodhin gabimet dhe kur gjykatat zbatojnë drejtësinë procedurale në mënyrë të drejtë dhe të vazhdueshme. Në përmbajtje, ushtrimi i mjeteve juridike është bërë mënyra me të cilën ata mbahen përgjegjës nga një mbikëqyrjen e organeve më të larta. Funksioni i katërt përkon me mundësinë që mjeti juridik lejon që çështjet e zbatimit të ligjit të bëhen të qëndrueshme dhe konsistente (Marshall, 2011, fv. 3-4).

Me anë të institutit të mjetit juridik, i pandehuri mund t'i adresojë për t'u trajtuar të gjitha pretendimet e tij ankimore në një gjykatë të shkallës më të lartë. Ai mund të gjejë të gjithë pa-përputhshmëritë të cilat janë në mes rregullave të cilat duhet respektuar gjatë

procedurës penale, apo dhe pretendimeve të tjera të cilat përbëjnë bazë për të kundërshtuar aktgjykimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Në procedurën penale nuk është paraparë institut i ankesës që me anë të saj të kërkohet nga gjykata e nivelit të njëjtë gjyqësor për ta trajtuar ankesën e tillë. Sipas legjislacionit në vendin tonë dhe në përputhje me rregullat e parapara në instrumente ndërkombëtare, vendimet e gjykatave të shkallës së parë mund t'i trajtojë vetëm niveli më i lartë se sa niveli i parë dhe asnjëherë këtë gjë nuk mund ta bëjë niveli i njëjtë gjyqësor që ka lëshuar një vendim gjyqësor. Në disa procedura jo-penale, mund të kërkohet që çështja e caktuar të rishqyrtohet nga organi që ka vendosur, ndërsa në procedurë penale kjo zgjidhje nuk është e pranueshme.

E drejta për mjete juridike mund të shpjegohet edhe për shkakun se të drejtat e njeriut nuk janë asnjëherë plotësisht dhe tërësisht të mbrojtura, detyrimi që kanë institucionet shtetërore për t'i respektuar të drejtat e njeriut nuk nënkupton patjetër dhe në çdo rast garantimin e tyre. Për këtë arsye, paraqesin rëndësi mjetet juridike të parashikuara në legjislacionin e një vendi me qëllim mbrojtjen gjyqësore të të drejtave themelore, kur individit nuk i ka mbetur rrugë tjetër për t'i gëzuar ato. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në çdo fazë të gjykimit të zakonshëm, sepse edhe gjykatat janë të detyruara të zbatojnë dhe të respektojnë të drejtat e njeriut (Vorpsi, 2011, f. 15).

Sipas nenit 32 të Kushtetutës, theksohet se i pandehuri gëzon të drejtën për mjete juridike, sikurse: *"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj apo të tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."* Gjithashtu instituti i ankesës me këtë është paraparë në parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, përkatësisht në nenin 102, paragr. 4, ku përcaktohet se: *"Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese"* (Kushtetuta e Kosovës, 2008). Pra, Kushtetuta ka përfillur parimin e dyshkallshmërisë si standard fundamental të së drejtës për gjykim të drejtë. Në këtë pjesë, ky akt është në përputhje me pjesën normative të PDCP-së dhe KEDNJ-së dhe garanton çdo individi të drejtën e tij për të përdorur mjetet juridike për të

ankimuar vendimet e lëshuara nga autoritetet gjyqësore. Mjetet juridike duhet të jenë efikase, praktike, të qasshme dhe nuk duhet të jenë abstrakte dhe teorike. Zaten edhe praktika evropiane për të drejtat e njeriut në jurisprudencën e saj ka vendosur kritere që mjetet juridike të ofruara për të pandehurin, nuk duhen të jenë thjesht mjete juridike formale, abstrakte dhe teorike, ato para së gjithashtu duhet të shërbejnë si instrumente praktike që garantojnë individit efikasitet nga përdorimi i tyre. Kushtetuta përcakton dhe mundësinë e pasjes së mjeteve të jashtëzakonshme juridike, mirëpo nuk precizon se cila do të ishte natyra e veçantë e tyre, duke lënë në diskrecion përcaktimit ligjor për këtë çështje. E drejta e përdorimit të mjeteve juridike nuk përfshihet në përmbajtjen e të drejtës për gjykim të drejtë. Kjo e drejtë përcaktohet si një e drejtë e veçantë, edhe pse në instancë të fundit e drejta për përdorimin e mjeteve juridike është në funksion të drejtësisë procedurale dhe vet arritjes së qëllimit të gjykimit të drejtë. Pavarësisht vendit që mund t'i përcaktohet kësaj të drejtë, qoftë ajo si e drejtë e veçantë, apo element përbërës i të drejtës për gjykim të drejtë, është më me shumë rëndësi qëllimi që arrihet me përdorimin e saj nga i pandehuri në procedurë penale.

3.2. E drejta për të ditur arsyet e vendimit dhe efektet e mos-arsyetimit

Vendimi i dhënë nga një gjykatë kompetente, e pavarur, e paanshme dhe e themeluar me ligj, duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi i dhënë duhet të jetë në përputhje me plotë me të gjeturat gjatë zhvillimit të gjykimit dhe duhet të jetë reflektim i gjithë procesit gjyqësor në çështjen konkrete penale.

Lidhur me këtë, mungesa e arsyetimit të duhur të vendimit në dukje të parë nuk mund të vlerësohet si shkelje e të drejtës për gjykim të drejtë, pasi që taksativisht nuk është pjesë përbërëse e nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 31 të Kushtetutës. Mirëpo, nga praktika e GJEDNJ-së, përkatësisht në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, theksohet se gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre në shkallë të parë. Kjo bënë të mundur që i akuzuari të ushtrojë në mënyrë të përshtatshme të drejtën e ankesës. Mungesa e arsyetimit të përshtatshëm të vendimit, apo vendimi me

arsyetim gjysmak apo pa arsyetuar, cenon të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht vet të drejtën për lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes të përcaktuar me nenin 6 § 3 (b) (Hadjianastassiou v. Greqia, GJEDNJ, 1992, paragr. 33). Përdorimi i mjeteve juridike të dhëna në procedurë penale, nuk duhet të jenë abstrakte, por duhet të jenë efektive me qëllim të arritjes së qëllimit përfundimtar të gjykimit të drejtë. Në çështjen *Van De Hurk kundër Holandës*, GJEDNJ thekson se neni 6 § 1 i Konventës i obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, por nuk mund të thuhet që kërkohet të jepet përgjigje të hollësishme për çdo argument dhe as nuk kërkohet nga GJEDNJ të shqyrtojë nëse argumentet janë përmbushur në mënyrë adekuate (Van De Hurk v. Holanda, GJEDNJ, 1994, paragr. 61).

Në këtë kontekst edhe TPNJ në një nga çështjet e gjykuara në stadin e apelit thekson se kërkesat e Statutit të TPNJ-së për një proces gjyqësor të drejtë përfshijnë të drejtën e të akuzuarit për të pasur një mendim të arsyetuar nga Dhoma Gjyqësore bazuar në nenin 23 te Statutit dhe Rregullën 98 ter (c) të Rregullores. Mendimi i arsyetuar garanton të drejtën për apel të të akuzuarit dhe mundësinë që Dhoma e Apelit të kryejë detyrën e vetë statutore bazuar në nenin 25 për shqyrtimin e këtyre apeleve. Mirëpo kushti për mendimin e arsyetuar ka të bëjë me aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore dhe jo me çdo parashtrim të bërë gjatë procesit gjyqësor (shih: Prokurori v. Limaj dhe të tjerët, TPNJ, 2007, paragr. 81 dhe Prokurori v. Milutinovic, TPNJ, 2009, paragr. 64).

Në përputhje me standardet e përmendura më sipër, sipas KPP-së, në dispozitën nenit 370 (Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim), është paraparë që gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit (paragr. 6). Aktgjykimi i cili nuk është përpiluar në sipas dispozitës së nenit 370, rrjedhimisht nuk ka arsyetim sipas detyrimeve ligjore që dalin nga kjo dispozitë, përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Kjo dispozitë është në përputhje me standardet e përcaktuara nga GJEDNJ, pasi është konceptualizuar në rregullat e procedurës penale. Megjithatë, ashtu edhe sikurse përmendet në këto vendime, sqarimet nuk d.m.th. të jenë tepër sqaruese, po të njëjtat duhet të reflektojnë çdo element të vendimit, përfshirë këtu përgjigjen sqaruese për cilëndo provë të administruar në procedurë penale, analizën e ligjit material dhe procedural, si dhe lidhjen logjike dhe konsistente ndërmjet gjithë zhvillimit të çështjes penale me aktgjykimin e dhënë për çështjen.

3.2. Konceptualizimi i të drejtës për mjete juridike në KPP

3.2.1. E drejta e përdorimit të mjeteve juridike nga i pandehuri sipas KPP-së

Për të evituar gabimet faktike dhe juridike në aktgjykimin e shkallës së parë, në procedurën penale bashkëkohore është miratuar një sistem i mjeteve juridike. E drejta e përdorimit të mjeteve juridike në procedurën penale bashkëkohore është një e drejtë themelore e të pandehurit, ku me realizmin e kësaj të drejtë mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut (Sahiti & Murati, 2016, fv. 399-400). Arsyetimi dhe qëllimi kryesor i ekzistimit të mjeteve juridike është eliminimi i pasojave të vendimeve gjyqësore të padrejta dhe të paligjshme dhe krijimi i kushteve për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm (Sahiti & Murati, 2016, f. 400). Teoria e të drejtës së procedurës penale, varësisht nga qëndrimet teorike, apo rregullimet e veçanta ligjore, mjetet juridike i ka klasifikuar në shumë ndarje. Ndarja me e njohur është në mjete juridike të rregullta dhe në mjete juridike të jashtëzakonshme. Përderisa mjetet juridike të rregullta mund të përdoren derisa aktgjykimi nuk e ka marrë formën e prerë, mjetet e jashtëzakonshme juridike mund të përdoren pasi që aktgjykimi ka marrë formën e prerë. Mjete të rregullta juridike konsiderohet ankesa kundër aktgjykimit (neni 380) dhe ankesa kundër aktvendimit. Ndërsa mjete të jashtëzakonshme juridike sipas klasifikimit tonë ligjore janë: kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe kërkesa për rishikimin e procedurës penale (neni 418). Mjetet juridike të cilat mund t'i gëzojë i pandehuri në procedurë penale, në aspektin formal-procedural përmbushin kërkesat që dalin nga neni 2 § 1 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe neni 14 § 5 të PDCP-së. Të dy instrumentet ndërkombëtare, kërkojnë që shtetet t'u ofrojnë të pandehurve të drejtën për të përdorur mjete juridike të përshtatshme, që vendimi i shkallës së parë të të mund të rishqyrtohet nga një instancë me e lartë gjyqësore. Kjo mundësi ofrohet me anë të mjetit juridik të ankesës. Përveç kësaj, KPP ofron mundësi shtesë për të pandehurin, duke i ofruar mjete juridike të jashtëzakonshme të cilat mund t'i shfrytëzojë për një periudhë kohore më të gjatë se sa ankesa si mjet i rregullt juridik. Mjete juridike duhet të jenë përmbajtjesore, dhe jo thjesht formale dhe

teorike. Mjetet juridike duhet të jenë të njëmendta dhe kërkesa për rishqyrtim të ndikojë esencialisht në eliminimin e lëshimeve për gabimet eventuale faktike dhe juridike.

Kundër aktgjykimit shkallës së parë, ankesë mund të paraqesin prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. (KPP, neni 380, paragr. 1) Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit, ndërsa i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale. Ankesë mund të paraqesë edhe personi, pasuria e të cilit është konfiskuar ose nga i cili është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale, si dhe personi juridik, pasuria e të cilit është konfiskuar (KPP, neni 381).

Sipas nenit 383 të KPP-së, ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë:

1) për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;

2) për shkak të shkeljes së ligjit penal;

3) për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike; ose

4) për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.

Përjashtimisht, ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike kur ka marrëveshje mbi pranim të fajësisë apo kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pranimin e tillë. Ky përjashtim nuk cenon të drejtën për mjet juridik si një e drejt themelore në procedurë penale, pasi vet i pandehuri arrin ujdi që çështja penale të përfundohet me marrëveshje, gjë përjashton dhe mundësinë që për objektin e njohur të marrëveshjes të ushtrohet ankesë, si mjet i rregullt juridik. Pra, me anë të ankesës, i pandehuri ka të drejtë që të atakojë vendimin e shkallës së parë në të gjithë bazat, përfshirë çështjen fakteve dhe ligjit. Ky përcaktim është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare që kërkojnë që mjeti juridik i rregullt kundër vendimit të shkallës së parë, duhet të jetë përmbajtjesor dhe duhet t'i jep

mundësi të pandehurit që vendimi i marrë kundër të tij të rishqyrtohet nga një instancë me lartë gjyqësore.

3.2.2. Gëzimi i gjykimit të drejtë në procedurën shqyrtuese sipas mjetit juridik

Gjykimi në procedurën e apelit duhet të garantojë të njëjtat standarde të gjykimi të drejtë, sikurse garantohen në procedurën e shkallës së parë, pasi gjykimi në shkallën e dytë, është vetëm vazhdim i gjykimit për të njëjtën çështje penale. E drejta për apel nuk është e kufizuar vetëm të drejtën e paraqitjes së ankesës si mjet i rregullt juridik, por përfshihet në kuptimin e gjerë, duke marrë për bazë dhe zhvillimin e vet gjykimit të apelit. Standardet të cilat duhet të përcjellin procedurën e apelit, përfshijnë të drejtën e të pandehurit për kohë të mjaftueshme për të përgatitur apelin, të drejtën për mbrojtës, të drejtën për *"barazi të armëve"*, këtu përfshihet e drejta e të pandehurit për t'u njoftuar me përmbajtjen e ankimimit nëse ka paraqitur prokurori eventualisht ankesë kundër vendimit të shkallës së parë; të drejtën për një seancë para një trupi gjykues kompetent, të paanshëm dhe të pavarur dhe të drejtën për vendim publik brenda një afati të arsyeshëm.

E drejta e të pandehurit për kohë të mjaftueshme për të përgatitur apelin, është një nga standardet themelore të cilat përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë, që buron nga neni 6 § 3 (c) i KEDNJ-së dhe neni 30, paragr. 3 i Kushtetutës. Në lidhje me afatin ligjor për paraqitjen e ankesës në procedurë penale, sipas nenit 380 të KPP-së, i pandehuri dhe palët tjera të autorizuara, mund të paraqesin ankesë brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit të shkallës së parë. Në lidhje me paraqitjen e afatit për ankesë, me Rregulloren e Procedurës dhe Provave të nxjerrë nga TPNJ, është paraparë 30 ditë afat për njoftimin e paraqitjes së ankesës (Rregulla 108) dhe 75 ditë afat për paraqitjen e ankesës nga njoftimi i të drejtës për të ushtruar ankesë (Rregulla 111). Krahasimisht dy procedurat kanë dallime të mëdha në afatin ligjor për paraqitjen e ankesës, gjë që afati ligjor për paraqitjen e ankesës në procedurën penale në vendin tonë mund të jetë shumë i vogël për disa aktgjykime të cilat përfshijnë krime të rënda dhe kanë vëllim të madh në natyrën e çështjes. Afati i shkurtër mund

të cenojë vet parimin e të drejtës për gjykim të drejtë, ku kjo e drejtë përcakton se i pandehuri gëzon të drejtën për kohë të mjaftueshme për të paraqitur mbrojtjen e tij në procedurë penale. KPP nuk ka përcaktuar çështjen e zgjatjes së afatit për paraqitjen e ankesës për shkaqe të arsyeshme, kur rrethanat e çështjes mund të diktojnë afat më të gjatë se sa afati ligjor i përcaktuar prej 15 ditëve. Në dispozitën e nenit 447 të KPP-së, janë përcaktuar bazat për të cilat mund të kërkohet kthimi i afatit në gjendjen e mëparshme, përfshihet çështja e lëshimit të afatit për ndonjë shkak të arsyeshëm nga ana e të pandehurit, e që mund të jenë të natyrave të ndryshme. Afati subjektiv për paraqitjen e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme parashihet 8 ditë, ndërsa afati objektiv parashihet 3 muaj. Megjithatë, kjo dispozitë shprehimisht nuk parasheh dhe çështjen e zgjatjes së afati, por vetëm çështjen e lëshimit të afatit për ndonjë arsye për të cilën gjykata mund të rivendos afatin nëse i pandehuri arrin të bind gjykatën se lëshimi i afatit ka qenë i arsyeshëm. Ashtu edhe siç përcaktohet në dispozitën e nenit 399 të KPP-së, paraqitja e ankesës pas kalimit të afatit prej 15 ditëve për paraqitjen e ankesës, Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të pa-afatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

Lidhur me këtë, neni 6 § 3 (b) i KEDNJ-së është interpretuar duke nënkuptuar se aktiviteti i mbrojtjes substanciale në emër të të pandehurit mund të përfshijë gjithçka që është *"e nevojshme"* për t'u përgatitur. I akuzuari duhet të ketë mundësinë për të organizuar mbrojtjen e tij në mënyrë të përshtatshme dhe pa kufizime, me mundësi për të vënë të gjitha argumentet relevante për mbrojtjen e tij para gjykatës dhe të ndikojë në rezultatin përfundimtar të procedurës (Tarlac Ignatius Connolly v. Britania e Madhe, GJEDNJ, 1996, paragr. 4). Sikurse e përmendëm më sipër në rastin *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, e drejta për ankesë është efektive, nëse i pandehuri brenda një afati të arsyeshëm kohor është njoftuar me arsyet e vendimit të marrë nga shkalla e parë. Dhënia e arsyeve të vendimit, bënë të mundur që i akuzuari të ushtrojë në mënyrë të përshtatshme të drejtën e ankesës. Mungesa e arsyetimit të përshtatshëm të vendimit, apo vendimi me arsyetim gjysmak apo paarsyetuar, cenon të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht vet të drejtën për lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes të përcaktuar me KEDNJ dhe Kushtetutë. Pra, në të dyja vendimet e përmendura, GJEDNJ vë theksin në mbrojtjen efektive që duhet mundësuar të pandehurit në

procedurën penale, e veçanërisht në procedurën e apelit, që i pandehuri në mënyrë të përshtatshme të ketë mundësi t'i ushtrojë të drejtat e tij të mbrojtjes. Nuk mund të thuhet e drejta e ushtrimit të ankesës në afatin prej 15 nga momenti i pranimit të aktgjykimit, është afat në kundërshtim me standardet e parapara ndërkombëtare, por megjithatë nëse e gjykojmë nga një perspektivë objektive, mund të shprehemi se ky afat mund të jetë pengues për raste të caktuara, që për rrjedhojë mund të shkaktojë dëmtime të interesave të të pandehurit në procedurë penale.

Për të ruajtur paanshmërinë në shqyrtimin e mjetit juridik, me nenin 375 të KPP-së është përcaktuar se asnjëra palë nuk lejohet të ketë komunikim në prezencën e vetëm njërës palë me kolegjin shqyrtues, Gjykatën e Apelit apo Gjykatën Supreme lidhur me kundërshtimin apo kërkesën për mjet juridik që pret zgjidhjen nga kolegji shqyrtues, Gjykata e Apelit ose Gjykata Supreme, apo të cilën pala pretendon ta paraqesë te kolegji shqyrtues, Gjykata e Apelit ose Gjykata Supreme. E njëjta rregull vlen për gjyqtarët të cilët nuk duhet komunikuar në çfarëdo mënyrë me palët në procedurë veçmas palës tjetër. Kjo rregull tenton të ruaj pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve dhe të gjykatës, në lidhje me ndikimet e mundshme në marrjen e vendimeve. Kjo normë duhet të respektohet gjatë orarit dhe pas orarit të punës dhe nuk mund të cenohet nga asnjëra palë, përfshirë vet-kufizimin e gjyqtarëve përkatës, për të ruajtur neutralitetin si të paanshëm, dhe për të mbajtur integritetin e pozitës së gjyqtarit dhe pavarësinë e gjykatës si institucion. Mishërimi i kësaj dispozitë në rregullat e KPP-së, obligon gjykatat që në secilin stad të procedurës duhet t'i ofrojnë palëve shanse të barabarta dhe t'u krijojnë hapësirë të përshtatshme për procedurë shqyrtuese që do të vihen në pah elementet e kontradiktoritetit. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka nxjerrë disa vendime, dy nga këto vendime ka konstatuar se janë shkelur parimet e të drejtës për gjykim të drejtë. Në çështjen Shoqëria aksionare *Raiffeisen Bank Kosovë SH. A. kundër Gjykatës Supreme* (2014), kjo gjykatë thekson se njëra nga palët përderisa ka humbur afatin për të ushtruar mjetin juridik, i është drejtuar Gjykatës Supreme për të kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme, gjë që kjo ia është aprovuar një kërkesë e tillë. Për këtë rast, Gjykata Kushtetuese konkludon se pala kundërshtare nuk është njoftuar asnjëherë për efektet e këtij vendimi, derisa sa është njoftuar për rifillimin e procedurës gjyqësore, gjë që ka gjetur se Gjykata Supreme ka dështuar të

njoftojë palën kundërshtare për ushtrimin e mjetit juridik, që rrjedhimisht është shkelur parimi i *"barazisë së armëve"* dhe është cenuar kontradiktoriteti. Ndërsa në çështjen *Shaban Mustafa kundër Gjykatës Supreme* (2012), gjykata thekson se në procedurën sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, Gjykata Supreme ka dështuar të njoftojë palën kundërshtare lidhur me procedurën shqyrtuese sipas mjetit juridik të ushtruar. Për këtë rast, gjykata ka konstatuar se ka pasur cenim të së drejtës për gjykim të drejtë, pasi është dashur të thirrej në procedurë gjyqësore jo vetëm për të pasur njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për të pasur mundësi për t'i parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës.

3.2.3. Efektet e vendimeve të gjykatës së apelit në shqyrtimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e Apelit përveç funksioneve të zakonshme të gjykimit, është edhe kontrolluese e respektimit të të drejtave të pandehurit në procedurë penale. Ajo është instancë e rëndësishme që kujdeset për vendosjen e drejtësisë procedurale dhe eliminimin e të gjithë gabimeve, lëshimeve dhe shkeljeve të cilat mund t'i ketë bërë gjykata e instancës së parë gjyqësore. Roli korrektues i gjykatës së apelit, ndihmon në eliminimin e gabimeve faktike dhe juridike, duke përfillur të drejtën e të pandehurit për vendosje të drejtë dhe të ligjshme të çështjes penale. KPP në përputhje me kërkesat e PDCP-së dhe KEDNJ-së me protokollet shtesë, ofron të pandehurit ankesën si mjet juridik të mund të përdorë që çështja e tij të rishqyrtohet nga një instancë me e lartë gjyqësore. Pra, kjo e drejtë është një nga të drejtat fundamentale që ka i pandehuri në procedurë penale dhe është e mishëruar në dispozitat e KPP-së, si një nga garancionet themelore të drejtësisë procedurale.

E drejta e procedurës penale parimisht qëndron në parimin *tantum devolutum quantum appellatum*, d.m.th. Gjykata e Apelit shqyrton aktgjykimin e shkallës së parë vetëm në kufijtë e përcaktuar me ankesë, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimit nuk ekzaminohet dhe konsiderohet si *res judiciata*. Neni 394 i KPP-së përmban disa përjashtime nga ky parim, pasi Gjykata Apelit sipas detyrës zyrtare shqyrton disa pjesë të aktgjykimit të atakuar, pavarësisht a janë përfshirë

në ankesë apo jo. Kontrolli i tillë quhet *ultra petitum* (shih: Sahiti & Murati, f. 351). Sipas nenit 394 të KPP-së, Gjykata e Apelit shqyrton aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, por çdo herë sipas detyrës zyrtare shqyrton nëse, ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragr. 1 (1), (2), (6) dhe (8), (9), (10), (11) dhe (12): përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi; në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet; aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes; aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme; aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me kriteret të cilat duhet t'i ketë në formën dhe përmbajtjen me shkrim bazuar në nenin 370 të KPP-së. Gjithashtu gjykata e apelit, zyrtarisht shikon edhe nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të akuzuarit në kundërshtim me dispozitat e KPP-së; nëse në çështjen e mbrojtjes së detyrueshme është mbajtur shqyrtimi gjyqësor pa praninë e mbrojtësit; dhe nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Gjykata e Apelit, në disa nga pjesët të cilat përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të KPP-së, sipas detyrimit zyrtar, kontrollon ligjshmërinë e aktgjykimit, duke mos lejuar në këtë mënyrë që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të mbetet në fuqi me të meta juridike të tilla, e të cilat në instancë të fundit cenojnë vet të drejtën për gjykim të drejtë. Ndërsa, në të gjithë pjesët tjera të cilat nuk e ka për obligim të shqyrtojë gjykata e apelit sipas detyrës zyrtare, e shqyrton me kërkesën e palës që ka paraqitur ankesë, në kufijtë e ankesës të cilat i ka përshkruar në mënyrë shkresore. Edhe sipas detyrës zyrtare, edhe me kërkesën e vet të pandehurit në procedurë penale, ankesa si instrument juridik mundëson eliminimin e gabimeve faktike apo juridike të cilat kanë mund të shkaktohen nga gjykata e shkallës së parë.

Bazuar në dispozitën e nenit 398 të KPP-së, vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën ndaj aktgjykimit të gjykatës themelore në seancë të kolegjit ose në bazë të shqyrtimit janë:

1) hedh e ankesën si të paafatshme ose të palejuar;

2) e refuzon ankesën si të pabazë dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore;

3) e anulon aktgjykimin dhe çështjen ia kthen gjykatës themelore për rigjykim dhe vendim; ose

4) e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore.

Sipas nenit 398, paragr. 2 të KPP-së, Gjykata e Apelit mund të urdhërojë gjykatën themelore që të caktojë një tjetër gjyqtar të vetëm gjykues, kryetar të trupit gjykues ose trup gjykues sipas një sistemi të caktimit të lëndëve që të jetë objektiv dhe transparent, nëse Gjykata e Apelit vlerëson se gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues që e ka gjykuar rastin në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka zbatuar ligjin siç duhet, ka vlerësuar shumë gabimisht provat ose mos-caktimi i gjyqtarit apo trupit gjykues tjetër do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë ose konflikt të interesit.

Në të gjithë rastet kur gjykata apelit konstaton se ekzistojnë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, qoftë me shqyrtimin e ankesave të paraqitura, apo kontrollit sipas detyrës zyrtare që bënë gjykata bazuar në dispozitën e nenit 394 të KPP, apo për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, ku në të dy rastet nuk mund të procedohet me ndryshim të aktgjykimit të gjykatës themelore (KPP, neni 403), në raste të tilla, gjykata apelit anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim. Gjykata e Apelit me aktvendim e anulon aktgjykimin e gjykatës themelore edhe refuzon aktakuzën nëse konstaton rrethanat për hudhje të aktakuzës (KPP, neni 358, paragr. 1), apo nëse gjen se gjykata themelore nuk ka pasur kompetencë lëndorë për gjykimin e rastit, përveç kur ankesa është paraqitur vetëm në favor të të akuzuarit. Gjykata e Apelit mund të anulojë pjesërisht aktgjykimin e gjykatës themelore kur pjesë të posaçme të aktgjykimit mund të veçohen pa ndonjë pasojë për gjykim të drejtë (KPP, neni 402, paragr. 2 dhe 3).

Sipas nenit 404 të KPP-së, vendimi i Gjykatës së Apelit duhet arsyetuar. Në arsyetim të aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në arsyetim shënohen dispozitat e shkelura dhe në çka konsistojnë shkeljet, në pajtim me nenin 384 të KPP-së. Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, në arsyetim shënohen të metat në vërtetimin e gjendjes faktike apo

arsyet përse provat dhe faktet e reja janë të rëndësishme dhe me ndikim në marrjen e vendimit të drejtë. KPP ka përafruar zgjidhjet në përputhje me kërkesat që dalin nga praktika e GJEDNJ-së. Cilido vendim që nxirret nga cilado instancë në procedurë penale duhet të arsyetohet, arsyetimi duhet të jetë reflektim i qëllimit të vendimit që duhet t'i përmbajë të gjithë elementet relevante të një vendimit të drejtë dhe të ligjshëm. Ashtu edhe sikurse theksohet në çështjen Hadjianastassiou kundër Greqisë, mungesa e arsyetimit të përshtatshëm të vendimit, apo vendimi me arsyetim gjysmak apo i paarsyetuar, cenon të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht vet të drejtën për lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes të përcaktuar me KEDNJ dhe Kushtetutë. Në këtë kontekst, dobësitë të cilat mund t'i përmbajë vendimi i Gjykatës së Apelit në arsyetim të tij, cenon të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht të drejtën për mjete juridike të jashtëzakonshme. Edhe pse GJEDNJ nuk kërkon nga shtetet që të pandehurit t'i ofrohet më shumë se sa një mjet juridik për të shqyrtuar të gjithë vendimin e shkallës së parë, mungesa e arsyetimit të vendimit të nxjerrë nga Gjykata e Apelit, cenon të drejtën për mjete juridike të jashtëzakonshme, të përcaktuar me të drejtën e brendshme. KEDNJ dhe praktika e GJEDNJ-së, përmbajnë kërkesat minimale të standardeve të cilat duhet t'i ofrohet të pandehurit në procedurë penale, dhe nuk i kufizon shtetet që të pandehurve t'u ofrojë garancione shtesë të cilat mund të begatojnë të drejtën për gjykim të drejtë, jashtë obligimeve të cilat dalin nga Konventa dhe vendimet e GJEDNJ-së.

3.2.4. Favoret e të pandehurit përkitazi me ushtrimin e mjeteve juridike dhe e drejta për ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme

Beneficium Cohaesionis dhe *Reformatio in Peius* janë dy institute të rëndësishme të cilat garantojnë të pandehurit favore në procedurë penale lidhur me të drejtat dhe privilegjet të cilat mund t'i përfitojë. *Beneficium cohaesionis* (beneficioni i bashkëngjitjes), parasheh mundësinë që në rastet kur gjykata sipas ankesës shqyrton mjetin juridik të ushtruar nga ndonjëri nga të akuzuarit për një çështje penale, në përputhje me vendimet të cilat i merr për të pandehurin që ka ushtruar mjet juridik, përshtatshmërisht vendos dhe për të pandehurin tjetër që gjendet në

pozitë të njëjtë, edhe pse nuk ka ushtruar mjetin juridik, apo kërkesat në mjetin juridik të ushtruar nuk korelojnë me përmbajtjen e mjetit juridik të ushtruar nga i bashkëpandehuri tjetër, bazë për të cilën është dhe reflektimi i vendimit në instancë të fundit (Sahiti & Murati, 2016, f. 421). KPP shprehimisht kërkon të respektohet instituti *beneficium cohaesionis* tek ankesa kundër aktgjykimit (neni 397), si mjet i rregullt juridik dhe tek rishikimi i procedurës penale (neni 427) dhe në procedurën sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 436), si mjete të jashtëzakonshme juridike. Burimi i rregullës procedurale *beneficium cohaesionis* gjendet te parimi i drejtësisë dhe i barazisë së personave në cilësinë e të bashkëpandehurve para ligjit. Me anë të këtij favori sigurohet trajtimit i njëjtë i të gjithë të pandehurve në të njëjtën procedurë penale në lidhje me të njëjtën çështje juridike penale. Në këtë mënyrë eliminohet mundësia që të pandehurit të vihen në pozitë të pabarabartë (Murati, 2006, f. 96). Efektet e këtij favori për të pandehurin në procedurë penale, përmbushin kërkesat kushtetuese për barazi para ligjit, të përcaktuara me nenin 3 dhe nenin 24 të Kushtetutës.

Në lidhje me të drejtën të cilën e ka i pandehuri për të ushtruar ankesë, zgjidhjet bashkëkohore të cilat janë përcaktuar në dispozitat procedurale, kanë krijuar siguri për vet të pandehurin që të mos frikësohet të paraqesë ankesë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për të cilën nuk është i kënaqur, mirëpo mund të jetë i pasigurt për ushtrim të ankesës, me ndonjë frikë eventuale se gjykata e instancës më të lartë gjyqësore mund t'ia keqësojë edhe më shumë pozitën e tij procedurale. Në kontekst të kësaj, në dispozitën e nenit 395 të KPP-së, është përfshirë instituti *reformatio in peius*, që i jep siguri të pandehurit se në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi për sa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij. KPP shprehimisht kërkon të respektohet instituti *reformatio in peius* tek ankesa kundër aktgjykimit (neni 395), si mjet i rregullt juridik dhe te rishikimi i procedurës penale (neni 427) dhe në procedurën sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 436), si mjete të jashtëzakonshme juridike.

Edhe pse këto institute nuk janë të përmendura shprehimisht si standarde që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë, sikurse është neni 14 i PDCP-së, neni 6 i KEDNJ-së, neni 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, apo edhe nenin 31 dhe 32 i Kushtetutës, prapëseprapë ato përmbushin kërkesat të cilat dalin nga vet kjo e drejtë. *Beneficium cohaesionis* është në

funksion të së drejtës për barazi para gjykatës, si një nga të drejtat themelore në procedurë penale, ndërsa ndalesa *reformatio in peius* ndihmon të pandehurin që procedura penale të jetë procedurë e drejtë dhe jo-arbitrare, pavarësisht pozitës të cilën e ka prokurori i shtetit si organ shtetëror. Ashtu edhe sikurse e kemi përmendur, këto nuk dalin si kërkesa minimale të përcaktuara me aktet dhe praktikën ndërkombëtare, e veçanërisht ndalesën *reformatio in peius*, por janë institute të rëndësishme të cilat tentojnë të ruajnë qasjen e dinjitetshme ndaj të pandehurit në procedurë penale, duke i garantuar jo vetëm një tërësi të të drejtave minimale, por edhe privilegje të caktuara që përmirësojnë dukshëm pozitën e tij procedurale.

Edhe pse i pandehuri gëzon të drejtën për ankesë, si dhe të privilegjet që i përmendëm, njëkohësisht ai gëzon edhe mjete të jashtëzakonshme penale. Çështja penale edhe pse përfundohet me aktgjykim të formës së prerë, aktgjykimi mund të ndodh të jetë marrë në mënyrë jo të drejtë duke u bazuar në fakte dhe prova të vërtetuara gabimisht, ose gjykata në gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht ka aplikuar ligjin, ose për arsye se rrethanat e reja, për ekzistimin e tyre gjykata ka kuptuar me vonesë, ose të njëjtat janë shfaqur më vonë, pasqyrojnë se gjykata me rastin e vendosjes së çështjes penale nuk ka vendosur sipas kritereve të përcaktuara sikurse do të duhej të vendosej për një çështje penale. Përkundër pikëpamjes se çështja e gjykuar konsiderohet çështje me gjendje faktike të vërtetuar drejtë dhe të gjykuar sipas ligjit, me qëllim që të pengohet zbatimi i vendimeve me të meta të caktuara, KPP përjashtimisht lejon mundësinë e atakimit të aktgjykimeve të formës së prerë me mjete të jashtëzakonshme juridike. Atakimi i aktgjykimit me mjet të jashtëzakonshëm juridik mund të bëhet për shkak të lajthimit të natyrës faktike apo të gabimeve juridike (Sahiti & Murati, 2016, f. 429). Shtimi i mjeteve juridike sikurse janë mjetet juridike të jashtëzakonshme, përmbushin funksionin themelor të drejtësisë që vendimi gjyqësor duhet të jetë i drejtë dhe i ligjshëm. Ushtrimi i këtyre mjeteve juridike, u jep mundësi instancave më të larta gjyqësore për t'i korrigjuar shkeljet e caktuara të rregullave ligjore. Me qëllim që asnjë shkelje e ligjit të mos mbetet si e tillë, procedurat gjyqësore si tërësi, duhet të sigurojnë mjete efikase dhe efektive juridike për të eliminuar shkeljet eventuale të rregullave ligjore.

Nga arsyet e përmendura më sipër, KPP ka përafruar zgjidhjet procedurale, duke i mundësuar të pandehurit mjete juridike shtesë për të kërkuar rishikimin e plotë apo të

pjesshëm të procedurës penale, të bazuar në arsyet ligjore ashtu edhe sikurse janë përcaktuar me rregullat procedurale. Sipas nenit 418 të KPP-së, parashihet që i pandehuri gëzon tri mjete të jashtëzakonshme juridike: rishikimi i procedurës penale (nenet 419 - 428); zbutja e jashtëzakonshme e dënimit (nenet 429 - 431) dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë (nenet 432 - 441). Me përjashtim të rasteve kur me KPP është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar (neni 4, paragr. 2).

E drejta e përdorimit të mjeteve juridike, përfshirë përdorimin e mjeteve juridike të jashtëzakonshëm është një nga të drejtat themelore kushtetuese e paraparë me nenin 32 të Kushtetutës. Kjo dispozitë nuk bënë dallim ndërmjet mjeteve të rregullta juridike dhe atyre të jashtëzakonshme, përkundrazi ajo mjeteve juridike i referohet si tërësi e mjeteve të cilat përcaktohen saktësisht me ligj. Dispozita e tillë kushtetuese nuk kufizohet vetëm në një mjet juridik, ashtu edhe siç thirret neni 14 § 5 i PDCP-së, apo neni 2 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, që kërkojnë nga shtetet palë të këtyre instrumenteve që të pandehurit t'i mundësohet një mjet juridik për të rishqyrtuar vendimin që ka marrë nga gjykata e instancës së parë, por Kushtetuta mjeteve juridike i referohet si tërësi të mjeteve, qofshin ato të rregullta, apo të jashtëzakonshme. Lidhur me rregullimin kushtetues të mjeteve juridike, Kushtetuta në dispozitën e nenit 102, paragr. 5, garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, ndërsa e drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Pra, në kontekstin kushtetues mjetet juridike nuk shihen të ndara njëra nga tjetra, por shihen nga pikëpamja e domosdoshmërisë që duhet t'i gëzojë i pandehuri, me qëllim që të drejtat e tij procedurale garantohen dhe të mos cenohen në ndonjë mënyrë gjatë gjykimit në çështjen penale.

Lidhur me detyrimet të cilat dalin nga instrumentet ndërkombëtare për mjetet e jashtëzakonshme juridike, as pjesa normative e nenit 6 të KEDNJ-së, përfshirë nenin 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe as neni 14 § 5 i PDCP-së, nuk përmendin ndonjë obligim që përfshin shtetet, që të pandehurve në procedurë penale t'u sigurohet më shumë se sa një mjet juridik. Edhe në rastin *Bochan kundër Ukrainës*, GJEDNJ rithekson se çështja e rregullimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk është obligim që del nga KEDNJ dhe protokollet e saj,

por është çështja e brendshme e shteteve të cilat mund të garantojnë të pandehurit më shumë se sa një mjet juridik, obligim që del nga Konventa. Mjetet juridike shtesë, qofshin këto mjete juridike të jashtëzakonshme, janë diskrecion i brendshëm i shteteve për të përcaktuar llojet dhe mënyrën e rregullimit të tyre (Bochan v. Ukrahina, 2015).

Edhe pse mjetet juridike të jashtëzakonshme nuk parashihen nga KEDNJ dhe rrjedhimisht as shtetet që zbatojnë detyrimet që dalin nga kjo nuk obligohen të ofrojnë mjetet juridike të tilla, sipas nenit 441 të KPP-së nuk është pengesë që kërkesa për mjet të jashtëzakonshëm juridik t'i japë mundësi të pandehurit që të paraqesë në bazë të të drejtave të siguruara me KPP dhe të mbrojtura me Kushtetutë ose KEDNJ dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e GJEDNJ-së. Kjo nënkupton se e drejta për gjykim të drejtë parashihet në të gjithë procedurën penale, pavarësisht se disa nga të drejtat sikurse janë mjetet juridike të jashtëzakonshme nuk parashihen shprehimisht në KEDNJ.

3.3. Efektiviteti i mjeteve juridike dhe rishikimi i njëmendtë

Mjetet juridike, ashtu edhe sikurse përmenden në një mori të vendimeve të GJEDNJ-së, nuk duhet të jenë thjesht mjete juridike formale, teorike dhe abstrakte, ato duhet të jenë mjete juridike të njëmendta dhe të cilat ofrojnë mundësi që përfundimet të jenë në përputhje me kërkesat ligjore. Lidhur me mjetet juridike, ashtu edhe sikurse janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 32 të Kushtetutës, neni 14 § 5 të PDCP-së, nenit 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, nuk mjafton vetëm t'i garantohen të pandehurit si mjete formale. Të njëjtat duhet të jenë mjete të njëmenda të cilat ndikojnë substancialisht në rishikimin e njëmendtë të procedurës lidhur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pa paragjykuar asnjëherë rezultatin përfundimtar. Kushtetuta e Kosovës në dispozitën e nenit 54, përveç përcaktimit që çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, përmend të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur. Gjithashtu, sipas nenit 13 të KEDNJ-së përcaktohet se çdokujt që i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, ka të

drejtën e një mjeti efektiv para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare. Tekstualisht në këto akte theksohet se nuk është e mjaftueshme që e drejta për mjete juridike të jetë vetëm formale apo abstrakte, por të njëjtat duhet të jenë mjete juridike efektive.

Në shumë raste, GJEDNJ thekson se neni 13 i KEDNJ-së garanton të gjithë personave disponueshmërinë që në nivel kombëtar të kenë mjeti juridik për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë. Efekti i nenit 13, është të kërkojë sigurimin e mjeteve juridike të brendshme për t'u marrë përmbajtësisht me një ankimim ndaj një vendimi gjyqësor. Pavarësisht rregullimeve të brendshme të shteteve veç e veç, mjeti juridik i ofruar, apo cilido mjet juridik tjetër që do të duhej të disponojë i pandehuri duhet të jetë *"efektiv"* në praktikë dhe në ligj (M.S.S. v. Belgjikës dhe Greqisë, GJEDNJ, 2011, paragr. 288). Efektiviteti i mjeteve juridike nuk lidhet vetëm me ankesën si mjet juridik të përcaktuar në nenin 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, por lidhet drejtpërdrejt me të gjithë mjetet juridike të cilat i ofrohen personave, qofshin ata të pandehur apo jo, me qëllim të përmbushjes së të drejtave të cilat burojnë nga KEDNJ dhe të cilat janë të zbatueshme në shtetet për të cilat personat e caktuar kanë pretendime se iu janë cenuar të drejtat e garantuara me këtë instrument. Përveç kësaj, e drejta për mjete efektive juridike nuk është e lidhur në natyrën të patjetërsueshme vetëm gjyqësore, por ato mund të kërkohen varësisht prej natyrës konkrete nga organet të cilat kërkohet përmbushja e një detyrimi që buron nga konventa.

Lidhur me këtë, *"efektiviteti"* i një *"mjeti juridik"* brenda kuptimit të nenit 13 të KEDNJ-së, në instancë të fundit nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për ankuesin, por me të drejtën fundamentale që pavarësisht rezultatit përfundimtar, proceduralisht të drejtat nuk duhet të jenë vetëm formale. Nëse një mjet i vetëm nuk plotëson tërësisht kërkesat e nenit 13 të KEDNJ-së, pra nuk është plotësisht efektiv për t'i përmbushur qëllimet e këtij neni, për t'i vlerësuar mjetet juridike a janë apo jo mjaftueshëm efektive, duhet të merret parasysh tërësia e mjeteve juridike të cilat janë të parashikuara në legjislacionin e brendshëm për të përmbushur një qëllim të caktuar (M.S.S. v. Belgjikës dhe Greqisë, GJEDNJ, 2011, paragr. 289). Forma e një mjeti juridik, apo e mjeteve juridike, për gjykatën nuk është esenciale, por janë qëllimet të cilat arrihen qoftë veçmas si një mjet juridik, apo si tërësi mjetesh juridike. Pavarësisht se GJEDNJ

nuk ka vendosur restriksione për të kërkuar nga ndonjë shtetet që efektiviteti të arrihet vetëm nga një mjet juridik, Kushtetuta (neni 32 dhe neni 102, paragr. 5) dhe KPP (neni 380) kanë ndërtuar të drejtën për ankesë si tërësi të drejtash të cilat i takojnë të pandehurit në procedurë penale që të kundërshtojë vendimin e shkallës së parë, duke lejuar mundësinë që Gjykata e Apelit të bëjë një rishikim të plotë për të gjithë bazat e mundshme për të cilat mund të ushtrohet ankesa. Ndërsa, mjetet e jashtëzakonshme janë natyrë mjetesh tjetër dhe nuk lidhet me obligimet të cilat dalin nga Konventa.

Për të qenë efektiv, mjeti juridik i kërkuar nga neni 13 të KEDNJ-së duhet të jetë i disponueshëm në praktikë dhe në ligj, veçanërisht në kuptimin që ushtrimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustifikueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit (M.S.S. v. Belgjikës dhe Greqisë, GJEDNJ, 2011, paragr. 290). Kjo pikëpamje duhet kuptuar në dy dimensione, përkatësisht në të drejtën formale për të poseduar të drejtën për mjet juridik, si dhe të drejtën për të pasur mjete juridike përderisa të drejtat e garantuara nuk mund të gëzohen në mënyra tjera, përveçse ushtrimit të mjeteve juridike, si instrumente për realizimin e të drejtave të garantuara.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shpejtësisë që duhet të ketë instanca që trajton mjetin juridik të ushtruar, duke mos përjashtuar që esenca e mjetit juridik mund të dëmtohet me kohëzgjatjen e saj të tepërt (M.S.S. v. Belgjikës dhe Greqisë, GJEDNJ, 2011, paragr. 292). Kjo lidhet edhe me kohëzgjatjen e procedurës në instancën që trajton përmbajtjen e mjetit juridik të ushtruar, pasi edhe sikurse kërkohet me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së dhe nenin 31, paragr. 1 të Kushtetutës, e drejtë themelore e të pandehurit në procedurë penale është dhe gjykimi në kohë të arsyeshme, në cilëndo nga stadet e procedurës penale, përfshirë dhe në stadin e procedurës për mjetet juridike. Çështjen e neglizhencës dhe mos-vendosjes së çështjes brenda një kuadri ligjor të arsyeshëm, GJEDNJ e përcakton shprehimisht si cenim të vet të drejtës për mjete juridike përkatësisht të drejtën e të pandehurit për mjete juridike efektive të përcaktuar me dispozitën e neni 13 të KEDNJ-së.

Çështja e të drejtës për mjete efektive juridike ka qenë objekt i trajtimit të Gjykatës Kushtetuese, përveç tjerash edhe në çështjen *Gëzim & Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë & KGJK-së*. Lidhur me këtë rast, përkatësisht për të drejtën për mjete

juridike efektive, gjykata në këtë drejtim vëren se legjislacioni në fuqi: Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Ligji për KGJK, nuk ofrojnë mjete efektive juridike për mbrojtjen e të drejtave të parashtruesve. Në fakt, në njërën anë, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nuk parasheh masa per adresimin e mosveprimit të institucioneve përgjegjëse në rastet kur janë të detyruara të veprojnë. Në anën tjetër, siç mund të shihet edhe nga Ligji për KGJK, parashtruesit nuk kanë pasur mundësi tjetër për të ushtruar mjete juridike.

3.4. Subsidiariteti i instancave që veprojnë sipas mjeteve juridike

Sipas Kushtetutës së Kosovës gjykatat janë të obliguara të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit (neni 102, paragr. 3), dhe gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm (neni 102, paragr. 4). Në mënyrë që gjykatat t'i arrijnë qëllimet ligjore të tyre, pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata (neni 102, paragr. 2). Gjykatat e instancës së parë gjyqësore, sikurse vëmë në dukje, duhet kushtuar vëmendjen maksimale që të gjykojnë çështjen e paraqitur përpara tyre me profesionalizëm dhe me objektivitet, duke pasur si qëllim përfundimtar zbatimin e përpiktë të ligjit gjatë ndarjes së drejtësisë. Pra, ato janë të obliguara që të mos bëjnë çfarëdo shkelje gjatë zbatimit të ligjit, duke përmbushur në këtë mënyrë qëllimin e drejtë për të parandaluar çfarëdo lëshimi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre gjyqësore.

Me qëllim që të arrihet drejtësi e plotë procedurale dhe të pandehurit t'i ofrohet gjykimi i drejtë, ashtu edhe sikurse kërkohet me instrumentet juridike ndërkombëtare dhe të brendshme, janë ndërtuar mekanizma të cilat veprojnë sipas mjeteve juridike të ushtruara nga palët në procedurë penale. Këto instanca veprojnë si instanca subsidiare, pasi ekziston supozimi se të gjithë instancat gjyqësore, përfshirë dhe instancën e parë gjyqësore gjykojnë sipas kërkesave kushtetuese të përcaktuara me nenin 102, paragr. 3, duke mos lejuar që të bëhen shkelje në dëm të interesave të të pandehurit në procedurë penale. Duke qenë se këto instanca janë të karakterit subsidiar, ato veprojnë vetëm kur këtë e kërkojnë palët sipas mjeteve juridike

të përcaktuara ligjërisht. Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit vepron sipas ankesave të paraqitura nga palët e çështjes penale përkatëse dhe vetëm atëherë kur drejtësia procedurale sipas pretendimeve të palëve nuk është arritur në instancën e parë gjyqësore. Edhe mjetet tjera juridike, sikurse janë mjetet e jashtëzakonshme, palët mund t'i përdorin vetëm atëherë kur e kanë konsumuar të drejtën e ankesës dhe vendimi përfundimtar ka marrë formë të prerë sipas përcaktimeve ligjore. Subsidiariteti i instancave që veprojnë sipas mjeteve juridike ka për qëllim që palët e pakënaqura t'i realizojnë të drejtat e tyre sipas një rendi logjik dhe pa i shfrytëzuar të gjithë mjetet juridike që kanë në dispozicion. Nëse i pandehuri do t'i shfrytëzojnë mjetet juridike të ofruara, të njëjtat duhet që t'i shterojë sipas mundësisë që i ofrohet të përcaktuara me ligj, dhe jo duke anashkaluar një mjet juridik për të shfrytëzuar një mjet tjetër, përjashtimisht rasteve kur mjeti juridik prima facie është joefektiv. Ri-shqyrtimi i vendimit të shkallës së parë, nga një gjykatë e shkallës më të lartë, është në përputhje me kërkesat që dalin nga neni 2 i protok. nr. 7 të KEDNJ dhe nenit 14 të PCDP. Të dyja instrumentet ndërkombëtare përveç të drejtës që japin të pandehurit për të ushtruar ankesë, njëkohësisht adresojnë çështjen që ankesa duhet paraqitur një gjykate më të lartë për nga hierarkia e gjykatave, gjë që e njëjta gjykatë të ketë tagrin të shqyrtojë ankesën e paraqitur.

Subsidiariteti i instancave të rregullta gjyqësore vlen vetëm pasi palët të paraqesin mjetet juridike sipas kushteve të përcaktuara ligjore. Gjykata Kushtetuese sipas fushëveprimit që ka bazuar në nenin 113, si palë të autorizuar lejon që para saj të paraqiten edhe individët. Sipas nenit 113, paragr. 7 të Kushtetutës dhe nenit 49 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (2009), individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në çështjen *Besianë Gashi kundër KGJK-së*, Gjykata Kushtetuese thekson se arsyeja për ekzistimin e rregullit të shterimit të mjeteve juridike është që t'iu lejojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë këtu edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar apo rregulluar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës ofron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Gjykatës Kushtetuese (Besianë Gashi v. KGJK-së, GJK, 2013, paragr. 23).

PJESA E KATËRT

EFEKTET JURIDIKE TË PROVAVE TË PAPRANUESHME, ROLI I GJYKATËS KUSHTETUESE NË GJYKIMIN E DREJTË DHE KUFIZIMI I TË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË GJATË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME

KAPITULLI IX

EFEKTET JURIDIKE TË PROVAVE TË PAPRANUESHME NË TË DREJTË PËR GJYKIM TË DREJTË

1. Shqyrtime krahasuese për provat e papranueshme

Çështja e sigurimit të dëshmive në procedurë penale tanimë duhet shqyrtuar çdoherë në kontekst të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Ligjet bashkëkohore të procedurë penale kanë vendosur kritere dhe standarde të larta në rrugën e gjetjes dhe administrimit të provave, duke paraparë mënyra dhe procedura që duhet respektuar përderisa ndërmerren aktivitete të tilla. Shumë sisteme juridike provat e papranueshme i konsiderojnë absolutisht të pavlefshme, rrjedhimisht nuk mund të bazohet aktgjykimi në këto prova, ndërsa sistemet tjera juridike bëjnë zgjidhje kompromisi në mes të tendencës për të drejtat e njeriut dhe tendencës për efikasitetit të procedurës penale, duke i dhënë përparësi herë njërës tendencë, e herë tjetrës.

Për t'i parë dallimet në mes këtyre dy tendencave mund të krahasojmë shembullin e të drejtës belge dhe asaj amerikane. Në të drejtën belge, që nga viti 2003 janë vendosur kritere në rregullat për pranimin apo përjashtimin e provave, duke u *"rishkruar"* plotësisht këto rregulla nga Gjykata e Kasacionit. Sipas kësaj gjykate, përdorimi i provave të marra në mënyrë të paligjshme pranohet, me përjashtime të mëposhtme:

a) kur legjislacioni shprehimisht përcakton pavlefshmërinë si një sanksion për mosrespektimin e një akti të veçantë në të drejtën penale belge;

b) paligjshmëria ose parregullsia i ka bërë provat të pabesueshme; apo

c) përdorimi i provave të marra në mënyrë të paligjshme nuk është në përputhje me parimin e një gjykimi të drejtë (Meese, 2013, f. 64).

Kriteri i fundit ka qenë objekt i sqarimit të mëtejshëm nga Gjykata e Kasacionit, në të cilën gjyqtari i procedurës mund të marrë parasysh një ose të gjitha rrethanat e mëposhtme:

1) autoritetet kanë kryer me qëllim paligjshmërinë ose parregullsinë;

2) serioziteti i veprës penale është më i madh se paligjshmëria ose parregullsia;

3) provat e marra në mënyrë të paligjshme vërtetojnë vetëm ekzistencën e një vepre penale, por nuk provojnë se kush e ka kryer veprën penale,

4) paligjshmëria nuk ka ndikuar në të drejtat e mbrojtura nga rregullat ligjore që janë shkelur; dhe

5) karakteri i thjeshtë formal i rregullave ligjore që janë shkelur (Meese, 2013, f. 64).

Përkundër të drejtës belge, në SHBA të drejtat kushtetuese të të akuzuarit në një çështje penale kërkojnë përjashtimin e provave të marra në kundërshtim me rregullat për marrjen e provave. Kështu, nëse provat sigurohet nga një kontroll i paligjshëm i personit ose provës, që bie ndesh me të drejtat kundër kontrollit dhe sekuestrimit të paligjshëm sipas Amandamentit të Katërt, apo nëse provat zbulohen pas një deklarate bindëse që bie në kundërshtim me Privilegjin e Amandamentit të Pestë kundër vet-inkriminimit, apo prova mundësohet duke mos i mundësuar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes sipas Amandamentit të Gjashtë, gjykatat për shkelje të ligjit, duhet të përjashtojnë atë (Murphy, 2010, f. 113).

Instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë nuk kërkojnë nga shtetet që të zbatojnë ndonjë sistem të caktuar të dëshmive, e as nuk i udhëzojnë gjykatat se si ato duhet t'i zgjedhin dhe vlerësojnë provat. Megjithatë, ato vendosin disa standarde lidhur me provën, të cilat çdo sistem i drejtësisë penale duhet të garantojnë në një mënyrë apo në tjetrën. Për shembull, autoritetet e prokurorisë kanë për detyrë t'i zbulojnë mbrojtjes të gjitha provat fajësuese dhe shfajësuese. Me rëndësi jetike për drejtësinë dhe cilësinë e mbledhjes së dëshmive është edhe e drejta e të pandehurit për të shqyrtuar dëshmitarët dhe ekspertët të paraqitur kundër tij dhe për të siguruar pjesëmarrjen dhe shqyrtimin e dëshmitarëve dhe ekspertëve në emër të tij (Kempen, 2014, fv. 9-10). Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për më tepër ofrojnë udhëzime në masën në të cilën autoritetet mund të përdorin prova kundër të pandehurit kur kjo dëshmi është marrë me shkelje të të drejtave të njeriut, siç janë e drejta për privatësi apo e gjykimit të drejtë (p.sh. në rast të shkeljes së të drejtës për heshtje ose të drejtës për ndihmë juridike) (Kempen, 2014, f. 10).

Edhe pse asnjë dispozitë e këtyre instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk e ka përfshirë si element substancial provat juridikisht të papranueshme të cilat mund të cenojnë të drejtën për gjykim të drejtë, ka mjaftueshëm instrumente të tilla të cilat ndalojnë provat juridikisht të papranueshme e të cilat mund të cenojnë të drejta tjera të pavarura e të cilat përfshijnë:

- Të drejtën për liri dhe siguri;
- Ndalimi i torturës, trajnimit çnjerëzor, poshtërues apo denigrues;
- E drejta për privatësi apo dhe
- E drejta e pronës.

Edhe pse disa të drejta nuk janë absolute, pavarësisht kësaj të gjithë të drejtat kur kufizohen duhet ndjekur një qëllim legjitim të njohur nga parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke i njohur kriteret e arsyeshmërisë, domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe asnjëherë të bëhen pjesë e arbitraritetit apo dhe *prima facie* të bien në kundërshtim me dispozitat e këtyre instrumenteve ndërkombëtare. Këto të drejta janë pjesë e rendit juridik ndërkombëtare dhe paraqesin norma juridike *ius cogens* dhe të cilat nuk guxojnë të cenohen pasi shkelin detyrimet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut.

2. Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi provat e papranueshme

GJEDNJ nuk ka komentuar nëse pranueshmëria apo papranueshmëria e provave, apo në trajtimet se mënyra e sigurimit të provave shkel në vetvete të drejtën për gjykim të drejtë të paraparë sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Në çështjen *Edwards kundër Britanisë së Madhe* (1991) kjo gjykatë shprehet se nuk është detyrë e saj që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve me vlerësimet e dhëna nga gjykatat e rregullta në nivel kombëtar, pasi si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që të vlerësojnë provat për çështjet penale përkatëse. Pra, gjykata thekson se mënyra e marrjes së provave dhe dhënia e vlerave provuese të tyre, në vetvete nuk shkel neni 6 të Konventës, por megjithatë nuk mund të thuhet se jo-

domosdoshmërisht çështjet e provave nuk mund të cenojnë gjykimin e drejtë në mënyrë të tërthortë.

GJEDNJ merret me çështjen e provave të papranueshme, por në një kontekst tjetër, përkatësisht çështjen e administrimit apo paraqitjes së këtyre provave kjo gjykatë e sheh në kontekstin e kontradiktoritetit, parimit të *"barazisë së armëve"* apo respektimit të të gjithë garancioneve të cilat u jep kjo e drejtë të pandehurit. Në çështjen *Birutis dhe të tjerët kundër Lituanisë*, kjo gjykatë thekson se me qëllim të paraqitjes së argumenteve në frymën e kontradiktoritetit, provat në procedurë penale duhet të paraqiten në një seancë publike dhe në praninë e të pandehurit. Nga kjo rregull ka përjashtim, por ato nuk duhet të cenojnë të drejtat e mbrojtjes. Në këto situata, gjykimi do të jetë në përputhje sipas nenit 6 § 1 dhe nenit 6 § 3 (d), ku kërkohet që të pandehurit t'i jepet mundësi adekuate dhe të përshtatshme për të shqyrtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarin kundër tij (Birutis dhe të tjerët v. Lituania, GJEDNJ, 2002, paragr. 28).

Sikurse gjykata ka vendosur në shumë çështje të ngritura para saj, nuk është detyrë e saj të komentojë dhe të lëshohet për të interpretuar mënyrën e marrjes së provave apo çmuarjen e tyre, sepse nuk është detyrë e saj të bëjë këtë. Por, kjo nuk do të thotë se kjo gjykatë nuk do të trajtojë provat lidhur me kërkesën për të shqyrtuar nëse të pandehurit i është siguruar gjykim i drejtë dhe se a i janë respektuar garancitë procedurale që ofron e drejta për gjykim të drejtë lidhur me provat. Cenimi i të drejtave të mbrojtjes mund të shpie në deklarata inkriminuese të cilat mund të përdoren si argumente në fazat e mëvonshme për të bazuar aktgjykimin kundër vet të pandehurit. Në rastet kur deklaratat e të dyshuarit merren në kohën kur nuk iu është siguruar avokati mbrojtës dhe ato deklarata përdorën si argumente kundër tij në fazat e mëvonshme të procedurës penale, mund të cenojë të drejtën për gjykim të drejtë, pasi nuk iu janë siguruar të pandehurit të drejtat e mbrojtjes. Këto mund të jenë dhe objekt i trajtimit të së drejtës së brendshme, mirëpo ashtu sikurse e kemi përmendur në pjesën e parë, është obligim i organeve procedurale për të siguruar avokat mbrojtës gjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale, sepse mund të shpije në procedurë të padrejtë. Në këto situata mund të cenohen të drejtat e garantuara për një gjykim të drejtë, edhe pse të njëjtat mund të ngatërrohen me mënyrën e marrjes së provave. Prerogativat e mbrojtjes janë elemente të së

drejtë për gjykim të drejtë dhe nuk mund të përjashtohen asnjëherë sepse cenojnë në thelb vet këtë të drejtë. Përveç cenimit të të drejtave të mbrojtjes gjatë marrjes së provave që shkel vet nenin 6, është edhe pamundësia për të ardhur në shprehje kontradiktoriteti nga pala e akuzuar, për të kundërshtuar vet provat e paraqitura nga pala e akuzës. Të pandehurit duhet dhënë rasti për të marr në pyetje dëshmitarin dhe të ballafaqohet me të fizikisht në seancë gjyqësore dhe të mos përdoren deklaratat e tij pa iu dhënë mundësia të pandehurit për të sfiduar dëshmitarin, ashtu dhe të mund të kundërshtojë dhe komentojë ekspertizën apo prova të tjera të paraqitura në procedurë penale.

GJEDNJ i përmbahet qëndrimit se përdorimi i provave të fituara në mënyrë të paligjshme, veçanërisht dëshmitë e marra në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ-së që garanton të drejtën për respektimin e jetës private, nuk sjell domosdoshmërisht proces të padrejtë (Schenk v. Zvicra, 1988). Lidhur me këtë, nuk është roli i kësaj gjykate të përcaktojë, si parim, nëse lloje të veçanta provash, për shembull, prova të siguruara në mënyrë të paligjshme - mund të jenë të pranueshme apo të pa pranueshme, apo nëse parashtruesi ishte apo nuk ishte fajtor. Çështjes që duhet t'u përgjigjet është, nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën me të cilën janë marrë provat, ishin të drejta apo jo. Kjo përfshin një ekzaminim të *"paligjshmërisë"* së supozuar dhe, aty ku ka shkelje të ndonjë të drejtë të Konventës, natyra e shkeljes të përcaktohet qartë. Prandaj, drejtësia e një gjykimi nuk është domosdoshmërisht e dëmtuar nga përdorimi i provave të marra në mënyrë të paligjshme, për shembull, të provave të marra në shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private të individit në fjalë. Nëse shkelja e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së do të varet nga fakti nëse dëshmitë mund të kundërshtohen në gjykim (procedurë kontradiktore), nëse ajo ishte e vetmja dëshmi mbi të cilën ishte bazuar një dënim apo nëse për shkak të mënyrës së mbledhjes së provave - për shembull duke nxitur një person për të bërë deklarata të caktuara ose për të kryer vepra të caktuara të cilat nuk do të ishin kryer, por ishte përcaktues roli aktiv i autoriteteve shtetërore - duhet të konsiderohet se shkel të drejtën për të mos kontribuar në ve-inkriminimin (përfshirë këtu të drejtën për të heshtur) ose ngjashëm me provokimin për të kryer një vepër penale (CFR-CDF Opinion 3 - Opinion on the status of illegally obtained evidence in criminal procedures in the Member States of the European Union, 2003, fv. 6-7).

Lidhur me *"agjentët provokatorë"*, në çështjen *Teixeiro kundër Portugalisë*, GJEDNJ erdhi në disa konkluzione të cilat shpallin veprimet e ndërmarra nga policia si veprime të cilat shkelin nenin 6 të KEDNJ, pasi që të pandehurit nuk iu është siguruar gjykim i drejtë në përputhje me kërkesat e nenit 6. Gjatë procesit të provuarit për veprën penale që hetohej nga zyrtarët policor, agjentët kaluan përtej rolit që duhet të kishin në këto raste, ata nxitën apo provokuan veprën, gjë që veprimet e tyre aktive ishin në kundërshtim me vet qëllimet që garanton neni 6 i Konventës. Me këtë vendim, gjykata përcakton se veprimet e *"agjentëve provokatorë"*, duhet të jenë pasive dhe asnjëherë nuk duhet provokuar kryerjen e veprës penale, pasi nxitja do të bie ndesh me vet qëllimet e nenit 6 (Teixeira De Castro v. Portugalia, GJEDNJ, 1998, paragr. 38).

Pra, kjo gjykatë nuk komenton çështjet që lidhen me provat si përmbajtje në vetvete, apo mënyrën e marrjes së tyre, mënyrë kjo e garantuar me të drejtë të brendshme, mirëpo ajo vendos mbi kriteret të cilat garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, thjesht ajo kontrollon përputhshmërinë në mes provave të siguruara dhe kritereve të garantuara me nenin 6 të Konventës. Gjykata nuk trajton provat si çështje e pavarur, por ajo kontrollon garancitë e përgjithshme procedurale, por që mund të kenë ndërlidhje të caktuara, gjë që bënë procedurën penale si procedurë të padrejtë.

4. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese mbi provat e papranueshme

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese funksionon në përputhje me frymën e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Sipas nenit 53 të Kushtetutës, është obligim kushtetues i Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave që funksionojnë sipas Ligjit mbi gjykatat dhe ligjeve tjera relevante, që të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, t'i interpretojnë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Sikurse GJEDNJ, edhe Gjykata Kushtetuese në praktikën gjyqësore të saj, asnjëherë nuk e ka cilësuar mënyrën e marrjes së provave në vetvete, apo vlerën provuese të dhënë nga gjykatat e rregullta për ndonjë provë të caktuar, si

shkelje të së drejtë për gjykim të drejtë, të garantuar me neni 31 të Kushtetutës apo nenin 6 të KEDNJ-së.

Në çështjen *Çlirim Grezda kundër Gjykatës Supreme,* kjo gjykatë thekson se parashtruesit e kërkesës nuk mund të ankohet në këtë gjykatë me pretendimet se gjykatat e rregullta kanë bërë gabime të fakteve apo të ligjit përderisa nuk i kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë (Çlirim Grezda v. Gjykata Kushtetuese, 2011, GJK, paragr. 22). Zaten, shumica e kërkesave të parashtruara pranë kësaj gjykate janë të dominuar me çështje të cilat në instancë të fundit shpallen të papranueshme (krahaso me kapitullin X të temës). Është e gabuar që kjo gjykatë të shihet si një nga veglat shtesë në përpjekjet ligjore me mjete atakuese, pasi kjo është vetëm mundësi për të kontrolluar kushtetutshmërinë e vendimit dhe asnjëherë nuk mund të shihet si gjykatë që vlerëson apo rivlerëson fakte, pasi një çështje e kësaj natyre është e rezervuar vetëm për gjykatat e rregullta. Sikurse edhe shprehet edhe vet kjo gjykatë, nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme si autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë, apo dhe gjykatave të instancave më të ulëta, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk është për të vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Fazilja Berisha v. Gjykata Supreme, GJK, 2011, paragr. 16).

Edhe sa i përket çështjes së provave, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (Fazilja Berisha v. Gjykata Supreme, GJK, 2011, paragr. 17). Kjo gjykatë, nuk mundet dhe nuk do të përpiqet të përcaktojë nëse, në bazë të ligjit apo të dëshmive, ka prova të mjaftueshme për ta shpallur parashtruesin fajtor për vepër penale. Ajo vetëm do të përpiqet, të përgjigjet nëse gjykatat e rregullta kanë shkelur në mënyrë procedurale të drejtat e parashtruesit të garantuara me Kushtetutë (Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme, GJK, 2013, paragr. 80). Do të ishte jashtë juridiksionit të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj për

funksionimin e kësaj gjykate, që të merret me çështjet që ngritën pranë saj, në rast se ajo do të trajtojë rastin në mënyrë meritore dhe për elementet që lidhen në mënyrë të pavarur vetëm me provat. Sigurisht, provat nuk mund të përjashtohen në mënyrë absolute nga trajtimi edhe nga juridiksioni i vet gjykatës, por duhet argumentuar në mënyrë të bazuar se provat që kontestohet si të papranueshme duhet të lidhen drejtpërdrejt me cenimin e dispozitave kushtetuese dhe të atyre të KEDNJ.

Në çështjen *Shefqet Berisha kundër Gjykatës Supreme*, Gjykata Kushtetuese thekson se për sa i përket çështjes së administrimit të provave, Kushtetuta dhe KEDNJ nuk vendosin rregulla për prova te tilla. Pranueshmëria e provave dhe mënyra se si duhet të vlerësohen janë kryesisht çështje që duhet të rregullohen me ligjin kombëtar dhe gjykatat kombëtare. E njëjta vlen edhe për vlerën provuese të provave dhe barrën e të provuarit. Gjithashtu, gjykatat e rregullta duhet të vlerësojnë rëndësinë e provave të propozuara (Shefqet Berisha v. Gjykata Supreme, GJK, 2017, paragr. 73). Në paragr. 74 dhe 75 të vendimit, kjo gjykatë përmend se detyrë e saj sipas Kushtetutës dhe Konventës është të konstatojë nëse procedurat në tërësi janë të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave. Prandaj, duhet të përcaktojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë ashtu që të garantojnë një gjykim të drejtë. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të kryejnë një shqyrtim të duhur të parashtresave, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët. Për më tepër, përkitazi me elementet që lidhen me trajtimin e provave nga gjykatat, Gjykata ka vërejtur se, edhe pse pranimi i provave të nxjerra në mënyrë të paligjshme në vetvete nuk shkel nenin 6, por në rastin *Schenk kundër Zvicrës* (1988), GJEDNJ ka konstatuar se kjo mund të shpie në padrejtësi përkitazi me faktet e një rasti të veçantë.

Lirisht mund të thuhet se mënyra e gjykimit të provave të papranueshme në sistemin gjyqësor kosovar, është në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe me detyrimet normative të instrumenteve ndërkombëtare. Ndikimet për tu afruar në qasje për këtë çështje janë të shumëfishta, ku njëra ndër to është edhe obligueshmëria e zbatimit të praktikës së GJEDNJ-së sipas Kushtetutë, apo edhe zbatimi i drejtësisë për një periudhë relativisht të gjatë nga gjyqtarë ndërkombëtar që vijnë nga sistemet juridike ku KEDNJ është e zbatueshme. Të dyja situatat kanë influencuar që çështjet të trajtohen nën dritën e standardeve të parapara të KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së.

5. Efektet e provave të papranueshme në cenimin e të drejtave tjera të garantuara

Qëndrimet e mbajtura nga GJEDNJ në lidhje me çështjen e provave të papranueshme si çështje të cilat nuk shkelin të drejtat për gjykim të drejtë, nuk duhet nënkuptohen se kjo gjykatë legjitimon pavlefshmërinë e provave dhe bënë një *"konvalidim"* duke i bërë të njëjtat prova të pranueshme dhe të ligjshme, përkundrazi gjykata vetëm shprehet se provat juridikisht të papranueshme nuk shkelin përmbajtjen e të drejtën për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së, por nuk përjashtohet mundësia asnjëherë se të njëjtat mund të cenojnë të drejta tjera të garantuara me konventë. Gjykata shprehet se çështja e pranueshmërisë së provave nuk është çështje e trajtimit që bënë neni 6, përjashtimisht rasteve kur procedura penale shihet hapur se është e padrejtë dhe arbitrare.

Duke qenë se në procedurën penale mund të cenohen të drejtat e rëndësishme, legjislacionet penalo-procedurale, garantojnë sidomos këto të drejta: e drejta e integritetit dhe dinjitetit njerëzor; e drejta e lirisë dhe sigurisë personale; e drejta për gjykim të drejta; e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare; e drejta e paprekshmërisë së banesës dhe fshehtësisë së korrespodencës. Shkeljet e tilla mund të jenë të karakterit penalo-juridik dhe penalo-procedural. Si pasojë e cenimeve penalo-procedurale është pamundësia e mbështetjes së vendimit gjyqësor në prova të palejuara. Kur një vendim gjyqësor bazohet në shkelje të të drejtave të caktuara, ai mund të ndryshohet në procedurën përkatëse si me mjete juridike të rregullta, ashtu edhe me mjete të jashtëzakonshme (Murati, 2008, fv. 27-29).

Kërkesa për ekzaminim të *"paligjshmërisë"* së pretenduar nga ana e të pandehurit në procedurë penale në çështjen kundër tij, mund të evidentojë shkelje të të drejtave tjera të parapara me Kushtetutë apo me KEDNJ. I pandehuri, duhet që mjetet juridike që ka në dispozicion t'i orientojë drejt kërkesave për kontrollim të të drejtave përkatëse, pasi jo-domosdoshmërisht këto prova e papranueshme shkelin nenin 6 të KEDNJ, apo nenin 31 të Kushtetutës. Pa paragjykuar në asnjë situatë, mund të themi se pretendimet për *"paligjshmëri"* mund të cenojnë të drejta të tjera sikurse i përmendëm më sipër. Konsumimi i mjeteve juridike

në një drejtim të gabuar, mund t'i sjellë parashtruesit humbjen e rastit që të kërkojë të drejtën e tij në tërësinë e të drejtave që i garantohen me këto instrumente.

Sipas nenit 34 të KEDNJ-së, nga parashtruesi kërkohet që kërkesën të bazojë në ndonjë nga të drejtat e garantuara, ndërsa Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton se parashtruesi duhet të identifikojë të drejtën e tij të cenuar që garantohet me Kushtetutë, pra, barra e të provuarit për këto çështje qëndron mbi kërkuesin dhe nuk është detyrë e gjykatës të bëjë punën e parashtruesit duke precizuar apo argumentuar të drejtën e cenuar, pasi këto instanca vetëm gjykojnë pretendimet ankimore të parashtruesve.

KAPITULLI X

EFEKTET E SHQYRTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PËR CENIMIN E TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË NGA GJYKATA KUSHTETUESE

1. Shqyrtime hyrëse

Sipas kapitullin VIII të Kushtetutës është përcaktuar mënyra e funksionimit dhe fushëveprimit të Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 113 përmendet fushëveprimi dhe palët e autorizuara që mund të paraqiten përpara kësaj gjykate, ku përveç autoriteteve publike, sikurse është Kuvendi, Presidenti, Qeveria, Avokati i Popullit, Komuna apo Gjykatat, në cilësinë e palës mund të paraqiten edhe individët si persona fizik apo juridik (Kushtetuta, 2008). Secila nga palët e përmendura e ka të përcaktuar fushëveprimi e tyre si palë. Individët mund të paraqiten si palë, pasi ata janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë (Kushtetuta, neni 113, paragr. 7). Individët mund të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese të kontrollojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëse ka shkelje të parimeve të së drejtës për gjykim të drejtë të përcaktuar me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës. Rëndësia që ka kjo gjykatë si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës (Kushtetuta, neni 112, paragr. 1), është me ndikim jashtëzakonisht të madh në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si një nga të drejtat themelore kushtetuese, mund të trajtohet në mënyrë meritore nga kjo gjykatë vetëm pasi që pala pretenduese t'i plotësojë kushtet formale për pranueshmëri të kërkesës.

Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e rregullt sikurse janë gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, apo Gjykata Supreme, por është autoritet i veçantë gjyqësor që fushëveprimi i saj lidhet vetëm me interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën (Kushtetuta e Kosovës, neni 112, paragr. 1). Edhe për nga rregullimi kushtetues dhe ligjor, fushëveprimi i Gjykatës Kushtetuese është i ndryshëm nga autoritetet e rregullta gjyqësore. Lidhur me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individit të përcaktuara me Kushtetutë, Gjykata

Kushtetuese paraqitet si autoritet subsidiar dhe merret vetëm atëherë kur gjykatat apo autoritetet tjera kanë dështuar për t'i mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut.

Tanimë instrumentet juridike bashkëkohore që mbrojnë të drejtat e njeriut, theksojnë se procesi i rregullt ligjor nuk konsiderohet thjesht vetëm si një e drejtë e veçantë, por ajo trajtohet si parim kushtetues që shtrihet ndaj disa të drejtave dhe lirive themelore të individit. Funksioni themelor i të drejtës për gjykim të drejtë është mbrojtja e të pandehurit nga ndërhyrjet e paligjshme të autoriteteve shtetërore që udhëheqin apo marrin pjesë në procedurë penale. Për t'u siguruar që liritë dhe të drejtat e individit në procedurë penale do të jenë plotësisht të mbrojtura dhe të pacenuara, i pandehuri gëzon një mjet juridik shtesë, jashtë mjeteve juridike që gëzon në instancat e rregullta gjyqësore, me qëllim që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar kontrollin e vendimit përfundimtar të marrë në procedurë penale (Vorpsi, 2011, f. 13). Nëse brenda instancave të rregullta gjyqësore nuk mbrohen garancitë procedurale, apo garancionet e tilla nuk korrigjohen, individët sipas nenit 113, paragr. 7 të Kushtetutës gëzojnë një mjet tjetër efektiv sikurse janë autorizimet e individit për të ngritur shkeljet e të drejtave të tij individuale të garantuara me Kushtetutë.

Gjykatat dhe organet tjera, gjatë zhvillimit të procedurës penale janë të obliguara të respektojnë të drejtat kushtetuese të cilat i takojnë të pandehurit. Praktikisht gjykata me dashje apo në lajthitje, me veprim apo mosveprim, mund që t'i cenojnë të drejtat fundamentale të të pandehurit në procedurë penale. Pasi vendimmarrja për një çështje të caktuar penale asnjëherë nuk mund të jetë e përkryer, Kushtetuta ka paraparë që i pandehuri të ketë mundësi t'i shfrytëzojë mjetet juridike për rishqyrtim të vendimeve, me qëllim që asnjë vendimi në formë të plotë apo të pjesshme të mos mbetet i padrejtë dhe i kundërligjshëm në këtë formë të prodhojë pasoja juridike në kundërshtim me frymën e përgjithshme të cilat kërkojnë instrumentet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Vendimi i nxjerrë kundër të pandehurit i cili ka formën e prerë në një çështje të caktuar penale, mund t'i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese (Kushtetuta, neni 113, paragr. 7 dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 47, 48 dhe 49). Ankesat kushtetuese individuale që kontestojnë kushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, mund të bëhet objekt për t'u trajtuar në mënyrë meritore si një rast i caktuar,

nëse argumentohet se veprimet apo vendimet e nxjerra nga instancat e rregullta gjyqësore bien ndesh me parimet e garantuara kushtetuese me të drejtën për gjykim të drejtë.

2. Kriteret formale për pranueshmërinë e kërkesës

Për t'u trajtuar nga Gjykata Kushtetuese kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkesa duhet t'i plotësojë kushtet për pranueshmërinë e saj. Kushtet për pranueshmërinë e kërkesës janë të përcaktuara me nenin 113, paragr. 7 të Kushtetutës, nenet: 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregullën 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese. Për t'i plotësuar kriteret kushtetuese dhe ligjore sipas dispozitave të përmendura më sipër, për pranueshmërinë e kërkesës që konteston kushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor në procedurë penale, mund të paraqitet nga individi që nuk është i kënaqur me vendimin që kanë nxjerrë instancat e rregullta gjyqësore, nëse:

1) kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër muajve nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor;

2) t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj;

3) të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është vendimi gjyqësor penal të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj dhe

4) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

Kërkesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë, gjykata nuk i merr në konsiderim dhe i shpallë të papranueshme. Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese (plotësuar më 2014), në Rregullën 36 (3), përcakton se një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme në rastet vijuese, kur:

a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;

b) kërkesa është anonime;

c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;

d) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për peticion;

e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;

f) kërkesa nuk është ratione materiae (juridiksioni lëndor) në pajtim me Kushtetutën;

g) kërkesa nuk është ratione personae (juridiksioni ndaj personave) në pajtim me Kushtetutën; ose

h) kërkesa nuk është ratione temporis (juridiksioni kohor) në pajtim me Kushtetutën.

2.1. Subjekti kërkues

Kushti i parë i pranueshmërisë së kërkesës është që kërkesa duhet të jetë individuale. Kërkesa duhet të paraqitet nga individi që konteston kushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor. Kushtetuta nuk lejon përdorimin e padisë popullore - *actio popularis*. Askush pranë gjykatës pa autorizim dhe miratim të të pandehurit që ka pranuar aktgjykimin penal nuk mund të paraqitet dhe të ndjekë procedurën në emër të tij. Mirëpo, sipas dispozitës së nenit 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, përcaktohet se palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala. Pra, parashtruesi mund të iniciojë çështje individuale pranë kësaj gjykate vetëm nëse ka interes të drejtpërdrejtë në të.

Sipas nenit 113, paragr. 7 të Kushtetutës, parashihet që kërkesat individuale duhet të paraqiten vetëm nga individët. Kur është fjala për emërtimin *"individ"* apo *"person"*, kjo përfshin personat fizik dhe personat juridik si subjekte të së drejtës. Njëkohësisht, si palë të barabarta mund të paraqiten personat juridik krahas personave fizik dhe kanë legjitimacion të plotë pranë Gjykatës Kushtetuese. Sikurse personat fizik që mund të jenë palë në cilësinë e të pandehurve në procedurë penale, njëkohësisht edhe personat juridik gëzojnë pozitë të njëjtë, pasi sipas nenit 40 të KPK personat juridik kanë përgjegjësi penale, ndërsa sipas nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale (2011), përcaktohet se ndaj personave juridik, sikurse ndaj çdo personi tjetër fizik aplikohen dispozitat e KPK-së dhe të KPP-së. Përderisa vlejnë standardet e njëjta të drejtësisë procedurale si për personat fizik, ashtu

edhe për ata juridik, e drejta për gjykim të drejtë është e drejtë unike në procedurë penale pavarësisht nga subjektiviteti juridik i personit, qoftë ai person fizik apo juridik.

2.2. Afati ligjor për parashtrimin e kërkesës

Kërkesa për kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor të marrë në procedurë penale duhet parashtruar brenda afatit ligjor, pasi të gjitha çështjet procedurale pranë Gjykatës Kushtetuese janë të lidhura me afat ligjor. Sipas dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej katër muajve, ndërsa afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Kërkesa që nuk është *ratione temporis* në pajtim me afatin prej katër muajve, konsiderohet e papranueshme dhe gjykata në mungesë të juridiksionit kohor, nuk vendoset me aktgjykim për çështjen në mënyrë meritore.

Në rast se parashtruesi nuk ka arritur të parashtrojë kërkesën e tij brenda afatit ligjor pranë gjykatës, sipas dispozitës së nenit 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, mund të kërkojë nga gjykata duke shfrytëzuar institutin për kthim në gjendje të mëparshme - *restitution in integrum*, gjykata pasi konstaton se pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Afati i kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme ka afatin subjektiv dhe objektiv. Në afatin subjektiv, parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Afati objektiv i kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme është një vit dhe pas kalimit të këtij afati gjykata nuk ka juridiksion ratione temporis.

Afati ligjor prej katër muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b), të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që ngrenë çështje që kanë të bëjnë me Kushtetutën, trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Mustafë Xhekaj v. Gjykata Supreme, GJK, 2014, paragr. 17).

2.3. Shterimi i mjeteve juridike

Sipas nenit 113 paragr. 7 të Kushtetutës, kusht tjetër për pranueshmërinë e kërkesës, është që kërkuesi *"t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."* Objekti i parimit së shterimit të mjeteve të brendshme është për të lejuar autoritetet gjyqësore për të trajtuar pretendimet për shkelje të një të drejte dhe, kur është e përshtatshme, për të mundësuar rivendosje para se pretendimi t'i paraqitet Gjykatës Kushtetuese (Mushkolaj, Morina, & Lamoen, 2014, f. 348). Meqenëse Kushtetuta është ligji themelor i një shteti, kjo duhet të zbatohet nga të gjitha gjykatat. Pra, Gjykata Kushtetuese duhet të shërbejë si instancë e fundit për parandalimin e shkeljes së të drejtave. Në rast se gjykata e rregullta do të zbatonin në mënyrë korrekte normat kushtetuese dhe ligjore, do të zvogëlohej numri i ankesave (Hajiyev, 2002, f. 3).

Kriteri për shterimin e mjeteve juridike, sipas interpretimit të GJEDNJ-së (shih: neni 53 i Kushtetutës), është që t'iu ofrojë autoriteteve, përfshirë edhe gjykatave, mundësinë për të parandaluar apo përmirësuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës ofron mjete efektive juridike për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Gjykatës Kushtetuese (Ahmet Ismail Rexhepi v. Policia e Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Publik Komunal të Prishtinës, GJK, 2010, paragr. 18).

Rregulli i shterimit të mjeteve juridike përcakton se Gjykata Kushtetuese vepron si gjykatë subsidiare dhe jo si autoritet primar. Autoritetet primare janë gjykatat e rregullta që kanë për obligim të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit (Kushtetuta, neni 102, paragr. 3) dhe që prezumohet se të njëjtat jetësojnë në praktikë të drejtat e garantuara kushtetuese, përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë. Parimisht, shterimi i rrugëve gjyqësore është kriter i domosdoshëm që një kërkesë të jetë e pranueshme pranë Gjykatës Kushtetuese.

Rregulla e shterimit të mjeteve juridike nuk është absolute, ajo mund të jetë përjashtuese kur mjetet juridike të ofruara nuk janë efektive, apo mjetet juridike nuk ofrohen fare. Sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet të

shterojnë mjetet juridike vendëse, që janë në dispozicion dhe që janë efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. GJEDNJ, më tej, pranoi që rregulli i shterjes së mjeteve juridike nuk është as absolut e as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike. Me rastin e shqyrtimit, nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin e vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (Gëzim dhe Makfire Kastrati v. Gjykata Komunale në Prishtinë dhe KGJK, GJK, 2013, paragr. 47).

Lidhur me llojin e mjetit juridik që duhet shteruar, duhet përmendur se në procedurën penale në Kosovë, të pandehurit i ofrohen mjete juridike të rregullta dhe mjete juridike të jashtëzakonshme. Sipas nenit 113, paragr. 7 të Kushtetutës dhe neni 47, paragr. 2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk precizohet se cili lloj i mjeteve juridike duhet të shterohet që një kërkesë të jetë e pranueshme, por përmendet vetëm shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Gjykata Kushtetuese në çështjen *Bajrush Xhemajli kundër Gjykatës Supreme*, ka konsideruar se parashtruesi plotëson kriterin formal të shterjes së mjeteve juridike edhe pse ka shteruar vetëm mjetet juridike të rregullta dhe jo edhe mjetet juridike të jashtëzakonshme. Parashtruesi ka kontestuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme, që në çështjen e tij bazuar në dispozitat e KPP-së së mëparshëm, ka vepruar si gjykatë e ankesës, e jo si gjykatë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Me këtë, Gjykata Kushtetuese ka vendosur standard me anë të se cilës ka përcaktuar se nga parashtruesit kërkohet vetëm shterimi i mjeteve juridike të rregullta dhe jo edhe atyre të jashtëzakonshme juridike. Pra, atëherë kur aktgjykimi i marrë pas ushtrimit të ankesës merr formën e prerë, për Gjykatën Kushtetuese vlerësohet se plotëson kriterin formal të shterimit të mjeteve juridike (Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme, GJK, 2013, paragr. 64-65).

2.4. Saktësimi dhe bazueshmëria e kërkesës

Sipas dispozitës së nenit 48 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese, një tjetër kriter për pranueshmërinë e kërkesës është që *"parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."* Në parashtresat e dorëzuara në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë hollësitë e shkeljes së pretenduar të të drejtave dhe lirive të parashkruara në Kushtetutë dhe të tregojë veprimet konkrete (ose mosveprimet) e autoriteteve publike që kanë shkaktuar ato shkelje duke ia bashkëngjitur kërkesës të gjitha vendimet përkatëse me qëllim që Gjykata të ketë një pasqyrë të qartë të fakteve të rastit dhe të problemeve të ngritura. Në këtë mënyrë gjykata do të jetë në gjendje që të përcaktojë nëse rasti është i pranueshëm, dhe nëse është i pranueshëm, atëherë duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës (Mushkolaj, Morina, & Lamoen, 2014, fv. 358-359). Është kriter i domosdoshëm që parashtruesi të përcaktojë saktësisht cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë, duke arsyetuar shkeljen e tillë nga autoritetet gjyqësore të rregullta (Alil Memedoviq v. Gjykata Qarkut & Gjykata Supreme, GJK, 2011, paragr. 19).

Gjatë zhvillimit të procedurës penale në ndonjë nga instancat gjyqësore, i pandehuri mund të bëhet *"viktimë"* e mosrespektimit të dispozitave të garantuara kushtetuese. Nëse akti apo veprimet kundër-kushtetuese janë shkaktuar para marrjes së vendimit të formës së prerë, pretenduesi është i obliguar që pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese t'i paraqesë pranë instancave gjyqësore të rregullta, pasi që edhe ato janë të thirrura të veprojnë në përputhje me dispozitat kushtetuese. E drejta kushtetuese e shkelur gjatë procedurës së rregullt gjyqësore në gjykatat që trajtojnë çështjen penale mund të eliminojnë shkeljet eventuale, duke mos shfrytëzuar mjetin juridik të kërkesës për kontroll të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Me rastin e parashtrimit të kërkesës nga ana e kërkuesit, duhet identifikuar në mënyrë të qartë të drejtat kushtetuese të cilat pretendohet se janë shkelur.

Parashtruesi i kërkesës duhet të identifikojë saktësisht vendimin gjyqësor që konteston pranë Gjykatës Kushtetuese. Parimisht, vendimi gjyqësor duhet të jetë i formës së prerë, pasi të jenë shteruar të gjithë mjetet e rregullta juridike. Përveç të dhënave të vendimit gjyqësor që kontestohet, jo-domosdoshmërisht kërkohen të bashkëngjitura shkresat e lëndës për çështjes penale të gjykuar nga instancat e rregullta gjyqësore. Të dhënat relevantë për çështjen që ngritët pranë gjykatës, sipas nenit 26 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese mund t'i kërkojë vet gjykata nga institucionet publike relevante, pasi që të gjitha gjykatat dhe organet publike të Kosovës kanë për detyrë të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me të sipas kërkesës së saj.

Përveç kritereve të përmendura më sipër, një kërkesë e parashtruar pranë Gjykatës Kushtetuese nuk duhet që të jetë qartazi e pabazuar. Sipas Rregullës 36 paragr. 2, të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie; b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; c) gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

Pretenduesi duhet që kërkesën e tij të bazuar si *"viktimë"* ta arsyetojë dhe të paraqesë dëshmi të mjaftueshme për të argumentuar shkeljen e një të drejte të garantuar kushtetuese. Gjykata Kushtetuese refuzon si të pabazuar nëse pretenduesi dështon që të argumentojë prima facie kërkesat të përmendura si më sipër (Nexhat Ramadani v. Gjykata e Qarkut Gjilan dhe Gjykata Supreme, GJK, 2012, paragr. 25).

3. Kufijtë e shqyrtimit të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë

Gjykata Kushtetuese nuk vepron sipas detyrës zyrtare, ajo aktivizohet vetëm sipas kërkesave apo ankesave të paraqitura pranë saj. Sipas dispozitës së nenit 23 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht se pala tërhiqet edhe pse e ka nisur procedurën, gjykata do të vendosë për çështjet që iu janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara.

Sipas praktikës së deritanishme pranë Gjykatës Kushtetuese, në asnjë nga rastet kur është shqyrtuar kushtetutshmëria e vendimeve gjyqësore penale, nuk ka ndodhur që një palë që ka filluar procedurën të tërhiqet nga përmbajtja e kërkesës së parashtruar. Në rast të tërheqjes së parashtruesit pasi ka paraqitur kërkesën, është në diskrecion të kolegjit gjyqësor të vlerësoj rrethanat e çështjes së parashtruar, për të vlerësuar rëndësinë dhe pasojat e tjera të cilat mund të lindin në rast të vendosjes në mënyrë meritore.

Parimisht, gjykata vepron në bazë të kufijve të kërkesës së pretenduesit. Gjykata është e obliguar të veprojë sipas kërkesë së paraqitur nga pretenduesi, duke respektuar parimin tantum devolutum quantum appellatum. Ajo mund të shqyrtojë dhe procedurën si tërësi edhe në pjesët kur nuk është përmendur në kërkesën e parashtruesit dhe të vendos për çështje jashtë kërkesës, që njihet si ultra petitum (shih: Sahiti & Murati, 2016, f. 417). Në disa raste sikurse e përmendëm, gjykata mund të dalë jashtë pikave të kërkesës së parashtruar, mirëpo asnjëherë nuk mund të tejkalojë bazën e kërkesës pa ndonjë parashtrim tjetër, ku pala do të mund të plotësojë ose ndryshojë pikat e kërkesës, edhe pse kjo nuk mund të quhet dalje nga përmbajtja e kërkesës, pasi përsëri vendoset sipas kërkesës së ndryshuar të parashtruesit. Çështjet e pa-atakuara me anë të ankesës, Gjykata nuk e ka obligim që t'i trajtojë dhe si të tilla nuk i vendos ato me rastin e kontrollit të kushtetutshmërisë.

Sipas Rregullës 36, paragr. 3, të Rregullores së Punës së GJK-së, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme inter alia nëse gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri. Parimi *res judicata* është një kriter të cilin Gjykata Kushtetuese e respekton. Në çështjen *Bajrush Gashi kundër Gjykatës Kushtetuese*, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi përsëriti kërkesën se po i shkelen të drejtat kushtetuese për gjykim të drejtë, pasi çështja e parashtruar *prima facie* është e pabazuar pasi bie në kundërshtim me kriteret për pranueshmërinë e kërkesës përderisa gjykata për të njëjtën çështje kishte vendosur më përpara dhe gjykoi se çështja ka të bëjë me parimin res judicata (Bajrush Gashi v. Gjykata Kushtetuese, GJK, 2013, paragr. 31). Duke marrë parasysh procedurat para gjykatave të rregullta, Gjykata konsideron se kërkesa për gjykim të drejtë, e sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 31 të Kushtetutës, është se ajo mbulon procedurat në tërësi, dhe çështja nëse një person ka pasur një gjykim të drejtë shikohet me anë

të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo vetëm të një incidenti të veçantë ose të një mangësie procedurale, si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (Kamer Hajdini v. Gjykata Supreme, GJK, 2014, paragr. 39).

4. Efektet e shqyrtimit të vendimeve gjyqësore

Pa dyshim, mbrojtja e të drejtave dhe lirive kushtetuese është objektivi i të gjitha gjykatave: por kompetenca e Gjykatës Kushtetuese ka veçoritë e saj (Hajiyev, 2002, f. 3). Gjykata Kushtetuese nuk vepron ex-officio, por vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar (Kushtetuta e Kosovës, neni 113, paragr. 1). Fushëveprimi i kësaj gjykate është i përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Ajo është autoritet gjyqësor i pavarur nga gjykatat e rregullta dhe interpreton Kushtetutën dhe nuk shndërrohet në një gjykatë të faktit ashtu sikurse janë gjykatat e instancave të rregullta gjyqësor.

Sikurse çdo kërkesë tjetër edhe kërkesat individuale të parashtruara pranë Gjykatës Kushtetuese, duhet të përmbajnë vetëm pretendimet e rëndësishme që ndërlidhen drejtpërdrejt me garancionet dhe të drejtat kushtetuese që një i pandehur pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës penale nga instancat e rregullta gjyqësore nuk ka gëzuar të drejtën për gjykim të drejtë, apo të drejtat tjera të ndërlidhura me këtë të drejtë dhe që lidhen drejtpërdrejt me autorizimet dhe fushëveprimin e kësaj gjykate. Pra, kjo gjykatë merret vetëm me kontrollimin e respektimit të të drejtave të të pandehurit (parashtruesit) në procedurë penale, nëse atij iu ka ofruar gjykim i drejtë dhe i paanshëm sipas të drejtave të cilat i gëzon një i akuzuar me Kushtetutë. Ajo mund të shqyrtojë vetëm nëse të drejtat e të akuzuarit në procedurën penale janë respektuar. Parashtruesi do ta bëjë këtë edhe nëse në fakt ndihet i pakënaqur nga ajo që ai e konsideron të jetë një bindje e gabuar, sepse është i vetmi argument që do të dëgjohet (Trechsel, 2011, f. 181).

Në çështjen *Kamer Hajdini kundër Gjykatës Supreme*, parashtruesi në kërkesën e paraqitur ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve dhe aktvendimeve të

kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat pretendohen të kenë shkelur të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së. Gjykata përderisa ka trajtuar kriteret e përcaktuara për pranueshmërinë e kërkesës, thekson se ajo nuk është gjykatë e faktit dhe brenda fushëveprimit të saj të vlerësoj rrethanat se si kanë vepruar gjykatat e rregullta gjatë zhvillimit të procedurave paraprake penale. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si *"gjykatë e shkallës së katërt"*. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave t'i vlerësojnë provat që i kanë para tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Kamer Hajdini v. Gjykata Supreme, GJK, 2014, paragr. 41-42).

Gjykata nuk e trajton në thelb çështjen, duke i trajtuar edhe njëherë faktet dhe mënyrën e vlerësimit të tyre, apo standardet të cilat janë përdorur për çmuarjen dhe vlerësimin e provave. Gjykata ndalen ekskluzivisht në trajtimin e mënyrës së zbatimit të standardeve kushtetuese gjatë procedurës penale konkrete të cilat janë të përcaktuara me nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 31 të Kushtetutës dhe dispozitat tjera të cilat përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë. Shumica e kërkesave individuale të paraqitura pranë kësaj gjykate, janë kërkesa të papranueshme, pasi shumica e parashtruesve kontestojnë mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe paraqesin pretendime tjera të cilat nuk lidhen me cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë, gjë që gjykata nuk mund të tejkalojë fushëveprimin e përcaktuar ligjërisht dhe të ushtrojë funksione gjyqësore të instancave të rregullta gjyqësore. Ajo ndalet vetëm në kontrollin e respektimit të garancioneve kushtetuese të përcaktuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe instrumenteve tjera të zbatueshme, të cilat i garantohen të pandehurit në procedurën penale si tërësi.

Thjeshtë fakti se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të drejtës për gjykim të drejtë të

garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ (Bujar Spahiu v. Gjykata Supreme, GJK, 2014, paragr. 31).

Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 116, paragr. 1, të Kushtetutës janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Kosovës. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit ose ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme (Kushtetuta e Kosovës, neni 116, paragr. 2). Gjykata në çështjen *Bajrush Xhemajli kundër Gjykatës Supreme*, pas kërkesës së parashtruesit që aktgjykimi i formës së prerë ndaj tij të mos ekzekutohet përderisa nuk përfundohet çështja e ngritur pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykata konkludoi se, pa paragjykuar vendimin përfundimtar të kërkesës, parashtruesi i kërkesës ka ofruar argumente mjaft bindëse se zbatimi i vendimeve të instancave të rregullta gjyqësore që prerazi është vendosur me dënim me burgim ndaj tij, privimi i tij nga liria mund të rezultonin me dëmtimin e pandreqshëm të parashtruesit të kërkesës (Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme, GJK, 2012, paragr. 24)

Sipas rregullën 66 paragr. 2, të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, përcaktohet se nëse Gjykata ka nxjerrë një vendim për një lëndë penale, në bazë të dispozitës së ligjit, rregullores ose statutit komunal që është shpallur jo-kushtetues, personi kundër të cilit është nxjerrë vendimi mund të rihapë procedurën në lëndën penale. Kjo rregull nuk ka përcaktuar ndonjë afat të veçantë, qoftë afat subjektiv apo objektiv, por ka lënë të hapur se në cilëndo periudhë kohore nëse një dispozitë e ndonjë akti në bazë të së cilës është vendosur për ndonjë nga të drejtat e të pandehurit në procedurë penale, nga Gjykata Kushtetuese e njëjta shpallet kundër-kushtetuese, i pandehuri mund të rihapë procedurën penale pranë Gjykatës përkatëse për të kërkuar rigjykim në përputhje me efektet që kanë rezultuar nga rrethanat e reja të krijuara.

Sipas rregullës 74 paragr. 1 të kësaj Rregulloreje, parashihet se nëse Gjykata përcakton se një gjykatë ka lëshuar vendim duke shkelur Kushtetutën, ajo do ta shpallë të pavlefshëm atë vendim dhe do t'ia kthejë atë për rikonsiderim, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës. Lidhur me mënyrën e zbatimit të vendimeve, sipas rregullës 63, paragr. 4 të Rregullores së Punës së

Gjykatës Kushtetuese, kjo gjykatë mund të specifikojë, me vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës. Pas gjetjes se në një çështje të caktuar parashtruesi nuk ka gëzuar të drejtën për gjykim të drejtë ashtu sikurse përcaktohet në kushtetutë, aktgjykimi për rikonsiderim i kthehet instancës gjyqësore që ka bërë shkeljen me qëllim të korrigjimit dhe rivendosjes së çështjes sipas kërkesave të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Sipas rregullës 63, paragr. 5 të kësaj rregulloreje, parashihet që instanca gjyqësore që obligohet të zbatojë vendimin do të dorëzojë informacionet, nëse kërkohet ashtu si kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës (shih: Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme, 2012, paragr. 51 dhe 52).

Në pajtim me nenin 24, paragr. 3, 4 dhe 5 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, vendimet duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruara, nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari raportues. Përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtareve përcaktojnë vendimin e gjykatës. Vendimet shpallen publikisht dhe i dërgohet secilës palë sipas detyrës zyrtare dhe shpallet në gazetën zyrtare (Kushtetuta e Kosovës, neni 116, paragr. 4).

5. Analizë e kërkesave për cenim të së drejtës për gjykim të drejtë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për periudhën 2009 – 2016

Në këtë pjesë kemi analizuar vendimet e nxjerra nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës lidhur me të drejtën e pretenduar të palëve për gjykim të drejtë të parashtruara pranë kësaj gjykate nga viti 2009 kur është themeluar kjo gjykatë, deri në vitin 2016. Në bazë të vendimeve të shpallura nga Gjykata Kushtetuese në regjistrin e publikuar online, si dhe në seritë e buletineve të publikuara, kërkuesit kanë parashtruar gjithsejtë 86 kërkesa për t'u shqyrtuar nga kjo gjykatë, për cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë. Nga të gjithë këto kërkesa, gjykata ka gjetur se vetëm dy janë të bazuara dhe janë gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së. Vendimet tjera të shpallura nuk i plotësojnë kushtet formale për t'u trajtuar, pasi kanë të meta formale që bien në kundërshtim me kushtet e pranueshmërisë së kërkesave të tilla.

Nga këto statistika mund të shohim se në raport me Gjykatën Kushtetuese palët shohin atë si një institucion që merret me rishqyrtim të fakteve, apo si gjykatë të shkallës së katërt dhe jo në thelb të përgjegjësive që ajo ushtron realisht.

Në vazhdim po e pasqyrojmë tabelën me vendime të nxjerra nga Gjykata Kushtetuese lidhur me pretendimet për cenim të së drejtës për gjykim të drejtë për periudhën 2009 – 2016:

Nr.	Parashtruesi i kërkesës	Numri dhe data e vendimit	Pretendimet për të drejtat e shkelura (neni dhe akti)	Lloji i vendimit të shpallur
1)	*Mehdi Faik Fazliu v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 31/09, dt.11 maj 2010	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (pa specifikim)	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
2)	*Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 07/09, dt.19 maj 2010	Neni 6, KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
3)	*Dedë Gecaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 22/09, dt.20 maj 2010	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (pa specifikim)	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar) palejueshmëri
4)	*Sami Sekiraqa v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut*	Rasti nr. KI 16/09, dt. 23 qershor 2010	Neni 31 dhe 32 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
5)	*Petrit Morina v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 20/09, dt. 19 tetor 2010.	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (pa specifikim)	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
6)	*Hamide Osaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 55-2010, dt. 3 mars 2011	Neni 6, 24, 31 dhe 32 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
7)	*Alil Memedoviq v. Gjykata e Qarkut Prishtinë & Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 50-2010, dt. 21 mars 2011	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Mos saktësimi i kërkesës)
8)	*Binak Thaqi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 106-2010, dt. 4 tetor 2011	Neni 24.2, 30.1, 31.1.4, dhe 32 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Mos-shterimi i mjeteve juridike)
9)	*Ilmi Rakovica v. Gjykata Qarkut në Prishtinë & Gjykata*	Rasti nr. KI 113/10, dt. 3 nëntor 2011	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Mos-shterimi i mjeteve

	Supreme			juridike)
10)	*Dedë Bala v. Gjykata Komunale të Prishtinës; Gjykata së Qarkut të Prishtinës & Gjykatës Supreme*	Rasti nr. KI 42/11, dt. 12 dhjetor 2011	Neni 31 dhe 54 – Kushtetuta Neni 6 dhe 13 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
11)	*Lutfi Dervishi v. Gjykata Qarkut në Prishtinë*	Rasti nr. KI 80/11, 12 dhjetor 2011	Neni 31 – Kushtetuta Neni 5 dhe 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Mos shterimi i mjeteve juridike)
12)	*Muhamet Bucaliu v. Prokurori i shtetit*	Rasti nr. KI 92/11, 12 dhjetor 2011	Neni 24.1, 31.1 dhe 51 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
13)	*Nexhat Ramadani v. Gjykata Qarkut në Gjilan & Gjykata Supreme*	Rasti nr. Kl 10/11, 29 nëntor 2011	Neni 23, 24 dhe 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
14)	*Çlirim Grezda v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 62/11, 25 nëntor 2011	Neni 21, 23, 29, 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
15)	*Baki Musa v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 14/11, 23 nëntor 2011	Neni 24 dhe 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
16)	*Zyfer Sahitolli v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 59/11, 9 mars 2012	Neni 31.2 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
17)	*Neki Myha dhe Nijazi Xharavina v. Gjykata e Qarkut në Pejë*	Rasti nr. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11, dt. 20 mars 2012	31, 32, 53, 10 – Kushtetuta Neni 6 dhe 13 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
18)	*Vladimir Ukaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 26/11, dt. 25 nëntor 2011	Neni 31 § 1, 2 dhe neni 4, 32 dhe 41 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
19)	*Astrit Shabani v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Prishtinë*	Rasti nr. KI 66/11, dt. 21 maj 2012	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
20)	*Myrteza Dyla v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 108/11, dt. 4 maj 2012	Neni 31, 32 dhe 102 - Kushtetuta Neni 6 dhe 13 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
21)	*Arben KIQINA v.*	Rasti nr. KI 52/10,	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për

	Gjykata e Qarkut në Gjilan & Gjykata Supreme	dt. 11 qershor 2012		papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
22)	*Jeton Sefer KIQINA v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Prishtinë*	Rasti nr. KI 43/11, dt. 11 qershor 2012	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
23)	*Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Gjilan*	Rasti nr. KI 78/11, dt. 11 qershor 2012	Neni 30 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
24)	*Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Gjilan*	Rasti nr. KI 81/11, dt. 11 qershor 2012	Neni 30, 31 - Kushtetuta Neni 5 § 1, neni 6 § 1 dhe 2 dhe 14 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
25)	*Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 06/12, dt. 9 maj 2012	Neni 31 - Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktgjykim Gjykata konstaton që është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një tribunal i pavarur, siç garantohet me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
26)	*Shkumbin Mehmeti v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Prishtinë*	Rasti nr. KI 145/2011, dt.2012	Neni 21, 22, 24, 27, 29, 31, 32, 33 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
27)	*Selim Krasniqi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 111/11, dt.20 mars 2012	Neni 24, 30 dhe 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
28)	*Bali Dellova v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 44/12, dt.3 korrik 2012	Neni 22 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
29)	*Baton Morina v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 159/2011, dt. 13 korrik 2012	Neni 31, 32, 33 dhe 53 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
30)	*Alban Kastrati v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 24/12, dt. 10 qershor 2012	Neni 3, 21, 22, 24, 30, 31dhe 54 – Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri

			Neni 6 - KEDNJ	(Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis"* dhe kërkesa është qartazi e pabazuar sipas Gjykatës)
31)	*Jeton Salihu dhe Mentor Salihu v. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë & Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 13/11, dt.31 gusht 2012.	Neni 24, 30, dhe 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
32)	*Fatbardh Gabraj v. Gjykata e Qarkut në Pejë & Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 131/10, dt. 6 shtator 2012	Neni 23, 24, 30, 31 dhe 33 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
33)	*Shkelqim Devolli Blerim Devolli Ismet Bojku v. Gjykata e Qarkut në Prishtinë*	Rasti nr. KI 56/12, dt.19 shtator 2012	Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
34)	*Predrag Đorđević v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 163/11, dt.13 korrik 2010	Neni 24, 31 – Kushtetuta Neni 7 dhe 10 - DUDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
35)	*Avni Aliaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 76/11, dt. 11 tetor 2012	Neni 31§ 1 dhe 2 dhe neni 23 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
36)	*Valbona Zogaj v. Gjykata Supreme dhe Gjykata e Qarkut në Prizren*	Rasti nr. KI 21/11, dt. 03.07.2012.	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
37)	*Kastriot Gerbeshi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 03/12, dt. 31 tetor 2012	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
38)	*Hazër Susuri dhe Baki Hoxha v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 81/12, dt.15 janar 2013	Neni 32 dhe 54 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
39)	*Agim Stublla v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 74/12, dt.9 janar 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
40)	*Arianit Dyla v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 101/12, dt.18 janar 2013	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
41)	*Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 123/12, dt. 29 janar 2013	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Res judiciata)

42)	*Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 78/12, dt. 24 janar 2013	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 – KEDNJ Neni 10 - DUDNJ	Aktgjykim Gjykata konsideron se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, është shkelur për shkak se dështimi për t'i lejuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës për kundër-ekspertizë cenoi të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurave në tërësi dhe e privuan parashtruesin nga mundësia për të paraqitur argumente në mbrojtjen e tij në të njëjtat kushte si të prokurorisë.
43)	*Besnik Asllani v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 139/12, dt. 29 janar 2013	Neni 31 dhe 6 - Kushtetuta Neni 6 dhe 13 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
44)	*Adriatik Gashi dhe Burim Miftari v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 85/12 dhe KI 86/12, dt. 22 janar 2013	Neni 31, 32 dhe 53 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
45)	*Agron Prenaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 35/12, dt. 17 janar 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (nuk ka specifikim të drejtës)
46)	*Gani Morina v. Gjykata e Qarkut në Pejë*	Rasti nr. KI 103/11 , dt. 23 janar 2013	Neni 24, 31, 54, 55.5 – Kushtetuta Neni 1 dhe 8 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
47)	*Haki Gjocaj v. Gjykata Supreme*	rregulli 36KI 113/12, dt. 25 janar 2013	Neni 29, 31, 51.2 dhe 55 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Mos-shterimi i mjeteve juridike)
48)	*Ljubiša Živić v. Gjykata Qarkut në Mitrovicë & Gjykata Komunale në Vushtrri*	Rasti nr. KI124/11, dt. 21 nëntor 2012	Neni 3, 4, 54 dhe 56 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
49)	*Mark Duhanaj v. Gjykata Qarkut në Pejë & Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI19/13, dt. 12 mars 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
50)	*Enver Zeneli v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 10/13 , dt.12 mars 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)

51)	*Rifat Osmani v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 20/13, dt. 12 mars 2013	Neni 31, - Kushtetuta Neni 5.3, 5.4 dhe 6.1 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
52)	*Betim Ramadani v. Prokuroria e shtetit*	Rasti nr. KI 01/13, dt. 30 prill 2013	Neni 3, 41 dhe 54 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
53)	*Zahir Hasani v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 04/13, dt. 24 maj 2013.	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
54)	*Sokol Mushkolaj v. Gjykata Supreme, Gjykata e Qarkut në Prishtinë & Gjykata Komunale në Prishtinë*	Rasti nr. KI 22/13, Aktvendim për papranueshmëri i 10 qershor 2013	Neni 31 dhe 33 - - Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri 36 (1) (c) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.
55)	*Miftar Krasniqi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 38/13, dt. 15 maj 2013.	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6, paragr.1 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
56)	*Jashar Avdullahi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI-56/13, dt. 20 qershor 2013.	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
57)	*Bujar Shatri v. Gjykata e Qarkut në Prishtinë & Prokurori i Shtetit*	Rasti nr. KI 60/13, dt. 19 qershor 2013	Neni 36, paragr.3 – Kushtetuta Neni 12 – DUDNJ Neni 8 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Mos-shterimi i mjeteve juridike)
58)	*Bardhyl Krasniqi v. Gjykata e Qarkut në Prizren*	Rasti nr. KI39/13, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 qershor 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
59)	*Sali Shala v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 35/13, dt. 17 qershor 2013	Neni 21, 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
60)	*Asllan Bahtiri v. Gjykata e Qarkut në Prishtinë*	Rasti nr. KI-70/13, dt. 17 tetor 2013	Neni 30 dhe 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
61)	*Hysen Muqa v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 69/13, dt. 16 Tetor 2013	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6, paragr. 1 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
62)	*Raim Gashi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 80/13, dt. 18 tetor 2013	Shkelje e KPP-së, pa specifikuar të drejtën	Aktvendim për papranueshmëri

			kushtetuese	(Kërkesa është qartazi e pabazuar)
63)	*Isni Thaçi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI116/13 , dt. 27 dhjetor 2013	Neni 53 – Kushtetuta Neni 5.1, 5.3 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
64)	*Nazmi Mustafi v. Gjykata e Apelit*	Rasti nr. KI-88/13, dt. 22 tetor 2013	Neni 29 – Kushtetuta Neni 5 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
65)	*Tahir Bytyqi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI97/13, dt. 16 tetor 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
66)	*Blerim Shabi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI61/13, dt. 18 nëntor 2013	Neni 21, 23, 24, 30, 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
67)	*Bajrush Gashi v. Gjykata Kushtetuese*	Rasti nr. KI75/13, dt. 5 dhjetor 2013	*"Gjykata Kushtetuese më vonë ka marrë vendim tjetër me të cilin kërkesa e tij ishte refuzuar si e pabazuar, pa arsyetim."*	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
68)	*Abdyl Islami v. Gjykata Kushtetuese*	Rasti nr. KI14/14, dt. 26 shkurt 2014	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
69)	*Prend Prenkpalaj v. Gjykata Komunale Prizren*	Rasti nr. KI158/13, dt. 3 janar 2014	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
70)	*Emrije Asllani v. Prokuroria e shtetit & Gjykata e Qarkut në Prizren*	Rasti nr. KI88/12, dt. 2 dhjetor 2013	Neni 31 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
71)	*Lukë Kuzhnini v. Gjykata e Apelit*	Rasti nr. KI149/13, dt. 5 dhjetor 2013	Neni 31, 21, 23, 24, 25 dhe 29 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
72)	*Lumni Limaj v. Ministria e Drejtësisë*	Rasti nr. KI90/13, dt. 20 janar 2014.	Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
73)	*Arben Krasniqi v. Gjykata Themelore*	Rasti nr. KI32/14, dt. 12 mars 2014.	Neni 5 dhe 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e

				pabazuar)
74)	*Afrim Karaxha v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI123/13, dt. 20 janar 2014.	Neni 31, parag 1 dhe 2, neni 46, 54 - Kushtetuta Neni 6 dhe neni 1 i protok. 1 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
75)	*Durrës Shahini v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI34/14, dt. 24 mars 2014	Neni 29, 31 – Kushtetuta Neni 5 dhe 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
76)	*Selam Shoshaj dhe Bashkim Krasniqi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI43/13, dt. 17 tetor 2013	Neni 29 dhe 31 – Kushtetuta Neni 5 dhe 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
77)	*Abdyl Pasjaqa v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 33/13, dt. 7 maj 2014.	Neni 3, 6, 21, 24, 31 dhe paragr. 2 deri më 4 të nenit 102 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
78)	*Kamer Hajdini v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI33/14, dt. 31 mars 2014	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 – KEDNJ Neni 10 - DUDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
79)	*Bujar Spahiu v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 39/14, dt. 3 korrik 2014.	Neni 30 (6)n, 31 dhe 32 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
80)	*Afrim Terpeza v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 03/14, dt. 2 korrik 2014	Neni 24, 30 (paragr. 2 dhe 5), 31 (paragr. 4 dhe 6), 54, 106 (2) – Kushtetuta Neni 6 – KEDNJ Neni 7 dhe 10 - DUDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
81)	*Valon Haskaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI40/14, dt. 26 qershor 2014	Neni 31, 33 dhe 54 – Kushtetuta Neni 6 – KEDNJ Neni 8 dhe 10 - DUDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
82)	*Luan Ramadani v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI31/14, dt. 3 korrik 2014	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
83)	*Lalushe Boneshta v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI 123/14, dt. 9 dhjetor 2014	Neni 21(2), 24, 29, 31, 32 dhe 53 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
84)	*Abdurrahman Nazifi v. Gjykata Themelore në*	Rasti nr. KI140/14, dt. 25 nëntor 2014,	Neni 30 (5), 31 dhe 32 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri

	Prishtinë			(Mos-shterimit të mjeteve juridike)
85)	*Driton Kelmendi v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI148/14, dt. 9 dhjetor 2014	Neni 31 – Kushtetuta Neni 6 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
86)	*Alban Rexha v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI77/14, dt. 16 shtator 2014	Neni 31 dhe 102 (paragr. 2 dhe 3) – Kushtetuta Neni 6, paragr. 3 (d) – KEDNJ Neni 14 (1) - PDCP	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
87)	*Fidan Hyseni v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI130/14, dt. 9 dhjetor 2014	Neni 32 – Kushtetuta Neni 14 (5) – PDCP Neni 2 - KEDNJ	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)
88)	*Gazmend Musollaj dhe Nezir Kerrellaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI80/14 KI93/14, dt. 25 nëntor 2014	Neni 33 (4), 3, 19 dhe 31 - Kushtetuta paragr. 4, i nenit 33 të Kushtetutës	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është e paafatshme *"ratione temporis")*
89)	*Shpejtim Ademaj v. Gjykata Supreme*	Rasti nr. KI137/14, dt. 21 janar 2015	Neni 24, 31, 33 dhe 34 - Kushtetuta	Aktvendim për papranueshmëri (Kërkesa është qartazi e pabazuar)

Nga tabela e paraqitur më sipër, pamë të dhënat e parashtruara për numrin e parashtruesve të kërkesave, pretendimet e tyre për të drejtat e shkelura në procedurë penale, si dhe lloji dhe arsyeshmëria e vendimit. Nga kjo mund të japim disa mendime të vlefshme lidhur me rolin e Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe të drejtën e palëve për tu paraqitur pranë kësaj gjykate.

Nëse krahasojmë numrin e rasteve të vendosura me aktgjykim të formës së prerë nga gjykatat e rregullta, ky numër i kërkesave të paraqitura për këtë periudhë kohore të cilën e pasqyruam më sipër, nuk reflekton ndonjë fluks të madh të parashtrimeve. Por për këto raste është një karakteristikë dalluese pasi mbi 97% të rasteve janë refuzuar si kërkesa të papranueshme. Nga analiza e përmbajtjes së këtyre vendimeve, mund të shohim se palët ende nuk e kanë kuptuar drejtë fushëveprimin e kësaj gjykate, gjë që ekziston një keqkuptim lidhur me funksionet e saj. Në shumicën prej këtyre rasteve, gjykata është shprehur se nuk është gjykatë e faktit dhe as gjykatë e shkallës së katërt, po juridiksion gjyqësor që vepron sipas

fushëveprimit të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj, e që në këtë rast lidhet me shqyrtimet e pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese në procedurën penale.

Papranueshmëria e kërkesave bazohet kryesisht në mos-shterjen e mjeteve juridike, pastaj lidhet me tejkalimin e afateve, papërcaktueshmërinë e të drejtës së shkelur dhe situata të tjera. Nga dy rastet në të cilat gjykata ka shpallur aktgjykim duke i dhënë të drejtë parashtruesve, gjykata ka gjetur se është shkelur parimi i *"barazisë së armëve"*, përkatësisht e drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur.

Në çështjen *Bajrush Xhemajli kundër Gjykatës Supreme* (2013), parashtruesi ka kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012 dt. 22 qershor 2012, pasi sipas tij Gjykata Supreme pa ndonjë arsyetim të bazuar, nuk ka shqyrtuar provat e propozuara nga mbrojtja. Sa i përket meritave të kërkesës, gjykata ka vërejtur se mënyra se si janë trajtuar provat në rastin e parashtruesit, demonstron një kompleks vendimesh, të cilat reciprokisht përforcojnë ndikimin e tyre mbi drejtësinë e gjykimit të parashtruesit. Së pari, gjykatat e rregullta në vazhdimësi kanë refuzuar të autorizojnë një ekspertizë plotësuese sipas kërkesës së bërë nga avokatët e parashtruesit lidhur me vërtetimin e faktorëve që ndikuan në aksident. Së dyti, gjykatat e rregullta e justifikuan këtë refuzim me pretendim se situata në bazë të raportit ekzistues të ekspertëve ishte mjaftueshëm e qartë. Megjithatë, ky raport i ekspertit ishte i bazuar në raportin e bërë nga Policia, pa ndonjë procedurë nga eksperti për të vërtetuar personalisht, me përpjekje individuale, informatat e përmbajtura në raportet policore. Vlefshmëria e raporteve të Policisë, gjithashtu, nuk ishte vërtetuar në asnjë fazë të procedurës nga ndonjë zyrtar i autorizuar gjyqësor ose nga ndonjë gjykatë. Është e diskutueshme ajo se deri ne çfarë mase ishte në pozitë parashtruesi të kontestonte përmbajtjen e këtij raporti, edhe në qoftë se ai ishte ne gjendje të kontestonte raportin e ekspertit bazuar në këto raporte policore. Për këto mangësi në trajtimin e provave në rastin e parashtruesit, Gjykata konstaton se, kur shikohet drejtësia e procedurës penale në rastin e parashtruesit si tërësi, nuk mund të thuhet se ai ka përfituar nga një *"gjykim i drejtë"* të garantuar sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe për këto arsye gjykata e shpalli të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe ktheu aktgjykimin e kësaj për rivendosje (shih: Buletini i Gjykatës Kushtetuese, 2013, f. 172)

Në çështjen *Bajrush Gashi kundër Gjykatës Supreme* (2012), parashtruesi ka kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 67/2011, si të vendim të marrë me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi ankohet veçanërisht që gjyqtari që ka vendosur rastin e tij në cilësinë e Kryetarit të Kolegjit në Gjykatën e Qarkut në Prizren, njëkohësisht ka marrë pjesë edhe në vendimin e Gjykatës Supreme në kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Për më tepër, parashtruesi pretendon që gjyqtari në fjalë është dashur të përjashtohej nga pjesëmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme. Në përgjigjen e Gjykatës Supreme për këtë rast, thuhet se pjesëmarrja e gjyqtarit të njëjtë ka ndodhur për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve që ka kjo gjykatë dhe për asnjë arsye tjetër. Gjykata thekson se paanshmëria e Gjykatës Supreme për këtë rast ka mundësi të vihet në dyshim dhe se brengat e parashtruesit në këtë kuptim konsiderohen të bazuara subjektivisht dhe objektivisht. Gjykata ka konsideruar që çështja nëse ka pasur apo jo gjyqtarë të mjaftueshëm për të vendosur për zbutje të dënimit është çështje brenda gjyqësorit, e që mund të diskutohet, sipas nevojës, mes gjyqësorit dhe Qeverisë. Përgjegjësia kryesore për administrimin e duhur të drejtësisë i përket Qeverisë, derisa çështjet organizative nuk mund të shfrytëzohen si justifikim për mosrespektimin e Kushtetutës. Në këto rrethana, Gjykata ka theksuar se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një gjykatë e pavarur, siç garantohet me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së, është cenuar. Gjykata e shpalli të pavlefshëm aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe obligoi Gjykatën Supreme që të rigjykojë çështjen (shih: Buletini i Gjykatës Kushtetuese, 201, f. 125).

KAPITULLI XI

EFEKTET JURIDIKE TË KUFIZIMIT TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË

1. E drejta për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

1.1. E drejta për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme sipas instrumenteve ndërkombëtare

Në instrumentet ndërkombëtare që garantohet e drejta për gjykim të drejtë, kjo e drejtë nuk hynë në grupin e të drejtave për të cilat këto instrumente shprehimisht kërkojnë që nuk mund të pezullohet. Megjithatë, ky aspekt nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë nga kërkesa për të respektuar të drejtën për gjykim të drejtë, pasi vet esenca e kësaj të drejtë nënkupton respektimin e thelbit të saj, si një nga të drejtat themelore të cilat janë pjesë e Kushtetutës sonë bazuar në nenin 22 të saj. Sipas nenit 4 § 1 të PDCP-së, theksohet se në kohën kur një rrezik publik i jashtëzakonshëm kërcënon ekzistencën e popullsisë dhe shpallet si i tillë, shtetet palë të instrumentit mund të marrin masa me të cilat i shmangen detyrimet e parapara, në vëllimin e caktuar sipas kërkesave të situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në s'përputhje me detyrimet e tyre të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të mos ngatërrojnë, si pasojë, një diskriminim të caktuar. Sipas nenit 4 § 2 të PDCP-së, parashihet se nuk mund të ketë shmangie nga neni 6 [drejta për jetë], neni 7 [ndalimi i torturës dhe dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore, e poshtëruese], neni 8 [ndalimi i mbajtjes në robëri dhe në një gjendje nënshtrimi], neni 11 [liria e hyrjes dhe daljes nga shteti], neni 15 [parimi i legalitetit], neni 16 [e drejta e subjektivitetit personal], dhe neni 18 [liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë].

Gjithashtu, në dispozitat e PDCP-së përcaktohet se shtetet që shfrytëzojnë të drejtën e shmangies, i njoftojnë menjëherë shtetet e tjera palë nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, lidhur me dispozitat nga të cilat ato janë shmangur si dhe lidhur me arsyet që i kanë shtyrë të bëjnë këtë shmangie. Me ndërmjetësimin e njëjtë bëhet një kumtim i mëtejmë lidhur me afatin kur këto shtete do përfundojnë shmangien. Lidhur me njoftimet e përmendura, shteti

i Kosovës nuk ka asnjë obligim të raportojë në formën e tillë, pasi nuk është shtet palë e këtij instrumenti. Konventa është e hapur vetëm për shtetet anëtare që janë pjesë e OKB-së, gjë që Kosova ende nuk është anëtarë. Kosova vullnetshëm me rastin e hartimit të Kushtetutës, PDCP-në dhe një mori instrumentesh të tjera ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore, i ka përfshirë si pjesë të rendit juridik të saj.

Sipas nenit 15 § 1 dhe 2 të KEDNJ-së, parashihet se në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset, çdo shtet palë e konventës mund të marrë masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga Konventa, vetëm për aq sa e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare. Për të drejtat sikurse është e drejta për jetën, ndalimi i torturës, ndalimi i skllavërisë dhe të drejtën për t'u mos u dënuar pa ligj, Konventa përcakton shprehimisht se nuk mund të bëhet asnjë shmangie, pavarësisht rrethanave të gjendjes së jashtëzakonshme. E drejta për gjykim të drejtë nuk është në mesin e të drejtave që shprehimisht Konventa nuk ka lejuar shmangie.

Çdo shtet palë e Konventës që ushtron që shmang respektimin e dispozitave të Konventës gjatë shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme e mban plotësisht të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të KE-së për të gjitha masat e marra dhe arsyet pse ato janë marrë. Gjithashtu, ato duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të KE-së për datën në të cilën këto masa kanë humbur fuqinë dhe dispozitat e Konventës vihen sërish në zbatim të plotë. Kosova nuk është anëtar i KE-së dhe në pamundësi të ratifikimit të Konventës, me rastin e hartimit të Kushtetutës së saj, në mënyrë të drejtpërdrejt e ka bërë pjesë të rendit të vet juridik dhe KEDNJ. Duke mos qenë palë e Konventës, ajo dhe nuk ka obligime për respektimin e Konventës në kontekst të raportimit pranë instancave përkatëse sikurse e bëjnë shtetet palë të Konventës. Ajo në mënyrë të drejtpërdrejt i zbaton dispozitat e Konventës si pjesë të rendit të brendshëm juridik.

1.2. E drejta për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme sipas Kushtetutës

Rregullimi i gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë është kategori kushtetuese. Sipas nenit 56, paragr. 1 të Kushtetutës, parashihen rrethanat në të cilat mund të shpallet gjendja e

jashtëzakonshme, ku përcaktohen të drejtat të cilat nuk mund të pezullohen gjatë periudhës kur ekziston gjendja e jashtëzakonshme. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme të përcaktuar me Kushtetutë dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.

Sipas nenit 131, paragr. 1 të Kushtetutës, shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme është në diskrecion të Presidentit të Republikës. Presidenti mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme, kur ka: 1) nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; 2) rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; 3) fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij. Përderisa zgjat gjendja e jashtëzakonshme, sipas nenit 131, paragr. 2 të Kushtetutës, ky akt (Kushtetuta) nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me Kushtetutë.

Sipas nenit 56, paragr. 2 të Kushtetutës, nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara sikurse në vijim: dinjiteti i njeriut, barazia para ligjit, e drejta për jetën, ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar, e drejta e lirisë dhe sigurisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale, e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, e drejta e martesës dhe familjes, liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

E drejta për gjykim të drejtë është një nga të drejtat të cilën Kushtetuta e përcakton si të drejtë të pashmangshme, pavarësisht rrethanave në të cilën gjendet shoqëria dhe shteti. Duke mos pasur të drejtë që shteti të pezullojë këtë të drejtë, ajo duhet të garantohet pavarësisht rrethanave të caktuara, ndërsa e njëjta mund të kufizohet për arsye të cilat përcaktohen në ligj në mënyrë specifike, por asnjëherë të vijë si rezultat i kufizimit të drejtave dhe lirive të caktuara për shkak të gjendjes e cila është shpallur në rrethana të caktuara. Edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Kushtetuta nuk suspendohet, ajo qëndron si akt i zbatueshëm për aq sa lejohet dhe është e mundshme për t'u zbatuar në praktikë. Sikurse gjithë sistemi juridik, edhe Kushtetuta është një nga aktet të cilat duhet të zbatohen vetëm atëherë kur krijohen rrethana

dhe mundësi që e njëjta të gjejë hapësirë të nevojshme për t'u jetësuar. Duke ditur se shteti ligjor qëndron në thelb të Kushtetutës dhe sistemit juridik, funksionimi i tillë nuk e cenon të drejtën për gjykim të drejtë, përkundrazi e mban në mënyrë të vazhdueshme si një nga të drejtat të cilat e përbëjnë esencën e shtetit ligjor dhe të së drejtës.

1.3. Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti

Pezullimi i të drejtës për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme duhet të jetë në përputhje me përshtatshmërinë dhe domosdoshmërinë e arritjes së qëllimit të caktuar, duke mos cenuar në asnjë mënyrë esencën e të drejtës për gjykim të drejtë. Dispozitat të cilat vlejnë për kufizimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, në mënyrë analoge për aq sa është e mundshme interpretohet dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Shteti për të arritur qëllimet e tij legjitime, domosdoshmëria dhe propocionaliteti duhet të jenë parimet dalluese gjatë menaxhimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

Shmangia nga respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, apo derogimi i plotë i kësaj të drejte, duhet të bazohet në arsyet e domosdoshmërisë. Të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat u nënshtrohen kufizimeve apo shmangieve të caktuara nuk guxojnë të cenojnë të drejtat e garantuara dhe nuk është e lejuar të zbatohen nën veprimet e arbitraritetit. E drejta për gjykim të drejtë, edhe pse e përfshirë si një nga të drejtat të cilat nuk guxojnë t'u shmanget, ajo mund të bëhet arbitrarisht objekt i ndonjë shmangie për disa nga elementet të cilat e përbëjnë vet esencën e të drejtës. Krahasuar me KEDNJ-në dhe PDCP-në, Kushtetuta është shumë më e ashpër në favor të absolutizimit të së drejtës për gjykim të drejtë në të gjithë rrethanat në të cilat gjendet shteti dhe shoqëria. Duke njohur vlerën e gjykimit të drejtë, marrë parasysh dhe situatat që mund të vendoset në mënyrë arbitrare, rregullat kushtetuese aktuale nuk lejojnë relativizimin e kësaj të drejte.

1.4. Instrumentet ndërkombëtare të cilat nuk lejojnë pezullimin e të drejtës për gjykim të drejtë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 1984, obligon të gjithë shtetet të cilat janë palë në këtë konventë që të garantojnë të drejtë për gjykim të drejtë për të gjithë të dyshuarit dhe të pandehurit, duke u ofruar atyre të gjithë garancitë procedurale të garantuara me instrumente ndërkombëtare. Pavarësisht rrethanave në të cilat gjenden këto shtete, kanë për obligim që të respektojnë këto standarde, gjë që ka një kujdestari dhe raportim permanent. Konventa përcakton të drejtën e personit për t'u trajtuar në mënyrë të dinjitetshme dhe në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Tortura dhe veprimet tjera të cilat shkaktojnë trajtim çnjerëzor, poshtërues dhe denigrues nuk duhet të gjejnë hapësirë në territoret dhe nga zbatuesit e ligjit për shtetet që kanë pranuar obligimet nga ky instrument ndërkombëtar. Pavarësisht rrethanave, Konventa nuk amniston shtetet që në raste të caktuara të mund të shmangin apo dërgojnë respektimin e ndalesës kundër torturës. Konventa në nenin 2 § 2, përcakton se asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën. Sipas nenit 7 § 3 të Konventës, i garantohet të pandehurit trajtim human gjatë gjithë zhvillimit të procesit penale. Pavarësisht rrethanave në të cilat është shteti, trajtimi që mund të rezultojë me tretman çnjerëzor, poshtërues dhe denigrues është i papranueshëm.

Në kohë lufte, instrumentet ndërkombëtare janë strikte në garantimin e të drejtës për gjykim të drejtë. Shprehimisht është e përcaktuar garantimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, duke u ofruar gjithë garancionet procedurale të përcaktuara me instrumente ndërkombëtare. Sipas nenit 3 të Përbashkët të Konventës së Gjenevës (1949), përcakton se në rastin e konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar që ndodh në territorin e njërës nga palët kontraktuese të konventës, është e detyruar të garantojë që personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë hedhur

armët, apo që janë me sëmundje, plagë, paraburgim ose ndonjë shkak tjetër, në të gjitha rrethanat duhet të trajtohen në mënyrë humane, pa i diskriminuar në bazë të racës, ngjyrës, religjionit ose besimit, gjinisë, origjinës ose pasurisë, ose ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm. Për këtë kategori të personave sipas Konventës është e ndaluar inter alia: dhënia dhe ekzekutimi i dënimeve pa vendim të mëparshëm të shpallur nga një gjykatë e krijuar sipas rregullave, duke siguruar të gjitha garancitë gjyqësore të pranueshme.

Sipas nenit 5 të Konventës e Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë në Luftë (si një ndër katër konventat e Gjenevës, 1949) thekson që në secilin rast, personat civil duhet të trajtohen me humanitet, dhe në rast të gjykimit, nuk do të hiqen të drejtat e gjykimit të drejtë dhe të rregullt të përshkruar në Konventë. Atyre u jepet gjithashtu e drejta dhe privilegjet e plota të një personi të mbrojtur në kohën më të hershme të mundshme dhe që duhet të jetë në përputhje me sigurinë e Shtetit.

2. Kufizimi i të drejtës për gjykim të drejtë

Të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës penale mund t'i kufizohen të drejta të caktuara të cilat janë të lidhura me personin si subjekt i së drejtës. Normalisht personi që i nënshtrohet procedurës penale në cilësinë e të pandehurit, sipas arsyetimeve të ligjshme, mund t'i vendoset ndonjë nga masat për të siguruar praninë e tij në procedurë. Cilado masë qoftë, në një mënyrë ia cenon një të drejtë të caktuar, mirëpo përderisa autoriteti shtetëror është duke ndjekur një qëllim legjitim sikurse është zhvillimi i procedurës penale, kjo me automatizëm përjashton procedurën penale si veprim arbitrar, por legjitimon veprimet procedurale të autoriteteve si veprime të domosdoshme dhe proporcionale për të jetësuar qëllime të ligjshme.

E drejta për gjykim të drejtë është ngritur në një parim të rëndësishëm në procedurë penale. Rregullat kushtetuese dhe ligjore kanë vendosur kritere të veçanta, për rastet kur një e drejtë mund të kufizohet dhe sa do të mund të jetë kohëzgjatja e tij. Sipas Kushtetutës, një e drejtë e garantuar kushtetuese, mund të kufizohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht

me ligj dhe vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi (Kushtetuta e Kosovës, 2008, neni 55, paragr. 1 dhe 2). Ndërsa, sipas nenit 55, paragr. 3 të Kushtetutës, parashihet që me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut, apo kufizimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

E drejta për gjykim të drejtë, nuk është një e drejtë e pakufizuar, varësisht nga natyra e rastit, ajo mund të paraqitet si një e drejtë absolute, ndërsa në raste tjera si një e drejtë relative. Elementet e gjykimit të drejtë, sikurse është e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm, e drejta për përkthyes dhe ndihmë juridike, barazia e mjeteve, e drejta për t'u mbrojtur vet ose me anë të mbrojtësit, e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim janë të drejta absolute dhe nuk guxojnë të cenohen në asnjë rrethanë. Të drejtat e tilla absolute, në rast se do të kufizoheshin do të paraqisnin rrezik që të cenohet vet esenca e të drejtës së garantuar. Ndërsa, në elemente tjera, e drejta për gjykim të drejtë mund të jetë relative. E drejta për gjykim publik, mund të jetë një nga të drejtat të cilat mund të kufizohet. Kjo nuk është e drejtë absolute, pasi sipas nenit 294, paragr. 1 të KPP-së, parashihet se, nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, nëse është e nevojshme për rastet e caktuara të cilat në mënyrë taksative përmenden në KPP. Publiku mund të përjashtohet dhe të kufizohet vetëm ne publicitetin e palëve. Kjo e drejtë nuk është absolute, por nuk guxon të cenohet vetë e drejta në mënyrë arbitrare dhe të keqpërdoret ajo.

Lidhur me kohëzgjatjen e kufizimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese në çështjen *Valon Bislimi kundër Ministria e Punëve të Brendshme, KGJK dhe Ministria e Drejtësisë,* vëren që praktika e mirëfilltë gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson që një masë e shqiptuar, ndonëse e justifikuar në fillim, mund të bëhet disproporcionale dhe t'i shkelë

të drejtat e individit nëse automatikisht zgjatet për një periudhë të gjatë kohore (Valon Bislimi v. Ministria e Punëve të Brendshme, KGJK dhe Ministria e Drejtësisë, GJK, 2010, paragr. 77). Në këtë kontekst, kufizimi i ndonjë të drejtë të caktuar që përbënë të drejtën për gjykim të drejtë, duhet të ndjekë praktikën e njëjtë, duke siguruar që të pandehurit t'i ofrohen garancionet e përshtatshme në procedurë penale dhe kufizimet eventuale të cilat bazohen në ligj, të kenë kohëzgjatje racionale në mënyrë që masa e përcaktuar e kufizimit t'i respektojë kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Rishqyrtimi i vazhdueshëm i një mase të vendosur në një moment të caktuar, bënë të mundshme që kufizimet e caktuara të kenë legjitimitet permanent.

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

1. Gjetjet kryesore të studimit

Qëllimi kryesor i studimit ishte shqyrtimi i masës së konceptualizimit të së drejtës për gjykim të drejtë në të drejtën e procedurës penale, si dhe krahasimi i harmonizimit të kësaj të drejte me standardet e parapara në instrumentet dhe jurisprudencën ndërkombëtare. Hulumtimi i temës në një literaturë gjithëpërfshirëse, konsultimi me një numër të madh të rasteve gjyqësore të nxjerra nga GJEDNJ, më pas analiza e standardeve për gjykim të drejtë në instrumentet ndërkombëtare dhe në aktet e brendshme, duke filluar nga Kushtetuta, ligjet dhe aktet nënligjore, bazuar në këtë hulumtim mund të konkludojmë se:

- E drejta për gjykim të drejtë paraqitet si një nga të drejtat themelore që garantohet me instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, duke filluar nga neni 10 i DUDNJ-së, neni 14 i PDCP-së, neni 6 i KEDNJ-së. Kjo e drejtë është pjesë e rëndësishme e shumicës së instrumenteve ndërkombëtare konvencionale dhe jo-konvencionale. Instrumentet e detyrueshme kanë mekanizmat që kontrollojnë respektimin e normave që janë pjesë e këtyre instrumenteve, zbatimin e PDCP-së e përcjellë Komiteti për të Drejtat e Njeriut, ndërsa zbatimin e KEDNJ-së, e përcjellë GJEDNJ. Tanimë, e drejta për gjykim të drejtë është pjesë thelbësore e gjykimeve penale që bëjnë gjykatat penale ndërkombëtare. Sikurse gjykatat ad hoc, ashtu edhe Gjykata e Përhershme Penale, në statutet e tyre dhe në rregulloret e procedurës dhe provave kanë vendosur të drejtën për gjykim të drejtë, duke përvetësuar të gjithë standardet ndërkombëtare që garantojnë këtë të drejtë që nga PDCP dhe KEDNJ, si dhe përvetësimin e jurisprudencës së mekanizmave që bëjnë interpretimin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare. Praktika e GJEDNJ-së është një nga praktikat më ndikuese në rajonin e Evropës, ajo tanimë është bërë udhërrëfyes shtetet të cilat kanë objektiva të qartë për avancimin e të drejtave të njeriut. Një rol të jashtëzakonshëm ka dhënë për shtetet e dala pas rënies së

komunizmit, ku përveç zbatimit të drejtpërdrejt të KEDNJ, këto shtetet kanë ndërtuar një legjislacion në përputhje me jurisprudencës e GJEDNJ-së.

- Konceptualizimi i të drejtës për gjykim të drejtë në Republikën e Kosovës është pjesë e rëndësishme e sistemit juridik. Ajo është e pranishme në të gjithë aktet juridike relevante që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, duke filluar nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik, si dhe në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Kjo e drejtë është në harmoni me kriteret që kërkohen sipas instrumenteve dhe ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë. Sipas nenit 22 të Kushtetutës, në Kosovë zbatohen drejtpërdrejt një mori instrumentesh ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, sikurse janë: 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; 3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; 4) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; 5) Konventa për të Drejtat e Fëmijës apo 6) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Teknika e përvetësimit të cilën e ka aplikuar Kosova, përbënë një metodologji të veçantë që nuk prodhon efekte detyruese për të si shtet. Në pamundësi që Kosova të bëhet anëtare e OKB-së, apo e KE-së, ka bërë pjesë të rendit të saj të brendshëm juridik këto instrumente ndërkombëtare. Një teknikë tjetër të cilën e ka përdorë, është dhe huazimi gjuhësor në pjesën dërmuese të legjislacionit të saj, që garanton të drejtën për gjykim të drejtë. Mirëpo, pavarësisht se qytetarët i kanë të garantuara të drejtat e tyre me këto instrumente ndërkombëtare, ata nuk mund të paraqiten si palë kërkuese në GJEDNJ, pasi Kosova nuk është shtet anëtar i KE-së.

- E drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe të themeluar me ligj, është konceptualizuar në të gjitha aktet e rëndësishme dhe është e harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Pavarësia e pushtetit gjyqësor sigurohet nëpërmes KGJK-së që funksionon sipas rekomandimeve të KE-së dhe të Komisionit të

Venedikut. KGJK është institucion i pavarur kushtetues dhe ka pavarësi institucionale që është e shprehur nëpërmes pavarësisë: juridiksionale, administrative, financiare dhe në vendimmarrje. Përbërja e KGJK-së është diverse, edhe pse disa nga emërimet që vijnë nga Kuvendi, kjo nuk e cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Organizimi i brendshëm administrativ i gjykatave, është autonomi e vet gjyqësorit dhe nuk është i lidhur as në vijë horizontale, e as vertikale me pushtetin e Qeverisë, apo të Kuvendit. Pavarësia individuale e gjyqtarëve shprehet nëpërmes pavarësisë së brendshme dhe pavarësisë së jashtme, që është në përputhje me *Magna Karta të Gjyqtarëve*, me opinionet e KKGJE-së dhe Opinionet e Komisionit të Venedikut. Emërimi dhe promovimi i gjyqtarëve bëhet nga KGJK, si organ përgjegjës për të siguruar pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe është në përputhje me kërkesat që dalin nga instrumentet ndërkombëtare të sipërpërmendura. Liria e shprehjes dhe e asociimit i garantohet gjyqtarëve sikurse çdo qytetari në Kosovë, me një kujdes të shtuar lidhur me funksionet gjyqësor që i ushtron gjyqtari, duke ruajtur çdoherë pavarësinë dhe paanshmërinë e funksionit. Imuniteti është kategori kushtetuese që vlen edhe për gjyqtarë, ai është funksional dhe nuk është absolut, por është masë mbrojtëse e mjaftueshme që ata të ndjehen të pavarur dhe t'i sigurohet paanshmërisë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Imuniteti funksional është i shtrirë ndaj ndjekjeve penale dhe padive civile. Përgjegjësia disiplinore është një dimension i rëndësishëm që siguron një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, me bazën ligjore pozitive që zbaton pushteti gjyqësor, sjelljet e pahijshme sanksionohen dhe bëhen objekt trajtimi në instancat përkatëse pranë KGJK-së. Procedura disiplinore udhëhiqet vetëm nga gjyqtarët dhe nuk përbënë interferim të pushteteve tjera, apo personave që nuk bartin funksione gjyqësore.

- E drejta e të pandehurit për gjykim të paanshëm sigurohet nëpërmes Kushtetutës, KPP-së, Ligjit për Gjykatat, Ligjit për KGJK, Kodit të Mirësjelljes për Gjyqtarë. KPP përmban dispozitat në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të përjashtuar gjyqtarët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë që bien ndesh me standardet e kërkuara të paanshmërisë. Sikurse tek rasti i paanshmërisë objektive, ashtu dhe tek rasti i

paanshmërisë subjektive, i pandehuri gëzon të drejtën për të kërkuar përjashtimin e një gjyqtari mbi bazën e qëndrueshme të një arsyetimi të pranueshëm. Këto standarde janë në përputhje me instrumentet ndërkombëtare, sikurse janë: Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, Opinionin e KKGJE-së për Standardet e Pavarësisë së Gjyqësorit dhe Palëvizshmërinë e Gjyqtarëve, Magna Karta e Gjyqtarëve, apo me jurisprudencën e GJEDNJ-së.

- E drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj është e paraparë në Kushtetutë, KPP dhe Ligjin për gjykatat. Struktura aktuale e gjykatave është strukturë me bazë kushtetuese dhe nuk lejon sistem gjyqësor paralel, ku në situata të jashtëzakonshme të krijohen gjykata të veçanta për ndonjë çështje të caktuar. Kjo është në përputhje me kërkesat që dalin nga instrumentet ndërkombëtare, sikurse është neni 14 i PDCP-së, apo neni 6 i KEDNJ-së. Kjo e drejtë përfshin dhe të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar nga gjyqtar kompetentë, gjë që shprehet dhe me elementin e legjitimitetit të gjyqtarit, duke filluar nga mënyra e emërimit, qëndrimi në detyrë, si dhe çështjen e mandatit në përgjithësi. Gjykata qëndron si institucion apolitik dhe nuk ndjek rrugë programore politike, por funksionin vetëm mbi bazën kushtetuese dhe ligjore që ka legjitimitet qytetar demokratik. Pushteti gjyqësor siguron mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Edhe pse sistemi paraqitet si mekanizëm subsidiar, ajo është instancë kredibile për t'i trajtuar çështjet relevante sipas Kushtetutës dhe ligjit. Mbrojtja gjyqësore është e drejtë kushtetuese dhe përfshin të drejtën e personit që t'i drejtohet gjykatës dhe të drejtën për të pasur mjete efektive juridike. Në të dy elementët që përbëjnë këtë të drejtë, ende nuk është krijuar praktikë e përshtatshme që çdokush që ka pretendim për shkelje të ndonjë të drejtë të përcaktuar me Kushtetutë apo ligj, të mund t'i adresojë drejtpërdrejt në instancat përkatëse dhe çështja e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës të jetë i njëmendtë dhe jo vetëm formale. Lidhur me çështjen e gëzimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata Kushtetuese në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së ka gjetur në një mori rastesh se parashtruesve u është shkelur e drejta për mjete juridike, pasi ata nuk kanë pasur mjete juridike, apo të

njëjtat nuk kanë qenë efektive, gjë që u është mohuar e drejta e tyre për t'iu drejtuar gjykatës, pa paragjykuar asnjëherë rezultatin në favor ose jo të tyre. Gjithashtu, e drejta për barazi para gjykatës, është e drejtë e ndërtuar me bazë kushtetuese dhe ligjore të harmonizuar me instrumentet ndërkombëtare, ku çdo i pandehur gëzon të drejtën të trajtohet i barabartë, pavarësisht cilësive apo orientimit të tij personal, apo të origjinës dhe nuk guxon të jetë subjekt i trajtimit diskriminues përgjatë zhvillimit të procedurës penale.

- E drejta për gjykim publik si e drejtë e përgjithshme është adresuar në mënyrë të qartë në Kushtetutë, KPP, Ligjin për gjykatat dhe Ligjin për KGJK dhe është në përputhje me standardet e përcaktuara me instrumente ndërkombëtare. Edhe pse kjo e drejtë deri në shqyrtim gjyqësor është gati e pavërejtur, kjo situatë asnjëherë edhe në këtë fazë nuk e cenon të drejtën e të pandehurit për të gëzuar këtë të drejtë. Gjykimi publik mundëson që publiku të shoh se si po bëhet drejtësia, pasi drejtësia është interes edhe i qytetarëve dhe jo vetëm i të pandehurit. Gjykimi publik mundëson të vihet në pah e vërteta dhe mundësohet kontradiktoriteti i procedurës penale në mes të palëve si palë kundërshtare dhe gjyqtarit si arbitër i paanshëm, por me raste dhe me një rol edhe aktiv. Në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 14 të PDCP-së, sipas nenit 294 të KPP-së, në rrethana të veçanta shqyrtimi gjyqësor mund të zhvillohet pa praninë e publikut. Prania e mediave është e lejuar sikurse për publikun e gjerë dhe mund të kufizohet ashtu edhe sikurse mund të bëhet për publikun. Shpallja e aktgjykimeve në procedurën penale më nuk bëhet vetëm me publikimin e dispozitivit dhe arsyetimit të shkurtër, por aktgjykimi si dokument publik, duke ia hequr pjesët e caktuara që nuk duhet të jenë të qasshme për publikun e gjerë, shpallen dhe publikohen në faqet e gjykatave në internet.

- Gjykimi në afat të arsyeshëm është konceptualizuar në të gjitha aktet e rëndësishme që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë. Afatet e hetimit të një rasti prej 2 viteve dhe një mundësi për vazhdim të hetimit për 6 muaj, duhet respektuar me arsyeshmëri dhe

të mos jetë abuziv. Gjykimi i një çështje gjyqësore në shkallën e parë dhe atë të apelit nuk ka afat të përcaktuar ligjor të përcaktuar, gjë që kjo mund të shkelë të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi që autoritetet gjyqësore kanë në diskrecion një afat të papërcaktuar brenda së cilës duhet të veprojnë apo përfundojnë veprimet e tyre. Një mangësi që mund të vërehet është se nuk eksiton ndonjë rregull ne procedurën penale ose procedura tjera që parasheh mjete juridike efektive për të realizuar të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm. Mungesa e një mjeti juridik efektiv për të përshpejtua të drejtën e të pandehurit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe të drejtën për tu kompensuar për tej-zgjatjen e procedurave jashtë afatit të arsyeshëm kohor, cenon të drejtën e të pandehurit për të pasur gjykim të drejtë. Pra, mungesa dy mjeteve juridike efektive është një dobësi që gjenden në të drejtën e procedurës penale në Kosovë dhe bie ndesh me obligimet që dalin nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

- E drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur dhe të gjitha dimensionet e saja, sikurse janë: e drejta për t'u informuar për akuzën; e drejta për të përfituar disa lehtësi të përshtatshme për mbrojtjen; e drejta që të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës të zgjedhur prej tij; e drejta për të marrë pjesë në kërkimin e provës; e drejta për t'u asistuar nga një përkthyes dhe e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, janë të drejta që janë adresuar në të gjitha aktet juridike relevante që rregullojnë të drejtën e procedurës penale. Në harmoni me standardet ndërkombëtare, çdo i dyshuar apo i akuzuar gëzon të drejtën që menjëherë të njoftohet me shkaqet dhe natyrën e akuzës dhe në çfarëdo kohe gëzon të drejtën për lehtësi të përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, përfshirë të dhënat për përmbajtjen e akuzës që iu është ngritur atij. E drejta për të pasur avokat mbrojtës, shprehet ndërmjet mbrojtjes së detyruar që gëzon ai në procedurë penale dhe mbrojtjes fakultative, ku në të dyja rastet i pandehuri gëzon të drejtën të zgjedh avokat mbrojtës sipas preferencave të tij dhe të ketë komunikim të pakufizuar lidhur me çështjen për të cilën ka angazhuar mbrojtësin. I pandehuri gëzon të drejtën për mbrojtje me shpenzime publike, atëherë kur

shpenzimet e mbrojtjes nuk mund t'i mbulojë personalisht. Mbrojtja duhet të jetë e përshtatshme që i përgjigjet natyrës së akuzës kundër tij, dhe nuk duhet të jetë vetëm mbrojtje formale apo abstrakte. Në rastet kur i pandehuri nuk flet apo nuk kupton gjuhën me të cilën gjykata zhvillon procedurën penale në çështjen kundër tij, ka të drejtë të shprehet në mënyrën apo gjuhën të cilën e flet dhe e kupton. Ai ka të drejtë për përkthyes dhe interpret sipas nevojës dhe nuk mund t'i kufizohet një e drejtë e tillë. Edhe pse sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, prania e të pandehurit në procedurë penale është e drejtë e të pandehurit, prania e të pandehurit në procedurë penale në Kosovë është si kusht i domosdoshëm për t'u zhvilluar procedura penale, gjë që gjykimi në mungesë i të pandehurit nuk mund të zhvillohet.

- Prezumimi i pafajësisë është e drejtë e përfshirë në Kushtetutë, KPP dhe akte të tjera dhe përmban të drejtën e të pandehurit për t'u mos u vet-inkriminuar dhe të drejtë për të heshtur. Sikurse parashihet në standardet ndërkombëtare, barra e provës në procedurë penale i takon prokurorit, ndërsa i pandehuri është subjekti ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. I pandehuri gëzon të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm përderisa zhvillohet procedura penale, ai mund të merr pjesë në kërkimin e provës, vetëm sipas vullnetit dhe vlerësimit të interesit të tij personal apo në të mirë të drejtësisë. Në të gjithë rastet kur gjykata nuk është e bindur për vërtetësinë e plotë të ndonjë fakti, dyshimi interpretohet sipas rregullës *in dubio pro reo*. Prezumimi i pafajësisë nuk mund të cenohet nga asnjë autoritet tjetër publik edhe gjatë raportimeve me media, i pandehuri gëzon të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm. I pandehuri që shpallët i pafajshëm, gëzon të drejtën për t'u kompensuar për dëmet të cilat iu kanë shkaktuar në procedurë penale.

- Sipas Kushtetutës dhe KPP-së, i pandehuri është palë e barabartë me prokurorin në procedurë penale, pa ndonjë disavantazh të konsiderueshëm në procedurë penale. Në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e drejta për *"barazi të armëve"* është elaboruar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në disa çështje, e cila shprehet se kjo e

drejtë përbëhet nga tri elemente themelore a) të drejtën për të sfiduar dëshmitarët e prokurorisë (ose të ekzaminojë provat tjera të paraqitura nga prokuroria në mbështetje të rastit të tyre); b) të drejtën, në rrethana të caktuara për të thirrur një dëshmitar sipas zgjedhjes për të dëshmuar në gjykatë, d.m.th. për mbrojtjen dhe c) të drejtën për të pyetur dëshmitarët e prokurorisë në të njëjtat kushte si ato të ofruara për dëshmitarët e mbrojtjes. Kontradiktoriteti është një element që përbënë të drejtën për *"barazi të armëve"*, pasi çdo provë duhet t'i nënshtrohet procedurës kontradiktore dhe çdo palë të thotë fjalën e vet. Shqyrtimi i dëshmitarë dhe sidomos *"dëshmitarëve anonimë"* është një sfidë dhe për procedurën tonë penale. Edhe pse KPP përcakton se ekziston mundësia e mbrojtjes së identitetit të dëshmitarit, sipas nenit 262, paragr. 3, gjykata nuk shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin. Në këtë rast, ligjvënësi ka vënë rezervat në dispozitat e KPP-së, duke mos dhënë vlerë përcaktuese të njëjtë sikurse për dëshmitarët të cilëve u dihet identiteti.

- Mjetet juridike që gëzon i pandehuri janë në përputhje me standardet e parapara me nenin 14 të PDCP-së, apo nenin 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. Edhe pse këto instrumente kërkojnë që të pandehurit t'i sigurohet minimalisht një mjet juridik për të pasur të drejtën që të kërkojë rishqyrtimin e vendimit të pranuar nga gjykata e shkallës së parë, sipas KPP-së, i pandehuri gëzon të drejtën për ankesë si mjet i rregullt juridik dhe të drejtën për mjete të jashtëzakonshme juridike. Të gjitha vendimet e nxjerra nga gjykata në procedurë penale, sipas nenit 370 të KPP-së duhet të jenë të arsyetuara, gjë që është në përputhje të plotë me kërkesat që dalin nga vendimi i GJEDNJ në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*. Gjykatat që veprojnë sipas mjeteve juridike, kanë karakter subsidiar dhe angazhohen vetëm atëherë kur i pandehuri nuk është i kënaqur me vendimet e nxjerra nga instancat tjera gjyqësore. Respektimit i rregullit për shterimin e mjeteve juridike është kriter formal që duhet respektuar.

- Provat juridikisht të papranueshme edhe pse janë të kundërligjshme, në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese nuk i ka gjykuar që cenojnë të drejtën për gjykim të drejtë. Megjithatë, shqyrtimi i ligjshmërisë së provave është e rezervuar për gjykatat e rregullta, gjë që i pandehuri gëzon mjete juridike efektive të mjaftueshme që të arrijë t'i realizojë kërkesat e ligjshme në procedurë penale në Kosovë. Tendenca që provat juridikisht të papranueshme të klasifikohen si shkelje të së drejtë për gjykim të drejtë, ka hasur në vendime refuzuese, pasi në shpjegimet e dhëna është theksuar se të njëjtat nuk cenojnë asnjë nga standardet të cilat përcaktohen me këtë të drejtë. Gjykata Kushtetuese edhe pse është institucion i ri i drejtësisë, po luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut lidhur me procedurën penale. Duke iu referuar praktikës së GJEDNJ, kjo gjykatë po bënë përpjekje të vlefshme për të zëvendësuar rolin e GJEDNJ në mbrojtjen e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 të Konventës. Për secilin rast që paraqitet para saj, kjo gjykatë vendos për rastin nën dritën e standardeve që dalin nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.

- Rregulla kushtetuese që parasheh që e drejta për gjykim të drejtë në asnjë rrethanë nuk mund të pezullohet dhe se standardet të cilat përbëjnë këtë të drejtë, që nuk mund të jenë objekt i shmangies së çfarëdollojtë, është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare, sikurse është: KEDNJ, PDCP, Konventat e Gjenevës (1949), Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese etj. E drejta për gjykim të drejtë, nuk është një e drejtë e pakufizuar, varësisht nga natyra e rastit, ajo mund të paraqitet si një e drejtë absolute, ndërsa në raste tjera si një e drejtë relative. Elementet e gjykimit të drejtë, sikurse është e drejta t'iu drejtuar gjykatës, e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm, e drejta për përkthyes dhe ndihmë juridike, barazia e mjeteve, e drejta për t'u mbrojtur vet ose me anë të mbrojtësit, e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim janë të drejta absolute dhe nuk guxojnë të cenohen në asnjë rrethanë. Të drejtat e tilla absolute, në rast se do të kufizoheshin do të paraqisnin rrezik që të cenohet vet esenca e të drejtës së garantuar.

Ndërsa, në elemente tjera, e drejta për gjykim të drejtë mund të jetë relative. E drejta për gjykim publik, mund të jetë një nga të drejtat të cilat mund të kufizohet.

2. Rekomandimet kryesore të studimit

Bazuar në rezultatet e analizës së të dhënave të studimit dhe gjetjeve të elaboruara më lartë, rekomandimet e studimit janë si në vijim:

- Gjykatat e rregullta, përfshirë këtu, gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme, duhet të marrin më shumë në konsideratë praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Kjo praktikë, përveç që përfaqëson nivelin më të avancuar të sistemit të drejtësisë, njëkohësisht sipas nenit 53 të Kushtetutës paraqitet si obligim kushtetues, ku theksohet se të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, duhet të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

- KGJK duhet të hartojë politika afatgjata lidhur me çështjet delikate që lidhen me funksionimin e sistemit gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur. Lidhur me këtë, duhet eliminuar gradualisht praktikat e rregullimit me akte nënligjore të çështjeve të cilat lidhen me anonimizimin dhe publikimin e aktgjykimeve; rekrutimin, provimin, emërimin, riemërimin apo shkarkimin e gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave; trajnimin gjyqësor; çështjen e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve; transferin dhe caktimin e gjyqtarëve në gjykata; çështjen e sjelljeve etike dhe sjelljeve të pahijshme; çështjen e përcaktimit të procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së brenda gjyqësorit; çështjen e organizimit të brendshëm të gjykatave dhe çështje të tjera me rëndësi. Rregullimi me akte nënligjore krijon teren të përshtatshëm për individët apo grupe të interesit për të vendosur rregulla dhe kritere të caktuara paragjykuese. Çështjet e rregullimit të gjyqësorit duhet të konsiderohen stabile dhe nuk duhet të jenë objekt

ndërrimeve dhe luhatjeve të shpeshta. Përcaktimi i politikave në gjyqësor duhet të parashihen në periudhë afatgjate dhe me ligje.

- Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore duhet të shkojnë në favor të homogjenizimit të përbërjes së KGJK-së me vetëm nga gjyqtarët. Kjo do të pavarësonte objektivisht gjyqësorin edhe nga dyshimet abstrakte të çfarëdollojta. Interferimi i çfarëdolloj nga pushtetet tjera, qofshin ato nga ekzekutivi, apo legjislativi, do të mund të krijonin dyshime të ligjshme për mungesën e pavarësisë institucionale të gjykatave. Çështjet e menaxhimit të gjykatave duhet të përafrohet me praktikat e vendeve të BE-së, duke unifikuar kulturën e funksionimit të gjykatave që nga rekrutimi, ashtu edhe nga mënyra e ushtrimit të funksionit.

- Gjykimi në afat të arsyeshëm kohor duhet të shndërrohet në normë imperative dhe të saktësuar. Garancionet përgjithësuese të papërcaktuara konkretisht kanë krijuar teren të përshtatshëm që detyrimi për të vepruar në afat të arsyeshëm kohor të mund të abuzohet. Konkretisht, duhet përcaktuar afat ligjor brenda së cilës duhet të veprojë Gjykata e Apelit për çështjet e atakuara me ankesë. Duhet ndërtuar mekanizma nga KGJK dhe KPK të atillë, që varësisht rrethanave konkrete të rastit, gjyqtarët dhe prokurorët në rast se nuk respektojnë afatet e arsyeshme kohore të kenë konsekuenca negative për funksionet e tyre. Në rregullat e procedurës penale duhet paraparë mjetin juridik për të përshpejtuar gjykimin në rastet kur nuk respektohet e drejta për gjykim në afat të arsyeshëm, si dhe duhet paraparë mjeti juridik për kompensim. Pra, mungesa e dy mjeteve juridike efektive është një dobësi që gjenden në të drejtën e procedurës penale në Kosovë dhe bie ndesh me obligimet që dalin nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

- E drejta për gjykim publik dhe e drejta e publikut për të ditur se si po administrohet drejtësia, shton obligimin që gjykimi publik nuk duhet të bëhet vetëm në gjykatore, por ajo duhet t'i përshtatet trendit bashkëkohor të administrimit të drejtësisë, duke publikuar të gjithë aktgjykimet të cilat merren nga secila instancë gjyqësore. Tanimë

rregullat formale mund t'i gjejmë në shumë akte juridike të zbatueshme për gjyqësorin, njëkohësisht këto rregulla duhet të zbatohen në përpikëri edhe praktikisht.

- Nga analiza e të dhënave të mbledhura për rastet e vendosura nga GJK për vitet 2009-2016, mund të shohim se nga 86 rastet gjykuara nga kjo gjykatë, 84 nga këto janë shpallur të papranueshme, duke u refuzuar për tu vendoset në mënyrë meritore. Lidhur me këtë rekomandohet të ngritët niveli i kompetencës të mbrojtësve profesionist lidhur me rolin e njëmendtë që luan Gjykata Kushtetuese si institucion i drejtësisë.

3. Kufizimet e studimit dhe mundësitë për hulumtime të mëtejshme

Pavarësisht ofrimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të elaboruara më sipër, si çdo studim tjetër empirik, edhe ky studim mund të ketë shumë kufizime që duhet të pranohen studimi. Çdo studim për hulumtimin e të drejtës për gjykim të drejtë shfaq një konluzion se kjo e drejtë nuk është një njëdimensionale, por përbëhet nga dimensione të shumta, që secila nga to mund të hulumtohet në mënyrë të pavarur.

Së pari, punimi është kufizuar në trajtimin normativ të së drejtës për gjykim të drejtë në procedurën penale, ku jemi përqendruar në shpjegimet tona lidhur me konceptualizimin e kësaj të drejte në të drejtën e procedurës penale, si dhe masën e harmonizimit të kësaj të drejte me instrumentet dhe jurisprudencën ndërkombëtare, e veçanërisht me atë të GJEDNJ-së. E drejta për gjykim të drejtë siç dihet nuk përqendrohet vetëm në domethënien e saj normative, gjë që punimi nuk përfshin të gjithë faktorët e mundshëm që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë në kuptimin e gjerë, sikurse mund të merret në konsideratë aspekti kulturor, siç është arsimimi dhe traditat zakonore si rregulla joformale; niveli i standardit jetësor të popullsisë në përgjithësi; apo edhe ndikimi trashëgimisë së kulturës juridike nga sistemi gjyqësor i periudhës socialiste jugosllave, ose ndikimi i elementeve të ndryshme të kulturave juridike që kanë dominuar gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar të sistemit të drejtësisë.

Së dyti, për shkak të ndryshimeve të shpeshta ligjore që po bëhen në sistemin e drejtësisë, studimi është i kufizuar në rregullat juridike pozitive që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë në procedurën penale. Sistemi i drejtësisë, përveç që përfaqëson një legjislacion tepër të ri për nga koha e krijimit, rregullat që i dedikohen këtij sistemi janë objekt i luhatjeve të shpeshta, e që nganjëherë edhe të pamenduara mirë. Përjashtimisht Kushtetutës, vetëm në një hark kohor të shkurtër, i gjithë korpusi legjislativ që prek gjyqësorin ka pësuar dhe po vazhdon të pësojë ndryshime të shumta dhe të shpeshta.

Së treti, lidhur me trajtimin e të drejtës për tu gjykuar nga një gjykatë e paanshme, e pavarur dhe të themeluar me ligj, parimisht studimi është kufizuar tek institucioni i gjykatës, përkatësisht tek KGJK si institucion që është përgjegjës për të garantuar pavarësinë e sistemit gjyqësor. Në pikëpamje më të gjerë, do të ishte e mirëseardhur të përfshihet trajtimi i rolit të KPK-së në garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë për prokurorët e shtetit dhe në sistemin gjyqësor në përgjithësi.

Së katërti, punimi nuk është zgjeruar edhe në të drejtat tjera sikurse është e drejta për liri dhe siguri, e drejta për kompensim, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit. Edhe pse këto të drejta janë pjesë të pandashme të gjykimit të drejtë, arsye për mos-përfshirje është se të njëjtat paraqiten si të drejta të pavarura në secilin instrument të rëndësishëm juridik, sikurse paraqitet gjykimi i drejtë, si një e drejtë e pavarur.

Kufizimet e studimit të elaboruara më sipër ofrojnë disa qasje për hulumtime dhe përmirësime të mëtutjeshme. Heqja e kufizimeve të mësipërme, do të ofrojë një perspektivë më të gjerë trajtuese, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë së rezultateve të studimit.

BIBLIOGRAFIA

A. Libra dhe artikuj

Amann, D. M., & Sellers, M. (2002). The United States of America and the International Criminal Court. *The American Journal of Comparative Law, 50*(1), 381-404.

Ambos, v. (2003). International Criminal Procedure: 'Adversarial', 'Inquisitorial' or Mixed? *International Criminal Law Review, 3*, 1-37.

Aquilina, v. (2014). The Right to a Public Trial under Maltese Criminal Law - An Analysis from a Comparative and Human Rights Angle. *European Journal of Comparative Law and Governance*, 130/147.

Ashworth, A., & Redmayne, M. (2005). *The Criminal Process* (Vol. Third edition). Oxford: Oxford University Press.

Barton, P. (1982). The Right to a Public Trial in Criminal Proceedings. *Manitoba Law Journal, 12*(2), 129/146.

Berger, M. (2012). The Right to Silence in The Hague International Criminal Courts. *University of San Francisco Law Review, 47*.

Bonomy, I. (2007). The Reality of Conducting a War Crimes Trial. *Journal of International Criminal Justice, 5*(2), 348–359.

Brick, S. (1971). Self-Representation in Criminal Trials: The Dilemma of the Pro Se Defendant. *California Law Review, 59*(6), 1497 - 1498.

Campbell, L. (2008). Organised Crime, Anonymous Witnesses and Fair Trials in Ireland: Responding to R v Davis. *International Commentary on Evidence, 6*(1), 1-18.

Croquet, N. A. (2011). The International Criminal Court and theTreatment of Defence Rights: A Mirror of the European Court of Human Rights' Jurisprudence? *Human Rights Law Review, 11*(1), 91/131.

EI-Obaid, A., & Appiagyei-Atua, K. (1996). Human Rights in Africa -A New Perspective on Linking the Past to the Present. *Mcgill Law Journal*, 41, 819-854.

Field, S. (2009). Fair Trials and Procedural Tradition in Europe. *Oxford Journal of Legal Studies, 29*(2), 365–387.

Fields, J. (2017). Komentar - Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarët e Kosovës. Prishtinë: USAID.

Funk, T. (2006). *Kosovo Trial Skills Handbook.* Prishtinë: United States Department of Justice Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training Office of the Resident Legal Advisor Pristina, Kosovo.

Gamble, R., & Dias, N. (2008). International Fair Trial Protections in Criminal Trials. *Sri Lanka Journal of International Law, 20*(1), 25-52.

Gaynor, F., & Morris, L. v. (2008). M. Cherif Bassiouni, The Legislative History of the International Criminal Court. *Journal of International Criminal Justice, 6*(4), 815-819.

George, B. J. (1968). The Right of Silence in Japanese Law. *Washington Law Review, 43*, 1147/1167.

Giannoulopoulos, D. (2016). Strasbourg Jurisprudence, Law Reform and Comparative Law: A Tale of the Right to Custodial Legal Assistance in Five Countries. *Human Rights Law Review*(16), 109 - 110.

Ginther, v. (1990). The European Convention for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment. *European Journal of International Law, 1*(1), 123/130.

Gray, A. (2013). Constitutionally Heeding the Right to Silence in Australia Monash. *Monash University Law Review, 39*(1), 156-187.

Gruda, Z. (2007). *E drejta ndërkombëtare publike.* Prishtinë.

Gruda, Z. (2012). *Mbrojtja Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.* Prishtinë.

Hajiyev, v. (2002). *The Role of the Constitutional Court and Ordinary Courts in the Protection of Human Rights.* Venice, Italy: Venice Commission.

Heydon, J. (1974). Silence as Evidence. *Monash University Law Review, 1*, 53-66.

Higgins, G. (2007). Fair and Expeditious Pre-trial Proceedings: The Future of International Criminal Trials. *Journal of International Criminal Justice, 5*(2), 394-401.

Hunt, D. (2004). The International Criminal Court. *Journal of International Criminal Justice, 2*(1), 56-70.

ICTY Manual on Developed Practices. (2009). Italy: UNICRI Publisher.

(2011). *Interpretation of torture in the light of the practice and jurisprudence of international bodies.* The UN Voluntary Fund for Victims of Torture.

Kempen, P. v. (2014). *Criminal Law and Human Rights.* United Kingdom: ASHGATE.

Krapac, D. (2010). *Kazneno Procesno Pravo.* Zagreb.

Kelly, J. M. (1964). Audi Alteram Partem. Natural Law Forum, 103-110.

Korf, D. (2006). *E drejta për jetën - Një udhëzues për zbatimin e Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Strasburg, Francë: Këshilli i Evropës.

Langford, I. (2009). Fair Trial: The History of an Idea. *Journal of Human Rights, 8*(1), 37-52.

Legal History: Origins of the Public Trial. (1960). *Indiana Law Journal, 35*(2), 251.

Marshall, P. D. (2011). A Comparative Analysis of the Right to Appeal. *Duke Journal Of Comparative & International Law*, 1-46.

Martines, T. (2011). *E drejta kushtetuese.* Tiranë: UET/Press.

Meese, J. (2013). The Use of Illegally Obtained Evidence in Belgium: A Status Questionis. *Digital Evidence and Electronic Signature Law Review, 10*, 63-66.

Mole, N., & Harby, C. (2001). *E drejta për një proces të drejtë gjyqësor - Një udhëzues për implementimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.* Strasburg: Cedex, Këshilli i Evropës.

Morina, V. (2008). *Ndikimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Jurisprudencën Kushtetuese Nacionale: Reflektime teorike mbi kufizimet e të drejtave të njeriut.* E drejta(1), 107-135.

Murati, R. (2005). Protection of Human Rights Under Kosovo's Criminal Code and Criminal Procedure Code. *Chicago-Kent Law Review, 80*(1), 99-118.

Murati, R. (2006). *Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja.* Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

Murati, R. (2008). Karakteristikat kryesore të sistemit gjyqësor penal në Kosovë. *E drejta*(1-2/2008), 49-68.

Murati, R. (2008). Karakteristikat kryesore të sistemit gjyqësor penal në Kosovë. *E drejta*(1-2), 49-68.

Murphy, P. (2010). *Murphy për provën.* Tiranë: UET Press & MAPO Editions.

Mushkolaj, G., Morina, V., & Lamoen, J. v. (2014). *Komentar - Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.* Prishtinë: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Natalya Clark, J. (2011). Peace, Justice and the International Criminal Court: Limitations and Possibilities. *Journal of International Criminal Justice, 9*(3), 521–545.

Ņesterova, I. (2013). The Right not to Incriminate Oneself as an Essential Aspect of the Right to a Fair Trial in the Application of Simplified Forms of Criminal Procedure. *Juridiskā zinātne / Law*(5), 205–216.

Pradel, J., Corstens, G., & Vermeulen, G. (2009). *E drejta Penale Evropiane.* Tiranë: Papirus.

Quick, C. (1955). A Public Criminal Trial. *Dickinson Law Review*.

Sahiti, E., & Murati, R. (2016). *E drejta e procedurës penale.* Prishtinë: Artini.

Sahiti, E., Murati, R., & Elshani, X. (2014). *Komentar i Kodit të Procedurës Penale.* Prishtinë: GIZ.

Summers, S. J. (2007). Fair Trials: *The European Criminal Procedural Tradition and the European Court of Human Rights.* Oregon: Hart Publishing.

Shapiro, H. (1951). Right to a Public Trial. *Journal of Criminal LaW and Criminology, 41*(6).

Simons, M. (2009). International Criminal Tribunals and the Media. *Journal of International Criminal Justice*(7), 83-88.

Sivasubramaniam, B. (2013). *The Right of an Accused to a Fair Trial: The Independence of the Impartiality of the International Criminal Courts (Phd thesis)*. Durham: Durham University.

Trechsel, S. (2011). The Significance of International Human Rights for Criminal Procedure. *National Taiwan University Law Review, 6*(1), 178-204.

Trechsel, S. (2006). *Human Rights in Criminal Proceedings*. London, UK: Oxford.

Voermans, W., & Albers, P. (2003). *Councils for the Judiciary in EU Countries.* Leiden/The Hague: The Venice Commission and the Council of Europe.

Vorpsi, A. (2011). *Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.* Tiranë: Maluka.

Warbrick, C. (1998). International Criminal Courts and Fair Trial. *Journal of Conflict and Security Law, 3*(1), 45-64.

Widder, E. R. (2015). A Fair Trial at the International Criminal Court? Human Rights Standards and Legitimacy (Doctoral dissertation). Hull, Britani e Madhe: University of Hull.

Yanev, L. (2012). Honouring the Right to a Fair Trial within Reasonable Time: The Bulgarian Criminal Justice System. *European Journal of Crime Criminal Law and Criminal Justice, 20*(4), 445-468.

Zaganjori, X., Anastasi, A., & Çani, E. M. (2011). *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.* Tiranë: Adelprint.

B. Tekste Ligjore

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2003/26, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, Vëllimi 3 - 2003.

Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 korrik 2010, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 78, 20 gusht 2010.

Kodi nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Miratuar Nga Kuvendi I Kosovës Më 20 Prill 2012, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 19 / 13 KORRIK 2012.

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 dhjetor 2012, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 37 më 28 dhjetor 2012.

Kodin nr. 192/2012 i etikës dhe sjelljes profesionale për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK, 8 tetor 2012.

Komentar - Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarët e Kosovës, Millennium DPI Partners, LLC, 2017

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, miratuar më 9 prill 2008, e hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

Ligji i procedurës penale i RSFJ-së, i cili për një kohë është zbatuar në Kosovë edhe pas vendosjes së Administratës së UNMIK-ut në bazë të Rregulloreve nr.1999/1 dhe 1999/24.

Ligji nr. 03/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 Nëntor 2008, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 44, 22 dhjetor 2008

Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13.03.2008, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 27 / 03 QERSHOR 2008.

Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lendeve dhe caktimin e lendeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 mars 2008, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 27 / 03 QERSHOR 2008.

Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 16 Dhjetor 2008, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 46, 15 janar 2009.

Ligji nr. 03/L-199 për gjykatat, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 22 korrik 2010, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 79, 24 gusht 2010.

Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 shtator 2010, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 84, 3 nëntor 2010.

Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 shtator 2010, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 83, 29 tetor 2010.

Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 shtator 2010, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 83, 29 tetor 2010.

Ligji nr. 04/-L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 korrik 2011, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 13, 1 shtator 2011.

Ligji nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 gusht 2011, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 16, 14 shtator 2011,.

Ligji nr. 04/L-076 për policinë, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2 mars 2012, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 04, 19 mars 2012.

Ligji nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 2012, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 30, 9 nëntor 2012.

Ligji nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 11 shkurt 2013, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 5, 8 mars 2013.

Ligji nr. 04/L-171 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-199 për gjykatat, miratuar nga kuvendi i Kosovës më 20 dhjetor 2012, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 37, 28 dhjetor 2012.

Ligji nr. 04/L-193 për Avokatinë, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2 maj 2013, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 20, 31 maj 2013.

Ligji nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 korrik 2013, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 33, 2 shtator 2013.

Ligji nr. 05/L -032 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/l-199 për gjykatat, miratuar nga kuvendi i Kosovës më 28 maj 2015, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 17, 30 qershor 2015.

Ligji nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 maj 2015, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 17, 30 qershor 2015.

Ligji nr. 05/L -094 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -033 si dhe Ligjin nr. 04/L-115, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 24 mars 2016, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 11, 6 prill 2016.

Ligji nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 maj 2015, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 17, 30 qershor 2015.

Ligji nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 maj 2015, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 17, 30 qershor 2015.

Ligji nr. 06/L -025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-034, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 mars 2018, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 3, 19 prill 2018.

Rregullore nr. 05/2016 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, KGJK, 2016.

Rregullore nr. 04/2016 për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme, KGJK. 2016.

Rregullore e Punës nr. 341/2014 e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e nxjerrë më 28 tetor 2014 nga Gjykatës Kushtetuese.

Rregullore mbi organizimin e brendshëm të gjykatave, KGJK, 2013.

Rregullore nr. 01/2014 për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, KGJK, 2014.

Rregullore nr. 02/2013 për programin e trajnimit të vazhdueshëm, IGJK, 2013.

Rregullore nr. 03/2017 - për trajnimin fillestar, Akademia e Drejtësisë, 2017.

Rregullore nr. 06/2017 për trajnimin e gjyqtarëve, KGJK, 2017.

Rregullore nr. 07/2017 – për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 03/2017 për trajnimin fillestar, Akademia e Drejtësisë, 2017.

Rregullore nr. 11/2016 për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, KGJK, 2016.

Rregullore nr. 13/2016 për ndryshimin e Rregullores nr. 05/2016 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtareve, KGJK, 2016.

Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, UNMIK, 2001.

Rregullore nr. 2005/52 për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, UNMIK, 2005.

Rregullore nr. 14/2015 për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për organizimin e provimit për kandidatët për gjyqtarë, KGJK, 2015.

Rregullore nr. 15/2016 për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve, KGJK, 2016.

Rregullore nr. 16/2015 për emërimin e interpretëve dhe përkthyesve gjyqësorë, KGJK, 2015.

C. Dokumente ndërkombëtare

African Charter on Human and Peoples Rights Adopted in Nairobi June 27, 1981 Entered into Force October 21, 1986

Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 (Universal Declaration on Human Rights, G.A.res. 217 A(III), U.N. Doc. A/810 at 71).

Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët dhe Memorandum shpjegues, Këshilli i Evropës, Strasburg 1998.

Konventa e OKB-së për Parandalimin e Torturës dhe Mënyrave të tjera të Trajtimit Mizor, Jonjerëzor ose poshtërues ose e dënimit evitit 1984 (Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, G.A. res. 39/46, annex, 39 U.N. GAOR Supp. (No. 51) at 197, U.N. Doc. A/39/51 (1984), entered into force June 26, 1987.

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e vitit l950, me protokollet shtesë (European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, (ETS No. 5), 213 U.N.S. 222, entered into force Sept. 3,1953, as amended by Protocols No 3, 5, 8, i 11 which enterd into force on 21 September 1970, 20 December 1971, 1 January 1990, and 1 November 1998 respectively).

Konventa Europiane për parandalimine torturës, trajtimit jonjerëzor e poshtërues dhe të dhe të trajtimit jonjerëzore të dënimit e vitit 1987 (European Convention for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, (ETS No. 126), entered into force Feb. 1, 1989).

Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve e vitit 1989 (Convention on the Rights of the Child, G.A.res.44/25, annex, 44 U.N. GAOR Supp. (No. 49) at 167, U.N. Doc. A/44/49 (1989), entered into force Sept. 2, 1990).

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e vitit 1965 (International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination,660 U.N.T.S. 195, entered into force Jan. 4, 1969).

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave e vitit 1979 (Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination against Women, G.A. res.34/180, 34 U.N. GAOR Supp. (No. 46) at 193,U.N. Doc. A/34/46, entered into force Sept. 3, 1981).

Magna Karta për Gjyqtarë (Parimet Fundamentale), KKGJE, 2010.

Masat për Implementimin efektiv të Parimeve Bangalore të Sjelljes së Gjyqësorit (Masat e implementimit) miratuar nga Grupi i Integritetit Gjyqësor në mbledhjen e mbajtur në Lusaka, Zambia, 2010.

Masat për zbatimin efektiv të Parimeve të Bangalores të Sjelljes Gjyqësore, 2010 .

Opinion 3 (CFR-CDF) - Opinion on the status of illegally obtained evidence in criminal procedures in the Member States of the European Union. E.U. Network of Independent Experts on Fundamental Rights (2003).

Opinion i përbashkët mbi draft ligjin mbi obligimet disiplinore të gjyqtarëve të Republikës së Moldavisë, Komisioni i Venedikut dhe OSBE, 2014.

Opinion i Përbashkët mbi Draft ligjin plotësimi dhe ndryshimi i Kodit Gjyqësor (Sistemi i Vlerësimit për Gjyqtarë) e Armenisë, Komisioni i Venedikut dhe Këshilli i Evropës, 2004.

Opinion nr. 1 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës për standardet e pavarësisë së gjyqësorit dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve, 2001.

Opinion nr. 712/13 mbi draft ligjin mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës, Komisioni i Venedikut, 2014.

Opinioni nr. 10 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për Këshillin Gjyqësor në shërbim të shoqërisë, 2007.

Opinioni nr. 3 i Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për vëmendjen e Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve në veçanti etikën, sjelljet e papërshtatshme dhe objektivitetin, 2002.

Opinioni nr. 4 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) drejtuar për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës për trajnimin adekuat fillestar dhe trajnimin gjatë shërbimit, për gjyqtarë në nivelin kombëtar dhe evropian, 2003.

Opinioni nr. 403 i Komisionit tw Venedikut për emërime gjyqësore, 2006.

Opinioni nr. 6 i i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) për gjykim tw drejtw brenda afatit tw arsyeshëm kohor dhe roli i gjykatësit nw gjykime duke marrw parasysh mjetet alternative tw zgjidhjes sw mosmarrëveshjeve, 2004.

Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe politike - me protokollet e vitit 1966 (International Covenant on Civil and Political Rights, G.A. res. 2200A (XXI), 21 U.N. GAOR Supp. (No.16) at 52, U.N. Doc. A/6316 (1966), 999 U.N.T.S. 171, entered into force Mar. 23, 1976).

Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, miratuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e kundërvajtësve mbajtur në Milano me 26 Gusht deri më 6 Shtator 1985 dhe e miratuar nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 29 nëntor 1985 dhe 40/146 13 dhjetor 1985.

Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, OSBE, ODIHR, Grupi kërkimor Max Planck Minerva për Pavarësinë Gjyqësore, Kiev, 2010.

Rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, Këshilli i Evropës, 2010.

Rregullat standarde minimale lidhur me sjelljen ndaj të dënuarve e vitit 1955 (Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners, adopted Aug. 30, 1955, by the First United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, U.N. Doc. A/CONF/611, annex I, E.S.C. res. 663C, 24 U.N. ESCOR Supp. (No. 1) at 11, U.N. Doc. E/3048 (1957), amended E.S.C. res. 2076, 62 U.N. ESCOR Supp. (No. 1) at 35, U.N. Doc. E/5988 (1977).

Rregullat standarde minimale të OKB për zbatimin e procedurave gjyqësore ndaj të miturve të vitit 1985 (United Nations Standard Minimum Rules for the Administration of Juvenile Justice ("The Beijing Rules"), G.A. res. 40/33, annex, 40 U.N. GAOR Supp. (No. 53) at 207, U.N. Doc. A/40/53, 1985).

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave, IT/32/Rev.46, Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Sshkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërshtetërore të Kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 IT/32/Rev. 46, IT/32/Rev. 46.

Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991, miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së më 25 maj 1993, me Rezolutën 827, ndryshuar më: 13 maj 1998 me Rezolutën 1166, më 30 nëntor 2000 me Rezolutën 1329, më 17 maj 2002 me Rezolutën 1411, më 14 gusht 2002 me Rezolutën 1431, më 19 maj 2003 me Rezolutën 1481, më 20 prill 2005 me Rezolutën 1597, më 28 shkurt 2006 me Rezolutën 1660, më 29 shtator 2008 me Rezolutën 1837 dhe më 7 korrik 2009 me Rezolutën 1877.

Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare i miratuar nga Konferenca Diplomatike e të Plotëfuqishmëve në Kombet e Bashkuara për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale më 17 korrik 1998, hyri në fuqi më 1 korrik 2002.

The Charter and Judgment of Tile Nurnberg Tribunal History and Analysis (Memorandum submitted by the Secretary-General), United Nations - General Assembly International Law Commission Lake Success, New York 1949.

Trial of the major war criminals before the International Military Tribunal Nuremberg , 14 november 1945 - 1 october 1946. Nuremberg, Germany (1947).

D. Vendime gjyqësore

1. Vendime te Gjykatës Kushtetuese

Abdurrahman Nazifi v. Gjykata Themelore në Prishtinë. Rasti nr. KI140/14 (Gjykata Kushtetuese, 25 nëntor 2014).

Abdyl Islami v. Gjykata Kushtetuese. Rasti nr. KI14/14 (Gjykata Kushtetuese, 26 shkurt 2014).

Abdyl Pasjaqa v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 33/13 (Gjykata Kushtetuese, 7 maj 2014).

Adriatik Gashi dhe Burim Miftari v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 85/12 dhe KI 86/12 (Gjykata Kushtetuese, 22 janar 2013).

Afrim Karaxha v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI123/13 (Gjykata Kushtetuese, 20 janar 2014).

Afrim Terpeza v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 03/14 (Gjykata Kushtetuese, 2 korrik 2014).

Agim Stublla v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 74/12(Gjykata Kushtetuese, 9 janar 2013).

Agron Prenaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 35/12 (Gjykata Kushtetuese, 17 janar 2013).

Ahmet Ismail Rexhepi v. Policia e Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Publik Komunal të Prishtinës. Rasti nr. KI 05/09 (Gjykata Kushtetuese, 20 prill 2010).

Alban Kastrati v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 24/12 (Gjykata Kushtetuese, 10 qershor 2012).

Alban Rexha v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI77/14 (Gjykata Kushtetuese, 16 shtator 2014).

Alil Memedoviq v. Gjykata Qarkut & Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 50/10 (Gjykata Kushtetuese, 21 mars 2011).

Arben Kiqina v. Gjykata e Qarkut në Gjilan & Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 52/10 (Gjykata Kushtetuese, 11 qershor 2012).

Arben Krasniqi v. Gjykata Themelore. Rasti nr. KI 32/14 (Gjykata Kushtetuese, 12 mars 2014).

Arianit Dyla v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 101/12 (Gjykata Kushtetuese, 18 janar 2013).

Asllan Bahtiri v. Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Rasti nr. KI 70/13 (Gjykata Kushtetuese, 17 tetor 2013).

Astrit Shabani v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Prishtinë Rasti nr. KI 66/11, dt. 21 maj 2012

Avni Aliaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 76/11 (Gjykata Kushtetuese, 11 tetor 2012).

Bajrush Gashi v. Gjykata Kushtetuese. Rasti nr. KI 75/13 (Gjykata Kushtetuese, 5 dhjetor 2013).

Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 06/12 (Gjykata Kushtetuese, 27 qershor 2012).

Bajrush Gashi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 123/12 (Gjykata Kushtetuese, 29 janar 2013).

Bajrush Xhemajli v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 78/12 (Gjykata Kushtetuese, 24 janar 2013).

Baki Musa v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 14/11 (Gjykata Kushtetuese, 23 nëntor 2011)

Bali Dellova v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 44/12 (Gjykata Kushtetuese, 3 korrik 2012).

Bardhyl Krasniqi v. Gjykata e Qarkut në Prizren. Rasti nr. KI 39/13 (Gjykata Kushtetuese, 19 qershor 2013).

Baton Morina v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 159/2011 (Gjykata Kushtetuese, 13 korrik 2012).

Besianë Gashi v. KGJK. Rasti nr. KI 57/14 (Gjykata Kushtetuese, 20 shtator 2013).

Besnik Asllani v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 139/12 (Gjykata Kushtetuese, 29 janar 2013).

Betim Ramadani v. Prokuroria e shtetit. Rasti nr. KI 01/13 (Gjykata Kushtetuese, 30 prill 2013).

Binak Thaqi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 106/10 (Gjykata Kushtetuese, 4 tetor 2011).

Blerim Shabi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 61/13 (Gjykata Kushtetuese, 18 nëntor 2013).

Bujar Shatri v. Gjykata e Qarkut në Prishtinë & Prokurori i Shtetit. Rasti nr. KI 60/13 (Gjykata Kushtetuese, 19 qershor 2013).

Bujar Spahiu v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 39/14 (Gjykata Kushtetuese, 3 korrik 2014).

Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Gjilan. Rasti nr. KI 81/11 (Gjykata Kushtetuese, 11 qershor 2012).

Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Gjilan. Rasti nr. KI 78/11 (Gjykata Kushtetuese, 11 qershor 2012).

Çlirim Grezda v. Gjykata Kushtetuese. Rasti nr. KI 62/11 (Gjykata Kushtetuese, 19 janar 2012).

Dedë Bala v. Gjykata Komunale të Prishtinës; Gjykata së Qarkut të Prishtinës & Gjykatës Supreme. Rasti nr. KI 42/11 (Gjykata Kushtetuese, 12 dhjetor 2011).

Dedë Gecaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 22/09 (Gjykata Kushtetuese, 20 maj 2010).

Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 07/09 (Gjykata Kushtetuese, 19 maj 2010)

Driton Kelmendi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 148/14 (Gjykata Kushtetuese, 9 dhjetor 2014).

Durrës Shahini v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 34/14 (Gjykata Kushtetuese, 24 mars 2014).

Emrije Asllani v. Prokuroria e shtetit & Gjykata e Qarkut në Prizren. Rasti nr. KI 88/12 (Gjykata Kushtetuese, 2 dhjetor 2013).

Enver Zeneli v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 10/13 (Gjykata Kushtetuese, 12 mars 2013).

Fatbardh Gabraj v. Gjykata e Qarkut në Pejë & Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 131/10 (Gjykata Kushtetuese, 6 shtator 2012).

Fazilja Berisha v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 153/11 (Gjykata Kushtetuese, 5 gusht 2011).

Feti Islami v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 11/10 (Gjykata Kushtetuese, 25 janar 2011).

Fidan Hyseni v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 130/14 (Gjykata Kushtetuese, 9 dhjetor 2014).

Gani Morina v. Gjykata e Qarkut në Pejë. Rasti nr. KI 103/11 (Gjykata Kushtetuese, 23 janar 2013).

Gazmend Musollaj dhe Nezir Kerrellaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 80/14 KI 93/14 (Gjykata Kushtetuese, 25 nëntor 2014).

Gëzim dhe Makfire Kastrati v. Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Rasti nr. KI 41/12 (Gjykata Kushtetuese, 25 janar 2013).

Haki Gjocaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 113/12 (Gjykata Kushtetuese, 25 janar 2013).

Hamide Osaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 55/2010 (Gjykata Kushtetuese, 3 mars 2011).

Hazër Susuri dhe Baki Hoxha v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 81/12 (Gjykata Kushtetuese, 15 janar 2013).

Hysen Muqa v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 69/13 (Gjykata Kushtetuese, 16 Tetor 2013).

Ilmi Rakovica v. Gjykata Qarkut në Prishtinë & Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 113/10 (Gjykata Kushtetuese, 3 nëntor 2011).

Isni Thaçi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 116/13 (Gjykata Kushtetuese, 27 dhjetor 2013).

Jashar Avdullahi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 56/13 (Gjykata Kushtetuese, 20 qershor 2013).

Jeton Salihu dhe Mentor Salihu v. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë & Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 13/11 (Gjykata Kushtetuese, 31 gusht 2012).

Jeton Sefer Kiqina v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Rasti nr. KI 43/11 (Gjykata Kushtetuese, 11 qershor 2012).

Kamer Hajdini v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI33/14 (Gjykata Kushtetuese, 31 mars 2014).

Kastriot Gerbeshi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 03/12 (Gjykata Kushtetuese, 31 tetor 2012).

Lalushe Boneshta v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 123/14 (Gjykata Kushtetuese, 9 dhjetor 2014).

Ljubiša Živić v. Gjykata Qarkut në Mitrovicë & Gjykata Komunale në Vushtrri. Rasti nr. KI 124/11 (Gjykata Kushtetuese, 21 nëntor 2012).

Luan Ramadani v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 31/14 (Gjykata Kushtetuese, 3 korrik 2014).

Lukë Kuzhnini v. Gjykata e Apelit. Rasti nr. KI 149/13 (Gjykata Kushtetuese, 5 dhjetor 2013).

Lumni Limaj v. Ministria e Drejtësisë. Rasti nr. KI 90/13 (Gjykata Kushtetuese, 20 janar 2014).

Lutfi Dervishi v. Gjykata Qarkut në Prishtinë. Rasti nr. KI 80/11 (Gjykata Kushtetuese, 12 dhjetor 2011).

Mark Duhanaj v. Gjykata Qarkut në Pejë & Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 19/13 (Gjykata Kushtetuese, 12 mars 2013).

Mehdi Faik Fazliu v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 31/09, (Gjykata Kushtetuese, 11 maj 2010)

Miftar Krasniqi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 38/13 (Gjykata Kushtetuese, 15 maj 2013).

Muhamet Bucaliu v. Prokurori shtetit. Rasti nr. KI 92/11 (Gjykata Kushtetuese, 12 dhjetor 2011).

Mustafë Xhekaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 54/12 (Gjykata Kushtetuese, 11 mars 2014).

Myrteza Dyla v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 108/11 (Gjykata Kushtetuese, 4 maj 2012).

Nazmi Mustafi v. Gjykata e Apelit. Rasti nr. KI 88/13 (Gjykata Kushtetuese, 22 tetor 2013).

Neki Myha dhe Nijazi Xharavina v. Gjykata e Qarkut në Pejë. Rasti nr. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11 (Gjykata Kushtetuese, 20 mars 2012).

Nexhat Ramadani v. Gjykata e Qarkut Gjilan dhe Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 10/11 (Gjykata Kushtetuese, 17 janar 2012).

Petrit Morina v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 20/09 (Gjykata Kushtetuese, 19 tetor 2010).

Predrag Đorđević v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 163/11 (Gjykata Kushtetuese, 13 korrik 2010).

Prend Prenkpalaj v. Gjykata Komunale Prizren. Rasti nr. KI 158/13 (Gjykata Kushtetuese, 3 janar 2014).

Raim Gashi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 80/13 (Gjykata Kushtetuese, 18 tetor 2013).

Rifat Osmani v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 20/13 (Gjykata Kushtetuese, 12 mars 2013).

Sali Shala v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 35/13 (Gjykata Kushtetuese, 17 qershor 2013).

Sami Sekiraqa v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut. Rasti nr. KI 16/09 (Gjykata Kushtetuese, 23 qershor 2010).

Selam Shoshaj dhe Bashkim Krasniqi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 43/13 (Gjykata Kushtetuese, 17 tetor 2013).

Selim Krasniqi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 111/11 (Gjykata Kushtetuese, 20 mars 2012).

Shefqet Berisha v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 31/17 (Gjykata Kushtetuese, 14 qershor 2017).

Shkelqim Devolli Blerim Devolli, Ismet Bojku v. Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Rasti nr. KI 56/12 (Gjykata Kushtetuese, 19 shtator 2012).

Shkumbin Mehmeti v. Gjykata Supreme & Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Rasti nr. KI 145/11, (Gjykata Kushtetuese, 2012).

Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A. v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 10/14 (Gjykata Kushtetuese, 26 qershor 2014).

Shpejtim Ademaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 137/14 (Gjykata Kushtetuese, 21 janar 2015).

Shpresim Uka dhe Bekim Syla v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 10/15 & KI 12/15 (Gjykata Kushtetuese, 4 korrik 2016).

Sokol Mushkolaj v. Gjykata Supreme, Gjykata e Qarkut në Prishtinë & Gjykata Komunale në Prishtinë. Rasti nr. KI 22/13 (Gjykata Kushtetuese, 10 qershor 2013).

Tahir Bytyqi v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 97/13 (Gjykata Kushtetuese, 16 tetor 2013).

Valbona Zogaj v. Gjykata Supreme dhe Gjykata e Qarkut në Prizren. Rasti nr. KI 21/11 (Gjykata Kushtetuese, 03.07.2012).

Valon Bislimi v. Ministria e Punëve të Brendshme, KGJK dhe Ministria e Drejtësisë. Rasti nr. KI 06/10 (Gjykata Kushtetuese, 30 tetor 2010).

Valon Haskaj v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 40/14 (Gjykata Kushtetuese, 26 qershor 2014).

Vladimir Ukaj v. Gjykata Supreme Rasti nr. KI 26/11, dt. 25 nëntor 2011

Zahir Hasani v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 04/13 (Gjykata Kushtetuese, 24 maj 2013).

Zyfer Sahitolli v. Gjykata Supreme. Rasti nr. KI 59/11 (Gjykata Kushtetuese, 9 mars 2012)

2. Vendime të GJEDNJ-së

Anakomba Yula v. Belgjika. Aplikacioni nr. 45413/07 (GJEDNJ, 10 mars 2009).

Allenet De Ribemont v. Franca. Aplikacioni nr. 15175/89 (GJEDNJ, 10 shkurt 1995).

Birutis dhe të tjerët v. Lituania. Aplikacioni nr. 47698/99 dhe 48115/99 (GJEDNJ, 28 mars 2002).

Bochan v. Ukrahina. Aplikacioni nr. 22251/08 (GJEDNJ, 5 Shkurt 2015).

Buchholz v. Gjermania. Aplikacioni nr. 7759/77 (GJEDNJ, 6 maj 1981).

Bunkate v. Holanda. Aplikacioni nr. 13645/88 (GJEDNJ, 26 maj 1993).

Campell dhe Fell v. Britania e Madhe. Aplikacioni nr. 7819/77 & 7878/77 (GJEDNJ, 28 qershor 1984).

Edwards v. Britania e Madhe. Aplikacioni nr. 13071/87 (GJEDNJ, 10 korrik 1991).

Fatullayev v. Azerbajxhani. Aplikacioni nr. 409884/07 (GJEDNJ, 22 prill 2010).

Funke v. Franca. Aplikacioni nr. 10828/84 (GEJDNJ, 25 shkurt 1993).

Gjonboçari dhe të tjerë v. Shqipëria. Aplikacioni nr. 10508/02 (GJEDNJ, 31 mars 2008).

Gurepka v. Ukrahina. Aplikacioni nr. 61406/00 (GJEDNJ, 6 dhtator 2005).

Hadjianastassiou v. Greqia. Aplikacioni nr. 2945/87 (GJEDNJ, 16 dhjetor 1992).

Hermi v. Italia. Aplikacioni nr. 18114/02 (GJEDNJ, 18 tetor 2006).

Kamasinski v. Austria. Aplikacioni nr. 9783/82 (GJEDNJ, 19 dhjetor 1989).

Krčmář dhe të tjerët v. Republika Çeke. Aplikacioni nr. 35376/97 (GJEDNJ, 3 mars 2000).

Kyprianou v. Qipro. Aplikacioni nr. 73797/01 (GJEDNJ, 15 dhjetor 2005).

M.S.S. v. Belgjikës dhe Greqisë. Rasti nr. 30696/09 (GJEDNJ, 21 janar 2011).

Mc Farlane v. Irlanda. Aplikacioni nr. 31333/06 (GJEDNJ, 10 shtator 2010).

Öcalan v. Turqia. Aplikacioni nr. 46221/99 (GJEDNJ, 12 maj 2005).

Pélissier and Sassi v. Franca. Aplikacioni nr. 25444/94 (GJEDNJ, 25 mars 1999).

Pretto dhe të tjerë v. Italia. Aplikacioni nr. 7984/77 (GJEDNJ, 8 dhjetor 1983).

Raza v. Bullgaria. Aplikacioni nr. 31465/08 (GJEDNJ, 11 shkurt 2010).

Salduz v. Turqia. Aplikacioni nr. 36391/02 (GJEDNJ, 27 nëntor 2008).

Sejdinovic v. Italia. Aplikacioni nr. 56581/00 (GJEDNJ, 1 mars 2006).

Grayson & Barnham v. Britania e Madhe. Aplikacioni nr. 19955/05 dhe 15085/06 (GJEDNJ, 23 shtator 2008).

T.v. Britania e Madhe. Aplikacioni nr. 24724/94 (GJEDNJ, 16 dhjetor 1999).

Tarlac Ignatius Connolly v. Britania e Madhe. Aplikacioni nr. 27245/95 (GJEDNJ, 26 qershor 1996).

Teixeira De Castro v. Portugalia. Aplikacioni nr. 44/1997/828/1034 (GJEDNJ, 9 qershor 1998).

Telfner v. Austria. Aplikacioni nr. 33501/96 (GJEDNJ, 20 shkurt 2001).

Tomasi v. Franca. Aplikacioni nr. 12850/87 (GJEDNJ, 27 gusht 1992).

3. Gjykata Penale për Krimet e Kryera në ish-Jugosllavi (TPNJ)

Prokurori v. Limaj et al., Aktgjykimi: LT-03-66-A, TPNJ, 27 shtator 2007

Prokurori v. Milutinovic et.al, Aktgjykimi: IT-05-87-T, TPNJ, 26 shkurt 2009

A

Actio popularis.....252
Akte ligjore.....33, 38
Ankesat kushtetuese 250
Ankesë 220
Autoritet subsidiar.....249

B

Barazia e armëve 7, 201, 202, 203, 204, 207, 208, 209, 210
Barra e përgjithshme 189
Beneficium Cohaesionis.....231

D

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut11, 31, 48, 52, 127, 281
Dënim 49, 135, 157, 244, 260
Dëshmitar bashkëpunues 7, 197
Drejtësia procedurale 21, 22, 68
Dëshmitarët kundër tij 32

E

E drejta e apelimit.....38
E drejta e lirisë 41, 247, 275
E drejta e përdorimit të mjeteve efektive juridike ..33
E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare 247
E paanshme 23, 26, 31, 32, 34, 41, 46, 108, 109, 112, 129, 221, 282
E të drejtës për gjykim të drejtë 23, 24, 25, 31, 37, 40, 115, 205, 221, 225, 255, 259, 275, 276, 277

G

GJEDNJ 11, 24, 38, 40, 68, 91, 100, 109, 121, 122, 128, 138, 139, 140, 146, 148, 149, 150, 154, 155, 161, 164, 166, 167, 172, 173, 175, 176, 177, 178, 184, 190, 193, 202, 206, 213, 221, 230, 234, 235, 236, 246, 254, 281, 283, 286 8, 23, 24, 27, 37, 38, 41, 68, 109, 110, 120, 150, 164, 177, 178, 201, 230, 245, 246, 254, 281, 283, 285, 286, 287, 289, 290, 291, 305
GJNP.....11, 63, 64, 65, 66, 68
Gjykata e Apelit 115, 116, 120, 145, 226, 227, 228, 229, 230, 236, 237, 249
Gjykata e Vjetër e Londrës.....29
Gjykata Kushtetuese 25, 38, 99, 109, 112, 122, 124, 125, 178, 192, 203, 238, 245, 246, 249, 250, 253, 254, 256, 257, 258, 259, 260, 279, 286, 18, 19, 192, 236, 238, 245, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 287
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë 25
Gjykata më e lartë 38
Gjykata Supreme 109, 115, 116, 199, 203, 214, 227, 249, 260, 261, 286
Gjykatë e pavarur 12, 14, 15, 17, 23, 26, 34, 41, 57, 71, 72, 74, 86, 108, 129, 136, 137, 271, 272, 282
22, 29, 30, 35, 214, 217, 243, 244, 258, 271
Gjykim i drejtë 14, 17, 18, 19, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 30, 31, 34, 37, 39, 40, 43, 48, 52, 53, 56, 58, 62, 64, 65, 67, 68, 121, 127, 128, 129, 137, 141, 152,

160, 181, 186, 187, 189, 193, 212, 214, 219, 221, 222, 225, 226, 229, 230, 232, 240, 241, 243, 244, 245,246, 247, 249, 250, 252, 254, 257, 258, 259, 260, 261, 272, 273, 274, 275, 276, 278, 279, 280, 281, 287, 288, 22, 29, 30, 35, 214, 217, 243, 244, 258, 271

H

Hetimi i krimeve 61

I

I paligjshëm.....241
Imuniteti 97, 98, 99, 282
In dubio pro reo.....19, 65, 191, 192, 205, 286
Institucion i përkohshëm 61
Inter alia48, 117, 156, 179, 192, 195, 213, 214, 257, 277
Ish-Jugosllavi.....61
Ius cogens 18, 42, 242

J

Juridiksioni i gjykatës 38

K

Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve.....41
KEDNJ 11, 24, 25, 27, 31, 44, 74, 89, 109, 119, 121, 122, 123, 132, 133, 136, 140, 147, 148, 150, 155, 156, 161, 167, 172, 173, 175, 178, 186, 190, 193, 202, 207, 214, 216, 217, 218, 221, 223, 225, 226, 228, 230, 232, 233, 234, 235, 236, 242, 243, 244, 246, 247, 249, 258, 259, 260, 274, 281, 283, 284, 287, 288, 38, 108, 114, 128, 152, 169, 190, 203, 245, 280,
Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian 92, 282
KGJK 11, 75, 76, 77, 78, 82, 83, 84, 85, 88, 101, 102, 104, 117, 135, 170, 279, 282, 38, 74, 101, 105, 123, 12, 75, 76, 77, 78, 82, 83, 84, 85, 89, 91, 102, 105, 117, 123, 124, 236, 238, 282, 289
Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë 94
Kodi i Hamurabit.....28
Kodi Penal i Kosovës 173, 252
Kohë e përshtatshme.....36
Komisioni për të drejtat e Njeriut,.....36
Kontradiktoriteti 25, 37, 130, 155, 203, 204, 207, 210, 215, 242
Kontroll i kushtetutshmërisë 256
Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese 30, 281
KPP, 5, 7, 11, 14, 96, 97, 117, 118, 119, 120, 122, 123, 125, 126, 127, 139, 141, 142, 143, 145, 146, 147, 149, 150, 151, 153, 154, 155, 156, 157, 159, 161, 162, 165, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 179, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 203, 208, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 234, 235, 236, 237, 241, 242, 243, 244, 246, 247, 248, 249, 251, 252, 254, 256, 273, 276, 289, 301, 305, 306, 307, 309, 310
Kur'ani,.....28
Kushtetuta e Kosovës 31, 37, 74, 75, 89, 94, 95, 97, 99, 123, 129, 156, 169, 199, 207, 236, 237, 249

L

Ligj.....220
Liria e asociimit.....93
Liria e asociimit.....95
Liria e shprehjes.....93, 282

M

Magna Carta 28
Magna Karta e Gjyqtarëve 70, 73, 84, 87, 90, 96, 97, 101, 283
Mjete juridike 33, 220

N

Ndalimi i personave.....146

O

OKB11, 42, 48, 49, 53, 56, 61, 62, 63, 64, 73, 114, 118, 167, 273, 276, 281

P

PDCP, 3, 11, 14, 16, 26, 29, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 46, 56, 59, 64, 77, 80, 101, 117, 124, 128, 129, 138, 148, 158, 165, 170, 176, 184, 185, 190, 196, 204, 210, 220, 223, 235, 239, 242, 247, 251, 253, 254, 292, 295, 298, 303, 306, 307, 310, 311
I Pandehuri 22, 23, 24, 25, 33, 36, 40, 41, 42, 43, 52, 53, 56, 59, 60, 62, 64, 65, 67, 68, 74, 107, 108, 110, 111, 115, 122, 128, 129, 130, 133, 137, 138, 139, 140, 142, 145, 146, 149, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 187, 189, 190, 191, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 217, 223, 224, 225, 226, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 236, 237, 241, 242, 243, 244, 247, 250, 252, 254, 258, 259, 260, 276, 277, 279, 282, 283, 284, 285, 286, 287
Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit.....11, 90
Parimet e Bangalorit për Sjellje Gjyqësore 80, 94
Pavarësi e brendshme 87
Pavarësi e jashtme.....87
Pavarësia e gjyqtarëve.....86, 87
PDCP 11, 14, 24, 27, 30, 31, 32, 33, 51, 59, 74, 93, 108, 114, 119, 136, 146, 152, 156, 162, 169, 170, 175, 193, 203, 216, 221, 223, 228, 232, 233, 234, 270, 273, 276, 281, 283, 284, 287, 288
Policia 99, 196, 244
Pranueshmëria e kërkesës.....251, 258, 259
Prezumimi i pafajësisë 35, 156, 186, 187, 189, 199, 286, 25, 50, 190, 200, 46, 186, 147, 186, 189, 190, 191, 193, 195, 199, 200, 201, 35, 186
Prima facie.....238, 242, 256, 257
Prokuroria 36, 57, 98, 147, 161, 163, 203, 215, 216, 225, 286
Provat e papranueshme 240, 242, 245
Publiku 109, 112, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 189, 218, 284

R

Ratione materiae 251
Ratione personae.....251
Ratione temporis251, 253, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 270

Reformatio in peius 205, 231, 232
Res judicata.....257, 228
Restitution in integrum.....253

S

Shterimi i mjeteve juridike 253
Shteti aderues.....33
Sistemi akuzator 28
Sistemi i përzier 28
Sistemi inkuizitor 28
Subjekti kërkues.....252

T

Të akuzuarit 220
Të drejtat minimale 27, 35, 40
TPNJ 11, 58, 59, 60, 61, 62, 67, 159, 180, 191, 222, 225
Tribunali i Hagës 61

U

Ultra petitum 228, 257

V

Vendim gjyqësor.....220
Vepër penale 38
Vepra të lehta 38
Viktimë.....119, 209, 255, 256

A

Albers 79, 82

Amann 69, 70

Ambos 64

Anastasi 28

Appiagyei-Atua 45

Aquilina 139

Ashworth 24

B

Barton, ... 141

Bonomy 173

Brick 173

C

Campbell 236

Çani 28

Corstens 26, 131, 132, 165, 166, 168, 178, 188, 191, 210, 219, 236

Croquet 70, 74

D

Dias 39, 40, 53

E

EI-Obaid 45

F

Field 31

Funk 228

G

Gamble 39, 40, 53

George 69, 213, 215

Giannoulopoulos 176

Ginther 49

Gray 209

Gruda 42, 61

H

Hajiyev 275, 280

Harby 206, 219

Heydon 211

Higgins 68

Hunt 69

K

Kelly 218

Kempen 22, 27, 31, 210, 261

Korf 25

Krapac 23, 27, 220, 221, 228

L

Lamoen 275, 277

Langford 31

M

Marshall 37, 43, 44, 238
Martines.....76
Meese.....260, 261
Mole 206, 219
Morina.....41, 275, 277, 284, 286, 288
Morris.....69
Murati 10, 22, 30, 53, 98, 116, 122, 123, 140, 153, 167, 171, 198, 207, 218, 219, 222, 242, 248, 251, 252, 268, 279
Murphy.....261
Mushkolaj.....275, 277, 289

N

Natalya Clark 63
Ņesterova.....24

P

Pradel 26, 131, 132, 165, 166, 168, 178, 188, 191, 210, 219, 236

Q

Quick 138

R

Redmayne 24

S

Sahiti 30, 53, 98, 116, 122, 123, 140, 153, 167, 171, 198, 218, 219, 230, 242, 248, 251, 252, 279
Sellers.....69, 70
Shapiro.....137
Simons 144

T

Trechsel.....23, 80, 222, 280

V

Vermeulen 26, 131, 132, 165, 166, 168, 178, 188, 191, 210, 219, 236
Voermans.....79, 82
Vorpsi.....239, 271

W

Warbrick 66
Widder 31, 41

Y

Yanev, ...155, 160

Z

Zaganjori 28